# BIRËSIMI I TË MITURVE NËN DRITËN E ZHVILLIMEVE TË REJA NË SHQIPËRI DHE EUROPË

Eugena BISHA

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Juridike, me profil "E drejtë civile", për marrjen e gradës shkencore "Doktor"

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA (CANAJ)

Numri i fjalëve: 58579

Tiranë, mars 2017

## Deklarata e autorësisë

Ky punim është një kërkim individual sipas kritereve akademike dhe shkencore. Ai nuk është botuar asnjeherë më parë i tëri dhe nuk përmban materiale të shkruara apo publikuara nga persona të tjerë, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

©Eugena BISHA

# Abstrakti

*Ky disertacion trajton një ndër çështjet më delikate që kanë të bëjnë me fëmijët, birësimin. Punimi fokusohet kryesisht në evidentimin e mangësive dhe problematikave më kritike që lidhen me kuadrin normativ të institutit të birësimit në Shqipëri, duke e parë dhe në aspektin krahasimor me disa vende të BE-së, si Austria, Franca dhe Italia.*

*Çështja e birësimit të fëmijëve ka qënë në qendër të debateve politike, shoqërore dhe të doktrinës ndër vite. Birësimi është një e drejtë për fëmijën, i cili ka nevojë për figurë prindërore permanente, në rastet kur atij i mungon ajo. Aftësia e prindërve për të birësuar nuk duhet të kufizohet vetem nga nocioni ligjor, por duhen marrë parasysh edhe elementet social dhe etik.*

*Në Shqipëri këtij instituti i është kushtuar shumë pak vëmendje si në aspektin e studimeve akademike, ashtu edhe në hartimin e raporteve mbi problematikat e zbatimit në praktikë të dispozitave ligjore që rregullojnë birësimin e të miturve.*

*Ndoshta është e vështirë të gjendet "familja perfekte" për një fëmijë, por nëpërmjet birësimit, synohet që një fëmije t'i sigurohet një familje e pershtatshme dhe që në ambjentin e saj familjar nuk i cënohen të drejtat e garantuara me ligj. Në shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me të drejtat dhe mirëqënien e fëmijëve, pranohet se për ruajtjen e këtyre të drejtave, në rastet e fëmijëve jetim, të braktisur apo pa një mjedis të rregullt familjar, si ndër zgjidhjet më të mira e të mundshme është birësimi.*

*Fjalët kyçe: birësim, fëmijë, interesi më i lartë i fëmijës, prindër birësues/biologjik*

# Abstract

*This dissertation addresses one of the most sensitive issues relating to children- adoption. The paper focuses primarily on the identification of the most critical issues related to the legal framework of the adoption institution in Albania, viewing also in comparative aspect with some EU countries, such as Austria, France and Italy.*

*The issue of children adoption has been at the center of political debates, social and doctrine over the years. Adoption is a right for the child who needs a permanent parental figure when he lacks it. The ability of parents to adopt should not be limited only by the notion of law, but must also consider social and ethical elements.*

*In Albania, to this Institute has been paid little attention in terms of academic studies, as well as compiling reports on issues of practical implementation of the legal provisions governing the adoption of minors.*

*Perhaps it is difficult to find "the perfect family" for a child, but through adoption, a child is aimed to ensure an appropriate family and that family environment is not adversely affected its rights guaranteed by law. In most of the international conventions relating to the rights and welfare of children, it is recognized that maintaining these rights, in the case of orphans, abandoned or without a good family environment, as one of the best solutions possible is adoption.*

*Key words: adoption, children, best interest of the child, biological/adoptive parents*

*Familjes time!*

# Falenderime

*Një falenderim i veçantë dhe i sinqertë shkon për udhëheqësen time akademike dhe profesionale Prof.as.Dr. Erjona CANAJ, e cila më ka ndihmuar dhe mbështetur me këshillat profesionale për realizimin e këtij kërkimi shkencor.*

*Mirënjohje e veçantë për Prof.as.Dr. Juelda LAMÇE, për ndihmen e pakursyer dhe udhëzimet e nevojshme gjatë realizimit të këtij punimi.*

*Gjithashtu një falenderim i posaçëm shkon për Mag. Dr. Thomas SCHODITSCH, profesor në fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Karl-Franzens, Graz (Austri), për udhëheqjen, sygjerimet dhe mbështetjen e dhënë gjatë periudhës kërkimore në këtë fakultet.*

*Falenderime të përzemerta shkojnë për familjen time për mirëkuptimin, motivimin, mbështetjen emocionale gjatë gjithë kësaj periudhe.*

*Mirënjohje!*

## Lista e tabelave dhe grafikëve

Fig.1- dallimi ndërmjet adoptio dhe adrogatio në të drejtën romake....................................42

Fig.2- birësimi në vendet arabe para dhe pas zbritjes së Kuran...........................................47

Graf.1- birësimet ndërvendase të realizuara nga 2005-2015................................................95

Tab.1- birësimet ndërvendase të realizuara ndërmjet Shqipërisë dhe disa shteteve 2005-2009...........................................................................................................................149

Tab.2- birësimet ndërvendase të realizuara në 2013.........................................................151

Tab.3- birësimet ndërvendase të realizuara në 2014.........................................................153

Tab.4- birësimet ndërvendase të realizuara në 2015.........................................................154

Tab.5- birësimet e realizuara në Shqipëri në 2015............................................................141

Tab.7- birësimet e realizuara në Shqipëri në 2014.............................................................143

## Lista e akronimeve dhe shkurtimeve

| | |
|---|---|
| **AP** | Avokati i Popullit |
| **BE** | Bashkimi Europian |
| **GJED** | Gjykata Europiane e Drejtësisë |
| **GJEDNJ** | Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut |
| **GJL** | Gjykata e Lartë e Republikes së Shqipërisë |
| **ILF** | Interesi më i lartë i fëmijës |
| **IPSHRF** | Institucionet e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijë |
| **ISSH** | Instituti i Sigurimeve Shoqërore |
| **KC** | Kodi Civil |
| **KDF** | Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës |
| **KEB** | Konventa Europiane mbi Birësimin |
| **KEDNJ** | Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut |
| **KE** | Komisioni Europian |
| **KF** | Kodi i Familjes |
| **KiE** | Këshilli i Europes |
| **KNDCP** | Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike |
| **KP** | Kodi Penal |
| **KPrC** | Kodi i Procedurës Civile |
| **KSHB** | Komiteti Shqiptar i Birësimeve |
| **LFK** | Ligji i Familjes i Kosoves |
| **LIGJI 9695** | Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10358, datë 16.12.2010 dhe nr. 132/2015, datë 5.12.2015) |

| | |
|---|---|
| **MMSR** | Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë |
| **OJF** | Organizata jofitimprurëse |
| **OKB** | Organizata e Kombeve të Bashkuara |
| **RSH** | Republika e Shqipërisë |
| **SHF** | Shtëpia e fëmijës |
| **SHSSH** | Sherbimi Social Shtetëror |
| **UNCRC** | Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve |
| **UNICEF** | Fondi për fëmijët i OKB-së |
| **VKM** | Vendim i Këshillit të Ministrave |

## Fjalorth terminologjik

1. **“Agjenci ndërmjetësuese”** -janë organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, të liçencuara për të bërë ndërmjetësimin e birësimit sipas rregullimeve të KF dhe Ligjit mbi Procedurat e Birësimit.
2. **“Birësim”-** është vendosja e fëmijës në një familje tjetër, me të drejta dhe detyrime të njëjta me fëmijët biologjik
3. **“Birësues”-** është personi/personat që marrin një fëmijë, të privuar ose jo nga mjedisi familjar, duke e trajtuar *de jure* dhe *de facto* si fëmijë të lindur prej tyre.
4. **“Familja biologjike”-** përfshin prindin/prindërit biologjik të fëmijës.
5. **“Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut”-** gjykatë ndërkombëtare , e cila bën interpretimin dhe zbatimin e KEDNJ-së. Konventa i jep GJEDNJ-së kompetencën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
6. **“I/e birësuar”** -është fëmija i cili vendoset në një familje tjetër nga ajo biologjike, për t’u rritur dhe edukuar nga birësuesit, si të ishte fëmija i tyre biologjik.
7. **“Jetim biologjik”-** fëmijë, prindërit e të cilit kanë vdekur
8. **“Jetim social”-** fëmijë i braktisur nga familja biologjike
9. **“Jetim”**- kuptohet fëmija pa prindër, deri në moshën 25 vjeç, sipas përcaktimit të bërë në statusin e jetimit
10. **“Kafala”-** Kafala është angazhimi për të marrë përsipër me dëshirë mirëmbajtjen, edukimin dhe mbrojtjen e një fëmije minoren, njësoj siç do bënte babai për fëmijët e tij
11. **“Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut”-** është një instrument i Këshillit të Europes, dizenjuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit.

12. **“Kujdes alternativ”-** kur një familje për arsye të ndryshme nuk mund t’i ofrojë fëmijës kujdesin e duhur dhe kushtet e domosdoshme për rritjen dhe edukimin e tij, shteti është përgjegjës për t’i siguruar atij një kujdes alternativ.
13. **“Përgjegjësi prindërore”**- sipas KF-së, përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.
14. **“Prind”**- është personi/personat që kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy sëbashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese

# Përmbajtja e lëndës

**Deklarata e autorësisë**......2
**Abstrakti**......3
**Abstract**......4
**Falenderime**......6
**Lista e tabelave dhe grafikëve**......7
**Lista e akronimeve dhe shkurtimeve**......8
**Fjalorth terminologjik**......10
**KAPITULLI I: HYRJE**......15
**1.1 Qëllimi dhe rëndësia e punimit**......15
**1.2 Pyetjet kërkimore dhe Hipoteza**......16
**1.3 Kufizimet e punimit**......19
**1.4 Aspektet strukturore**......19
**KAPITULLI II-SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I PUNIMIT**......22
**2.1 Baza teorike e punimit**......22
**2.2 Debati doktrinar**......25
**2.3 Metodologjia dhe Metodat e kërkimit**......34
**KAPITULLI III-VËSHTRIM HISTORIK MBI BIRËSIMIN**......36
**3.1 Hyrje**......36
**3.2 Birësimi në Mesopotaminë e vjetër**......38
***3.2.1 Kodi i Hamurabit***......40
***3.2.2 Dokumentet Nuzi***......41
**3.3 Instituti i birësimit sipas të drejtës romake**......42
**3.4 Pikëpamjet e Bibles ndaj birësimit**......46
**3.5 Birësimi sipas Kuran dhe të drejtes islamike**......47
***3.5.1 Instituti i Kafala-së dhe mungesa konkrete e termit "birësim" në të drejtën islamike*……**......51
***3.5.2 Njohja e Kafala-së në vendet perëndimore***......54
**KAPITULLI IV-BIRËSIMI NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE**......58
**4.1 Hyrje**......58

**4.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar global mbi birësimin dhe të drejtat e fëmijëve** ........... 61

***4.2.1 Konveta e Hages për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Respekt të Birësimit Ndërvendas*** ........................................................................................... 61

***4.2.2 Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve*** ...................................................................... 64

***4.2.3 Konveta e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës*** ............................................................ 65

***4.2.4 Konventa e Hages 1996 "Mbi marrëdhëniet me fëmijën"*** ..................................... 68

***4.2.5 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*** ........................................................ 69

***4.2.6 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*** .................................. 69

**4.3 Kuadri ligjor ndërkombëtar rajonal mbi birësimin dhe të drejtat e fëmijëve** .......... 70

***4.3.1 Konventa Europiane për Birësimin e Fëmijëve 1967, ndryshimet që solli ajo në 2008…….*** ....................................................................................................... 71

***4.3.2 Konventa Europiane "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"*** ............................ 80

***4.3.3 Familja dhe birësimi, nocioni i "jetës familjare" sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*** ........................................................................................... 81

***4.3.4 Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut*** ........................................................ 85

***4.3.5 Karta Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqënien e Fëmijës*** ...................................... 86

**KAPITULLI V- KUPTIMI DHE RREGULLIMI I INSTITUTIT TË BIRËSIMIT SIPAS LEGJISLACIONEVE TË DISA VENDEVE TË BE-së** .......................................................... 87

**5.1 Hyrje** ........................................................................................................................ 87

**5.2 Birësimi në disa vende të Bashkimit Europian** .......................................................... 92

**5.3 Austria** ..................................................................................................................... 94

**5.4 Franca** .................................................................................................................... 102

**5.5 Italia** ...................................................................................................................... 105

**KAPITULLI VI- ANALIZË E KUADRIT NORMATIV MBI TË DREJTEN E BIRËSIMIT NË SHQIPËRI** ................................................................................................................ 115

**6.1 Hyrje** ...................................................................................................................... 115

**6.2 Prindërit birësues dhe biologjik; roli dhe legjitimimi i tyre në procedurat e birësimit…** ................................................................................................................ 118

***6.2.1 Birësimi me pëlqim nga ana e prindërve*** ............................................................ 120

***6.2.2 Forma ligjore e shprehjes së vullnetit të prindërve biologjik për birësim*** ........... 121

***6.2.3 Diferenca e moshës ndërmjet prindit birësues dhe të birësuarit*** ......................... 122

**6.3 Të miturit që legjitimohen për t'u birësuar** ............................................................. 125

**6.4 Procedurat e birësimit** ........ 127
*6.4.1 Procedura administrative* ........ 127
*6.4.2 Procedura gjyqësore* ........ 130
**6.5 Të drejtat e fëmijës të lindura pas birësimit** ........ 131
**6.6 Kuadri normativ mbi të drejtat e fëmijëve** ........ 133
**6.7 Statistikat e birësimeve të realizuara nga 2010-2015** ........ 140
**6.8 Birësimi ndërvendas në Shqipëri** ........ 143
*6.9 Statistikat të birësimeve ndërvendase* ........ 149
**KAPITULLI VII- QASJET BASHKOHORE DHE PROBLEMATIKAT E INSTITUTIT TË BIRËSIMIT** ........ 156
**7.1 Doktrina "Interesi më i lartë i fëmijës"** ........ 156
**7.2 Birësimi i personave madhorë** ........ 164
**7.3 Birësimi i të miturve nga persona homoseksual** ........ 168
*7.3.1 Çiftet homoseksuale në Shqipëri dhe lidhja e tyre me birësimin* ........ 172
*7.3.2 Birësimi nga çiftet e të njejtit seks sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së* ........ 174
**7.4 Braktisja e fëmijës nga prindërit birësues** ........ 176
**7.5 Revokimi dhe pavlefshmëria e birësimit** ........ 178
**7.6 Sekreti i origjinës, e drejta për konfidencialitet dhe privatësi përballë të drejtës për të njohur origjinën** ........ 181
**7.7 Birësimi ndërvendas** ........ 184
*7.7.1 Problematikat e birësimit ndërvendas; trafikimi i fëmijëve* ........ 189
**7.8 Vendosja e fëmijës në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijë……** ........ 193
*7.8.1 Problematikat në IPSHRF-ve, dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve në këto institucione…………* ........ 201
**KAPITULLI VIII- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME** ........ 209
**KONKLUZIONE** ........ 209
**REKOMANDIME** ........ 213
**BIBLIOGRAFIA** ........ 217

# KAPITULLI I: HYRJE

## 1.1 Qëllimi dhe rëndësia e punimit

Ky punim ka për qëllim studimin dhe hulumtimin në fushën e birësimit në kushtet e një mungese të theksuar të doktrinës shqiptare në lidhje me birësimin e të miturve dhe rregullimin ligjor të këtij instituti në Shqipëri dhe në aspektin krahasimor me disa vende Europiane.

Në këtë punim synojmë të shqyrtojmë dhe interpretojmë problematikat kryesore që shfaqen kryesisht gjatë procedurave administrative dhe gjyqësore të birësimit, por edhe pas tij dhe hartimi i rekomandimeve për të ngritur një kuadër ligjor e institucional më efikas.

Gjykojmë se, studimi dhe thellimi dhe përmirësimi i njohurive në këtë fushë, nga pikëpamja teorike dhe praktike, do të ndihmonte organet kompetente dhe gjykatat në vendimet e tyre në lidhje me birësimet vendase dhe ndërvendase.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të trajtojmë edhe aspektin ligjor mbi mundësinë e birësimit të të miturve nga persona homoseksual, indentifikimin e çështjeve më kritike që lidhen me të dhe debatet e vazhdueshme mbi përbërjen e familjes, pasi gjithmonë e më shumë persona single synojnë të birësojnë fëmijë, ndaj është shumë e rëndësishme për të qartësuar kriteret që duhet të merren parasysh në vendimet gjyqësore për birësim. Panvarësisht kohës në të cilën jetojmë, vëme re se shoqëria jonë është akoma konservatore kundrejt këtij fenomeni.

Me anë të këtij punimi, nuk synojmë të shterojmë të gjitha problematikat që paraqet tema, por është me rëndësi që kjo temë të jetë pikënisja e nxitjes së debateve, hartimit të

rekomandimeve të efektshme, vetem atëherë gjykatat do të jenë në gjendje të marrin vendime të qarta për birësimet në fjalë.

Urojmë që nëpërmjet këtij punimi shkenor të kontribuojmë sadopak në çështjet që lidhen me këtë tematikë kaq delikate dhe të rëndësishme, siç është birësimi i të miturve.

## 1.2 Pyetjet kërkimore dhe Hipoteza

**Hipoteza:** Kuadri normativ në lidhje me birësimin dhe procedurat që ndiqen për të birësuar një fëmijë, është i paplotë, me mangësi apo i paqartë për t'u dhënë zgjidhje disa problematikave aktuale, të tilla si:

- *Braktisja e fëmijës nga prindërit birësues dhe birësimi i ri* - Në KF-në dhe në ligjin nr. 9695, nuk ka asnjë dispozitë specifike që parashikon braktisjen e fëmijës nga prindërit birësues. Sipas dispozitave në fuqi, fëmija i braktisur nga prindërit birësues nuk legjitimohet të birësohet (për herë të dytë) nga një familje tjetër dhe më e mundshmja është ri-institucionalizimi i tij/saj në IPSHRF, sesa gjetja e një familje kujdestare. Kufizimi ligjor i birësimit të ri, krijon një të ardhme jo-stabël për fëmijën shpeshherë jo në interesin më të lartë të tij.
- *Revokimi i birësimit*- Kodi ynë i familjes dhe ligji 9695, e përcaktojnë birësimin si një institut të parevokueshëm, duke mos e pranuar as për raste përjashtimore. Edhe në rrethana madhore, kur vihet në rrezik zhvillimin fizik, mendor emocional e shoqëror i fëmijës, apo edhe kur vertetohet se birësimi është bërë për qëllime përfitimi, shfytëzimi apo trafikimi nga ana e prindërve birësues, kjo marrëdhënie nuk revokohet dhe opsioni i vetëm është heqja e përgjegjësisë prindërore.

- *Pavlefshmëria e birësimit*- në bazë të legjislacionit shqiptar është nëse pavlefshmëria e veprimit juridik gjen zbatim edhe për institutin e birësimit
- *Mosha e birësuesit/birësuesve*- Kodi i Familjes nuk ka vendosur një kufi maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve. Mosvendosja e nje kufiri tavan lejon krijimin e marrëdhënieve birësuese prind-fëmijë të ngjashëm me marrëdhënien natyrale gjysh/e-nip/mbesë.
- *Mosha e lejuar për jetimet të cilët strehohen në institucionet rezidenciale*- Kuadri normativ nuk është i qartë dhe shpeshherë konfuz përsa i përket moshës maksimale deri kur mund të qëndrojë një i mitur në këto institucione.
- *Mosnjohja në Shqipëri e birësimit në moshë madhore i kryer në një shtet tjeter*- mos dhënia e fuqisë ekzekutive e vendimeve të gjykatave të huaja që miratojnë birësimin e personave madhorë, sjell disa problematika ligjore që lidhen me veprime të ndryshme juridike.

**Pyetjet e hulumtimit** janë shumë të rëndësishme në një punim shkencor duke qënë se ato i japin një drejtim hulumtimit dhe vënë në pah qëllimin e punimit. Ky punim shkencor merr përsipër t'i përgjigjet disa pyetjeve kërkimore të rëndësishme si më poshtë:

a) A është plotësisht i përshtatshëm rregullimi juridik aktual që bën ligji për birësimet në Republikën e Shqipërisë, krahasuar dhe me legjislacionet e disa vendeve të tjera?
b) A duhet të hiqet kufiri i moshës së të birësuarit, po për birësuesin a duhet të vendoset një kufi moshe? A duhet të vendoset një kufi maksimal i moshës së prindit birësues me qëllim për të shmangur diferencen e madhe të moshës ndërmjet të birësuarit dhe birësuesit?

c) Birësimi i fëmijëve nga prindër homoseksual duhet të bazohet mbi interesin më të lartë të fëmijës apo në mosdiskriminimin e këtyre personave për shkak të orientimit tyre seksual?

d) A është e drejtë për fëmijën të privohet nga figura e nënës apo babait?

e) Gjykata, në shqyrtimin e çështjes së birësimit të një fëmije, për të vendosur se çfarë është më e mirë për fëmijën, duhet të bazohet së pari në lumturinë e fëmijës (në atë çfarë do fëmija), apo në aspekte të tjera si feja apo raca, kombësia, ose në gjendjen ekonomike të prindërve birësues? Cili ndër këto kritere është më i rëndësishëm për mirëqënien, mirërritjen dhe edukimin e një fëmije?

f) Në rastet e procedurave të birësimit të një fëmijë nga një çift që ka dhe fëmijë biologjik, interesi i cilit fëmijë duhet të prevalojë? A duhet të merret parasysh dhe dëshira e fëmijës biologjik nga gjykata në lidhje me birësimin e një vëllai apo motre?

g) A mund të kemi të drejtën e dy nënave ose dy baballarëve ligjërisht të njejtë, apo ato do konkurojnë kush do ketë përgjegjësinë prindërore?

h) Si duhet të veprohet nëse fëmija i birësuar braktiset nga prindërit birësues?

i) A duhet të parashikohet në dispozitat ligjore të institutit të birësimi dhe revokimi i tij?

j) A mund të kërkohet pavlefshmëria e një marrëdhënie birësimi? A gjejnë zbatim parimet e përgjithshme të pavlefshmërisë së veprimit juridik edhe për këtë institut?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe problematikave të birësimit në Shqipëri, janë analizuar në mënyrë të detajuar në këtë punim doktoral i cili është i hartuar në 7 krerë.

### 1.3 Kufizimet e punimit

Për trajtimin e kësaj teme kemi hasur në disa vështirësi të cilat shpesh herë ndikonin në ecurinë e punimit. Një ndër vështirësitë kryesore ishte karakteri etik dhe moral i temes e cila duhej parë përtej aspektit ligjor të saj dhe shpesh herë nën interpretime psikologjike, etike dhe sociale.

Një kufizim tjetër në punimin e këtij disertacioni ishte dhe mungesa e theksuar e literatures vendase të mirëfilltë në lidhje me të drejtën familjare dhe kryesisht me birësimin. Në bazë të kërkimeve individuale gjatë kësaj periudhe nuk më rezultojnë punime shkencore të mirëfillta në lidhje me birësimin. Vështirësi kishte dhe në gjetjen e vendimeve gjyqësore të gjykatave shqiptare, si pasojë e mos pasqyrimit tyre online.

Gjithashtu, mungesa e statistikave të përditësuara nga ana e Komitetit Shqiptar të Birësimit dhe nga Sherbimi Social Shtetëror ishte një vështirësi e shtuar për këtë punim. KSHB refuzonte vazhdimisht të jepte informacione të përgjithshme në lidhje me problematikat e hasura në praktikë.

### 1.4 Aspektet strukturore

Punimi është organizuar në disa kapituj dhe nënkapituj. Duke filluar nga kapitulli i dytë e në vazhdim, përveç trajtimeve teorike dhe analitike synohet t'u jepet përgjigje disa pyetjeve kërkimore të ngritura të cilat lidhen me aspekte dhe problematika të ndryshme të institutit të birësimit.

**Kapitulli I**, është një prezantim i strukturuar i punimit në aspektin metodologjik, duke shpjeguar metodologjinë dhe metodat mbi të cilat është udhëhequr ky punim; prezantim me qëllimin dhe rëndësine e tij, pyetjet kërkimore dhe hipotezën.

**Kapitulli II,** ndalet në një panoramë të përgjithshme të kuptimit të institutit të birësimit në kuadër të disiplinave të ndryshme, gjithashtu dhe në debatin doktrinar të vazhdueshëm që shoqëron këtë institut të rëndësishëm të së drejtës familjare.

**Kapitulli III**, paraqet një vështrim historik të evoluimit të institutit të birësimit që në lindjen e tij deri në ditët e sotme në vende të ndryshme, duke e parë dhe në aspektin krahasimor evoluimin e tij konceptual. Ky kapitull trajton dhe pikëpamjet e Bibles dhe Kuranit për birësimin.

**Kapitulli IV**, fokusohet tek kuadri ligjor ndërkombëtar, duke u ndalur dhe analizuar instrumentët më të rëndësishëm ndërkombëtar global dhe rajonal, që lidhen me birësimin e të miturve dhe të drejtat e tyre.

**Kapitulli V**, bën një analizë të kuadrit ligjor në fushën e birësimit të disa vendeve anëtare të BE-së, si Austria, Franca, Italia. Janë zgjedhur këto 3 shtete për shkak të veçantive në trajtimin e këtij instituti në legjislacionin e tyre, si shtete që njihen për risitë dhe qasjet bashkohore në konceptimin e birësimit të miturve.

**Kapitulli VI**, paraqet një trajtim të gjërë të institutit të birësimit sipas legjislacionit shqiptar në lidhje me efektet, procedurat administrative dhe gjyqësore, të drejtat dhe detyrimet e lindura nga vendosja e kësaj marrëdhënie si dhe bën evidentimin e problematikave të kuadrit normativ si dhe atyre në praktikë.

**Kapitulli VII**, ndalet qasjet bashkohore të institutit të birësimit në një hapësirë territoriale që përfshin jo vetem Shqipërinë, por edhe vendet e BE-së dhe SHBA-në. Ky kapitull analizon problematikat dhe debatet më bashkohore që kanë të bëjnë me birësimin e të miturve nga personat homoseksual. Gjithashtu, trajtohet çështja e fëmijëve pa përgjegjësi prindërore të vendosur në qendrat rezidenciale dhe problematikat më kritike me të cilat ato përballen, duke e parë në aspektin e rëndësisë që ka instituti i birësimit për këto fëmijë.

Në fund, në **kapitullin e VIII**, bëhet një përmbledhje e konkluzioneve të arritura gjatë punimit të këtij dizertacioni gjithashtu dhe disa rekomandimeve sesi mund të përmirësohet rregullimi ligjor i këtij instituti në legjislacionin shqiptar.

# KAPITULLI II-SKELETI TEORIK DHE MODELI ANALITIK I PUNIMIT

## 2.1 Baza teorike e punimit

*...Me qëllim zhvillimin e plotë dhe harmonik të personalitetit të vet, fëmija duhet të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi...*

*Hyrje në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve*

Njësia e qytetërimit është familja dhe anëtari më i ndjeshëm i saj, në të gjitha rrethanat, është fëmija (Pati, 2007: xxi). Çdo fëmijë ka të drejtën për një shtëpi të sigurtë dhe një familje të dashur. Fëmija ka nevojë për figurë prindërore permanente dhe në rastet kur i mungon ajo, birësimi ia ofron atë me të njejtin natyralitet ashtu si në marrëdheniet biologjike prind-fëmijë. Birësimi është i njohur si institut i së drejtës familjare nga shumica e legjislacioneve të botës të botës. Përfshirja në rendin e brendshëm juridik të një shteti është diktuar nga nevoja shoqërore (Kalia A., 2010: 219). Ky punim e trajton institutin e birësimit parë në dy këndvështrime të rëndësishme: në qëllimin dhe nevojën e këtij instituti, si pjesë e çdo shoqërie, si dhe në problematikat që shfaqen si pasojë e praktikimit ose jo të tij. Me të gjitha ndryshimet ligjore ndër vite, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe birësimit, interesi më i lartë i fëmijës ka prevaluar mbi çdo element tjetër në procedurat e birësimit. Çështja e fëmijëve është e të gjithëve, sepse fëmijët jo vetem nuk mund t'i zgjidhin vetë problemet e tyre, por janë motivi kryesor i punës dhe luftës tonë si familjarë dhe janë garancia më e fuqishme e ndërtimit të një të ardhmeje për këtë vend (Strategjia Kombëtare, 2012-

2016; 19). Ato janë e ardhmja e një kombi, ndaj dhe duhet t'i kushtohet një vemendje e veçantë çdo aspekti apo hapi të jetës së tyre.

Në ditët e sotme, birësimi sherben për të arritur 3 qëllime kryesore:

- u siguron fëmijëve të braktisur ose jetimë një familje
- u siguron çifteve pa fëmijë mundësinë për të pasur fëmijë
- u mundëson personave single pasjen e një fëmije, duke mos qënë në një lidhje martesore.

Gjendja juridike e fëmijës së birësuar, rrjedh nga akti juridik, birësimi, që vendos një marrëdhënie zgjedhjeje të bijësisë (e ashtuquajtura bijësi civile), midis personave që nuk kanë lidhje gjaku (Galgano, 1992: 952). Qëllimi i këtij instituti edhe në të drejtën shqiptare, ashtu si në shumicën e vendeve të tjera, është sigurimi i një familje permanente për fëmijën e cila i ofron një ambjent familjar të njejtë me atë të një familje biologjike, si dhe mundësi oportune per t'u rritur dhe edukuar si fëmijët e tjerë[1]. Të gjithë fëmijët duhet të kenë fatin për të jetuar në një familje dhe shoqëria me mekanizmat e saj duhet të angazhohet që t'ua sigurojë këtë (Selmani, 2008: 2). Birësimi është një formë e mbrojtjes shoqërore dhe ligjore për fëmijët pa përkujdesje prindërore (Gashi, Aliu, Vokshi, 2012: 369). Një ndër parimet kryesore që udhëheq të drejtat e fëmijëve në të gjitha legjislacionet dhe në atë shqiptar[2], është rëndësia e rritjes së fëmijës me prindërit e tij/saj biologjik. Por në rastet kur kjo e drejtë kufizohet nga

[1] Shih Vendimin 342 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, 27.10.2009
[2] Neni 3 paragr. 2, KF: "Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes".

pengesa ligjore dhe faktike, lind nevoja për vendosjen e fëmijës në një institucion për kujdesin e fëmijëve apo në një familje tjetër me anë të kujdestarisë apo birësimit. Transferimi i përgjegjësisë prindërore nga prindërit biologjik tëk birësuesit mund të bëhet në mënyrë vullnetare ose jo (Chedgzsey Smith-McKeever, 2001: 1). Me dhënien e fëmijës për birësim, synohet që fëmija të rritet në një familje që i mundëson *de jure* dhe *de facto* marrëdhënien prind-fëmijë të ngjashme me marrëdhënien ndërmjet prindit dhe fëmijës së vet biologjik. Fëmija pas birësimit duhet të ndjejë ekzistencën e një familje natyrore gjatë gjithë kohës dhe sido që të jetë "pala birësuese", një birësues apo dy birësues (të cilët janë bashkëshortë), duhet të marrin përsipër **s**i nga ana ligjore ashtu dhe emocionale rolin e prindit biologjik. Mënyra e themelimit të kësaj marrëdhie është ligjore (artificiale) sepse themelohet me akt juridik dhe jo në mënyrë natyrore siç themelohen marrëdhëniet prindërore në mes fëmijëve dhe prindërve natyror (Aliu, Gashi, 2007: 248). Birësimi nuk mund të bëhet për interesa të tjera si psh. për ndonjë shpërblim, plotësim të ndonje nevoje për të pasur fëmijë, çështje të ruajtjes së trashëgimisë brenda rrethit të caktuar familjar, etj. Kryesisht në Europën Lindore dhe në Ballkanin Perëndimor, akoma njerëzit nuk e pranojnë gjërësisht haptazi birësimin e një fëmijë, duke u munduar në këtë mënyrë të shmangin paragjykimet e të tjerëve. Në këto vende, përfshirë dhe Shqipërinë, birësimi i një fëmije synohet nga prindërit birësues të bëhet në fshehtësi të plotë duke u munduar ta fshehin këtë fakt dhe ta prezantojnë atë si fëmijën biologjik. Megjithatë statistikat tregojnë se vitet e fundit të kësaj dekade ka pasur rritje të kërkesave për birësim. Ukraina e deklaroi vitin 2008 si "viti i birësimve" dhe siguroi 2,066 birësime atë vit, nga 1492 që ishin në 2004 . Po ti referohemi birësimit ndërvendas në Rusi, rreth 62% të birësimive janë bërë me SHBA-në, ku vihet re një trend rritës i numrit të birësimeve ku nga 324 në 1992, në vitin 2005 ky numër shkon në 4639. Për periudhën 1999-

2014 në total janë arritur midis këtyre shteteve 46113 birësime të të miturve, prej të cilëve 50.4% janë meshkuj dhe 49.6 femra . Shifrat për birësimin vendas variojnë nga 7000-9000 fëmijë të birësuar në vit. Rusia nuk është partnere e Konvetës së Hages mbi birësimin.

## 2.2 Debati doktrinar

Çështja e birësimit të fëmijëve ka qënë në qendër të debateve politike, shoqërore dhe të doktrinës ndër vite. Birësimi, është një vendim i rëndësishëm për jetën e qënieve të ndryshme njerëzore dhe midis tyre të një minoreni në kondita cënueshmërie [3]; është një veprim juridik përmes të cilit themelohet marrëdhënia e birësimit midis birësuesit dhe të birësuarit (Aliu, Gashi, 2007: 248). Me krijimin e kësaj marrëdhënie të re, synohet krijimi i një marrëdhënie sa më të ngjashme me atë prind- fëmijë.

Si çdo e drejtë tjetër dhe e drejta familjare i është nënshtruar ndryshimeve kontemporane duke iu adresuar një shoqërie me koncepte më të hapura rreth familjes. Marrëdhënia prind-fëmijë e krijuar përmes procesit të birësimit, ka qënë dhe vazhdon të jetë pjesë e debatit doktrinar, rreth efekteve që sjell si tek fëmijët ashtu dhe tek prindërit. Në kuadrin ligjor ndërkombëtarë, rajonal dhe kombëtar, birësimi është një ndër alternativat më të mira që u ofrohet fëmijë pa përgjegjësi prindërore, kryesisht jetimëve biologjik dhe social. Por në këndvështrimin e studiuesve skeptik, birësimi duhet të jetë alternativa e fundit që mund t'i ofrohet kësaj kategorie fëmijësh.

[3] Të Drejtat e Fëmijëve në Birësimin Kombëtar dhe Ndërkombëtar, Qendra Ndërkombëtare e Referimit për Mbrojtjen e Minoreve në Birësim, Sherbimi Social Ndërkombëtar, Seksioni Italian, 1999

Në Shqipëri, familjes dhe rregullimit të saj ligjor nuk i është kushtuar vemendja e duhur. Ndër vite mungesa e studimeve të mirëfillta ka lënë në hije zhvillimin e debatit doktrinar dhe përmirësimin e legjislacionit; dekadat e fundit numërojmë një numër minimal studimesh empirike që lidhen direkt apo indirekt me birësimin. Megjithatë, tashmë ka filluar të vihet re një trend i ri, ku studiues nga disiplina të ndryshme (e drejta, sociologjia, psikologjia, historia), i janë bashkuar debatit të vazhdueshëm në lidhje me alternativën më të mirë të mundshme që duhet t'u ofrohet fëmijëve pa përgjegjësi prindërore. Studiuesit dhe ekspertët ligjorë mbajnë qëndrime të ndryshme (pro dhe kundër), për birësimin, si një ndër alternativat më të mira të mundshme që mund t'u ofrohen fëmijëve jetim apo të braktisur.

Trendi rritës në numër i birësimit, nuk ka ngelur pa kritika. Ndër format më kontraversiale të birësimit janë ai ndërvendas dhe ai nga prindër birësues gay. Birësimi ndërvendas pretendohet se tek i birësuari, sjell si pasojë: humbjen e kultures, traditave dhe gjuhës së atdheut; trafikim të fëmijëve dhe vështirësi nga ana e autoriteteve kompetente në kontrollin e ecurisë së raportit të ri të krijuar. Sipas Wilken, Jonet, Liu, Rowe, ky institut është kthyer në një "treg të zi bebesh", por megjithatë ato i referohen kryesisht shifrave të vitëve 1970-1980 (Hubing B., 2001: 665).

Studiuesit kohët e fundit sygjerojnë që birësimet ndërvendase të cilët konkludojnë në marrjen e fëmijëve për birësim nga kontinentet e tjera, ndihmojnë në mosplakjen e popullsisë së kontinentit të vjeter europian. Disa argumentojnë se birësimi ndërvendas promovon imperializëm dhe shfrytëzim të fëmijëve (Hubing B., 2001: 663). Sipas Bartholet[4], kjo formë

[4] Avokate prej vitesh për birësimet ndërvendase dhe anëtare e Grupit Këshillimor të Departamentit të Shtetit të SHBA-së dhe që përfaqëson interesat e Shteteve të Bashkuara në negociatat e Konferencës së Hagës dhe në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit në Shtetet e Bashkuara

birësimi duhet të shihet si një mundësi e mirë për të zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me fëmijët si: kequshqyerja, sëmundjet, qëndrimi në institucione apo në rrugë etj. Bazuar në rëndësinë e këtij instituti, duhet të ketë një strukturim sa më të mirë për të maksimizuar këtë potencial pozitiv.

Debate të forta janë zhvilluar në Europë mbi propozimet për të legalizuar birësimin nga prindër të të njejtit seks, të martuar apo jo. Në shtetet të cilat kanë lejuar martesat ndërmjet personave gay, gjithashtu dhe birësimin nga këto çifte, ka pasur kontestime dhe protesta për mos miratimin e tyre. Lejimi i birësimit për këtë kategori prindërish në vendet europiane, sa vjen e shtohet, duke passjellur ndryshime ligjore në fushën e birësimit. Rëndësia e institutit të birësimit, për fëmijët pa një ambjent familjar është e madhe, por gjithsesi synohet të mos shkohet në nevojat e këtij instituti, por të shmanget sa më shumë në ato raste kur mund të rivendosen lidhjet me familjen biologjike. Në bazë një studimi empirik të studiuses Hillis, aftësia prindëruese nuk ka lidhje me orientimin seksual (Hillis L., 2008: 237-246).

Problematikat që u kanë hapur udhë debateve dhe studimeve të ndryshme, lidhen me procedurat e birësimit, nëse duhet të bëhen brenda një afati kohor më të shkurtër dhe nëse tarifat e larta për birësimin ndërvendas ndikojnë në numrin e ulët të kërkesave për birësim. Për më tepër cilado qoftë forma e birësimit dhe çdo çështje e lidhur me fëmijët, ngre diskutime të ndryshme në fushën e të Drejtave të Njeriut.

### *Teoritë juridike dhe ekonomike*

E drejta e ka njohur këtë institut që në rregullimet dhe kodifikimet e para në botë. Bazuar në evolucionin historik të birësimit, vëmë re lindjen e teorive të ndryshme që e shoqërojnë atë në periudha të ndryshme. Teoritë klasike, e shikojnë birësimin në formën e tij të plotë dhe jo

të pjesshëm, duke synuar në gjetjen e një familje për fëmijën jetim, e cila zëvëndëson me të gjitha të drejtat dhe detyrimet familjen biologjike. Në fillimet e kodifikimeve të para moderne të këtij instituti, birësimi ishte një e drejtë që u ofrohej çifteve pa fëmijë dhe më vonë u lejuan dhe personat single si birësues. Fillimisht ishte një institut i projektuar përgjithësisht mbi bazën e nevojave të të rriturve dhe më vonë filloi të fokusohej në mirëqënien dhe interesin më të lartë të fëmijës. Teoria e mirëqëniës, e trajtuar fillimisht nga Platoni dhe Aristoteli, e përfshirë si parim në rregullimet ligjore, bazohet në aspektin fizik, emocional, material dhe shpirtëror të individit. Në kontekstin e birësimit, mirëqënia e fëmijës është kriteri kryesor që duhet t'i mundësohet atij në familjen birësuese. Parë në këndvështrimin e nënave beqare, para viteve '90, mirëqënia e nënave sigurohej nëse pas lindjes fëmija do i jepej një familje duke i mundësuar kështu nënës mundësinë të hedhë pas krahëve të shkuarën dhe të vazhdonte jetën normalisht (Weaver A., 1999: 31).

Ligjet e birësimit, synojnë të rregullojnë situata të dhimbshme dhe shqetësuese për shoqërinë të cilat lidhen me fëmijët e braktisur, jetim dhe ato fëmijë për të cilët prindërit kanë dhënë pëlqimin për birësim. Në sistemet ligjore common law dhe civil law, vend të veçantë zë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Në këto sisteme, interesi më i lartë i fëmijës udhëheq të gjitha dispozitat ligjore që prekin fëmijët.

Vitet e fundit doktrina ka shpalosur dhe një teori relativisht të re në konceptimin e saj që është ajo ekonomike[5]. Sipas kësaj teorie, birësimi i një fëmijë mund të bëhët dhe për një sërë arsyesh të cilat sjellin benefite ekonomike për prindërit birësues, ose të pakten ul nivelin e kostove që ka lindja e një fëmije. Këto arsye konsistojnë në: evitimin e trajtimeve mjekësore

[5] Shih: Dirk Bethmann, Michael Kvasnicka "A Theory of Child Adoption", University Magdeburg, qershor 2012

ndaj infertilitetit të njërit apo dy partnerëve dhe në përfitimet financiare që shteti trajton familjet birësuese për t'i inkujaruar dhe mbështetur. Në Shqipëri familjet birësuese nuk trajtohen me ndihma apo lehtësime financiare, ndaj kjo teori nuk gjen zbatim; ndërsa përsa i përket trajtimeve mjekësore dhe insemimeve artificiale, Shqipëria nuk ofron klinika të specializuara të besueshme dhe me kosto të ulët, ndaj personat e interesuar u drejtohen klinikave të ndryshme jashtë vendit duke paguar tarifa të larta, të përballueshme vetem për shtresën e popullsisë me të ardhura mbi-mesataren.

***Teoritë psikologjike dhe filozofike***

Studiuesit i kanë kushtuar rëndësi të veçantë studimeve psikologjike në lidhje me marrëdhënien prind-fëmijë të krijuar nëpërmjet birësimit. Birësimi është ndër ato institute tejet delikate, që për rregullimin e tyre ligjor është e domosdoshme hartimi i dispozitave ligjore edhe mbi bazën e studimeve psikologjike. Në shumë raste, fëmija "vuan" ardhjen e tij në jetë si pasojë e mos planifikimit nga prindërit, duke mbetur i padëshiruar apo i braktisur nga prindërit. Gjithashtu, është dhe ajo kategori e fëmijëve, të cilët fati i ka lënë jetim dhe pa familje, për të cilët shteti është përgjegjës për kujdesin ndaj tyre duke ofruar disa alternativa të mundshme, një ndër to dhe birësimin. Fëmija i birësuar rritet në një familje e cila nuk i ofron lidhje gjenetike me prindërit apo edhe me motrat dhe vëllezërit[6] dhe për këtë arsye kjo marrëdhënie prindërore dhe familjare përbën interes të veçantë për t'u studiuar.

---

[6] Megjithatë njeri prind mund të jetë prindi biologjik, ashtu si dhe vëllezerit dhe motrat mund të jenë biologjik nëse janë birësuar nga të njejtit prindër

Çështja më e diskutueshme dhe e debatueshme në rang psikologësh në lidhje zhvillimin mendor dhe emocional të fëmijëve të birësuar lidhet me “ushqyerjen” apo “natyrën”, pra me prindin që rrit dhe ushqen një fëmijë apo me atë që e lind.

Variabla të ndryshme të kombinuara sëbashku krijojnë personalitete, karaktere apo sjellje të ndryshme për çdo qënie njerëzore. Mjedisi ose eksperienca, influencojnë në personalitet në mënyra të ndryshme, në varësi të moshës dhe pjekurisë së individit (Clothier F., 1943: 222-226). Diversiteti i personaliteteve dhe karaktereve njërëzore sjell si pasojë reagime dhe rezultate të ndryshme ndaj disa fenomeneve, situatave apo marrëdhënieve të ndryshme midis njërëzve. Në këtë kuadër dhe marrëdhënia e birësimit sjell efekte pozitive apo negative në varësi të karakteristikave të ndryshme që e shoqërojnë atë.

Një numër i madh studimesh i referohen lidhjes së personalitetit të fëmijës me atë të prindit biologjik dhe atij birësues. Prindërit biologjik dhe birësues janë dy faktorët kyç në formimin e fëmijës së birësuar si nga lidhja gjenetike ashtu dhe nga ambjenti i përbashkët familjar. Studimi i parë mbi skizofreninë, konkludoi se ambjenti familjar kontribuon shumë pak në rrezikun e fëmijës për një ç’rregullim të tillë si skizofrenia. Të dhënat e këtij studimi u mblodhën nëpërmjet intervistave të fëmijëve të birësuar me nëna biologjike që vuanin nga skizofrenia, apo me fëmijë të birësuar prindërit biologjik të të cilëve nuk vuanin nga ç’rregullime mendore (Avi G. Haimowitz, 2015: 2). Rezultatet e këtij studimi mbështesin teorinë se pavarësisht mjedisit familjar në të cilin rritet fëmija, nëse prindërit vuajnë apo jo nga ç’rregullime mendore, rreziku për të vuajtur nga i njejti ç’rregullim është i njejtë, pavarësisht nëse rritet nga prindër biologjik apo birësues (Plomin R., DeFries, J. C., McClearn, G. E., & Rutter, M., 1997: 54). Në një studim tjetër mbi fëmijët e ndrojtur, vërehet

se fëmijët e birësuar ishin të ndrojtur njësoj si nënat e tyre biologjike edhe pse ishin rritur që bebe nga prindër birësues (Daniel & Plomin, 1985: 118-121). Sipas studiueses F.Clothier, fëmija i birësuar paraqet të gjitha ndërlikimet e zhvillimit social dhe emocional si çdo fëmijë, por egoja e fëmijës së birësuar cilësohet si kompensim i plagëve të lëna nga humbja e nënës biologjike.

Në 2011, Universiteti i Autonoma, Barcelonë, në bazë të një punë kërkimore[7], doli në përfundimin se fëmijët e birësuar nuk paraqesin ndryshime në përshtatje, në krahasim me fëmijët jo të birësuar. Megjithatë, fëmijët e birësuar nga Europa Lindore paraqitnin më shumë vështirësi në përshtatje dhe në marrëdhëniet ndërpersonale.

Familja dhe koncepti i saj ka ndyshuar shumë në dekadat e fundit. Sot, familja tradicionale nënë-baba-fëmijë gjithmonë e më shumë po zevendësohet nga familje nënë-fëmijë apo baba-fëmijë. Kohët e fundit birësimi është bërë një fenomen ndërkombëtar që teston dy parimet lidhur me të drejtat universale të njeriut dhe sistemet e ndryshme ligjore.[8] Çdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes nga familja, shoqëria dhe shteti për shkak të statusit të tij minoren. Që një fëmijë të rritet në një ambjent të përshtatshëm familjar, të edukohet, dhe të jetë një individ pozitiv në shoqëri nuk është e thënë të rritet nga dy prindër.

Studiuesit Feigelman dhe Silverman në vitin 1977 pas një studimi 6 vjeçar dolën në përfundimin se përshtatja e fëmijëve të rritur nga prindër single ishte e njejtë me atë të fëmijëve të rritur nga dy prindër birësues. Sipas Groze dhe Rosenthal në studimin e tyre në

[7] Natalia Barcons, Albert Fornieles and Carme Costas, (2011), “Psychological adaptation of adopted children examined in Spanish study”, Spanish Journal of Psychology
[8] Maarten Pareboom, The European Union and International Adoption, Center for Adoption Policy, Salisbury University http://www.adoptionpolicy.org/pdf/4-28-05-MPereboomTheEUandInternationAdoption.pdf

vitin 1991 mbi prindërimin dhe problematikat e birësimit, konkluduan se fëmijët e rritur në një familje me një prind, përjetonin më pak probleme se ato në familje me dy prindër[9].

Sipas studimeve psikologjike, të birësuarit në një shtet tjetër ndodhen në një rrezik të veçantë për vështirësitë e mëvonshme për arsye të ndryshme që lidhen me institucionalizimin e tyre (Houlihan, 2010: 14) të mëparshëm, duke shfaqur shpesh herë sjellje problematike në familjet birësuese dhe një vështirësi adaptimi për shkak të ndryshimit, në radhë të parë të ambjentit ku jetojnë nga një institucion në një ambjent familjar të vertetë, por edhe nga ndryshimi i kulturave, gjuhës etj. Shumica e të birësuarve vijnë nga shtëpitë e fëmijëve apo institucionet e tjera qe kujdesen për to.

Përsa i përket birësimit nga persona homoseksual ka teori dhe qëndrime të ndryshme të cilat e përkrahin ose jo atë. Kjo çështje vë në diskutim aftësinë e këtyre personave për të qënë prindër të mirë dhe ç'është më e rëndësishmja, vë në diskutim edhe interesin më të lartë të fëmijës nëse rritet nga prindër të të njejtit seks.

*A mund të jenë prindër të mirë homoseksualët?* Studime krahasuese midis fëmijëve të rritur nga prindër homoseksualë dhe heteroseksualë treguan se nuk kishte asnjë zhvillim të ndryshëm midis grupeve në katër zonat më kritike siç janë : inteligjenca e tyre, gjendja psikologjike, gjendja shoqërore dhe popullariteti midis shokëve[10]. Të dhëna të gjëra të një hulumtimi[11] 30 vjeçar tregojnë se prindërit gay dhe lezbike kanë demonstruar elasticitet në lidhje me shëndetin social, psikologjik dhe seksual pavarësisht dallimeve ligjore, ekonomike dhe stigmes sociale. Në bazë të një hulumtimi tjetër, adoleshentët që janë rritur në familje

---

[9] http://www.bbinternationaladoption.com/single-parent-adoption data aksesit 27.06.2016

[10] http://www.aleancalgbt.org/edukim/5-orientimi-seksual-dhe-homoseksualiteti data e aksesit:28.07.2016

[11] Studimi i Universitetit Tufts, Qendra Mjekësore Boston dhe Komitetit për Aspektet Psikologjike të Fëmijës dhe Shëndetit të Familjes, publikuar në Pediatrics, "Promoting the Well-Being of Children Whose Parents Are Gay or Lesbian", 2013

nga nëna lezbike që në lindje, kanë demontruar përshtatje të shëndetshme psikologjike[12]. Fëmijët e çifteve të të njejtit seks janë po aq të prirur të kenë progres normal nëpër shkolla sa fëmijët e shumicës së strukturave tjera të familjes[13]. Një grup studiuesish në një studim tyrin (Bos, 2016: 37) në 2016, që përfshinte 95 çifte prindërish me seks të njejtë dhe 95 çifte prindërish me seks të ndryshëm[14], dolën në përfundimin se fëmijët e prindërve të të njejtit seks, janë po aq të shëndetshëm psikologjikisht dhe emocionalisht sa dhe fëmijët e prindërve me seks të ndryshëm. Po në këtë studim, u evidentua se prindërit me seks të njejtë janë më të stresuar për të shfaqur dhe justifikuar cilësi në prindërimin e tyre sesa ato me seks të ndryshëm.

Kundërshtarët e këtij lloji birësimi, mbrojnë me fanatizën vlerat morale dhe fetare të familjes natyrale nënë-baba-fëmijë. Fëmija për një rritje sa më të mirë duhet të ketë prezent figurën e nënës dhe të babait. Legalizimi i birësimit nga çiftet homoseksuale u heq të drejtën bazike fëmijëve të kenë një nënë dhe një baba[15]. Gjithashtu pretendohet se çiftet e pamartuara dhe ato homoseksuale, nuk mund të mundësojnë stabilitetin që çiftet heteroseksuale mund të ofrojnë[16]. Juristë dhe ekspertë të fushës argumentojnë se familja e vetme legjitime është ajo e përcaktuar nga natyra ose traditat e hershme të shoqërisë dhe individët sillen me etikë vetem konform këtij modeli.

---

[12] Studim i Universitetit të Kalifornisë-San Francisko, Universitetit të Kalifornisë-Los Angjeles dhe , Universitetit të Amsterdamit, publikuar në Pediatrics "U.S. National Longitudinal Lesbian Family Study: Psychological Adjustment of 17-Year-Old Adolescents", 2010

[13] Studim i Universitetit Stanford, "Nontraditional Families and Childhood Progress Through School", 2010

[14] Bazuar në karakteristika si: mosha e prindërve dhe fëmijëve; niveli i edukimit të prindërve; raca, gjinia, vendi i lindjes së fëmijëve dhe rezidenca e familjes

[15] http://www.debatingeurope.eu/focus/arguments-gay-adoption/#.V5qSMVKKTIU data aksesit 29.07.2016

[16] Iloyd Vries, Adoption becoming easier for gays, CBS, Concerned Women for America, 29 tetor 2003, http://www.cbsnews.com/news/adoption-becoming-easier-for-gays/ data aksesit 12.07.2014

Në një studim të Universitetit të Teksasit, sociologu Mark Regnerus, doli në përfundimin se fëmijët e rritur nga prindër homoseksual nuk vuanin disavantazhe në krahasim me fëmijët e rritur nga nëna dhe babai i tyre të martuar (Regnerus, 2012: 752-770). Në janar të 2015, Paul Sullins, një prift katolik dhe profesor sociologjie[17], publikoi një studim (British Journal of Education, 2015: 99-120), ku tregonte se fëmijët e rritur nga prindër homoseksual përballeshin dy herë me më shumë probleme emocionale se ato të rritur nga prindër heteroseksual.

### 2.3 Metodologjia dhe Metodat e kërkimit

Në shkencat juridike kryesisht gjejnë përdorim metodat cilësore (kualitative) dhe më pak ato sasiore, ashtu si në këtë punim ku përdoren metodat cilësore. Për hartimin e këtij punimi kam marrë parasysh disa metoda kërkimore shkencore të larmishme, si metoda analitike, krahasuese, historike, shpjeguese dhe përshkruese. Këto metoda gjenden në të gjithë punimin si të përziera.

*1.2.1 Metoda analitike* ka shërbyer për analizën ligjore të kuadrit normativ mbi birësimin, akteve dhe konventave ndërkombëtare. Analiza e vendimeve gjyqësore si të gjykatave shqiptare ashtu dhe të gjykatave të huaja apo GJEDNJ-së, përdoret gjërësisht për të sqaruar dhe evidentuar zbatimin e ligjeve apo parimeve në rastet praktike.

*1.2.2 Metoda krahasuese* e përdorur në këtë disertacion, besoj se ka rritur më tej vlerën e punimit, pasi ballafaqon legjislacionin tonë mbi birësimin me atë të disa shteteve Europiane si Franca, Italia dhe Austria si pjesë e sistemin civil law dhe me legjislacion në disa vende të

[17] Universiteti Katolik i Amerikes

sistemit common law. Parë në këndvështrimin krahasimor, duke sjellë përvojen e vendeve më të zhvilluara, nëpërmjet këtij punimi synojmë të vëmë në dukje mangësitë dhe problematikat që paraqet në praktikë ligji jonë mbi birësimin e sipas rastit, dhënien e rekomandimeve për ndryshimet përkatëse në legjislacion.

*1.2.3 Metoda historike* do të na njohë me fillesat e nocionit të birësimin, konkretizimin dhe evoluimin e tij si institut i së drejtës, që nga Mesopotamia e vjeter, Perandoria Romake e deri në ditët e sotme. Është e rëndësishme të dimë gjenezen dhe hapat e parë të këtij instituti, në mënyrë që të kuptojmë se si ka evoluar ndër shekuj instituti i birësimit duke iu përshtatur nevojave dhe ndryshimit të shoqërisë. Një pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli është dhe analizimi i birësimit sipas Bibles dhe Kuranit. Në këtë pjesë të punimit, kemi një përzierje të metodave historike dhe asaj krahasuese.

*1.2.4 Metoda rishikim literature* është e rëndësishme të njohim dijet ekzistuese mbi temen e hulumtimit. Rishikimi i literatures ka për synim të bëjë analizë dhe përmbledhje të dijës së mëparshme që është e besueshme. Me anë të kësaj metode kërkimi, synohet të fitohen njohuri sa më shumë nga literaturat shkencore të botuara ndër vite. Kjo metodë do jetë e përdorshme më shumë në kapitullin historik dhe përshkrues.

# KAPITULLI III-VËSHTRIM HISTORIK MBI BIRËSIMIN

## 3.1 Hyrje

Birësimi, është një term i vjeter sa vetë njerëzimi. Historia e tij është pa fillim dhe pa fund (Russet, 2012: 3). Që në kohët antike dhe në të gjitha kulturat njerëzore, fëmijët kalonin nga prindërit biologjike të cilët nuk dëshironin ose nuk mundnin që të ushtronin përgjegjësinë prindërore, në prindër të cilët i donin këto fëmijë për të krijuar familje, për punë, për aleanca politike, për trashëgimi, për t'u kujdesur për prindërit në pleqëri, apo për një lidhje martesore të ardhshme. Birësimi ka qënë një praktikë e zakonshme në antikitet në zona dhe periudha të ndryshme[18]. Vdekja e prindërve nga uria, sëmundjet, mosha dhe lufta kontribuonin në mundësinë që një fëmijë papritmas të mbetej pa prindër. Birësimi i fëmijëve është praktikuar gjatë gjithë historisë së njerëzimit me implikimet e tij ligjore, shoqërore dhe etike (Paulissian: 1). Për shumë njerëz sot, është një mënyrë për të krijuar ose për të zgjeruar familjen. Ai përmendet edhe në Bibël dhe në Kuran. Grekët, romakët, egjyptianët dhe babilonasit të gjithë kishin sisteme birësimi. Sipas romakëve birësimi është përzgjedhja e fëmijës së dikujt tjeter për ta trajtuar atë si të vetin; ndërsa sipas grekëve, është vendosja e fëmijës së dikujt tjeter në familjen tënde, duke synuar të ketë të njejtat të drejta dhe privilegje si fëmijët biologjikë. (Beard, 1847: 26). Romakët synonin nëpërmjet birësimit ruajtjen e mbiemrit dhe pasurinë e familjes. Birësimi kryesisht lidhej me mirëqënien dhe benefitet e të rriturve. Gjatë gjithë historisë, motivet e birësimit kanë ndryshuar shumë. Fillimisht, një institut i projektuar si një mjet për të kaluar mbiemrin ose pasurinë, më vonë një institut që pësoi ndryshime, duke u

[18] http://www.researchetcinc.com/historyofadoption.html data aksesit 06/12/2014

orientuar gjithmonë e më shumë në interesin më të lartë të fëmijës. Vetem kohët e fundit, ky proçes është fokusuar në interesin më të lartë të fëmijës (Goody, 1969: 59-61).

Qëllimi i birësimit nuk kishte domosdoshmërisht për qëllim të promovonte mirëqënien e fëmijës, por t'i jepte të rriturve një trashëgimtar (Barbara, 2007: 1). Praktika e tij ishte krejt e zakonshme në vende dhe periudha të ndryshme, por lidhja e tij me humanizmin ose infertilitetin është një fenomen kryesisht modern. Ai ishte një proçes nëpërmjet të cilit komunitetet merrnin përgjegjësi për jetimët, pikësëpari duke u caktuar fëmijëve shtëpi të reja brenda vendit, ndërsa birësimi ndërvendas erdhi si një proçes më novator sepse i dërgonte fëmijët jashtë kufinjve (Houlihan, 2010: 18). Sot, birësimi është i lidhur ngushtë me fëmijët jetimë.

Revolucionarët e shikonin birësimin si një mënyrë të vendosjes së barazive sociale. Në Kodin e Napoleonit, birësimi ishte një kontratë që lidhej lirisht ndërmjet personave madhorë, birësuesit dhe të birësuarit (Morin, 1986: 7).

Birësimet nga "të huaj" ose jo "të afërm" kanë mbizotëruar në kohë dhe karakterizoheshin nga vendosja e lidhjeve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve pa lidhje gjenetike. Ndërsa sot, një pjesë e madhe e fëmijëve birësohen nga të afërmit, njerku ose njerka, një ndryshim që korrespondon me rritjen e divorceve, rimartesat dhe bashkëjetesat e gjata. Në Angli, *de facto* birësimet kanë qënë të zakonshme në zonat industriale të qyteteve të mëdha shumë vite para Aktit të Birësimit në 1926 (Cretney, 1984: 419) [19]. Anglia nuk e kaloi legjislacionin për birësimin deri në 1926. Pas Luftës së Parë Botërore, kërkesa për foshnje filloi të rritej. Faktorë ndikues në trendin e birësimeve ishte rënia e menjëhershme e popullsisë e shkaktuar

[19] http://pages.uoregon.edu/adoption/topics/adoptionhistbrief.htm data e aksesit 23.08.2014

nga lufta. Forma moderne e birësimit është shfaqur në SHBA në shekullin e IX-të. I nxjerrë në 1851, 'The Massacusetts Adoption of Children Act', është konsideruar gjërësisht si ligji i parë modern i birësimit. Gjatë shekullit të 20-të, numri i birësimeve u rrit në mënyrë dramatike në SHBA. Në vitet 1900, formalizimi i marrëdhënieve familjare birësuese në gjykatë ishte akoma shumë i rrallë. Sot, birësimi është bërë një mënyrë plotësisht e pranueshme për të krijuar familje për personat single apo çiftet e çdo lloj gjinie (Rejou, 2003: 1). Birësimi është globalizuar më tej pas luftës së dytë botërore. Të shkruash për birësimin, është një temë shumë e prekshme në esencën e saj, sepse prek pjesën më të ndjeshme të shoqërisë- fëmijët (Selmani, 2008: 2).

### 3.2 Birësimi në Mesopotaminë e vjetër

Numri i jetimëve ose fëmijëve të braktisur ishte i madh në Mesopotaminë e vjetër. Mesopotamet shkruajten ligje dhe vendosen zakone e tradita shoqërore për të mbrojtur të drejtat dhe intereset e birësuesit dhe të birësuarit poashtu (Paulissian, 1991: 1). Forma më e hasur e birësimit ishte ajo e të sapo lindurit. Të rriturit mund të bëheshin pjesë e një tjeter familjeje me dëshiren e tyre, e quajtur “arrogation” (Nejat, 1998: 131).

Arsyet pse ato birësonin fëmijë ishin shpesherë të njejta më ato të ditëve të sotme. Çifte pa fëmijë birësonin fëmijë jetimë ose të braktisur për t'u dhënë atyre mbrojtje dhe familje. Por jo vetem çiftet pa fëmijë birësonin, gjithashtu edhe ato me fëmijë mund të birësonin një djalë ose një vajzë, i cili/e cila do të kishte të njejtat të drejta si fëmijët biologjik, madje edhe të drejtat trashëgimore. Skllevërit mund të birësoheshin gjithashtu.

Kontratë birësimi, viti 2000 para Krishtit:

> *"Arad-Iskhara, dhe Ibni-Shamash, ishin në një marrëdhënie birësimi së bashku. Ditën kur Arad-Iskhara ti thotë babait të tij, Ibni-Shamash "Ti nuk je babai im", ai duhet ta lidhë atë me zinxhir dhe ta shesë për para. Kur Ibni-Shamash ti thotë birit të tij, Arad-Iskhara "Ti nuk je biri im", ai duhet të largohet nga shtëpia dhe të mirat material"*[20].

Nëse në Mesopotaminë antike, pasuria e familjes nuk bazohej në tokën bujqësore, por më shumë në punishtet e tyre, personat pa fëmijë mund të ishin në kërkim jo vetem të një trashëgimtari për pronën e tyre por më shumë për një pasues të zanatit të tyre (Huebner, 2013: 185). Ndonjëherë, kontrata e birësimit kishte për qëllim që babai birësues t'i mësonte zanatin e tij fëmijës birësues, që në këto raste në përgjithësi ishte djalë. Nëse proçesi i të mësuarit dështonte dhe i birësuari nuk kishte mundur të mësonte zanatin e babait birësues, atëhere ai i kthehej familjes biologjike. Duke qënë se nuk plotësohej kushti kryesor për të cilin ishte lidhur kontrata, ajo bëhej e pavlefshme.

Ligjet e birësimit ishin të ndryshme në pjesë të ndryshme të Mesopotamisë. Këtu mund të përmendim Kodin e Hamurabit, Ligjin e Asirisë së Mesme dhe Kontratat Nuzi. Gjithashtu, kode të ngjashme ligjore u krijuan në disa qytetërime afër, përfshirë shembujt e hershëm mesopotamas të Kodit të Ur-Nammu, Ligjeve të Eshnunës, Kodit të Lipit-Ishtar dhe Kodit të mëvonshëm ligjor të Hititëve (W, 2003: 19). Ndër to, më të rëndësishmit ishin Kodi i Hamurabit dhe Kontratat Nuzi. Birësimi në përgjithësi lejohej për femrat dhe meshkujt gjithashtu. Një grua mund të birësonte një djalë ose vajzë si trashëgimtarin/en e tij i cili/e cila do të kujdesej për të në moshë të vjetër. Ajo kishte të drejtë t'a lejonte vajzën e saj të martohej ose të punonte si prostitute (Rhea & Greenwood, 1998: 132).

[20] https://legacy.fordham.edu/halsall/ancient/mesopotamia-contracts.asp data e aksesit 23.09.2015

### 3.2.1 Kodi i Hamurabit

Hamurabi ishte mbret i Dinastisë së Parë të qytet-shtetit të Babilonisë. Babilonia ishte një nga shumë qytet-shtetet që gjendëshin në Mesopotami, të cilat luftonin me njëra-tjetren për të pasur nën zotërim tokën bujqësore pjellore (Van De Mieroop, 2005: 1). Kodi i Hamurabit (përafërsisht i viteve 1792- para Krishtit) i gjetur në Irakun Jugor të sotëm, përmban ligjin më të vjetër të shkruar të birësimit (Barbara, Moe, 2007: 1). Ai njihet si vepra e parë e madhe juridike në botë (Anastasi, 2006: 18).

Grupimet e ligjeve të mëparshme janë zhdukur, por janë gjetur disa gjurmë të tyre dhe Kodi i Hamurabit në mënyrë të qartë nënkupton ekzistencën e tyre (Horne, 1915). Mbreti Hamurab e shpalli Kodin pasi kishte rindërtuar unitetin e Babilonisë (Anastasi, 2006: 18).

Kodi vetë ishte i organizuar me llogjikë dhe kujdes dhe rënditja e seksioneve të tij kushtëzohej nga lënda (Herman & Johns, 1910-1911). Ai përbëhej nga 282 nene, të shkruara në 12 tableta që rregullonin në mënyrë të qartë dhe strikte organizimin e shoqërisë. Në seksionin për familjen, nenet 185-191 rregullonin marrëdhënien e birësimit midis birësuesit dhe të birësuarit. Ndryshe nga ligjet më të hershme, ai shkruhej në gjuhën akadiane, gjuha e përditshme e Babilonisë dhe mund të kuptohej nga çdokush në qytet që dinte të lexonte (Breasted, 2003: 141).

Ky Kod, ishte një vijmësi e traditave Sumeriane dhe Akadiane. Sipas këtij kodi, biësuesi vendoste një marrëdhënie shumë të fortë me të birësuarin, të njejtë me lidhjet e gjakut. Birësimi ishte shumë i zakonshëm në Babiloni për prindërit pa fëmijë biologjik ose për ato prindër që ishin në moshë të vjetër dhe që kishin mbetur vetem pasi fëmijët e tyre ishin martuar.

Vëmë re se, arsyet e birësimit drejtoheshin nga interesi i prindërve, të cilëve u jepej mundësia për të krijuar familje apo për të gjetur 'kujdestar' për shkak të moshës së tyre. Procedura e birësimit kryhej nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate në të cilën mirëpërcaktoheshin të drejtat dhe detyrimet e palëve. Mund të flasim për të drejta dhe detyrime të të birësuarit më shumë kur ai ishte në moshë madhore dhe birësimi bëhej për shkak të moshës së vjetër të prindërve.

### *3.2.2 Dokumentet Nuzi*

Tekstet Nuzi janë dokumente të kohës antike të qytetit të Nuzit në Mesopotaminë e atëhershme, të cilët paraqisnin aspektet ligjore ekonomike, shoqërore dhe religjioze. Ato duhet të datojnë gjysmës së parë të shekullit të XIV para Krishtit [21]. Birësimi në Mesopotami ishte gjerësisht i përdorur. Nuzi ishte një qendër administrative jo larg nga kryeqendra Hurrian në Kirkuk në veri të Irakut të sotëm, ateherë Mesopotamia. Rregullimi ligjor që dokumentet Nuzi i bënin birësimit, ishte i ngjashëm më atë të Gjenezis. Dokumentet Nuzi shpreheshin rreth marrëveshjeve apo kontratave që një burrë mund të birësonte një grua si motër duke i dhënë asaj një pozitë më të lartë dhe një mbrojtje më të madhe. Kjo mund të shpjegojë pse Abraham (Gjeneza 12:10:20) dhe Isac (Gjeneza 26:7) thanë që gratë e tyre ishin motrat e tyre. Është e mundur që ato t'i kenë birësuar ato për t'u dhënë një status më të lartë sipas zakoneve [22].

---

[21] Gazeta: Zeitschrift der Deutschen Morgenlandischen botimi 1, 2011

[22] http://www.biblearchaeology.org/post/2006/02/27/Great-Discoveries-in-Biblical-Archaeology-The-Nuzi-Tablets.aspx data e aksesit 9.07.2015

Sipas teksteve Nuzi popullsia e mbretërisë Arrapha, njihte tri lloje birësimi në lidhje me vajzat gjatë mesit të shekullit të pesëmbëdhjetë dhe gjashtëmbëdhjetë para Krishtit. Dikush mund të birësonte një vajzë *ana mãrtũti* "si bijë", *ana kallũti* si "thjeshtër". Çdokush mund të jepte të bijën ana mãrtũti për marrëdhënie bijësie, ta jepte atë së bashku me nënën e saj (bashkëshorten e tij) për birësim. Mund të ndodhte që një grua të jepej për birësim, por që kjo marrëdhënie të pasohej me një martesë të mëvonshme me një person të tretë.

Raste të tjera kishin të bënin me birësimin e një vajzë nga birësuesi duke vendosur marrëdhënie "motër-vëlla", me qëllim për të lidhur martesë më vonë, për shkak se mosha e vajzës ishte nën moshën e lejuar për martesë. Marrja e një vajze *ana kallũti*, është një premtim nga ana e birësuesit që ta martojë atë me të birin ose me një skllav. Skllevërit konsideroheshin anëtarë të familjes. Në kontekstin e fleksibilitetit ligjor, ka gjithashtu praktika që e ndryshojnë terësisht mënyrën tonë të të përceptuarit të birësimit, të tilla si birësimi i babait ose nënës[23].

### 3.3 Instituti i birësimit sipas të drejtës romake

Që në kohët antike, në të gjitha kulturat njerëzore, fëmijët janë transferuar/kaluar nga të rritur që nuk donin ose nuk mundeshin të ishin prindër, në të rritur të cilët i donin këta fëmijë për t'u dhuruar dashuri, punë ose pasuri.[24] Termi romak ishte "adoptio". Adoptio, nënkuptonte adoptio dhe adrogatio. Adrogatio ishte termi i birësimit të një të rrituri si *son homo siu juris* i cili nuk ishte nën pushtetin e të atit ose ishte vetë *paterfamilias.*

---

[23] Gazeta: *Zeitschrift der Deutschen Morgenlandischen Gesellschaft botimi 1 2011, fq 11*

[24] http://pages.uoregon.edu/adoption/topics/adoptionhistbrief.htm data e aksesit 5.12.2014

**ADOPTIO**

**Adoptio** | **Adrogatio**

*Mund të birësoheshin:*

-personat nën pushtetin e paterfamiliasit

-të miturit,vajzat, gratë,skllleverit

*Mund të birësohej:*

- i rrituri->son homo siu juris
- paterfamiliasi

Efektet

Të dy llojet e birësimit i jepnin të birësuarit të njejtat të drejta dhe detyrime me fëmijët biologjik.

*Fig.1*

Të drejtat dhe detyrimet e të birësuarit ishin të njëjta me ato të fëmijës biologjik, të trashëgonin mbiemrin dhe pasurinë dhe të kujdeseshin për familjen. Fëmijët luanin një rol të rëndësishëm në jetën e familjes romake, ato ishin nën pushtetin dhe kontrollin absolut të babait. Autoriteti kompetent që merrej me procedurat dhe miratimin e birësimit ishte gjykata, pretori, ose administratori i zonës.

Në Perandorinë Romake, në birësim kryesisht përfshiheshin meshkujt e rritur dhe aristokracia. Familjet e pasura që nuk kishin djem, shpesh herë birësonin djem të rritur për të pasur një trashëgimtar. Praktika e birësimit në Romën antike është e dokumentuar në Kodin e Justinianit. Birësimi fillimisht propozohej për të kompensuar mungesën e një trashëgimtari biologjik (Gaudement, 2000: 74).

Por, në ndryshim me kohët moderne ku birësimi bëhët kryesisht për të krijuar familje dhe për të vendosur marrëdhënie prindërore, në Romën e vjetër, birësimi filloi të bëhej kryesisht për arsye politike ose ekonomike, ashtu siç bëhet sot birësimi i personave madhore që lejohet

vetem në disa shtete. Duke pasur një trashëgimtar, sigurohej vazhdimësia e familjes, mbiemrit, pasurisë, apo edhe e titullit që mbante babai, siç mund të ishte ai i perandorit, ku perandori i ardhshëm do ishte i biri, qoftë fëmija biologjik apo ai i birësuar. Duke tejkaluar përdorimin normal familjar të tij, birësimi ndonjëherë i përgjigjej disa shqetësimeve sociale ose politike, që bënin fjalë për të integruar një plebe në grupin e patricëve, ose, në të kundërt, për të 'transferuar' tek plebejtë një patric i cili kështu mund të kandidonte për tribunatin e plebejnve (Gaudement, 2000:74). Birësimi shërbente gjithshtu edhe për të kaluar pushtetin suprem të perandorisë (Prevost, 1950: 360-381). Disa perandorë romak si Hadrian (117-138), Trajan (98-117) Mark Aureli (161-180), Nero, Antonius Pius, Kaligula, Tiberi dhe Augusti ishin të birësuar. Oktavi, i vetëquajtur August pasi u bë perandor, ishte i birësuari i Jul Çezarit, përmes proçesit të birësimit adrogatio. Duke qënë dhe nip i Çezarit, ky birësim i dha mundësinë Oktavit të kishte mbështetjen e duhur politike për t'u bërë Parandori i I-rë i Romës. Birësimi praktikohej si një mjet për të siguruar një trashëgimtar me fokus në interesin e të rriturve; perandori Trajan, birësoi Hadrianin, i cili e pasoi atë si perandor në 117 (Alstein & Simon,1991: 2).

Një varg birësimesh të tjera u bënë me qëllimin për të zgjedhur perandorët e ardhshëm. Mark Aureli u birësua nga Antonius rreth moshës 17 vjeçare dhe u martua me vajzën e tij. Ai punoi përkrah babait të tij adoptues ndërsa mësonte mënyrat e qeverisjes dhe çështjeve publike. Ishte Hadrian, ai i cili kishte birësuar Antonius-in si djalin e tij dhe që gjithashtu ndërhyri që Mark Aureli dhe Verus[25] të birësoheshin nga Antonius. Në epoken e Antonius, pushteti perandorak u kaloi dy binjve të birësuar (Parsi, 1963). Panvarësisht se Antonius e kishte

[25] Lucius Aurelius Verus Augustus ishte emri i tij, por që zakonisht përdoret dhe e hasim me emrin Verus.

përzgjedhur Mark Aurelin si pasuesin e tij të vetem, Mark Aureli insistoi që Verus të ishte bashkë-sundimtar.

*Pse kaq shumë perandorë romak birësonin pasuesit e tyre?* Mungesa e trashëgimtarëve biologjik ishe arsyeja kryesore pse gjithë këto perandorë ishin të birësuar. Ashtu siç Susan Treggiari citon në Fjalorin e Oxford-it:"Birësimi i meshkujve të rritur ishte një..., i përshtatshëm për aristokratët pa fëmijë dhe për perandorët që kishin nevojë për një pasues". Në këto familje sundimtarësh hasim rastet tipike të birësimeve në antikitet, ku arsyet ishin kryesisht për të zgjedhur një sundimtar për vendin, apo për lidhje martesore të mëvonshme. Birësimet për fëmijët e braktisur apo pa prindër ishin të rralla. Këto fëmijë merreshin për skllavëri. Gjithashtu, birësimet e vajzave ishin shumë të rralla dhe bëheshin nëpërmjet proçesit të adoptio. Fillimisht, vetem burrat mund të birësonin për shkak të statusit të tyre të paterfamilias-it. Kjo ndryshoi më vonë, kur dhe femrat u lejuan të birësonin.

Në Kodin e Justinianit citohet: *"…kur një filiusfamilias (biri i një familje) është dhënë për birësim nga babai i tij natyral një të huaji, pushteti i babait natyral nuk bie; asnjë e drejtë nuk kalon tek babai birësues…"*. Në të drejtën romake birësimi synonte të përmbushte interesat e të rriturve; vetëm kohët e fundit birësimi është fokusuar në interesin të fëmijëve (Goody, 1969: 59-61).

### 3.4 Pikëpamjet e Bibles ndaj birësimit

Në bibël gjejmë dy kuptime të termit birësim. Njëri i referohet kalimit të fëmijëve ose personave madhore në një familje tjetër nga ajo e origjines dhe termi tjeter i referohet birësimit të besimtarëve nga Zoti. Kjo doktrinë pasqyrohet tek Galatians 3:26-4:7. Sipas kësaj doktrine, të gjithë të pagëzuarit pa dallim, skllevër apo të lirë, meshkuj dhe femra, të gjithë janë të Krishtit dhe nëse janë të Krishtit atëherë janë fara e Abrahamit dhe trashëgimtarë të tij sipas premtimit.

Në bibël gjejmë evidenca që ky institut ka qënë ekzistent edhe atëherë. Në bibël thuhet se Zoti kërkon nga njerëzit që të birësojnë besimtarët e rinj si fëmijë të tyre dhe t'u japin atyre të njejtat të drejta trashëgimie si fëmijëve biologjik (Ro´m 8:14-17 dhe Gal 4:5-7). Aty përmendën raste të ndryshme si birësimi i shërbyesit Eliezer nga Abrahami (15:2-3), Jacob ishte birësuar nga Laban, i cili nuk kishte djalë, në analogji të një kontrate Nuzi, në të cilën një burrë pa fëmijë birëson një djalë, e bën atë trashëgimtarin e tij dhe i jep atij vajzën e tij për grua (29-31)[26]. Libri i Exodus tregon historinë e Jochebed, një grua Hebre, e cila lindi një djalë në kohën kur faraoni kishte urdhëruar që çdo bebe mashkull e lindur duhet të vritej (Exodus 1:15-22), Jochebed e vendosi fëmijën në një shportë dhe e la atë në rrjedhën e lumit. Vajza e faraonit e gjeti shportëm me fëmijë, e birësoi atë dhe i vendosi emrin Moisi. Moisiu u bë një shërbyes i Zotit (Exodus 2:1-10). Jezu Krishti ishte adoptuar dhe rritur nga bashkëshorti i mamasë së tij, Jozefi, i cili e rriti Jezusin si fëmijën e tij. Bibla citon disa raste të birësimeve të ndryshme, të tilla si rasti i Genubath (1Ki 11:20), Esther (Es 2:7), Moisiu (Exod 2:10), por nuk ka evidenca që këto birësime ishin ndërrmarrë nëpërmjet një proçesi

---

[26] http://www.jewishvirtuallibrary.org/jsource/judaica/ejud_0002_0001_0_00486.html dt07/12/2014

ligjor. Dimë se birësimi ishte një institut evident shumë kohë më përpara lindjes së Jezu Krishtit dhe zbulesës së Bibles, ndaj në këtë periudhë birësimi ishte pothuajse në të gjitha qyteterimet i rregulluar me ligj.

Bibla nuk merrej me aspektin ligjor të birësimit, por e përmend atë si veprimin e duhur të besimtarëve ndaj fëmijëve pa prindër. Ester, sipas librit me të njejtin titull, ishte birësuar nga kushëriri i saj Mordekai pas vdekjes së prindërve. Ajo u bë mbretëreshë dhe Zoti e udhëzoi t´i sjelltë lirinë popullit hebre.

### 3.5 Birësimi sipas Kuran dhe të drejtes islamike

E drejta islamike e shikon konceptin e birësimit në një këndvështrim tjetër nga ai shoqërive të lashta Greke, Romake, Egjyptiane, por edhe nga koncepti modern i birësimit sot. Birësimi njihej dhe praktikohej në shoqëritë arabe para islamike dhe me anë të tij i birësuari njihej si i lindur nga prindërit birësues (Assim, 2014: 326); dhe kishte statusin ligjor të një fëmije legjitim (HouHou, 2014: 10). Ky koncept ligjor i birësimit u hodh poshtë nga ato vende që filluan të përqafonin islamin, ndaj konsiderohej i papranueshëm në krijimin e një komuniteti të ri islamik në Mekë dhe Medinë në atë kohë (Pearl&Menski, 1998: 408). Islami ka si parim t'u sigurojë fëmijëve jetim dhe fëmijëve të pambrojtur, sigurinë që një mjedis familjar ofron (Assim, 2014: 327).




*Zbritja e Kuran në tokë*

*Fig.2*

Sheriati është tërësia e parimeve dhe dispozitave të përgjithshme të së drejtës islame. Dy burimet themelore të tij janë Kur'ani dhe Sunneti. Sipas fjalorit të Oksfordit, *"Sheriati është sistemi ligjor Islamik bazë"...është një interpretim i parimeve të Kuranit dhe që mbulon të gjithë pjesët e jetës së një Myslimani.* Sheriati është një kodifikim i së drejtës islamike dhe rregullon fusha të ndryshme të së drejtës si atë familjare, penale, civile, tregtare. Termi Sheriat përdoret në Kuran në suren 45 vargu 18 dhe nënkupton shtegun nga shkretëtira për në burimin e ujit. Nuk ka një kufi të qartë midis rregullimeve ligjore dhe fetare (Lamçe, 2013: 183). Sipas Sheriatit është e ndaluar që një person të birësojë një djalë ose vajzë kur nuk është prindi biologjik i tij/saj. Në vendet islamike, panvarësisht ndryshimeve që bëhen në Kodet e familjes, legjislatorët nuk i tejkalojnë konceptet Kuranore rreth birësimit. Në ditët e sotme, pavarësisht nevojave shoqërore, shumica juristëve në vendeve myslimane nuk janë përkrahës të ndryshimeve në legjislacion për lejimin e birësimit në konceptin e plotë të tij. Ndryshe nga Judaizmi dhe Kristianizmi, islami ka rregullat e tij për 'birësimin' (Lammers, 2008: 13). Birësimi ashtu si dhe institutet e tjera të së drejtës, lejohej në respekt urdhëresave e Allahut.

Profeti Muhamed ka thënë: *“Unë dhe kushdo tjetër që kujdeset për jetimët jemi bashkëudhëtarë në Kopështin e Edenit”.* Ai birësoi Zaidin, birin e Haritha, të cilin e quajti birin e tij. Në Kuran citohet se:

*“nuk mund të bëhet bir dikush thjesht me anë të një deklarate…kjo është thjeshtë thënia juaj, nga goja juaj, por Allahu thotë të vertetën, dhe ai u udhëzon në rrugën e drejtë…Thërrisni ato (fëmijët në kujdestari) në emrin e babait të tyre sepse është më në udhën e Allahut, e nëse nuk u njihni babain ato janë vëllezërit tuaj në fe* (Kuran 33:4-5).

Pas zbritjes së Kuran në tokë, marrëdhënia ndërmjët Muhamed dhe Zaid nuk ndryshoi por Zaid u quajt sërish biri i Haritha.

Kjo tregon se islami e ndalon birësimin e fëmijës, kështuqë një fëmijë jetim i braktisur mund të merret në kujdestari për t´u rritur dhe edukuar, por pa gëzuar të drejtat dhe privilegjet e fëmijes biologjik. Një deklaratë me gojë apo një kontratë nuk mund ta bëjë lidhjen e gjakut ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit. Islami e shikon birësimin si një mbulim të së vertetes, të origjinës së fëmijës, duke dalë jashtë kornizave të së vertetës dhe jashtë asaj çfarë feja predikon. Në islam birësimi nuk mund të përdoret si mbulim i lindjeve jashtëmartesore, duke fshehur prindërit e vertetë të fëmijës, por çdokush që merr, rrit, edukon dhe e mbron si fëmijën e vet por pa i dhënë të drejtat e fëmijës biologjik dhe pa i fshehur origjinën, është i bekuar nga Allahu. Sipas Kuranit, ai do shpërblehet me Parajsën. Pra shohim ekzistencën e institutit të kujdestarisë që praktikohet për fëmijët e braktisur dhe jetimë. Ky institut në të drejtën islamike njihet me termin *kafala* dhe lejon marrjen ne kujdestari të fëmijëve duke i rritur si fëmijë biologjikë por pa të drejta trashëgimie apo mbiemrit.

Detyrat e prindërve janë të mirëpërcaktuara në islam. Nëna duhet të ushqejë me gji fëmijën deri në moshën 2 vjeçare dhe më pas të kujdeset për të deri në pubertet që për vajzat kjo

përkujdesje shkon deri në martese. Ndërsa babai ka për detyrë të kujdeset për arsimimin, veshjet dhe ushqimin e fëmijëve. Ai është përsoni përgjegjës për sjelljen e të ardhurave në familje dhe mbulimin e shpenzimeve.

*"Për këtë botë dhe në botën tjetër. Dhe të pyesin ty për fëmijët jetimë. Thuaj: "Përmirësimi për ta është më mirë, e nëse i përzieni punët tuaja me të tyret -. Ata janë vëllezërit tuaj" (Kuran 2:220). Dhe jepuni jetimëve pronat e tyre...dhe mos i konsumoni ato si tuajat…e ato që marrin pasuritë e tyre do digjen në zjarr (Kuran 4:2; 4:10).*

Në Kuran është e shprehur qartazi mbrojtja për fëmijët jetim dhe të braktisur, ashtu siç është dhe mosfshehja e prindërve biologjikë të fëmijës. Kjo është për shkak se Islami kërkon të ruajë prejardhjen biologjike dhe jo ta shkatërrojë atë. Një ndër vlerat që islami predikon është mosfshehja e të vertetës. Profeti Muhamed kishte "birësuar" gjithashtu një djalë, Zeidin. Këtë e gjejmë tek surja 33:37 në Kuran. Në Kuran gjejmë dhe shembuj të tjerë birësimi si ai i Jozefit dhe Musait (Kuran, 12: 21). Maroku, si një ndër vendet tipike të praktikimit të drejtes islamike mbi bazën e Ajeteve Kuranore e shikon familjen si të shenjtë dhe se e verteta mbi përbërjen e saj nuk duhet të fshihet.

Insemimi artificial është një formë moderne birësimi kategorikisht e ndaluar në islam, duke u konsideruar si një mekat i madh po aq sa tradhëtia bashkëshortore.

### *3.5.1 Instituti i Kafala-së dhe mungesa konkrete e termit "birësim" në të drejtën islamike*

*"Nuk ka pasur një shtytje të përbashkët për të hapur dyert për jetimët myslimanë, sepse pritej që këto përpjekje të dështonin"*

-Chuck Jonson, shef ekzekutiv i Këshillit Kombëtar të Birësimit, SHBA

Birësimi, një institut i njohur gjërësisht nga shumica e shteteve, sipas të cilit midis birësuesit dhe të birësuarit vendosen marrëdhenie të njejta me ato të prindit dhe fëmijës biologjik, është i ndaluar në shtetet islamike. Duke qënë se këto shtete si bazë të legjislacionit të tyre kanë Sheriatin praktikojnë një version tjetër të birësimit, atë të *kafala*. Edhe pse i konceptuar si një institut birësimi, kafala, i kufizuar nga normat e së drejtës islamike, ka një ngjashmëri me institutin e kujdestarisë dhe me birësimin e thjeshte në vendet e tjera jo islamike.

Po t'i referohemi kuptimit literal të fjalës kafala në gjuhën Arabe, ajo rrjedh nga folja *takafala*, që do të thotë të kujdesesh për një jetim duke i siguruar ushqim, veshmbathje dhe edukim. *Kafil*, i cili është prindi 'birësues'apo kujdestar, pranon të kujdeset dhe të mbështesë *makfoul*, fëmijën nën kujdestari deri sa të arrijë moshën madhore.

Neni 116 i kodit të familjes algjerian thotë: *"Kafala është angazhimi për të marrë përsipër me dëshirë mirëmbajtjen, edukimin dhe mbrojtjen e një fëmije minoren, njësoj siç do bënte babai për fëmijët e tij"*.

Në të drejtën marokene ky institut rregullohet nga ligji nr.15-01 dhe përkufizimi për kafala është i njejtë me atë në kodin algjerian të familjes. Sipas Kodit Maroken mbi Statusin Personal, birësimi nuk ka efekte ligjore dhe nuk prodhon asnjë nga efektet e marrëdhënies prind-fëmijë.

Ndërsa kuptimi i birësimit në vendet perëndimore shkon përtej këtij koncepti, duke i dhënë të drejtën fëmijës së birësuar të marrë mbiemrin e prindit/prindërve birësues dhe të trashëgojë si fëmijë biologjik. Në këto shtete si në Francë dhe Itali hasim dy lloje birësimi: a) birësimi i plotë dhe b) birësimi i thjeshtë. Birësimi i plotë, është ai lloj birësimi që juristët myslimanë e kanë shmangur më së shumti, (Pesle, 1919: 10) për shkak të krijimit të marrëdhënieve të bijësisë ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit. Sipas të drejtës algjeriane marrëdhënia e bijësisë nuk varet vetem nga statusi i fëmijës i birësuar apo biologjik por së pari nga marrëdhënia e prindërve të cilët duhet të jenë patjetër të lidhur nga martesa. Fëmija si makfoul nën kafala edhe pse nuk fiton të drejtat trashëgimore nga prindërit kafil, trashëgon nga pasuria e prindërve biologjik nëse ato njihen. Kurani është shumë i qartë në lidhje me çështjen e trashëgimit të pasurisë duke e lejuar këtë të drejtë vetem midis lidhjeve të gjakut.

Megjithatë Kuran i udhëzon besimtarët myslimanë që 1/3 e pasurisë së tyre ta shpërndajnë tek më të varfërit dhe në praktikë zakonisht fëmija makfoul përfiton *sadaka* nga pasuria e prindërve kafil. Kafala erdhi si një përshtatje e institutit të birësimit sipas rregullave të Kuranit.

Praktikohen dy lloje të kafala-së.

a) Kafala-ja gjyqësore

b) Kafala-ja noteriale

Për fëmijët të cilët janë të braktisur dhe të vendosur në shtëpitë e fëmijëve, është gjykata ajo që merr vendimin për kalimin e fëmijës nën kujdestarinë e një familje. Ndërsa për fëmijët, për të cilët janë prindërit e tyre biologjik ato që vendosin që fëmija të kalojë nën kujdesin e një familje tjetër për t'u rritur dhe edukuar, është i nevojshëm vetem çertefikimi noterial për të vendosur marrëdhenien e kafala-së. Një ndër arsyet pse prindërit vendosin që të heqin dorë

nga përgjegjësia prindërore ndaj fëmijëve të tyre bazohet në mundësitë e vështira ekonomike për t'i rritur dhe edukuar ato dhe për t'iu ofruar një të ardhme të mirë. Arsye tjetër mjaft e rëndësishme është dhe steriliteti ose mungesa e një fëmije mashkull i një çifti të afërm. Dy familjet mund të bien dakort akoma pa u ngjizur fëmija dhe që prindërit biologjik do e sjellin në jetë atë në dakortësi të plotë që të rritet dhe edukohet nga prindërit kujdestarë.

Revokueshmëria e kafala-së është e mundur në çdo kohë dhe për të dy llojet e saj. Sipas kafala, fëmija në asnjë rast nuk i shkëput marrëdheniet me familjen e origjinës dhe është në dijeni të plotë për origjinën dhe për prindërit e tij biologjik. Megjithatë, në ato raste kur fëmija është marrë foshnje dhe është ushqyer me gji nga nëna 'birësuese' atëherë ai mund të konsiderohet si fëmijë biologjik i prindërve. Krijimi i një marrëdhënie të tillë bijësie në islam quhet *rizâ* dhe fëmija *mahram*. Lidhjet martesore në kafala ndërmjet makfoul dhe ndonjë anëtari tjetër të familjes kujdestare janë rreptësisht të ndaluara. Vajzat makfoul duhet të mbajnë hijâb[27] edhe gjatë qëndrimit në shtëpi, ndërsa vajzat mahram mund të mos e veshin hijâbin sepse konsiderohen si i njejti gjak me anëtarët e tjerë të familjes.

Në vendet myslimane, me përjashtim të Turqisë, Indonezisë dhe Tunizisë, *kafala*, përcaktohet si një premtim apo marrëveshje vullnetare, për t'u kujdesur për mirëqenien dhe edukimin e një fëmije. Në kuadër të zhvillimeve dhe ndryshimeve të fundit në kontekstin e birësimit në islam, mund të themi se jemi nën dritën e një optimizmi që po sjell ndryshime në këtë fushë. Kafala pushon me arritjen e moshës madhore të fëmijës.

Në legjislacionin islamik, birësimi, i cili krijon lidhje familjare të krahasueshme me ato të krijuara nga bijësia biologjike, është i ndaluar. E drejta islamike në vend të kësaj, lejon një

[27] Hijâb është mbuloja për femrat myslimane pasi ato arrijnë moshën e pjekurisë. Ato mund të mos e veshin hijâbin në prani të femrave ose dhe të meshkujve që kanë lidhje gjaku me to.

formë ligjore të kujdestarisë e quajtur kafala. Në vendet myslimane, *kafala*, përcaktohet si një premtim apo marrëveshje vullnetare, për t'u kujdesur për mirëqenien dhe edukimin e një fëmije; përjashtim bëjnë Turqia, Indonezia dhe Tunizia.

Egjipti e lejon birësimin vetem për jo myslimanët duke mos u kufizuar nga Sheriati. Në praktikë, leja për birësim zakonisht nuk jepet për fëmijët e humbur të cilët janë në një moshë që të dinë emrin e tyre sepse prezumohet që familja e tij është në kërkim të tij; por mund të birësohen ato që kanë humbur ose janë braktisur që foshnje (Assim, 2014: 16). E kundërta ndodh me Tunizinë e cila birësimin ndërvendas e lejon vetem për çiftet myslimane.

### *3.5.2 Njohja e Kafala-së në vendet perëndimore*

Birësimi në shtetet anëtare të BE-së nuk barazohet me institutin e kafala. Njohja dhe konvertimi i kafalasë në birësim ka hapur debat doktrinal dhe jurisprudencial. Nuk ka një qëndrim të unifikuar përsa i përket kafalasë në vendet e BE-së. Disa shtete nuk e pranojnë konvertimin e këtij instituti në birësim, e disa shtete të tjerë nuk kanë një praktikë gjyqësore të unifikuar. Megjithatë ka një tendencë në njohjen dhe zbatimin e instituteve të ndryshme nga institutet e tyre kur ato i garantojnë mbrojtje fëmijës (Lamçe, 2014: lex, UET).

Konventa e Hages "Për juridiksionin, ligjin e aplikueshem, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin në respekt të përgjegjësisë prindërore dhe masave për mbrojtjen e fëmijëve" datë 19 tetor 1996, në nenin 3 të saj e përcakton kafala-në si një mjet për të ushtruar përgjegjësinë prindërore. Prej vitesh synohet ratifikimi nga sa më shumë shtete i kësaj konvente, në mënyrë që institutet e përmendura në të si përgjegjësia prindërore dhe mbrojtja e fëmijëve, të njihen njësoj nga të gjitha shtetet. Gjithashtu, sipas Kartës Afrikane të Fëmijëve

dhe udhëzimeve të Kombeve të Bashkuara, Kafala është formë alternative e kujdesit ndaj fëmijëve. Konventa e OKB e vitit 1989 "Mbi të drejtat fëmijëve" në nenin 20 të saj, ashtu si birësimin apo shtëpitë e fëmijës, e rëndit kafalanë ndër mjetet e pershtatshme për mbrojtjen e fëmijëve të cilët gjenden përkohësisht ose përfundimisht të privuar nga mjedisi familjar ose kur për të mbrojtur interesin më të lartë të tyre nuk mund të lejohen të qëndrojnë në atë mjedis. *Neni 20, pika 3 i Konventes thotë:*

*"Kjo përkujdesje alternative mund të këtë inter alia, formën e vendosjes në një familje të "Kafalasë" sipas të drejtës islamike të birësimit ose në rast nevoje, të vendosjes në një qendër të përshtatshme të kujdesit për fëmijët."*

Pavarësisht se idea e rënditjes kontestohet nga e drejta ndërkombëtare, prioriteti i dhënë opsioneve me bazë familjen, sherben të nënvizojë rëndësinë e një mjedisi familjar për zhvillimin e duhur të fëmijës (Cantwell & Holzscheiter, 2008: 19).

Marrja e një fëmijë në kafala, gjithmonë e më tepër po fokusohet drejt zgjerimit të familjes dhe interesit më të lartë të fëmijës duke e drejtuar këtë institut drejt logjikës së birësimit. Këtu përmendim vendimin numër 156 të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, *Harroudj kundër Frances*, i datës 04.10.2012. Pas refuzimit që kishte marrë nga gjykatat franceze për të konvertuar marrëdhënien me fëmijën nga kafala në birësim, shtetesja franceze Harroudj iu drejtua GJEDNJ-së. Gjykata vendosi unanimisht se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 "e drejta për të respektuar jeten private dhe familjare" të Konventes Europiane të të Drejtave të Njeriut. Duke qënë se Franca është vendi europian me më shumë emigrantë nga vendet islamike, ka një praktikë gjyqësore më të pasur në lidhje me çështjen në fjalë. Sipas Kodit Civil Francez birësimi i një të mituri nuk lejohet nëse vendi i tij i origjinës e ndalon atë. E kundërta ndodh nëse fëmija i lënë në kafala ka lindur në Francë.

Në një vendim në 1995, Gjykata e Apelit Tuluzë, ka lejuar konvertimin e një kafala-je në birësim të thjeshtë. Një vendim i tillë i gjykatës është krejt logjik duke e parë në aspektin e ngjashmërisë së madhe të kafala-së me birësimin e thjeshtë. Gjykata e Apelit në Paris, në një vendim të saj në 1 shkurt 2001 ka marrë një vendim komplet të kundërt, duke marrë në konsideratë që Kodi i Familjes algjerian e ndalon birësimin dhe pranon vetem kafala-në. Sipas kësaj gjykate, autorizimi që kanë dhënë autoritetet algjeriane që fëmija mund të marrë mbiemrin e personave që e kanë marrë përsiper, ka pasur për qëllim që të lejonte përfshirjen sociale dhe nuk ka asnjë lidhje me bijësinë ndaj nuk autorizon asimilimin e kafala në birësim të plotë (Houhou, 2014: 33).

Parlamenti francez miratoi në 2001 ligjin 2001-111 që trajton çështjen e birësimit të fëmijëve të huaj të lindur në vendet që e ndalojnë atë. Marrëveshja bilaterale ndërmjet Frances dhe Algjerisë e 27 dhjetorit 1968, e modifikuar në 2001 (Cournil&Reico, 2009: 241) që disiplinon kushtet e lëvizjes, punësimit, hyrjen dhe qëndrimin e algjerianëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Francë, u hap rrugën kërkesave për bashkim familjar të fëmijëve në kafala nëse ato janë rezidente të ligjshëm në Francë. Fëmijët nën kafala të cilët nuk kanë një leje qëndrimi në Francë nuk mund të marrin as bashkimin familjar me familjen me të cilën janë të lidhur më kafala. Në lidhje me këtë çështje mund t'i referohemi vendimit të Gjykatës së Apelit të Lionit i datës 22 shkurt 2011 nr.10LY01740 i cili refuzon dhënien e bashkimit familjar për një fëmije 17 vjeç nga Algjeria me tezen e tij rezidente në Francë, të lidhur së bashku dhe nga instituti i kafala-së. Refuzimi i bashkimit familjar vjen si pasojë e qëndrimit joligjor të fëmijës në territorin francez.

> *"Parlamenti Europian ka shqyrtuar edhe çeshtjen specifike te krijimit te Gjykatave islamike në disa shtete anëtare të BE-së. Kjo lidhet drejtperdejte me njohjen e një perjashtimi: moszbatimin e ligjit të*

*brendshëm në favor të ligjit të huaj. Komisioni shprehet se "nuk është në dijeni të ekzistencës së këtyre gjykatave" dhe se "sidoqoftë, këto vendime nuk mund të kenë vlere juridike për sa kohë nuk dalin nga gjykata të ngritura sipas ligjeve të shteteve anëtare: i takon shteteve anetare te garantojne respektimin e rendit juridik te brendshem" (Lamçe J., Lex UET, 2014).*

Rezulton se fëmijët nën kafala, nuk mund të birësohen nga ato që i kanë rritur (Houhou, 2014: 29). Kafala nuk krijon marrëdhënie bijësie, nuk jep të drejta trashëgimore dhe nuk mjafton për ta titulluar fëmijën me të drejtën e marrjes së shtetësisë të kujdestarit (GJEDNJ, 2012: Harroudj kundër Francës). Gjykata Europiane e Drejtësisë mbron dhe garanton të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare të përcaktuara në Konventen Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Në çështjen *Chbihi Loudoudi dhe të tjerë kundër Belgjikës*, kërkesa e aplikantëve ka të bëjë me refuzimin nga ana e autoriteteve belge për të njohur marrëveshjen e kafalasë dhe aprovimin e birësimit të mbesës së tyre. Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventes (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) në lidhje me refuzimin e birësimit dhe ska pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me statusin e rezidencës së fëmijës. Gjykata argumenton se refuzimi për birësim nga autoritetet belge është bërë në përputhje me ligjin dhe me Konventen e Hages nr.33, për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës dhe përsa i perket rezidencës së fëmijës pengesa e vetme kishte qënë pamundësia për të marrë pjesë në një ekskursion me shkollën, kjo e pamjaftueshme për të dhënë lejën e birësimit nga autoritetet belge.

Për shkak të lëvizjeve të shumta migratore nga vendet islamike në ato perëndimore, kanë lindur dhe shumë problematika në lidhje me institutin e kafalasë si pasojë e mos konvertimit në birësim.

# KAPITULLI IV-BIRËSIMI NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE

## 4.1 Hyrje

*"Të pranohet që fëmija për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, duhet të rritet në një ambjent familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi"*

*(Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve, Preambula)*

Birësimi është një e drejtë e rregulluar edhe në aktet ligjore ndërkombëtare globale dhe rajonale. Në të drejtën ndërkombëtare dhe kryesisht në shumicën e legjislacioneve kombëtare të vendeve të ndryshme, birësimi është një ndër alternativat më të mira që u ofrohet fëmijëve jetim apo të braktisur. Parandalimi i ndarjes së familjes dhe ruajtja e unitetit të saj janë komponentë të rëndësishëm në sistemin e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në nenin 9 paragrafi 1 i Konventes së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (Borzova, 2015: 8). Fatkeqësisht jo të gjithë e marrin kujdesin e familjes, ndaj është detyra e shtetit t'i sigurojë çdo fëmije, mundësinë për t'u rritur në ambjente që u sigurohet përkujdesje, përkushtim, arsimim, ushqim, strehim, në interesin më të lartë, në bazë të standarteve ndërkombëtare. Kuptimi i termit "familje" ka ndryshuar me kalimin e viteve duke sjellë nevojën e ndryshimeve ligjore në rang ndërkombëtar dhe kombëtar.

Që në fillim të viteve 60' birësimi ka qënë një ndër problematikat e trajtuara nga Këshilli i Europes. Fëmijët në shtetet anëtare të Këshillit të Europës, kanë të drejtë të gëzojnë gamën e plotë të të drejtave të njeriut, të mbrojtura nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, dhe instrumenta të tjerë

ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut (Strategjia e KiE, 2016-2021). Konventa e parë Europiane për birësimin doli në vitin 1967 dhe përcaktonte parimet esenciale për birësimin e të miturve, parime këto që duhet të adaptoheshin nga shtetet anëtare. Kjo Konvetë mbulon birësimin vendas dhe së bashku me jurisprudencën e GJEDNJ-së ka vendosur standarte në fushën e birësimit. Për të shmangur çdo lloj abuzimi apo trafikimi, është e dosmosdoshme një kornizë ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare solide. Një kornizë ligjore solide për birësimin në nivel kombëtar hap rrugën për një kornizë ligjore më të fortë për birësimin ndërvendas (Boer, 2009: 9).

Nëpërmjet rregullimeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, synohet që të parandalohet shitja dhe trafikimi i fëmijëve në emer të birësimit. Këtu përmendim Konventen e OKB-së për të drejtat e fëmijës; Deklaraten e OKB-së për parimet ligjore e sociale në lidhje me mbrojtjen dhe mirëqënien e minorëve duke i kushtuar një vemendje të veçantë kujdestarisë familjare dhe birësimit kombëtar e ndërkombëtar; Konventa e Hages për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkepunimin në fushën e birësimit ndërkombëtar.

Në aspektin e të Drejtës Ndërkombëtare Private, një sërë çështjesh ngrihen në lidhje me birësimin. Ka ndryshime të mëdha ligjore në rregullimin e këtij insituti në vende të ndryshme. Këto ndryshime konsistojnë në moshën e birësuesit dhe të birësuarit, diferencen e moshës ndërmjet tyre, të drejtat trashëgimore, efektet e birësimit etj. Përsa i përket birësimi në fushën ndërkombëtare, i definuar nga ligji ynë familjar si birësimi ndërvendas, ky ligj parashikon një sërë ndalimesh për njohjen e këtij lloji birësimi në rendin tonë juridik (Kalia A., 2010: 220). Problematikat që prekin fëmijët, kanë qënë gjithmonë në qëndër të vëmendjes në të gjithë botën. Fëmijët përdoreshin për përfitime ekonomike, punonin dhe ishin viktima të diskriminimit. Deri në shekullin e XIX nuk kishte rregullime ligjore të mirëfillta në kuadrin

ndërkombëtar për të drejtat e fëmijëve. Pas Luftës së Parë Botërore, një nga aktet e para të rëndësishme të Lidhjes së Kombeve të krijuar ishte miratimi i Deklaratës së Gjenevës të vitit 1924. Mbrojtja e posaçme e fëmijëve është pohuar edhe në Deklaratën mbi të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Kombet e Bashkuara me 20 nëntor 1959 dhe është njohur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike[28]. Rëndësi të madhe në arenën ndërkombëtare në lidhje me institutin e biërsimit kanë Konventat e Hages e 1993 dhe 1965.

Në të drejtën ndërkombëtare gjejmë disa instrumente ligjorë të cilët garantojnë të drejtat e fëmijëve dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e birësimit. Së bashku me standardet e tjera ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e fëmijës, duke përfshirë ato të miratuara nga Këshilli i Evropës, këto instrumente sigurojë një themel të fortë për gëzimin e të drejtave të njeriut nga të gjithë fëmijët pa asnjë lloj diskriminimi[29].

Të drejtat humane të fëmijëve dhe standartet mbi të cilat çdo qeveri duhet të aspirojë për realizimin e këtyre të drejtave, janë të përcaktuara në Konventen e të Drejtave të Fëmijës (Sommerfeld kundër Gjermanisë). Marrëdhënia ndërmjet prindit birësues dhe fëmijës së birësuar mbrohet nga neni 8 i KEDNJ, në të njejtën mënyrë si mbrohet marrëdhënia ndërmjet prindit dhe fëmijës biologjik.

Instrumentët ndërkombëtarë global dhe rajonal për birësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, rënditën më të detajuar në vijim.

[28] Shih: Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve
[29] Shih: EU Guidelines for the Promotion and Protection of the Rights of the Child

## 4.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar global mbi birësimin dhe të drejtat e fëmijëve

### *4.2.1 Konveta e Hages për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Respekt të Birësimit Ndërvendas*

Konventa e Hages e 29 majit 1993[30] është instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e birësimit të fëmijëve, i cili u ngrit duke pasur parasysh parimet e shpallura në instrumentet ndërkombëtare, sidomos në Konventen e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve të 20 nëntorit 1989 dhe në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Shoqërore dhe Juridike mbi Mbrojtjen dhe Mirëqënien e Fëmijëve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vendosjen në një familje ushqyese dhe birësimin brenda dhe jashtë vendit (Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 41/85, 3 dhjetor 1986). Shqipëria ka aderuar këtë konventë me ligjin Nr.8624, datë 15.6.2000, për aderimin në "Konventën e Hagës "për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"".

Konventa mbulon vetem birësimet që krijojnë një marrëdhënie të perhershme prind-fëmijë dhe synon krijimin e një sistemi bashkëpunimi midis shteteve kontraktuese, për të siguruar

[30] Shtetet që e kanë ratifikuar dhe e kanë në fuqi: Shqipëria (2001); Andora (1997); Armenia (2007); Australia (1998); Austria (1999); Azerbajxhani (2004); Bjellrusia (2003); Belgjika (2005); Brazili (1999); Bullgaria (2002); Burkina Faso (1996); Kanadaja (1997); Kili (1999); Kina (2006); Kosta Rika (1996); Kroacia (2014); Qipro (1995); Republika Çeke (2000); Danimarka (1997); Ekuadori (1996); Estonia (2002); Finlanda (1997); Maqedonia (2009); Franca (1998); Gjermania (2002); Gjeorgjia (1999); Greqia (2010); Hungaria (2005); Islanda (2000); India (2003); Irlanda (2010); Izraeli (1999); Italia (2000); Korea (R.2013); Letonia (2002); Lituania (1998); Luksemburgu (2002); Malta (2004); Mauritius (1999); Meksika (1995); Monako (1999); Mali i Zi (2012); Hollanda (1998); Zelanda e Re (1999); Norvegjia (1998); Panama (2000); Paraguaj (1998); Peruja (1996); Filipines (1996); Polonia (1995); Portugalia (2004); Republika e Maldoves (1998); Rumania (1995); Federata Ruse (R.2000); Serbia (2014); Sllovakia (2001); Sllovenia (2002); Afrika e Jugut (2003); Spanja (1995); Sri Lanka (1995); Suedia (1997); Zvicra (2003); Turqia (2004); Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (2003); SHBA (2008); Uruguaj (2004); Venezuela (1997); Vietnami (2012); Zambia (2015)

që birësimet jashtë vendit të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës dhe duke respektuar të drejtat e tij themelore dhe që të parandalohet rrëmbimi, shitja ose trafikimi i fëmijëve. Fëmija mund të birësohet vetem nëse është shpallur nga shteti i origjinës si i birësueshëm. Kriteret për shpalljen e një fëmije si të birësueshëm, përcaktohen nga legjislacionet kombëtare të shteteve kontraktuese.

Konventa vendos 4 qëllime kryesore:

1. Respektimin e interesit më të lartë të fëmijës në çdo birësim ndërvendas
2. Parandalimin e abuzimeve, shitjes apo trafikimit
3. Garantimin e të drejtës së fëmijëve për të pasur një familje permanente edhe pse jashtë vendit
4. Birësimi ndërmjet vendeve të jetë etik dhe i rregullt

Që në preambulën e saj, vihet theksi në rëndësinë e marrjes së masave të duhura që fëmija të mbetet në kujdesin e familjes së tij të origjinës, duke pranuar se birësimi jashtë vendit mund të ofrojë avantazhin e një familjeje të përhershme për një fëmijë, për të cilin nuk mund të gjendet një familje e përshtatshme në Shtetin e tij të origjinës. Në procedurat fillestare të birësimeve ndërvendase, konventa parashikon disa parime dhe aspekte proceduriale të cilat duhet të udhëheqin birësimin e fëmijëve.

Detyrat e autoriteteve kompetente të shtetit pritës: (neni 5);

1. Vendos nëse prindërit e ardhshëm kanë të drejtë dhe janë të përshtatshëm për të birësuar
2. Sigurojnë që prindërit e ardhshëm birësues janë të këshilluar sipas nevojës
3. Vendosin nëse fëmija autorizohet për të hyrë e banuar përgjithmonë në atë shtet

Çdo shtet kontraktues i Konventës cakton një Autoritet Qendror për të arritur objektivat e Konvetes, duke marrë masat e duhura për të:

a) Siguruar informacion lidhur me ligjet e shteteve të tyre për birësimin dhe informacion tjetër të përgjithshëm, si statistika dhe formularë standart
b) Informuar njëri-tjetrin lidhur me funksionimin e Konventës dhe për të eliminuar sa më shumë çdo pengesë në zbatimin e saj (neni 6& 7):

Konventa e Hages e 1993 synon për krijimin e një Autoriteti Qendror jo vetem në vendet pritëse por edhe në vendet e origjinës, i cili të akreditojë organizatat që punojnë në fushën e birësimit ndërkombëtar[31].

Në rastet kur, pas birësimit të një fëmije, familja vendos të shpërngulet në një shtet tjetër, birësimi mund të mos njihet automatikisht dhe mund të shoqërohet me një sërë pasojash. Prindërit birësues mund të jetë e nevojshme t'i drejtohen gjykatës së shtetit të ri për të kërkuar njohjen e marrëdhënies së birësimit. Nëse nuk shteti i ri nuk e njeh birësimin e fëmijës, e gjithë familja mund të shoqërohet me situata pasigurie dhe konfliktesh ligjore që kanë të bëjnë me përgjegjësinë prindërore[32].

Këshilli për Çështjet dhe Politikat e Përgjithshme i Konferencës së Hages, në mars 2016, konkludoi se Zyra Permanente duhet të ndërrmarrë disa veprime paraprake në fushën e mbrojtjes së birësimit vendas në shtetet e tjera.

Në Konferencën "Access to Foreign Law in Civil and Commercial Matters", organizuar nga Komisioni Europian dhe Konferenca e Hages në të Drejtën Ndërkombëtare Private në 2012,

---

[31] Sherbimi social ndërkombëtar, seksioni Italian, E drejta e fëmijës për t'u rritur në një familje, Udhëzues për ndërhyrjen në birësimin kombëtar e ndërkombëtar dhe në kujdestarinë familjare, fq 7
[32] Recognition of Domestic Adoptions in other States, https://www.hcch.net/en/publications-and-studies/details4/?pid=6524&dtid=33 , nëntor 2016

dolën në konkluzionet dhe rekomandimet se: është e nevojshme në praktikë të lehtësohet aksesi në legjislacionin e huaj, në shumë fusha si dhe në të drejtën e familjes. U theksua nevoja dhe avantazhet e zhvillimit të mekanizmave bashkëpunues në nivel global në mënyrë që të lehtësohet aksesi në ligjin e huaj. Instrumentët e ardhshëm duhet të parashikojnë një sërë mekanizmash që kujdesën për nevojat e aktorëve, mjeteve dhe burimeve të ndryshme që kërkojnë akses në ligjin e huaj duke përfshirë gjyqtarët, juristët, noterët, zyrtarët e qeverisë dhe publikun të gjerë. Në parimet e instrumentëve pasardhëse duhet të konsiderohen: aksesi i lirë për materialet ligjore të gjykatave, administrative dhe marrëveshjet ndërkombëtare për çdo individ; riprodhimi dhe ripërdorimi i materialeve ligjore; mbrojtja e të dhënave personale; përkthimi zyrtar i materialeve ligjore në gjuhë tjera.

Kritikët mendojnë se implementimi i Konventes së Hages rrit mundësitë për burokraci dhe në këtë mes janë fëmijët ato që dëmtohen duke qëndruar më gjatë në institucionet që kujdesen për to.

### *4.2.2 Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve*

Duke pasur parasysh cenimin masiv të së drejtës për të jetuar dhe shkeljen e të drejtave të fëmijëve, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, shpalli më 20 nëntor, 1959 "Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës", e cila ishte një adaptim i zgjeruar i DDF të Lidhjes së Kombeve të vitit 1924, apo siç njihet ndryshe Deklarata e Gjeneves. Që nga kjo datë, 20 nëntori është shpallur ditë e të drejtave të fëmijëve[33]. Në hyrjen e deklaratës në fjalë thuhet: *"Njerëzimi, u ka borxh fëmijëve gjërat më të mira që ai mund t'iu ofrojë"*. Kjo Deklaratë në

[33] www.unesco.org.com

pesë pika përcakton të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësitë e të rriturve për respektimin e këtyre të drejtave[34]. Deklarata kishte karakter rekomandues, ndaj në 1979 u propozua kalimi i saj në një fazë tjetër duke i dhënë karakter detyrues në të drejtën ndërkombëtare. 10 vite më vonë, në 1989 erdhi KDF-ja.

Jetimet dhe fëmijët pa përkujdes prindëror, sipas deklarates, duhet të strehohen dhe t'u ofrohet ndihmë. Deklarata përbëhet nga 10 parime. Parimi kryesor që mbron ajo, është barazia dhe mos diskriminimi i të miturve në bazë të origjinës, racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, mendimeve politike apo të tjera, statusit, lindjes dhe fesë. Gjithashtu ndër parimet e deklaratës, rënditet dhe ILF, parim i cili është fuqizuar gjithmonë e më tepër, në instrumentët e tjerë ndërkombëtarë vijues.

### *4.2.3 Konveta e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës*

Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, u miratua në vitin 1989 dhe hyri në fuqi në shtator të vitit 1990. Në parathënien e saj, nënvizohet rëndësia e familjes për rritjen edukimin dhe mirëqënien e fëmijës. OKB-ja përmes mjeteve të ndryshme të saj është përpjekur shumë për mbrojtjen dhe sensibilizimin mbi mirëqënien e fëmijëve në shoqëri [35]. Kjo Konventë është një traktat ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, që u garanton të gjithë fëmijëve një paketë të drejtash[36] duke përfshirë mbrojtjen, edukimin, kujdesin shëndetësor, ambjentin familjar, zhvillimin e aftësive dhe talenteve, dashurinë dhe lumturinë. Ajo ka ndryshuar

[34] http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/të-drejtat-e-fëmijëve data aksesit 19.06.2016
[35] Sherbimi social ndërkombëtar, seksioni Italian, E drejta e fëmijës për t'u rritur në një familje, Udhëzues për ndërhyrjen në birësimin kombëtar e ndërkombëtar dhe në kujdestarinë familjare, fq 6
[36] The children Act 1989 guidance and regulations, volumi 2: care planning, placement and case revieë, korrik 2015, fq 14

mënyrën se si shihen dhe trajtohen fëmijët dhe sot më shumë se kurrë më parë, fëmijët shihen si qenie njerëzore me një sërë të drejtash të qarta, dhe jo si objekte pasive të përkujdesjes dhe bamirësisë (UNICEF, 2015: 8). Ajo është konventa me numrin më të lartë të ratifikimeve në histori, nga 180 shtete.

Konventa garanton katër parime themelore:

1. Mbijetesa dhe zhvillimi fëmijës-(neni 6) rëndësi primare i kushtohet kujdesit shëndetësor. Ky parim synon realizimin e edukimit të fëmijës, evidentimin dhe zhvillimin e talenteve që fëmija mund të ketë dhe angazhimin e tij/ saj në qëndra kulturore-artistike.
2. Mbrojtja e fëmijës (neni 2) nga ambjente familjare apo jo që nuk janë të përshtatshme për fëmijën, mbrojtje nga dhuna psikologjike dhe fizike
3. Interesi më i lartë i fëmijës (neni 3)
4. Angazhimi i fëmijës (neni 12) kryesisht në vendimarrjet në lidhje me të.

***Fëmija dhe Birësimi sipas Konvetes së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës***

Sipas kësaj konvente, birësimi synon t'i ofrojë fëmijës një familje ku të ndjehet si në familjen biologjike dhe jo vetem t'i ofrojë një familje një fëmije. Konventa parasheh se interesat më të mirë të fëmijës do të jenë konsiderata parësore në procedurat e birësimit dhe se birësimet e fëmijës do të jenë të autorizuara vetëm nga autoritetet kompetente, të cilët do ti marrin vendimet në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme. (OSCE, Kosova, 2010: 3). Një fëmijë i cili është i privuar përkohësisht ose përgjithmonë nga ambjenti familjar ose është në interesin e tij që të mos lihet në një ambjent të tillë, ka të drejtën e një mbrojtjeje dhe asistence të veçantë nga ana e shtetit (neni 20.1). Birësimi është një projekt i personalizuar

për jetën e fëmijës dhe duhet të jetë i përcaktuar mbi bazën e studimit të kushteve të tij psikologjike, sociale, shpirtërore, mjekësore, etno-kulturore, dhe ligjore dhe nëse është e mundur edhe ajo e familjes së origjinës.

Ashtu siç vihet re edhe në parimet e saj, kjo konventë thekson rëndësinë e përkujdesjes dhe asistencës së veçantë që ka nevojë fëmija. Në përputhshmëri me këto të drejta, janë dhe instrumentët e tjerë ndërkombëtar po ashtu dhe legjislacionet e brendshme të vendeve që i kanë nënshkruar ato. Me rëndësi sipas konventes është që fëmijët të ndihen bashkëpunues në vendimet e marra nga të rriturit në lidhje me to. Duke qënë të angazhuar dhe të lirë për të shprehur mendimin e tyre gjatë proçesit të vendimarrjes, ato (fëmijët), do të mund të pranojnë më lehtësisht vendimet e marra nga të rriturit në interes të tyre. Nëse planet bëhen për të ardhmen e fëmijës, ai/ajo mund të ndihet më pak i/e frikësuar nëse e kupton çfarë po ndodh dhe ka qënë duke dëgjuar që nga fillimi (Children Act 1989, 2015: 14). Sa më afër moshës madhore të jetë fëmija, aq më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet për ta përfshirë në procedurat që lidhen me të ardhmën e tij/saj. Atyre mund t'u jepet informacioni i thjeshtëzuar por gjithmonë i saktë dhe se marrja për bazë e opinionit apo vendimit të tyre vlerësohet në bazë të çështjes për të cilën bëhet fjalë. Psh., në lidhje me birësimin, shtetet janë të lira të përcaktojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, moshën kur fëmijës i merret një opinion apo marrja e pëlqimit për familjen birësuese. Në rastin e birësimit, fëmijës duhet t'i përcillet informacioni i saktë rreth prindërve prospektivë birësues, ndonëse ky informacion mund t'i jepet në një formë të thjeshtëzuar duke iu përshtatur moshës dhe aftësisë për të kuptuar të fëmijës. Konventa parashikon hartimin e Strategjive Kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga Shtetet Palë. Më 19 dhjetor 2011 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi Protokollin e

tretë Fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, duke krijuar një procedurë individuale të ankimimit, në rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve[37].

### *4.2.4 Konventa e Hages 1996 "Mbi marrëdhëniet me fëmijën"*

Konventa e Hages "Për juridiksionin, ligjin e zbatuar, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin e përgjegjësisë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijës", bazohet në mbrojtjen e një game të gjërë të të drejtave të fëmijëve duke garantuar marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve, prindërve të tyre dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët. Ajo fokusohet në konfliktet juridiksional që ngrihen në procedurat e mbrojtjes së fëmijëve (Freema M., 2007: 23). Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Hagës së 19 tetorit 1996, më 18 maj 2006, me rezervat dhe deklarimet e parashikuara në këtë ligj. Sipas nenit 4 të këtij ligji, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 60 të Konventës, RSH rezervon të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta për të marrë masa për mbrojtjen e pasurisë së fëmijës në territorin e vet, si dhe rezervon të drejtën e mosnjohjes së një përgjegjësie prindërore apo të një mase për sa kohë nuk është në përputhje me ndonjë masë të marrë nga autoritetet e veta, në lidhje me këtë pasuri, siç është parashikuar në paragrafin e parë të nenit 55 të Konventës.

[37] http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/të-drejtat-e-fëmijëve data aksesit 06.06.2016

### *4.2.5 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*

DUDNJ, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1948. Kjo deklaratë i referohet të drejtave të fëmijëve në dy nene të saj dhe përkatësisht në nenin 25 parashikohet se: nënat dhe fëmijët kanë nevojë për kujdes dhe ndihmë të posaçme dhe se të gjithë fëmijët lindur brenda apo jashtë martese gëzojnë të njejtën mbrojtje sociale; ndërsa neni 26 i referohet të drejtës për arsimim e cila u përket të gjithëve dhe të pakten arsimi bazë të ofrohet falas. Deklarata i jep të drejtën prindërve për të vendosur në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre.

### *4.2.6 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike*

KNDCP e 1966, gjen zbatim për të rriturit dhe fëmijët gjithashtu. Ajo garanton ndër të tjera, të drejtat e fëmijëve dhe ndalon diskriminimin për shkak të racës, seksit, ngjyrës, origjinës kombëtare apo gjuhës (Slynn, 2016: 18). Në lidhje me fëmijët të drejtat e kësaj Konvente apo marrëveshje përfshijnë:

- Mbrojtje të veçantë për familjen, nënat dhe fëmijët
- Të drejtat për një standart të përshtatshëm jetese, duke përfshirë ushqimin, vesh-mbathjen dhe strehimin
- Të drejtën për arsimim

Dispozitat e saj për gjykimin e drejtë dhe mosdiskriminimin përdoren dhe në procedurat e birësimit. Shtetet ratifikuese të Konventes paraqesin raporte periodike mbi zbatimin e të drejtave të garantuara në Konventë. Raportet periodike janë të detyrueshme për çdo shtet në

lidhje me të gjitha Konventat e OKB-së që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Për secilin traktat ngrihet një komitet, i cili monitoron zbatimin e traktatit në shtetet anëtare. Komitetet mund të pranojnë ankesa individuale nga individët nën juridiksionin e shteteve që e kanë nënshkruar protokollin përkatës shtesë ose kanë bërë deklaratat e kërkuara (Slyn, 2016: 20).

## 4.3 Kuadri ligjor ndërkombëtar rajonal mbi birësimin dhe të drejtat e fëmijëve

**Këshilli i Europes (KiE)**

KiE është organizata ndërkombëtare më e vjetër në Europë. Fëmijët në vendet anëtare të Këshillit të Europës, kanë të drejtë të gëzojnë një gamë të plotë të të drejtave të njeriut të garantuara nga Konventa Europiane në të Drejtat e Njeriut, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (UNCRC) dhe çdo instrument tjetër ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut (Strategjia e KiE, 2016-2021: 5). KiE ka luajtur një rol të drejtëpërdrejtë në inkurajimin e reformave të rëndësishme në fushën e të drejtës familjare, shumë prej të cilave promovojnë të drejtat e fëmijëve (Fortin J., 2009: 72).

"Udhëzuesi drejt një Drejtësie Miqësore për Fëmijët", i aprovuar në 2010 nga Komiteti i Ministrave të KiE-së, synon të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e fëmijëve në lidhje me informimin, përfaqësimin dhe pjesëmarrje në procedurat administrative dhe penale në të gjitha shkallët e proçedimit (Sufaj, 2011: 74). Këshilli i Europes mbron dhe promovon të drejtat e njeriut, të cilat përfshijnë të drejtat e fëmijës (Strategjia KiE, 2016-2021: 5).

KiE-ja promovon Karten Europiane Sociale si një grup kryesor i standarteve minimale për mbrojtjen e të drejtave të familjeve dhe të fëmijëve.[38] Karta Sociale Europiane garanton mbrojtje ligjore, shoqërore dhe ekonomike për fëmijët. Ndërsa Konventa mbi birësimin e fëmijëve e vitit 1967 është instrumenti kryesor i KiE-së në fushën e birësimit, një dokument i ri, "Rekomandimi i Asamblesë Parlamentare 1443, mbi birësimin ndërvendas": për respektimin e të drejtave të fëmijëve, u nxor nga mbledhja e 5-të e Asamblesë me 26 janar 2000[39].

### *4.3.1 Konventa Europiane për Birësimin e Fëmijëve 1967, ndryshimet që solli ajo në 2008*

Konventa e parë Europiane mbi Birësimin u nënshkrua me 24 Prill 1967 nga 16 shtete të Bashkimit Europian dhe vendosi parimet themelore bazë mbi birësimin e fëmijëve brenda dhe jashtë vendit, parime të cilat duhet të bëheshin pjesë e të drejtës së brendshme të shteteve firmatare. Si parim esencial të kësaj konvente permendim statusin ligjor që i jep ajo fëmijës

[38] Parliamentary Assembly Resolution 1995 (2014) "Ending child poverty in Europe".

[39] "…Asambleja prandaj thërret Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europes për të dhënë një indikacion të qartë të vullnetit të tij politik për të siguruar që të drejtat e fëmijëve janë respektuar, duke ftuar menjeherë shtetet anëtare për të:

1. Ratifikuar Konventen e Hages mbi birësimin nëse nuk e kanë bërë akoma dhe të marrin përsipër të vëzhgojnë parimet e rregullat e saj, madje edhe kur ka të bëjë me shtetet që nuk e kanë ratifikuar vetë atë;
2. Të drejtojnë fushata informimi për t'u dhënë çifteve dhe profesionistëve që kanë të bëjnë me birësimin ndërvendas një kuptim të plotë të detyrimeve të Konventes së Hagës dhe implikimeve të saj;
3. Të zhvillojnë një bashkëpunim bilateral dhe multilateral thelbësor për aplikimin me efektivitet të konventes;
4. Të ndihmojnë ato vende, nga të cilat fëmijët e huaj vijnë, të zhvillojnë ligjet e tyre të birësimit dhe të trajnojnë personelin e duhur në autoritetet publike, në agjensitë e akredituara dhe profesionistët e përfshirë në birësim;
5. Të sigurojnë që prindërit e ardhshëm janë të pranueshëm dhe të përshtatshëm për të birësuar;
6. Të sigurojnë që në ngjarje të tilla si një divorc i prindërve birësues, braktisja e fëmijës së birësuar ose dalja e vështirësive në procedurat e birësimit, të respektohen të drejtat themelore të fëmijës, të tilla si e drejta e emrit dhe e shtetësisë;
7. Të sigurojnë të drejtën e fëmijës së birësuar të mësojë për origjinën e tij jo më vonë se me arritjen e moshës madhore të tij dhe të eleminojë nga legjislacioni i brendshëm çdo klauzolë që bie ndesh me të;

së birësuar, duke e barazuar atë me fëmijët biologjik në një familje. Ajo është nënshkruar nga 47 shtetet anëtare të Këshillit të Europës[40]. KiE-ja punon për më shumë se 40 vite të harmonizojë politikat dhe të adaptojë standarte dhe praktika të përbashkëta në vendet anëtare të saj, në fushën e familjes[41]. Ndryshimet shoqërore dhe ligjore që kanë ndodhur në Europë dekadat e fundit, kanë sjellë nevojën që shumë vende europiane, të vijnë me ndryshime të herë pas hershme në ligjet kombëtare të birësimit. Propozimet e para për përditësimin e Konventes së 1967 u bënë në Konferencën e parë Europiane në të Drejtën Familjare në vitin 1977 në Vjenë. Çdo vit një raport shpjegues jepet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, për sigurimin e të gjitha të dhënave dhe legjislacionin e ri, të arritur në çdo vend anëtar[42]. Në raportin e 7 majit 2008, sipas Komitetit të së Drejtës Familjare, përditësimi i konventes pritej të dilte pas Konventes së Hages të vitit 1993, gjë e cila u finalizua në vitin 2008. Problematikat e evidentuara nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, disa dispozita të Konvetes Europiane mbi Birësimin e fëmijëve 1967 të cilat binin në kundërshtim me instrumente ndërkombëtare, ndryshimet në Konventen Europiane të 25 janarit 1996 mbi "Ushtrimin e të drejtave të fëmijëve" në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në

[40] Andora (10.11.1994), Armenia (25.01.2001), Austria (16.04.1956), Azerbaxhani (25.01.2001), Belgjika (05.05.1949), Bosje dhe Hercegovina (24.04.2002), Bullgaria (07.05.1992), Republika Çeke (30.06.1993), Danimarka (05.05.1949), Estonia (14.05.1993), Finlanda (05.05.1989), Franca (05.05.1949), Greqia (09.08.1949), Gjeorgjia (27.04.1999), Gjermania (13.07.1950), Holanda (05.05.1949), Hungaria (06.11.1990), Islanda (07.03.1950), Irlanda (05.05.1949), Italia (05.05.1949), Kroacia (06.11.1996), Letonia (10.02.1995), Lihtenshajni (23.22.1978), Lituania (14.04.1993), Luksemburgu (05.05.1949), Mali i Zi (11.05.2007), Maqedonia (09.11.1995), Malta (29.04.1965), Mbretëria e Bashkuar (05.05.1949), Moldavia (13.07.1995), Monako (05.10.2004), Norvegjia (05.05.1949), Polonia (26.11.1991), Portugalia (22.09.1976), Qipro (24.05.1961), Rumania (07.10.1993), Federata Ruse (28.02.1996), San Marino (16.11.1988, Serbia (03.04.2003), Sllovakia (30.06.1993), Sllovenia (14.05.1993), Spanja (24.11.1977), Suedia (05.05.1949), Shqipëria (13.07.1995), Zvicra (06.05.1963), Turqia (09.08.1949), Ukraina (09.11.1995)
Vende jo anëtare të KE: Selia e Shejtë, Kanadaja, shih www.coe.int

[41] Council of Europe Achievement in the field of laë, Family Law and the Protection of Children, Secretariat of the Directorate of uman Rights and Legal Affairs (DG-HL), Strasburg, gusht 2008, fq.11

[42] Council of Europe-Explanatory Report to the Draft European Convention on the Adoption, fq 495

çështjet familjare që kanë të bëjnë me to, vendosën në lëvizje Këshillin e Europës të ngrinte një grup ekspertesh për rishikimin dhe perditësimin e Konventes së 1967, e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave në 2008. Këshilli ka kontribuar në një mënyrë deçizive në forcimin e mbrojtjes ligjore të familjes, në veçanti në mbrojtjen e interesit të fëmijës dhe sidomos në hartimin e një numri të madh të instrumentave ndërkombëtar (Konventave dhe Rekomandimeve) në këtë fushë[43]. Konventa e 1967 e përditësuar me atë të 2008 është instrumenti kryesor i Këshillit të Europës në fushën e birësimit. Ajo është shtylla kryesore mbi të cilën duhet të mbahen legjislacionet e shteteve anëtare në fushën e birësimit. Interesi më i lartë i fëmijës u bë thelbi i konventes së rishikuar[44].

Sipas nenit 1 qëllimi i kësaj Konvente është:

1. *Kjo Konventë aplikohet për birësimin e një fëmije i cili në kohën kur birësuesi aplikon për ta birësuar atë, nuk ka arritur moshën 18 vjeçare, nuk është dhe nuk ka qënë i martuar, nuk është dhe nuk ka qënë në një bashkëjetesë të regjistruar dhe nuk ka arritur moshën madhore.*
2. *Kjo Konventë mbulon vetem institutet ligjore të birësimit të cilat krijojnë një marrëdhënie prind-fëmijë të përhershme*.

Konventa kushtëzon vendet të cilat e ratifikojnë atë, që në ligjin e tyre kombëtar për birësimin, të lejojnë birësimin e një fëmije si nga dy persona me seks të ndryshëm të martuar së bashku ose në një bashkëjetesë të regjistruar[45], ashtu dhe nga persona single.

Qëllimi i saj është të marrë parasysh zhvillimet sociale dhe ligjore duke u mbajtur në Konventen Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe duke pasur parasysh që interesi më i lartë

[43] Council of Europe Achievement in the field of law, Family Laë and the Protection of Children, Secretariat of the Directorate of uman Rights and Legal Affairs (DG-HL), Strasburg, gusht 2008, fq.11
[44] Challenges in adoption procedures in Europe: Ensuring the best interests of the child, Joint Council of Europe and European Commission Conference,brochure conference proceedings, 2009, Strasbourg, fq. 9
[45] Në ato shtete të cilat e rregullojnë me ligj bashkejetesën e regjistruar

i fëmijës duhet të ketë përparësi mbi çdo konsideratë tjetër.[46] Ajo synon të harmonizojë ligjin e shteteve anëtare duke vendosur rregullat minimale për birësimin dhe të vendosë parimet themelore, siç janë interesi më i lartë i fëmijës, pëlqimi i fëmijës mbi birësimin dhe e drejta e të birësuarit të njohë origjinën e tij/saj. Këto parime ishin dhe risija kryesore e Konventes së rishikuar. Si parim kryesor i saj është ai i interesit më të lartë të fëmijës siç cilësohet dhe në nenin 4-t paragrafi i 1-rë. Në preambulën e saj, paraqitet rëndësia e një instrumenti të tillë ndërkombëtar të rishikuar, për plotësimin e Konventes së Hagës të vitit 1993 në "Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Respekt të Birësimit Ndërvendas". Këto dy konventa, rregullojnë dhe mbulojnë vetem institutet ligjore të birësimit që krijojnë marrëdhënie të përhershme prind-fëmijë[47].

Konventa e 2008 erdhi me disa ndryshime dhe dispozita të reja:

- pëlqimi i fëmijës është i nevojshëm nëse fëmija është në gjendje ta kuptojë atë
- kërkohet pëlqimi i nënës dhe babait në dhënien e pëlqimit për birësim të fëmijës
- pëlqimi i babait është po aq i rëndësishëm dhe i nevojshëm sa dhe ai i nënës edhe në ato raste kur fëmija ka lindur jashtë martese
- kjo konvente e shtrin rregullimin e saj edhe për çiftet heteroseksuale të pamartuara të cilët janë në një bashkëjetesë të regjistruar[48]
- konventa i lë të lirë shtetet që ta shtrijnë birësimin edhe për çiftet homoseksuale apo të të njejtit seks të cilët jetojnë sëbashku në një marrëdhënie të qëndrueshme.

[46] http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/202

[47] Shih neni 1 paragrafi 2 i Konventes Europiane mbi Birësimin 2008 dhe nenin 2 të Konventes së Hages 1993

[48] Shih neni 7 i KEB 2008

- vendos një ekuilibër më të mirë midis të drejtës së fëmijës për të njohur identitetin e tij/saj dhe të drejtës së prindërve biologjik përtë qëndruar anonym
- mosha minimale e birësuesit duhet të jetë midis 18 dhe 30 vjeç dhe diferenca e moshës mes birësuesit dhe fëmijës preferohet të jetë të pakten 16 vite.
- është eliminuar në gjithë Konventen e përditësuar çdo diferencë ndërmjet fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martese[49]

Ndërsa Konventa e '67 ka dispozita të veçanta në lidhje me të drejtat pronësore, që ajo e 2008 nuk i ka. Shtetet janë të lira që ta zgjërojnë qëllimin e kësaj Konvente dhe të lejojnë në legjislacionin e tyre çiftet e të njejtit seks të cilët janë të martuar ose janë në një bashkëjetesë të regjistruar ose në një bashkëjetesë fakti stabël të mund të birësojnë fëmijë. Konventa e rishikuar përmirëson ndjeshëm procedurat e birësimit të fëmijës.

***Dhënia e pëlqimit për birësim***

Sipas të drejtës ndërkombëtare fëmija ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet që kanë të bëjnë me të. Në jetën e një fëmije (me statusin e jetimit apo i braktisur) vendimet të cilat mund të jenë më me shumë rëndësi janë ato që kanë të bëjnë me vendin ku qëndron dhe personat me të cilët jeton. Ndaj është me rëndësi që marrja e konsensusit të fëmijës në rastet e vendimeve që afektojnë drejtpërdrejtë jetën e tyre është më shumë rëndësi. Duke marrë parasysh forcimin e statusit ligjor të fëmijës nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e fëmijës neni 12, Konventa Europiane në Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve 1996 dhe Konventa e Hages e 1993, pëlqimi i fëmijës është tani i rëndësishëm nëse fëmija mund ta

---

[49] Shih nenet 5, 10, 12 të Konvetes së 1967 http://eudo-citizenship.eu/InternationalDB/docs/Explanatory%20report%20CETS%20202.pdf

kuptojë plotësisht atë[50]. Konventa i lë të lirë shtetet që në legjislacionin e tyre të brendshem të përcaktojnë moshën në të cilën fëmija është në gjendje të kuptojë rëndësinë e birësimit dhe të merret për bazë pëlqimi i tij, gjithësesi në paragrafin (b) të nenit 5, Konventa, nënvizon se mosha e fëmijës nuk duhet të jetë mbi 14 vjeç. Për më tepër, është me rëndësi t'i jepet fëmijës mundësia për t'iu dëgjuar mendimi i tij/saj për çështjet që kanë të bëjnë drejtëpërdrejtë me të pavarësisht moshës (nëse e ka arritur apo jo moshën e caktuar në ligj për dhënien e pëlqimit). Duke i dhënë mundësi fëmijës të shprehë mendimin e tij/saj në lidhje me birësimin, ai/ajo do t'i pranojë më shpejt prindërit birësues. Megjithatë, fëmijët nuk janë vendimmarrës në proçesin e birësimit, por ata janë pjesë e proçesit të vendimmarrjes në mënyrë që pikëpamjet e tyre të merren parasysh, krahas atyre të ekspertëve të tjerë (Dambach, 2009: 15). Në çdo rast fëmija duhet të jetë i informuar dhe i vetëdijshëm (aq sa mosha ia lejon) për efektet e birësimit dhe prindërit birësues.

Pozita e prindërve biologjik kundrejt fëmijës që pritet të birësohet është ndër çështjet më të rëndësishme dhe të diskutueshme në çdo birësim (Sloan, 2009: 18). Konventa e 1967 në nenin 5 të saj e kërkonte pëlqimin e babait, vetem për fëmijet e lindur brenda martese, për fëmijët e lindur jashtë martese pëlqimi i babait nuk ishte i rëndësishëm. Asnjë diskriminim nuk mund ti bëhet atit të fëmijës së lindur jashtë martese nëse ai e ka njohur fëmijën si të vetin (Mandro, 2010: 480).

Në çështjen *Keegan kundër Irlandës,* gjykim i 26 Maj 1994 dhe në *Kroon kundër Hollandës* gjykim i 27 tetorit 1994, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në mënyrë të qartë nënvizon rëndësinë e marrjes së pëlqimit të babait për fëmijën e lindur jashtë martese me

[50] Council of Europe-Explanatory Report to the Draft European Convention on the Adoption, fq 5

kusht që atësia e fëmijës të jetë njohur nga babai. Fakti që legjislacioni Irlandez lejonte vendosjen në mënyrë sekrete të fëmijës për birësim, pa dijeninë ose pëlqimin e aplikantit(babait), duke lejuar që të krijohet lidhja midis fëmijës dhe prindërve propozues për birësim dhe me synim arritjen e mëvonshme të birësimi, arriti të ndërhyjë në të drejtën e aplikantit për respektimin e jetes familjare (Keegan kundër Irlandës, 1996).

Në arsyetimin që bën GJEDNJ-ja në lidhje me çështjen në fjalë, thekson faktin se dhënia e fëmijës për birësim (nga nëna) në një kohë shumë të shkurtër nga lindja e tij/saj, jo vetem shkatërron lidhjen e fëmijës me babain por dhe e vendos atë në kushte disavantazhi në 'betejën' e tij për marrjen e kujdestarisë së fëmijës kundrejt prindërve birësues të mundshëm. Gjykata udhëhiqet nga faktorët social, emocional dhe biologjik më pak sesa nga ato ligjor kur bëhet fjalë për vlerësimin e një marrëdhënieje si "jetë familjare" apo jo.[51] Gjithsesi edhe vetem lidhja ligjore mjafton për të krijuar jetën familjare që përcaktohet në nenin 8.

Në vendimin e saj *Pini kundër Rumanisë,* GJEDNJ-ja e përcakton marrëdhënien e krijuar midis birësuesit/birësuesve dhe të birësuarit përmbushëse të qëllimit të nenit 8 edhe nëse kjo marrëdhënie akoma nuk ka konkluduar në një bashkëjetesë të përbashkët dhe se nuk përmban lidhje emocionale midis tyre.

Konventa e 2008 e kërkon pëlqimin e babait në çdo rast. Në pikën c paragrafi 1 të nenit 5 të Konventes, parashikohet dhe pëlqimi i partnerit në një bashkëjetesë të regjistruar për fëmijën që birësohet nga partneri tjeter. Kjo nuk i detyron shtetet që të lejojnë në lëgjislacionin e tyre kombëtar bashkëjetesën e regjistruar, por u drejtohet vetem atyre shteteve të cilat e kanë të rregulluar atë në të drejtën e tyre. Personi që jep pëlqimin duhet të jetë i mirëinformuar rreth

[51] http://echr-online.info/right-to-family-life/

efekteve të pëlqimit të tij dhe se ky pëlqim duhet të jepet lirisht, me shkrim dhe në formën e kërkuar ligjore. Mund të mos jetë e nevojshme marrja e pëlqimit të njërit prind nëse ai ose ajo nuk ushtron përgjegjësinë prindërore ndaj fëmijës. Por kjo nuk përjashton mundësinë e informimit të prindit rreth birësimit të fëmijës. Sipas paragrafit 5 të nenit 5 të Konventes, pëlqimi i nënës për birësimin e fëmijës së saj është i vlefshem nëse jepet jo më heret se pas 6 javësh pas lindjes së fëmijës, ose nëse në legjislacionin kombëtar nuk përcaktohet një afat kohor, autoriteti kompetent duhet të ketë parasysh periudhën që i duhet nënës për të krijuar stabilitetin fizik dhe psikologjik pas lindjes. Në kundërshtim me opinionin publik në rrethana të caktuara, çdo shtet në Europë ka një mekanizëm për lejimin e birësimit pa pëlqimin prindëror (Fenton Glynn, 2015: 17).

***Statusi ligjor i fëmijës sipas Konvetes***

Efekti bazë i birësimit jepet në nenin 11 paragrafi 1-rë në Konventë:

> "*Pas birësimit fëmija duhet të bëhet një anëtar i plotë në familjen e birësuesit dhe duhet të ketë në lidhje me birësuesin, ose birësuesit apo familjen e tij/tyre të njejtat të drejta dhe detyrime si fëmija biologjik i birësuesit, prindërimi të cilit është rregulluar ligjërisht. Birësuesi/t duhet të ketë përgjegjësi prindërore për fëmijen. Birësimi duhet të përfundojë marrëdhenien ligjore midis babait dhe nënës së tij/saj dhe familjes së origjinës.*"

Pothuajse në të gjitha shtetet që njihet instituti i birësimit, efektet e birësimit të plotë janë këto të përmendurat në nenin 11. Neni 11 ka për qëllim të zëvëndësojë nenin 10 të Konvetes së 1967 dhe në këtë mënyrë të sigurojë një qëndrim modern rreth efekteve të birësimit (Lowe, 2009: 2). Në këndvështrimin tim, ndryshimi dhe futja e elementeve modern në Konventen e 2008 është për t'u vlerësuar. Konventa e 2008 kryesisht merret me birësimin e plotë duke nënvizuar rëndësinë e shkëputjes së marrëdhënieve të fëmijës me familjen e origjinës dhe që

në çdo pikëpamje fëmija të trajtohet si fëmijë biologjik i birësuesit apo birësuesve. Paragrafi 4 i nenit 11 u hap rrugën shteteve që të mund të fusin në legjislacionin e tyre forma të tjera të birësimit, përveç atij të plotë, por me efekte më të limituara se birësimi i plotë.

Ligji jonë mbi birësimin nuk parashikon forma të tjera birësimi përveç atij klasik apo siç njihet në vende të tjera si "birësim i plotë". Me forma të tjera të birësimit mund të kuptojmë dhe përmendim 'birësimin e thjeshtë' që praktikohet në shumë shtete si në Itali dhe Francë.

Me të "drejta dhe detyrime" kuptojmë ato me objekt personal dhe ekonomik ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit duke përfshirë dhe përgjegjësinë prindërore të birësuesit. Synohet që në respekt të pasurisë, ushqimit, sigurimeve, mirëmbajtjes, një fëmijë i birësuar duhet të trajtohet si çdo fëmijë tjetër i lindur në familje (Lowe, 2009: 6).

Konventa e 1967 parashikon marrjen në mënyre automatike të mbiemrit të birësuesit nga i birësuari. Në ndryshim nga konventa e 67', ajo e 2008 u lë shteteve mundësinë që ta përcaktojnë në legjislacionin e tyre mundësinë e marrjes së mbiemrit në mënyrë të detyrueshme apo jo. Siç përmendet dhe në Raportin Shpjegues të Konventes së 2008 *"...përvetësimi automatik i mbiemrit të birësuesit nuk është një rregull absolut". Kjo u lihet e lirë shteteve që në rrethana të caktuara, autoritetet kompetente të lejojnë që fëmija të mos ndryshojë mbiemrin e tij apo të mos marrë mbiemrin e birësuesit/birësuesve".*

Birësimi mund të revokohet ose anullohet me vendim të autoritetit kompetent. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë gjithmonë në konsideratën më të lartë (K.E.B, 2008: neni 14 paragr.1). Konventa ua lë në dorë vete shteteve të përcaktojnë rastet e revokimit të birësimit dhe procedurat që ndiqen.

### *4.3.2 Konventa Europiane "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"*

Në vitin 1990, Asambleja Parlamentare, në Rekomandimin 1121 (1990) mbi të drejtat e fëmijës, ftoi Komitetin e Ministrave të hartojë një instrument ligjor për të plotësuar dhe forcuar Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (raporti shpjegues i KiE). Ajo ka si objekt kryesor:"…në interesin më të lartë të fëmijës, të promovojë të drejtat e tyre, të garantojë të drejtat procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e atyre të drejtave duke u siguruar atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët janë vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjerë, të informuar dhe të lejohen të marrin pjesë në procedurat që ndikojnë tek ata para një autoriteti gjyqësor" (Killerbi, 1995: 127).

Si garantuese e ILF-së, Konventa i kushton rëndësi të madhe ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, strehimit dhe kontaktit me fëmijët. Konventa nuk shprehet për rastet e abuzimit të fëmijëve nga prindërit e tyre, nesë duhet të largohen apo jo nga prindërit. Masat procedurale që promovojnë ushtrimin e të drejtave të fëmijëve sipas konventës, përfshijnë aplikimin për përfaqësues të veçantë në procedimet gjyqësore nga vetë fëmija ose nëpërmjet personave të tjerë (Mandro A., 2010: 80). Në të drejtat procedurale, përcaktohet e drejta e fëmijëve për t'u përfshirë dhe për të shprehur pikëpamjet e tij në lidhje me procedurat.

### *4.3.3 Familja dhe birësimi, nocioni i "jetës familjare" sipas Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*

*1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*

*2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interest ë sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*(Neni 8 i KEDNJ-së)

KEDNJ, është një traktat ndërkombëtar rajonal miratuar në 1950, që mbron të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në vendet europiane. Ajo është konventa e parë e KiE në këtë fushë. Familja, cilado qoftë forma e saj, është njesia themelore e shoqërisë dhe mjedisi natyror për rritjen dhe mirëqënien e shoqërisë (Strategjia e KiE, 2016: 2). Në ditët e sotme, koncepti i familjes ka ndryshuar dramatikisht (Speizia, 2013: 402). Në Preambulen e KEDNJ-së, thuhet:

*"Familja, si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve, duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi".*

Duke qënë se familjet mund të përballen me situata tepër të vështira, shpesh herë prindërit të detyruar nga rrethanat vendosin ti japin fëmijët e tyre për birësim. Familja birësuese afirmohet si një zëvëndësim i familjes legjitime, e cila bëhet, juridikisht, një imitim pothuajse perfekt (Morin, 2009: 7). Familjet e formuara (nëpërmjet birësimit), demonstrojnë kapacitetin tonë njerëzor për të dashuruar ato që në shumë kuptime janë "të tjerë", në një botë ku shikohen si alienë (Bartholet, 2005: 108). Prindërit dhe fëmijët reciprokisht duhet të

ndihmojnë, të duan dhe të respektojnë njëri-tjetrin (KF, neni 217). Përkufizimi i familjes nga GJEDNJ ka ndryshuar duke iu përshtatur zhvillimeve shoqërore. Gjykata udhëhiqet nga faktorë emocional dhe biologjik më shumë sesa nga ato ligjorë, në vlerësimin e një marrëdhënieje si "familje"[52], ajo jep një interpretim të gjërë të nocionit "jetë familjare" sipas nenit 8 duke konstatuar se ekzistenca e saj është çështje fakti në varësi të realitetit në praktikë të lidhjeve të ngushta personale (shih: K dhe T. kundër Finlandës (2001)), (Gomien D., 2005: 83). Nëse e shikojmë birësimin si një lidhje ndërmjet dy lojtarëve, birësuesit dhe të birësuarit, shpesh harrohet ekzistenca e një lojtari të tretë, që janë prindërit biologjik të cilët gjithashtu përfitojnë të drejten për respektimin e jetes private dhe garantimin e familjes nga neni 8 i Konventes Europiane mbi Birësimin (Berro-Lefrevre, 2009: 13).

Në çështjen *Pini dhe të tjerë kundër Rumanisë,* Gjykata, e njeh si "jetë familjare" bazuar në nenin 8 të KEDNJ-së, marrëdhënien e krijuar nëpërmjet birësimit, ndërmjet fëmijëve dhe prindërve birësues edhe pse ato nuk kanë jetuar sëbashku. Për qëllime të nenit 8, përbëjnë "jetë familjare" edhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet prindit/prindërve birësues dhe fëmijës së birësuar. Bashkëbanimi nuk është një kusht thelbësor për krijimin apo vazhdimin e asaj që përcaktohet si jetë familjare në nenin 8.

Në *Kroon dhe të tjerë kundër Holandës*, Gjykata është shprehur se nocioni i jetës familjare nuk është i kufizuar vetem në marrëdhëniet në bazë të martesës, por mund të përfshijë dhe marrëdhënie të tjera *de facto* të familjes, ku palët jetojnë sëbashku jashtë martese. Njohja e jetës familjare *de facto* nga KEDNJ, bëhet në baza të njejta sikurse edhe lidhjet e krijuara në mënyrë zyrtare (Schalk dhe Kopf kundër Austrisë).

---

[52] http://echr-online.info/right-to-family-life/ data e aksesit: 25.07.2016

Jeta familjare përfshin si marrëdhëniet shoqërore dhe morale ashtu edhe ato të tipit material, të tilla si mirëmbajtja, detyrimi për ushqim, të drejtat trashëgimore etj.

Por a hyjnë të drejtat trashëgimore mes nipërve/mbesave të birësuar dhe gjyshërve në konceptimin e jetës familjare? Po nëse testamentlënësi ka vdekur para birësimit të fëmijës (nipit/mbesës)?

Lidhur me këtë çështje i referohemi gjykimit të GJEDNJ-së, *Pla dhe Puncernau kundër Andorës.* Në të gjitha shkallët e gjykimit në vend, një fëmije të birësuar (A) i ishte refuzuar e drejta për të trashëguar nga pasuria e nënës së babait birësues (gjyshes P), pasi kjo e fundit kishte parashikuar si kusht në testament, që djali i saj do ia kalonte pasurinë e trashëguar fëmijës ose nipit/mbesës nga një "martesë legjitime dhe kanonike". Nëse nuk përmbushej ky kusht, pasuria i kalonte fëmijëve ose nipërve/mbesave të vajzes së saj. Sipas Gjykatës së Lartë të Andorës, fëmija i birësuar A, nuk mund të konsiderohej si fëmijë i një martese të ligjshme dhe kanonike, ndaj dhe nuk legjitimohej si trashëgimtar i pasurisë në fjalë.

GJEDNJ, në vendimarrjen e saj në lidhje me këtë rast sqaron se në testament nuk kishte asgjë të shkruar që bënte differencimin e fëmijëve biologjik me ato të birësuar, kështuqë testamentlënësja nuk e ka pasur për qëllim përjashtimin e një fëmijë të mundshëm të birësuar. Në këndvështrimin e Gjykatës, një fëmijë i birësuar ndodhet në të njejtat pozita si fëmija biologjik në të gjitha aspektet.

Gjykata përsëriti se Konventa është një instrument i gjallë që interpretohet nën dritën e konditave të ditëve të sotme dhe se i është dhënë një rëndësi e madhe nga shtetet anëtarë të KiE-së, çështjes së barazisë të fëmijëve lindur brenda dhe jashtë martese në lidhje me të

drejtat e tyre civile[53]. Gjykata sqaroi se të drejtat trashëgimore mes nipërve dhe gjyshërve hyjnë në fushëveprimin e jetës familjare edhe nëse testamentlënësi ka vdekur para birësimit të nipit/mbesës (Roagna, 2012: 28).

Në marrëdhëniet prind-fëmijë të krijuara nëpërmjet birësimit edhe pse kemi mungesë të lidhjes së gjakut nuk nënkuptohet mungesa e konceptit të "jetës familjare" sipas nenit 8. Në *Söderbäck kundër Suedisë*, gjykata ka konstatuar se kur një fëmijë ka krijuar lidhje më të forta me partnerin apo bashkëshortin e njërit prej prindërve dhe jo me prindin biologjik, konsiderohet se shteti në mënyrë legjitime mund të lejojë që partneri apo bashkëshorti të birësojnë fëmijën. Në çdo rast, fëmijës i ofrohet familja e cila është në interesin më të lartë tijin, qoftë ajo gjysëm apo plotësisht e përbërë nga prindër jo biologjik. Gjithashtu, neni 8 mbron dhe marrëdhënien e mundshme ndërmjet prindit birësues dhe të birësuarit, kur fëmija nuk është vendosur akoma në familjen birësuese (Pini dhe të tjerë kundër Rumanisë). Në këtë rast kemi të bëjme me "jetë familjare potenciale". KEDNJ-ja mbron po ashtu si "jetë familjare" marrëdhënien e krijuar ligjërisht midis birësuesit dhe të birësuarit edhe në mungesën e një lidhje të ngushtë emocionale ndërmjet tyre, të ngjashme me prind-fëmijë.

***Të drejtat prindërore sipas nenit 8 të KEDNJ***

Në çështjen *Fretté kundër Francës* (2002), aplikanti pretendonte se refuzimi për autorizimin e birësimit, bazuar në orientimin e tij seksual, ka sjellë ndërhyrje arbitrare në jetën e tij private dhe familjare . GJEDNJ-ja vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 dhe 14.

---

[53] Përmbledhje për shtyp e lëshuar nga Kryesekretari i GJEDNJ-së, i vendimit Pla dhe Puncernau kundër Andorës

Në çështjen *E.B kundër Francës* (2008), aplikantja pretendonte se në të gjitha fazat për miratimin e birësimit të një fëmije, është përballur me diskriminim në bazë të orientimit të saj seksual gjë që ka ndikuar në jetën e saj private. Organet administrative dhe gjyqësore në procedurat për miratimin e birësimit, e kanë marrë vendimin e tyre bazuar në: mungesën e referencës së figurës së babait në shtëpinë e aplikantes dhe në sjelljet e partnerit të deklaruar të aplikantes. Lidhur me çështjen e ngritur nga ana e autoriteteve vendase që lidhen me mungesën e një figure atërore në familje, Gjykata vlerësoi se kjo nuk përbën domosdoshmërisht një problem në vetvete. Në arsyetimet e autoriteteve vendase në lidhje me refuzimin për miratimin e birësimit, vihej theksi në statusin e saj si një person i vetem, fakt i cili ishte determinues në marrjen e këtij vendimi. Gjykata arsyeton se Kodi Civil Francez nuk parashikon domosdoshmërinë e një referenti të seksit tjetër dhe se ligji francez lejon personat single të birësojnë një fëmijë. GJEDNJ-ja vendosi se ka pasur shkelje të nenit 14 i marrë në lidhje me nenin 8.

### *4.3.4 Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut*

Ashtu si dhe Konventat e tjera rajonale me misionin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe ajo amerikane detyron shtetet anëtare të respektojnë këto të drejta duke siguruar mos diskriminimin për arsye racore, gjinie, seksi, gjuhe, mendimi politik, kombësie, origjine, statusi ekonomik apo shoqëror. Konventa gjen zbatim në shtetet kontraktuese amerikane. Konventa i referohet që kanë të bëjnë me fëmijët në nenet: 12/4 në lidhje me të drejtat e prindërve për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve sipas bindjeve të tyre; në nenet 17/4 dhe 17/5 rëndësi ka që mbrojtja e fëmijës të bëhet vetem në interesin më i lartë tijin dhe

barazon fëmijët e lindur brenda dhe jashtë martese. Çdo  i mitur ka të drejtën e masave mbrojtjese, të kërkuara nga gjendja e tij si i mitur nga ana e familjes, shoqërisë dhe shtetit (neni 19). Neni 18 bazohet në të drejtën e emrit dhe të mbiemrit që i jepet nga njëri apo të dy prindërit.

### *4.3.5 Karta Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqënien e Fëmijës*

KADMF doli në 1990 si vazhdim i Deklaratës Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqënien e Fëmijës të vitit 1979 dhe ishte traktati i parë rajonal për të drejtat e fëmijëve. Ajo vendosi theksin kryesor në rregullimin e problematikave që shoqëronin fëmijët femra në lidhje me statusin e tyre dhe martesën. Gjithashtu nxiti shtetet anëtare të ratifikonin Konventën ndërkombëtare të Punës për moshën minimale të punës. Karta përcakton si fëmijë çdo qënie njerëzore deri në moshën 18 vjeçare.

Van Bueren e përshkruan atë si një ndër marrëveshjet më progresive në të drejtat e fëmijëve (Freeman M., 2007: 21). Në këtë Kartë, mirëqënia dhe interesi më i lartë i fëmijës duhet të jenë konsiderata kryesore. Në preambul citohet: vendi i veçantë dhe i privilegjuar i fëmijës në shoqërinë afrikane, gjithashtu dhe rëndësia e mbrojtjes së veçantë ligjore në lidhje me zhvillimin e shëndetit mendor, fizik dhe social tijin. Sipas nenit 3-5, fëmijët janë të përjashtuar nga dënimi me vdekje për krimet e kryera nga ato. Gjithashtu, Karta ndalon të gjitha format e abuzimit ndaj fëmijëve duke përfshirë ato fizike dhe mendore gjithashtu dhe trafikimin dhe shitjen e fëmijëve.

# KAPITULLI V- KUPTIMI DHE RREGULLIMI I INSTITUTIT TË BIRËSIMIT SIPAS LEGJISLACIONEVE TË DISA VENDEVE TË BE-së

## 5.1 Hyrje

Në të gjitha vendet anëtare të BE-së, instituti i birësimit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme ndër vite. Në disa vende birësimi është një praktikë e mirë-vendosur ndërsa në disa të tjera është ende relativisht i panjohur[54]. Në vendet europiane, birësimi kuptohet si një alternativë për kujdesin dhe rritjen e një fëmije në rastet kur prindërit biologjik nuk munden ose nuk dëshirojnë të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore. Në disa prej tyre, nuk lejohet birësimi nga çiftet e të njejtit seks, e ndërsa në disa legjislacione ky lloj birësimi nuk shihet si një cënim i interesit më të lartë të fëmijës.

Prej dekadash Bashkimi Europian është përqëndruar në përcaktimin e politikave dhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, megjithatë nuk ka një politikë të përbashkët të rregulluar në nivel të BE-së në fushën e birësimit.

Dekadat e fundit të shekullit të kaluar shënojnë dhe pikënisjen e trendit të birësimeve në Europë dhe ekzaktësisht shtetet si Franca, Italia dhe Spanja shënonin numrin më të lartë të tyre. Birësimi me llojet e tij ndryshon ndër vendet europiane, ndaj përbën një institut me karakteristika të veçanta. Disa prej tyre e lejojnë dhe disa jo birësimin ndërvendas. Disa shtete njohin lloje të ndryshme birësimi si ai plotë, i thjeshtë dhe birësimin e të rriturve, e ndërsa disa shtete të tjera rregullojnë me legjislacionin e tyre vetem birësimin e plotë.

Kryesisht në vendet europiane ekzistojnë dy lloje birësimi:

[54] https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 dt 10.04.2016

- Birësimi i plotë
- Birësimi i pjesshëm

Nëpërmjet birësimit të pjesshëm fëmija nuk i shkëput lidhjet me famijen biologjike dhe revokimi i birësimit arrihet më lehtësisht. Ndërsa në birësimin e plotë fëmija ka statusin e njëjtë me fëmijët biologjik dhe merr mbiemrin e familjes birësuese. Në Europë, birësimi i plotë njihet dhe praktikohet prej më shumë se 100 vjetësh. Legjislacionet e vendeve të ndryshme kanë vendosur kriterin e moshës maksimale për të birësuarin duke filluar nga 16-18 dhe deri "pa kufij", ndërsa kufiri tavan për moshën e birësuesit varion nga 40-55, apo ashtu siç ka legjislacione si dhe yni, që nuk vendos një kufi maksimal të moshës së birësuesit. Anglia, pavarësisht njohjes dhe praktikimit joformal të birësimit, rregullimin e parë ligjor të këtij instituti e realizoi me Aktin e Birësimit në vitin 1926. Ky akt ishte i pari që rregulloi institutin "modern" të birësimit në Europë. Birësimi sipas këtij legjislacioni kishte për qëllim të ofronte një zgjidhje diskrete të stigmatizimit dhe vështirësive që kanë nënat që sjellin në jetë fëmijë jashtë martese, por gjithashtu dhe për t'u mundësuar fëmijë çifteve pa fëmijë (Fenton-Glynn, 2015: 7). Me Raportin Hurst të vitit 1954 autoritetet lokale morën një rol më të madh në proçesin e birësimit duke lënë menjanë birësimin në rrugë private. Një fuqizim të rolit të tyre morën dhe gjykatat, të cilat filluan të merrnin në konsideratë dhe pëlqimin e prindërve biologjik në lidhje me birësimin e fëmijëve të tyre.

Në Gjermani që prej vitit 1991 më shumë se gjysma e numrit të birësimeve janë bërë nga bashkëshorti/ja e njërit prind biologjik (Ruzik, 2008: 5). Në Skoci ky lloj birësimi në periudhën 2001-2006 shkonte në 30-40% të numrit total vjetor të birësimeve.

Shifrat e birësimeve, pavarësisht se në përgjithësi ndjekin një trend të përbashkët, në disa vende pas vitit 2000 kanë qënë të qëndrueshme, në disa të tjera rënëse. Rritja e numrit të

martesave të dyta që prej viteve 1990 solli dhe rritjen e numrit të birësimeve nga njerku/a. Duke qënë se në Angli procedurat e birësimit ndërvendas kushtojnë shumë, numri i birësimeve vendase është shumë më i madh se ai i birësimeve ndërvendase.

Sot, të gjtha vendet europiane kanë ligjet e tyre të birësimit. Gjithmonë në çdo cep të botës, ka pasur dhe do të ketë fëmijë të cilët kanë nevojë për një familje për t'i birësuar. Për vendet e Europës Perëndimore shifrat e birësimit kanë pësuar rënie vitet e fundit. Me 1 nëntor 1956 hyri në fuqi ligji i birësimit në Holandë. Sipas Zyrës Qëndrore të Statistikave, nga viti 1956-1980 numri i birësimeve ka ardhur gjithnjë e në rritje nga 500-2000 birësime në vit. Nga viti 1980-1998 këto shifra pësojnë zbritje të konsiderueshme, por që rikthehen me rritje pas vitit 1999. Shifra më e lartë në këtë periudhë kohore është ajo e vitit 1980 e cila ishte rreth 2500 birësime. Në vitin 2008 Holanda numëronte vetem 25 birësime vendase, por numri vazhdoi të ishte fleksibël edhe në vitet në vijim. Që prej vitit 1998 iu dha e drejta për të birësuar fëmijë edhe çifteve që bashkëjetonin dhe personave single. Viti 2001 shënoi një ndryshim të madh në ligjin për birësimin në Holandë, ndryshim i cili lejoi birësimin e fëmijëve nga çiftet e të njejtit seks.

Sipas të drejtës Angleze, birësimi është proçesi nëpërmjet të cilit gjykata shuan lidhjet prindërore ndërmjet fëmijës dhe prindërve biologjik dhe krijon lidhje analoge ndërmjet tij dhe birësuesve (Cretney, 1984: 417).

Në të gjitha trajtimet ligjore që i bëhen këtij instituti në vendet europiane, ekziston e drejta e fëmijës për të patur dhe për t'u rritur në një familje, por a ekziston e drejta e 'prindërve' për të pasur fëmijë? Parë në këndvështrim dhe në interesin më të lartë të fëmijës, birësimi është një mjet për gjetjen e një ose dy prindërve birësues, të gatshëm për ta rritur, edukuar dhe për ta pranuar atë në familjen e tyre si fëmijë biologjik; e ndërsa në pikëpamjen e prindërve

potencial birësues, birësimi është një mënyrë për të pasur një fëmijë nëse ato janë në mënyrë të pavullnetshme pa fëmijë, ose nuk dëshirojnë të kenë një fëmijë përmes proçesit natyral (Ruzik, 2008: 2). Qëllimi kryesor i birësimit fokusohet në gjetjen e një familje për fëmijën dhe jo një fëmije për një familje.

Në Angli fillimisht (rreth viteve 1920) shikohej si një institut i fokusuar tek të rriturit; dhe që përmbushte nevojat e të rriturve më shumë sesa të fëmijëve (Gilmore, 2013:30). Vetem pas viteve 1980 iu dha rëndësi primare mirëqënies dhe interesit më të lartë të fëmijës. Në nivel kombëtar, parlamenti anglez miratoi Aktin e birësimit të vitit 1989, i cili bëri që mirëqënia e fëmijës të jetë konsiderata mbizotëruese në të gjitha vendimet e marra për të (Fenton-Glynn, 2015: 8). Gjatë procedurave të birësimit është me rëndësi realizimi i *"threshold test"*. Ky test ka të bëjë me përcaktimin e nivelit të dëmit që i kanoset fëmijës në ambjentin familjar ku jeton dhe se a duhet të hiqet nga aty, e më pas të jetë i gatshëm për birësim. Me "dëm" në këtë rast do të kuptojmë mungesën e kujdesjes së pritshme prindërore ndaj fëmijës dhe mungesa e fëmijës në shkollë.

Sipas Aktit të 89' në seksionin e birësimit, pika (4) gjykata ose agjensia birësuese duhet të këtë parasysh çështjet e mëposhtme:

- Dëshirat e verifikuara të fëmijës dhe ndjenjat lidhur me vendimin (duke u bazuar në moshën e fëmijës)
- Nevojat e veçanta të fëmijës
- Mosha, seksi, formimi dhe ndonjë karakteristikë tjetër e fëmijës që gjykata i konsideron të përshtatshmë
- Ndonjë dëm prej të cilit famija ka vuajtur ose është në rrisk për të vuajtur

Në vitet 2000, Rumania, u bë problem për aferat korruptive në lidhje me birësimin ndërvendas të fëmijëve. Agjensitë e birësimit ngritën një bazë të dhënash për famijët e gatshmë për birësim ku fëmijëve u vendosej çmimi në shuma që varionin nga 6,000-30,000 dollarë (Jacoby, 2009: 124). Shpejt u krijua ideja e një “tregu të ligjshëm” fëmijësh, të cilët shiteshin nga punonjësit e korruptuar të agjensive të birësimit. Për këtë arsye, në vitin 2004 Rumania nën presionin e BE-së nëpërmjet një moratorium ndaloi birësimin ndërvendas si kusht përpara se të bëhej anëtare e BE-së në 2007. Si pasojë e këtij moratorium, përafërsisht për më shumë se 1000 fëmijë, u pezulluan procedurat e birësimi duke i vendosur në familje zëvëndësuese të përkohshme. Në konferencën për shtyp të 4 korrikut 2006, Presidenti i Komisionit Europian Jose Manuel Barroso dhe zëvëndës Presidenti Franco Frattini deklaruan se autoritetet rumune kishin trajtuar problemin e birësimit të fëmijëve në bazë të kërkesave të Parlamentit Europian. Rumania nënshkroi Rezoluten e 10 korrikut 2006 të Parlamentit Europian, e cila kërkonte që të mos shtyheshin më birësimet ndërvendase të lëna pezull. Gjatë proçesit të zgjerimit, BE-ja kundërshtoi tërësisht birësimin ndërvendas në Rumani, qëndrim i cili ndryshon rrënjësisht, direkt pas anëtarësimit të kësaj të fundit në 2007; tashmë BE-ja përqafoi një politikë pro birësimit ndërvendas për Rumaninë. Në një shkrim të “The Financial Times” i 12 qershorit 2006, Rumania konsiderohej si “Guatanamo për bebat”. Megjithatë ky moratorium i dha Rumanisë “kartën hyrëse” për në Bashkimin Europian.

Birësimi vendas ka filluar të bjerë, ndonjeherë në mënyrë drastike në Europën Perëndimore, ndërsa përpjekje të sukseshme duket se janë bërë për t’a nxitur atë në vendet e Europës Lindore, Qëndrore dhe Baltike, veçanërisht në ato në të cilat birësimi ndërvendas është rritur

në 20 vitet e fundit.[55] Problematikë mbetet numri i vogël i kërkuesve për të birësuar në krahasim me numrin e fëmijëve të “gatshëm” për t’u birësuar. Megjithatë disa shtete si Austria, regjistrojnë numër më të madh të kërkuesve sesa të fëmijëve. Në këtë mënyrë krijohet një ç’ekuilibër që kërkon vëmendje të veçantë në nivel kombëtar, komunitar dhe ndërkombëtar.

## 5.2 Birësimi në disa vende të Bashkimit Europian

Deri më sot, nuk ka një rregullim ligjor të birësimit nga BE-ja. Sipas Traktateve, e drejta familjare substanciale, lihet në kompetencë të shteteve anëtare.[56]

Secili nga vendet anëtare aplikon rregullat e veta. Megjithatë, vendet anëtare, ndjekin disa parime të sanksionuara në konvetat ndërkombëtare:

- Prindërit biologjik të fëmijës, nëse janë gjallë, duhet të pyeten për birësimin
- Birësimi bëhet në interesin më të lartë të fëmijës
- Birësimi duhet të bëhet nga gjykata ose organi administrativ[57]

Fëmijët pavarësisht mjedisit ku rritën, kanë të drejtën të jenë të mbrojtur nga çdo lloj forme dhune apo abuzimi. Sipas nenit 3 pika 3 i Traktatit të Lisbonës, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është ndër prioritetet kryesore të BE-së. Karta e të Drejtave Themelore të BE-së garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nga Institucionet e BE-së, si dhe nga vendet e

---

[55] https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 dt. 05.03.2016
[56] European Parliament, Adoption: Cross-border Legal Issues and Gaps in the European Union, 2015, t: www.europarl.europa.eu/studies
[57] http://europa.eu/youreurope/citizens/family/children/adoption/index_en.htm data e aksesit: 10.09.2016

BE-së[58]. Në të gjithë shtetet anëtare, pëlqimi për birësim i prindërve biologjik nuk është i nevojshëm, nëse fëmija është i braktisur, pa përkujdesje prindërore, ose i refuzuar nga prindërit biologjik. Megjithatë, në bazë të nenit 24 të Kartes të Drejtave Themelore te BE-së, fëmija ka të drejtë të mbajë kontaktet me prindërit e tij/saj, kur kjo nuk bie ndesh me interesin e tij/saj. Në këtë Kartë, birësimi përmendet si e drejtë e prindërve dhe e fëmijëve, por nuk ka asnjë dispozitë që e rregullon. Mungesa e harmonizimit të kësaj të drejte në nivel komunitar, sjell situata problematike dhe mos siguri ligjore për birësuesit në rast të levizjes nga një shtet në një tjetër.

Sipas një studimi të Parlamentit Europian nga Chateau[59], situatat problematiket që mund të hasen, lidhen me këto çështje:

- Të drejtat trashëgimore[60]
- Shtetësia
- Çiftet e të njejtit seks
- Përgjegjësia prindërore dhe vendimet që lidhen me të
- Kafala

Njohja dhe procedurat e birësimit ndërvendas udhëhiqen nga Konventa e Hages nr. 33, të cilën të gjithë shtetet anëtare kanë ratifikuar. Gjithsesi në praktikë dhe në disa vende të BE-

[58] http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/rights-child/index_en.htm data e aksesit 08.03.2017
[59]Shih: Céline Chateau, EN Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs European Parliament, dhjetor 2015
[60] Shih: Negropontis kundër Greqisë

së, kërkohen disa procedura shtesë për njohjen e tij[61]. Kjo është në kontraditë të paster me Konventen e Hages dhe mund të jetë shumë problematike[62].

Prezenca në Europë e një numri të konsiderueshëm emigrantësh nga vendet islamike, sjell dhe problematika të ndryshme ligjore, të tilla si njohja e Kafalasë. Që në vitin 1998 Parlamenti Europian nëpermjet Rezolutes mbi prezencën myslymane në Europë ftonte vendet anëtare të forconin njohjen reciproke të kulturave të ndryshme në Europë (Lamçe J., Lex UET, janar 2014).

## 5.3 Austria

Birësimi në Austri është një institut i hershëm, i njohur dhe praktikuar si një derivat i birësimit në të drejtën romake, më heret duke pasur si kryefjalë të saj birësimin e të rriturve për arsye politike apo pasurore. Këtë e shohim në Kodin Civil Austriak të vitit 1810, i cili u jepte rëndësi të veçantë, (ashtu si shumica e legjislacioneve të vendeve europiane) birësimit të personave në moshë madhore. Ndryshimet ligjore të vitit 1960 e integruan institutin e birësimit në një institut me pikëpamje moderne, por pa dalë nga korniza klasike e tij. Vitet 1900, njihen si periudhë reformatore në konceptimin e birësimit në të gjithë Europen; tashmë objektivi kryesor u fokusua në gjetjen e një familje birësuese për një fëmijë të braktisur apo jetim dhe duke zbehur dalëngadalë qëllimet pasurore apo politike në bazë të të cilave kryhej

[61] 20 years of the 1993 Hague Convention assessing the impact of the convention on laws and practices relating to intercountry adoption and the protection of children, Zyra permanente, 2015
[62] European Parliament, Adoption: Cross-border Legal Issues and Gaps in the European Union, 2015, t: www.europarl.europa.eu/studies

një birësim. Si shumë vende të tjera të Europes kontinentale, Austria reformoi ligjin për birësimin në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të.

Në kohën e miratimit të Kodit Civil në 1911, birësimi përceptohej si një institut që lejonte kalimin e emrit dhe pasurisë të birësuarve në moshë madhore (një ide e marrë nga e drejta Romake dhe në përgjithësi e përqafuar nga të gjitha sistemet ligjore Europiane). Me 5 Maj 1980, Austria ratifikoi Konventen Europiane mbi Birësimin e të Miturve; dokumenti i parë ndërkomëtar me karakter të detyrueshëm në fushën e birësimit në këtë shtet.

*Procedurat e birësimit*

Sipas legjislacionit austriak, birësimi është një kontratë e lidhur midis birësuesit dhe të birësuarit, prej së cilës, të dy palëve u lindin të drejta dhe detyrime të njejta me ato midis prindit dhe fëmijës biologjik. Forma kontraktore e birësimit është formë e vjetër, e ruajtur që nga rregullimet e para ligjore të birësimit. Sot, shumica e shteteve të tjera europiane nuk e parashikojnë më në procedurat e tyre të birësimit formën kontraktuale të kësaj marrëdhënie. Megjithëse kemi të bëjmë me termin “kontratë”, ajo nuk i përgjigjet kuptimin të pastër të saj, pasi palët nuk mund t’i përcaktojnë vetë kushtet (të drejtat dhe detyrimet) e kontratës dhe se këto të fundit mirëpërcaktohen nga kodi civil austriak.

Birësimi kërkon një marrëveshje ndërmjet prindit birësues dhe të birësuarit, nëse ky i fundit është minoren, marrëveshja arrihet nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor dhe më pas, marrëveshja në fjalë duhet të aprovohet nga gjykata kompetente. Gjykata aprovon marrëveshjen e birësimit nëse është në interesin më të lartë të fëmijës dhe nëse ekziston ose pretendohet të krijohet një marrëdhënie që korrespondon me atë biologjike prind-fëmijë (neni 180a i KC).

Sipas nenit 179 të Kodit Civil Austriak: *(1) …birësimi krijon një marrëdhënie birësuese prind-fëmijë.*

> *(2) birësimi i një fëmije…duhet të lejohet vetem nëse prindërit birësues formojnë një çift të martuar. Si rregull, bashkëshortët mund të birësojnë vetem sëbashku një fëmijë. Një përjashtim mund të bëhet nëse fëmija që është për t'u birësuar është fëmija biologjik i bashkëshortit/ bashkëshortes, kur njëri bashkëshort nuk i përmbush kërkesat e të pasurit moshën madhore ose diferencën e kërkuar të moshës me të birësuarin, kur vendodhja e njërit bashkëshort ka qënë e panjohur për të paktën 1 vit, kur bashkëshortët nuk kanë jetuar në bashkësi martesore për të pakten 3 vite, ose kur ka arsye të njejta apo të veçanta që justifikon birësimin nga vetem njëri bashkëshort.*

Nëse nëna biologjike (ose prindërit) e fëmijës vendosin t'a deklarojnë fëmijën "të gatshëm" për birësim, duhet të aplikojnë tek Shërbimi i Mirëqënies dhe Rinisë, i cili është autoriteti publik përgjegjës për të siguruar prindër birësues për fëmijën (Brulard, Dumont, 2007: 8). SH.M.R zgjedh prindërit e përshtatshëm për të birësuar një fëmijë pas aplikimit të tyre për t'u futur në listat e pritjes. Kur ky autoritet vendos për një apo dy persona që janë të gatshëm për t'u bërë prindër nëpërmjet proçesit të birësimit, prindërit e ardhshëm dhe fëmija jetojnë sëbashku një periudhë prove nga 6-12 muaj përpara se të gjitha procedurat e birësimit të përfundojnë plotësisht. Gjatë kësaj periudhe prindërit nuk janë ligjërisht akoma prindër birësues. Me mbarimin me sukses të periudhës së provës, një marrëveshjë në formën e një kontrate nënshkruhet nga pridi/prindërit birësues dhe prindërit/nëna biologjik/e i/e fëmijës ose nga autoriteti kompetent (SH.M. R). Pas nënshkrimit të saj, kontrata, duhet të aprovohet nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata iniciohet me kërkesë të palëve, të cilët kërkojnë njohjen e kontratës *(Bestätigung).*

*Gjykata përpara se të marrë vendimin duhet të dëgjojë:*

- fëmijën nëse është të pakten 5 vjeç
- prindërit biologjik të të birësuarit, nëse ky i fundit nuk ka arritur moshën madhore
- prindërit strehues ose institucionin strehues
- Autoritetin Publik të Mirëqenies së të Rinjve

Pas shqyrtimit të provave (kontratës dhe gjendjes sociale-financiare të prindërve birësues) dhe dëgjimit të palëve në proçes, gjykata, nëse vendos në favor të tyre, nxjerr një vendim (Beschluss*)* i cili aprovon kontratën.

Nuk ka një kufi për moshën e të birësuarit, kjo do të thotë se Austria lejon birësimin e personave madhorë. Ky birësim për nga vetë natyra e tij, shoqërohet nga procedura më të thjeshta sesa në rastin e birësimit të një të mituri. Vetem tek birësimi i të miturve kërkohet të vertetohet vendosja e marrëdhënieve emocionale të ngjashme me atë të një fëmije me prindërit biologjik. Kur i birësuari ka arritur moshën madhore, gjykata kërkon arsye bindëse pse duhet të aprovojë birësimin, është vetë ai (i birësuari) që firmos kontratën e birësimit midis tij dhe prindit/prindërve birësues; pëlqimi i prindërve biologjik në këtë rast nuk është i nevojshëm.

Personat single ashtu si çiftet mund të birësojnë, ndërsa bashkëshortët duhet të birësojnë sëbashku. Ligji Austriak, nuk ka vendosur një limit maksimal të moshës që një person mund të birësojë një fëmijë, ndërsa kufiri minimal qendron 30 vjeç për burrat dhe 28 për gratë. Vendosja e kufirit minimal të moshës së birësuesit është vënë me qëllim që birësuesi në atë moshë është më i pjekur të kuptojë rëndësinë dhe përgjegjësinë e marrë përsipër që sjell birësimi i një fëmije. Diferenca e moshes ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit duhet të jetë

minimalisht 18 vite. Gjithësesi nëse një aplikant është mbi 40 vjeç, ai ka më pak shanse për birësimin, nëse ka dhe aplikantë të tjerë më të rinj në moshë në pritje.[63] Synimi i legjislatorëve austriakë ashtu si në shumicën e legjislacioneve të tjera ku lejohet birësimi, është që diferenca e moshës ndërmjet prindit birësues dhe fëmijës së birësuar të jetë sa më e ngjashme me diferencen natyrale që mund të ketë një prind me fëmijën e tij biologjik. Nuk ka kriter moshe për të birësuarin, përveçse prindërit e fëmijës nuk mund ta japin pëlqimin për birësimin e fëmijes pa mbushur 8 javë nga lindja. Kjo bëhet me qëllim që prindërit të mund të krijojnë një marrëdhënie me fëmijën, në mënyrë që të mos vendosin ta lënë atë për birësim.

E drejta Austriake nuk lejon birësimin e fëmijëve me HIV AIDS. Një aspekt i rëndësishëm i birësimit është legjitimimi i fëmijëve të lindur jashtë martese. Babai mund të birësojë fëmijën e tij nësë ka lindur jashtë martese dhe gjyshërit mund të birësojnë nipërit ose mbesat e tyre. Kujdestari mund ta birësojë fëmijën nën kujdestari vetem pasi të jëtë liruar nga detyra e kujdestarit dhe kur vertetohet se e ka menaxhuar pasurinë në mënyrë të drejtë dhe në interesin e fëmijës.

Nuk ka rregulla të veçanta as përsa i përket fesë apo races në lidhje me birësimin, por këto kritere duhen të mbahen parasysh në mënyrë që të sigurohet që birësimi është në interesin më të lartë të fëmijës.

Sipas nenit 182 (2) të Kodit Civil Austriak, lejohet të birësohet fëmija biologjik i partnerit apo partneres në një çift të martuar apo të pamartuar me partner të sekseve të ndryshme. Ky lloj birësimi nuk është i mundur për çiftet e të njejtit seks.

[63]http://www.anidoadoption.org/en/programs/austria , parë me dt.16.11.2015

Në çështjen *X. dhe të tjerë kundër Austrisë* 2013 të GJEDNJ-së, 3 paditësit (një çift femrash homoseksuale dhe fëmija i njëres prej tyre), u ankuan se u ishte mohuar e drejta për birësim nga "prindi i dytë" si shkak i gjinisë së njejtë të dy partnereve dhe që përbënte diskriminim në kundërshtim me nenet 8 dhe 14 të KEDNJ-së.

Paditësit të parë i ishte refuzuar e drejta për birësimin e fëmijës biologjik të partneres (birësim si prind i dytë), në të gjitha shkallët e gjyqësorit në Austri, vendim i cili bazuar në nenin 182 (2) të K.C, i jepte rëndësi më tepër se çdo elementi tjeter, faktit që birësuesi si prind i dytë kishte të njejtën gjini me prindin tjetër dhe se sëbashku përbënin një çift të pamartuar të të njejtit seks. [64]

GJEDNJ-ja me 7 nga 10 vota, vendosi se ka pasur shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 8 të saj, kur situata krahasohet me atë të një çifti të seksit të ndryshëm, të pamartuar, në të cilin njëri partner dëshiron të birësojë fëmijën e partnerit tjeter. Unanimisht Gjykata ka vendosur se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 së bashku me nenin 8, kur situata e paditësve është krahasuar me atë të një çifti të martuar sipas të cilës njëri bashkëshort dëshiron të birësojë fëmijën e bashkëshortit tjetër.

Çështjet e tjera të dërguara në GJEDNJ (*E.B kundër Francës; Frétte kundër Francës*), kanë të bëjnë me diskriminim e orientimit seksual të personave single si kërkues të vetem për të birësuar dhe se çështja X dhe të tjerë kundër Austrisë ishte e para që trajtoi diskriminim e personave të të njejtit seks si birësues të fëmijës së partnerit.

---

[64] Me 14 qershor 2005, Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme sipas nenit 140 të Kushtetutës Federative. [64] Me 26 qershor 2005, në Gjykatën e Rrethit, paditësit kërkuan aprovimin e birësimit me pretendimin se:…*paditësi i parë dhe i tretë (dy partnerer), kanë krijuar lidhje të ngushta emocionale dhe se paditësi i dytë (fëmija) ka përfituar nga të jetuarit në një familje me dy të rritur.* Qëllimi i tyre ishte të merrnin njohjen ligjore të familjes së tyre *de facto*. Pasi paditësit ezauruan të gjithë shkallët e gjyqësorit në Austri, iu drejtuan GJEDNJ-së.

*Birësimi ndërvendas*

Birësimi ndërvendas lejohet vetem kur sigurohet e ardhmja e fëmijës në një mënyrë shumë më të mirë sesa në shtetin e origjinës, ose kur rrezikohet shëndeti i fëmijës, në këtë rast në Austri. Në rastet kur i birësuari ka moshë madhore atëhere shikohet interesi më i lartë për të birësuarin dhe birësuesin.

Austria ka ratifikuar dhe implementuar Konventen Europiane për Birësimin e Fëmijëve. Me 18 dhjetor 1998, Austria nënshkroi Konventen e Hages për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Respekt të Birësimit Ndërvendas, e ratifikoi në 19 maj 1999 dhe që hyri në fuqi me 1 shtator 1999. Në Austri ndodhen 3 organizata private jo-fitimprurëse, të akredituara të cilat ofrojnë shërbime që mbështesin prindërit birësues për procedurat e birësimit. Duke qënë organizata jo-fitimprurëse, ato financohen nga qeveria austriake dhe objektivi i tyrë është t'u sigurojnë mbështetje të plotë prindërve dhe fëmijëve gjatë birësimit ndërvendas. Kjo mbështetje vazhdon deri në dy vjet pas miratimit të birësimit, por megjithatë, prindërit ose fëmija mund të kërkojnë informacione të mëvonshme që kanë të bëjnë me çështjen e tyre të birësimit. Psh. fëmija në moshë madhore mund të kërkojë të gjejë prindërit biologjik. Marrja e shërbimit nga këto organizata nuk është e detyrueshme për prindërit e ardhshëm, ato mund t'i drejtohen direkt autoritetit qëndror kompetent në vendin e origjinës së fëmijës, për nisjen e procedurave të birësimit ndërvendas.

*Ato ofrojnë*:

- Informacion nëpërmjet websiteve, telefonit, broshurave
- këshillim personal[65]

[65] Child on Europe, Form for the compilation of good practises in the post adoption phase for the Seminar on post adoption Art.9 c) Hague Convention Firence, 26 Janar 2006

- shkëmbim informacioni
- shërbime të tjera të ndryshme në mbeshtetje të familjeve para dhe pas birësimit
- lëshojnë çertefikata për aplikantët "për kualifikimin për të birësuar një fëmijë"

Këto organizata mbështesin fëmijët deri në moshën 18 vjeçare për një të ardhme më të mirë nëpërmjet birësimit ndërvendas. Kriteret dhe kushtet formale për përmbushjen e një birësimi ndërvendas janë të njejta me ato të birësimit vendas. Ndryshimin e bëjnë procedurat të cilat ndiqen për konkludimin e tyre. Në kohën e aplikimit për birësim ndërkombëtar, ashtu si dhe në birësimin vendas, një mashkull duhet të jetë minimalisht në moshën 30 vjeçare ndërsa një femer në moshën 28 vjeçare. Përjashtim bëjnë rastet kur fëmija i njërit bashkëshort birësohet edhe nga bashkëshorti tjetër. Numri i fëmijëve austriak të gatshëm për birësim është shumë i limituar dhe se autoritetet vendase kanë një listë të gjatë të prindërve prospektiv birësues.[66] Qeveria Austriake preferon që prindërit prespektiv birësues të jenë të martuar, edhe pse ligji nuk e specifikon zyrtarisht këtë.[67] Prioritet për të birësuar u jepet më tepër prindërve pa fëmijë sesa atyre që kanë fëmijë të tyre, si biologjik apo të birësuar. Kjo politikë ndiqet për t'u dhënë mundësi ç'do çifti të ketë një fëmijë dhe se në një familje pa fëmijë të tjerë, ka gjasa që fëmijës t'i plotësohen më mirë kushtet për rritjen dhe edukimin e tij. Kushtet socialo-ekonomike dhe shëndetësore të prindit/ prindërve birësues si për birësimin vendas, ashtu dhe për atë ndërvendas, përcaktohen nga Autoriteti i Mirëqënies së të Rinjve. Dikush që pretendon të birësojë një fëmijë në Austri duhet të jetë i pastër nga rekordet kriminale.

[66] http://austria.usembassy.gov/adoption.html 10.12.2015
[67] https://travel.state.gov/content/adoptionsabroad/en/country-information/learn-about-a-country/austria.html dt.13.12.2015

*Mbarimi i birësimit mund të pranohet kur:*

- prindërit divorcohen dhe i birësuari kërkon vetë mbarimin e marrëdhënies së birësmit
- kur njëra nga palët (birësuari ose birësuesi) vdes
- kur palët vendosin me konsenus për mbarimin e birësimit

## 5.4 Franca

Kodi civil francez i vitit 1804 nuk e lejonte birësimin e fëmijëve. Me daljen e ligjit të 19 qershorit 1923, ligji i birësimit u fokusua drejt fëmijëve duke lejuar birësimin e atyre që nuk kishin familje. Deri në atë kohë, në Francë birësimi lejohej vetem për personat madhorë. Duket qartë që ky institut ishte një rrjedhim i birësimit në Romën e lashtë, duke u nisur nga motivet dhe mosha e të birësuarit, por që në ndryshim nga e drejta Franceze e asaj periudhe, e drejta romake lejonte edhe birësimin e fëmijëve.

Gjatë regjimit të vjetër, instituti i birësimit nuk ekzistonte në Francë. Fëmijët pa familje merreshin në ngarkim nga Kishat, të cilat kujdeseshin për rritjen dhe edukimin e tyre. Gjatë viteve 1500 dhe 1600, në Francë ekzistonte një ligj, që u këkonte fisnikëve të birësonin fëmijët e braktisur të gjetur në tokat e tyre, por ligji në përgjithësi injorohej (Babb, 1990). Tendenca për njohjen e këtij instituti, shohim me Dekretin e 18 janarit 1792 i cili lejonte birësimin në Francë, por që nuk hyri në fuqi. Më vonë, me daljen e Kodit Civil Francez të 1804, mund të themi që ishte pikënisja e vertetë e institutit të birësimit në Francë. Por Kodi i Napoleonit lejonte vetem birësimin e personave madhore, duke përjashtuar nga kjo e drejtë fëmijët. Parë në këtë këndvështrim, mund të themi se birësimi kishte karakter pasuror.

Birësuesi duhet të ishte mbi 50 vjec, të mos kishte fëmnijë biologjik dhe të ishte kujdesur për së paku 6 vite për të birësurin gjatë fëmnijërisë së tij. Në këtë mënyrë, dikush mund të kujdesej për rritjen dhe edukimin e një fëmijë të braktisur, por që vetem pas arritjes së moshës madhore të fëmijës, mund ta birësonte ligjërisht.

U deshen 119 vite për të pasur ndryshime në legjislacionin francez në lidhje me birësimin. Me daljen e ligjit të 19 qershorit 1923, ligji i birësimit u fokusua drejt fëmijëve duke lejuar birësimin e atyre që nuk kishin familje dhe e uli moshën e birësuesit në 40 vjeç. Aspekti kontraktual i birësimit vazhdonte të ishte në fuqi. Ky ligj erdhi si pasojë e numrit të lartë të fëmijëve të braktisur. Franca prezantoi *"légitimation adoptive"* në vitin 1939.[68]

Viti 1941 solli ndryshime të tjera në të drejtën franceze në lidhje me birësimin. Nënat që lindnin fëmijë por që për arsye të ndryshme nuk dëshironin ta rrisnin vetë atë, në regjistrin civil nuk deklaronin emrin e tyre si nëna e fëmijës dhe emri i nënës shënohej me X. Fëmija i kalonte Ndihmës Sociale të Fëmijëve ASE, të cilët kujdeseshin deri në momentin kur i gjenin një familje birësuese fëmijës. Synimi i këtij ligji ishtë të minimizonte numrin e aborteve.

Ligji i 11 korrikut 1966, solli dy lloje birësimi, pothuajse të njëjtë me dy llojet e birësimit në Itali:

1. Birësimin e plotë.
2. Birësimin e thjeshtë apo të zakonshëm

Birësimi i plotë lejohej për fëmijët nën moshën 15 vjeçare, të cilët shkëpusnin çdo lloj marrëdhënie me familjen e origjinës. Raste përjashtimore ka kur ky birësim lejohet deri në moshën 18 vjeçare të fëmijës. Ky lloj birësimi ishte i parevokueshëm. Ndërsa birësimi i

68 https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 dt.12.04.2016

thjeshtë ashtu si në të drejtën italiane, nuk sillte shkëputjen e marrëdhënieve të fëmijës me familjen e origjines, nuk kishte kufi për moshën dhe ishte i revokueshëm.

Pas viteve 90', në Francë vihet re trendi i birësimeve si një metodë alternative për të krijuar familje. Vitet e fundit në Francë, numri i fëmijëve të gatshëm për t'u birësuar është më i vogël se numri i kërkesave për birësim. I njejti fenomen është edhe në Austri, por nuk mund të themi të njejtën gjë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku numri i fëmijëve të birësueshëm është më i madh se i prindërve që dëshirojnë të birësojnë një fëmijë. E njejta situatë me SHBA-në është edhe në Shqipëri, ku shtëpitë e fëmijëve janë të mbushura me fëmijë dhe prindërit që duan të birësojnë janë më të pakët në numër. Për këtë arsye Shqipëria ka numër të lartë të birësimeve ndërvendase. Në vitin 2003, 4500 fëmijë janë birësuar në Francë dhe vetëm 500 prej tyre ishin nga Franca[69].

Sipas Kodit Civil, në Francë mund të birësohen:

a) Fëmijët, për birësimin e të cilëve është dhënë pëlqimi i vlefshem nga nëna, babai apo Këshilli i Familjes
b) Ato që janë në kujdestarinë e shtetit
c) Fëmijët e braktisur

Procedurat e birësimit kalojnë në dy faza, atë administrative dhe gjyqësore.

Diferenca e moshës ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit duhet të jetë 15 vite, ndërsa në rastet kur birësohet fëmija i bashkëshortit/es kjo diferencë nuk duhet të jetë më pak se 10 vite. I

[69] http://www.adoptionbirthmothers.com/a-comparison-in-adoption-the-united-states-vs-europe/ parë me dt.02.04.2016

birësuari shkëput marrëdhnëniet me familjen biologjike, përveç rasteve kur birësohet nga bashkëshorti/ja, i/e prindit biologjik.

Sipas nenit 358, i birësuari, në familjen e birësuesit, ka të njejtat të drejta dhe detyrime me fëmijën biologjik. Femija jep pëlqimin e tij për birësimin me mbushjen e moshës 13 vjeçare. Nëpërmjet birësimit të plotë, i biësuari fiton të njejtat të drejta dhe detyrime në lidhje me birësuesit, njësoj sikur të ishte lindur nga ato. Birësimi i plotë prodhon efektet që në ditën e dhënies së vendimit dhe është i parevokueshëm. Ndërsa në birësimin e zakonshëm, i birësuari mbetet në familjen e tij të origjinës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, përfshirë edhe ato trashëgimore. I birësuari nuk e fiton në mënyrë automatike shtetësinë e prindërve, nëse kjo është e ndryshme.

Çështja Gourda[70], e cila ka të bëjë me marrëdhënien e birësimit ndërmjet J.Gourda dhe babait të saj legjitim është padyshim çështja e birësimit më e njohur në Francë për shkak të abuzimit seksual dhe dhunës së ushtruar ndaj birësueses nga babai i saj birësues , për 28 vite me rrallë.

## 5.5 Italia

Si në shumicën e vendeve të tjera Europiane, instituti i birësimit në Itali ka synuar historikisht t'u mundësojë personave apo familjeve pa fëmijë mundësinë e pasjes së një fëmijë që të trashëgojë emrin dhe pasurinë për brezat e ardhshëm. Kushtetuta e Italisë e vitit 1948, në nenin 29 dhe 31 të saj shprehet për mbrojtjen e fëmijëve, të rinjve dhe familjes. Ndërsa, në nenet 3 dhe 30 ajo garanton të drejtat e barabarta për fëmijët e lindur jashtë martese (European Social Charter (revised), 2007: 734).

---

[70] Shih vendimin e Gjykatws së Apelit Paris, 18 Prill 2008

Birësimi i të miturve në Itali rregullohet me ligjin nr 184 të 4 Majit 1983 'Birësimi dhe vendosja e të miturve', i cili është ndryshuar me ligjin nr.476 i vitit 1998 dhe ndryshimi i fundit është bërë me ligjin nr.149 i 28 Marsit 2001. Kodi Civil i 1942, njihte birësimin e të miturve dhe të rriturve. I ashtuquajturi 'Birësimi i thjeshtë', ishte për personat të cilët ishin mbi 50 vjeç dhe nuk kishin pasardhës legjitim. Diferenca e moshës ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit duhet të ishte minimalisht 16 vite dhe kërkohej pëlqimi i të dy palëve. Në rastet kur i birësuari ishte fëmijë, pëlqimi jepej nga prindërit apo nga kujdestari. Organi kompetent për të dhënë vendimin e birësimit ishte Gjykata e Apelit. Gjithmonë birësimi bëhej duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Në vitin 1967, kemi daljen e ligjit nr.431 mbi birësimin, me një fokus në fëmijët e braktisur. Ky ligj ishte më i hapur ndaj koncepteve moderne të birësimit. Nëpërmjet tij, tashmë synohej jo më "një fëmijë për një familje, por një familje për një fëmijë". Ky ligj pati risi birësimin e plotë, nëpërmjet të cilit fëmija i birësuar merrte statusin e fëmijës biologjik të çiftit dhe u lejonte çifteve që kishin të pakten 5 vite të martuar, të birësonin një fëmijë të braktisur deri në moshën 8 vjeçare dhe se ky fëmijë kishte marrë statusin si i braktisur nga një procedurë e veçantë gjyqësore. Mosha minimale e birësuesit u ul në 35 vjet. Ky lloj birësimi njihej si "birësimi i veçantë" ose "adozione special". Me këto ndryshime, fëmijët mund të bëheshin anëtarë të plotë të familjes birësuese duke humbur të drejtat dhe lidhjen me familjen biologjike. Birësimi i të rriturve vazhdonte të njihej akoma si forma kryesore dhe më e përdorur dhe quhej "birësimi i zakonshëm" ose "adozione ordinaria".

Në vitin 1983, Italia bëri ndryshime në ligjin e birësimit, me një ndryshim të roleve për nga rëndësia, duke e njohur birësimin e të miturve si formën bazë edhe pse duke e mbajtur sërish edhe birësimin e personave madhorë. Ligji nr.149 i vitit 2001 rregullon të drejtën e çdo fëmije

për të njohur prindërit e tij/ saj (European Social Charter (revised), 2007: 734). Kjo reformë ndryshimesh ligjore, erdhi e mbështetur nga vala e opinionit publik që ende e shikonte birësimin si një e drejtë e prezumuar për çiftet sterile të kenë një fëmijë, në vend të një të drejte të fëmijëve pa familje për të pasur një të tillë (Suplementary Report, UN, 2001: 33). Sipas këtij ligji, një fëmijë mund të birësohet ose mund të vendoset në një familje për t'u rritur dhe edukuar. Ndryshimi ndërmjet birësimit dhe vendosjes qëndron në faktorin kohë dhe në efektet ligjore që sjellin.

Kriteret kualifikuese për birësimin ndërvendas janë të njejta me atë të birësimit vendas. Si në çdo legjislacion të vendeve europiane, rëndësi i jepet interesit më të lartë të fëmijës, ndërsa procedurat shpesh herë janë të njejta ndër vende të ndryshme, por me specifikime të veçanta dhe karakterizuese për çdo legjislacion.

E drejta për t'i vënë në dispozicion të birësuarit, informacionin mbi prindërit biologjik, lind me mbushjen e moshës 25 vjeç të tij dhe se deri në këtë periudhë, ky informacion është në dispozicion vetem të prindërve birësues dhe spitalit (nëse është në nevojë urgjente dhënia e informacionit). Raste përjashtimore të informimit të fëmijës së birësuar nëse paraqiten arsye të forta, para mbushjes së caktuar me ligj, është kur ato kanë fituar zotësinë juridike për të vepruar (18 vjeç). Më këtë ligj e gjithë vemendja fokusohet më tepër tek fëmija sesa tek të rriturit.

*Kush mund të birësohet?*

Ligji parashikon se nëse fëmija është i privuar nga mjedisi i përshtatshëm familjar, ai mund të vendoset në një familje tjetër, e nëse kjo është e pamundur ose jo e përshtatshme, ai mund të vendoset në një nga institucionet përkatëse për rritjen e fëmijëve të braktisur apo jetimë.

Vendosja e fëmijës në një familje të përshtatshme është e përkohshme, ndërsa birësimi është i përhershem dhe fëmija është i barabartë para ligjit me fëmijët biologjikë. Një fëmijë mund të birësohet vetem nëse është deklaruar i *'birësueshëm'* nga gjykata e të miturve (ligji 149: neni 8/1) me një vendim formal *la dichiarazione dello stato di adottabilità* (ligji 149; neni 14/2) dhe mund ta revokojë atë vendim nësë është në interesin më të lartë të fëmijës (ligji 149, 2001: neni 18). Një fëmijë deklarohet si i 'birësueshëm' nësë është në gjendjen e braktisjes si shkak i mungesës së kujdesit nga prindërit ose të afërmit (ligji 149, 2001: neni 8/1). "Braktisje", kryesisht i referohet situatës në të cilën një fëmijë i mungon mundësia e të jetuarit në familjen e tij/saj (ligji 149, 2001: neni 8/2).

Dispozita të veçanta ligjore, përcaktojnë se një fëmijë mund të jetojë në një mjedis tjetër familjar nëse është i privuar nga mjedisi i tij familjar, apo interesi i më i lartë i tij nuk e lejon të qëndrojë në atë mjedis familjar. Koncepti themelor i ligjit Italian në mbrojtjen e fëmijëve është që "i mituri ka të drejtën subjektive të edukohet brenda familjes së tij" (ligji nr.149, 2001: neni 1). Në ato raste kur familja është e papërshtatshme, mërren masa sociale për të garantuar edukimin dhe zhvillimin e fëmijës në kushte normale. Këto masa kryesisht konsistojnë në mbështetje dhe mbrojtje sociale dhe kontribute nga familje të tjera, gjithmonë në garantim të zhvillimit psiko-fizik të fëmijës. Vetem kur nuk gjendet një familje tjeter ose një person i vetem për të marrë përsipër fëmijën, atëhere ai do vendoset në një institucion (neni 400 dhe vijues i Kodit Civil Italian). Kur fëmija është moralisht ose fizikisht i braktisur, ose edukohet në ambjente të pashëndetshme ose të rrezikshme, apo nga persona që për nga neglizhenca, imoraliteti, injoranca ose për arsye të tjera janë të paaftë të sigurojnë edukimin e tij, autoritetet publike, nëpërmjet organeve të mbrojtjes së fëmijëve, e vendosin atë, në një ambjent të sigurtë derisa ai mund të sigurojë përgjithmonë për mbrojtjen e tij (KC, neni 403).

Në rast se prindërit rifillojnë ushtrimin e pushtetit prindëror, institucioni duhet të kërkojë nga gjykata të vendosë kufizime apo kushte për ushtrimin e një pushteti të tillë (ligji nr.184, neni 3). Dispozitat për kujdestarinë (nga prindërit ose nga një person tjeter), gjenden në Kapitullin 1, X dhe XI të librit të 1 të Kodit Civil, nenet 343-4 dhe vijues. Italia ka ratifikuar dhe implementuar Konventen Europiane të Birësimit të Fëmijëve dhe Konventen e Hagës në mbrojtjen dhe Bashkëpunimin në Repekt të Birësimit Ndërvendas.

*Kush mund të birësojë?*

Prindërit prospektivë birësues duhet të jenë prej 3 vitesh të martuar (pa shkeputje as *de facto*) ose të bëshkëjetojnë në një marrëdhënie stabël po prej 3 vitesh. Periudha 3 vjeçare mund të merret edhe një bashkim i viteve bashkëjetesës dhe martesës sëbashku. Me ligjin e 2001, mund të konsiderohet në periudhën 3 vjeçare edhe bashkëjetesa para martese duke lejuar që çiftet në kushte të tilla të mund të birësojnë menjeherë një fëmijë. Birësimi u lejohet bashkëshortëve… që janë të aftë të edukojnë dhe të rrisin një fëmijë dhe që nuk ekziston ndërmjet tyre ndarje personale apo "de facto" (ligji 149/01, neni 6).

Diferenca moshore ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit ashtu si në ligjin shqiptar për birësimin, duhet të jëtë minimalisht 18 vite. Por ligji Italian jep edhe një kufizim tjeter, diferenca maksimale e lejueshme, duhet të jetë deri në 45 vite për njërin bashkëshort dhe 55 për tjetrin. Psh. Nëse nëna e ardhshme është 48 vjeçe dhe babai i ardhshëm është 58 ato mund të birësojnë një fëmijë maksimumi deri në moshën 3 vjeçarë, ose nëse babai është 70 vjeç dhe nëna 60 mund të birësojnë një fëmijë deri 15 vjeç. Këto limite mund të hiqen, nëse

bashkëshortët birësojnë dy ose më shumë vëllezer ose motra dhe akoma kanë një fëmijë të mitur biologjik, ose të birësuar.

Vendimi për të rritur diferencen maksimale të moshës ndërmjet prindërve birësues dhe fëmijëve birësues, nga 40 në 45, është kritikuar nga profesionistët e birësimit, sepse rrit mundësinë e çifteve të kërkojnë një fëmijë të vogël, duke rritur numrin e aplikimeve për birësim (UN Report, 2001: 33). Kjo është e veçanta e ligjit Italian i cili u jep prioritet vetem çifteve të reja siç bëjnë shumica e legjislacioneve të tjera, duke përfshirë edhe ligjin shqiptar mbi birësimin. Ky kriter bazohet në shprehjen latine *adoptio imitation naturae*, birësimi imiton natyren, duke synuar vendosjen e marrëdhënieve prind-fëmijë në një raport natyral familiar. Diferenca e moshës ndërmjet prindit birësues dhe birësuesit duhet të jetë normale për një marrëdhënie biologjike prind-fëmijë. Kriteri i ndjekur nga ligji, është diktuar shprehimisht nga dëshira për të formuar familjen birësuese në imazhin dhe ngjashmërinë natyrale të familjes [71].

Nëse birësuesi është i/e martuar, birësimi duhet të bëhet nga të dy bashkëshortët (nnei 42/2). Birësimi nga një person lejohet vetem kur ky i fundit nuk është i martuar dhe nga një çift lejohet vetem kur ato janë të martuar para ligjit. Askush nuk mund të birësohet nga më shumë se një person, perveçse nëse birësuesit janë të martuar (KC Italian, neni 194/2).  Sipas nenit 27/2 të ligjit 149/01 për birësimin, nëse njëri nga bashkëshortet vdes para dhënies së vendimit të birësimit, por pasi është dhënë pëlqimi i përbashkët për birësim, është e mundur të vazhdohet, pas kërkesës së bashkëshortit tjetër duke plotësuar formalitetet e nevojshme për birësimin e fëmijës.

[71] http://www.jus.unitn.it/cardozo/review/Persons/Marella1.html dt.24.04.2016

Legjislacioni Italian, nuk vendos kushte përsa i përket fesë, sterilitetit, numrit të fëmijëve të birësuar ose minimumit të kohës ndërmjet një birësimi dhe një tjetri (Beghé ,1996: II-14). Një birësim i dytë mund të lejohet për fëmijën kur prindërit e parë birësues janë privuar nga përgjegjësia prindërore dhe i mituri është dëklaruar sërsish si i braktisur dhe i përshtatshëm për t'u birësuar nga Gjykata e të miturve.

*<u>Llojet e birësimit:</u>*

*1.birësimi legjitim*- me anë të këtij lloji birësimi, fëmija birësues fiton të njejtin status dhe të drejta me një fëmijë biologjik.

Marrëdhënia e vendosur midis birësuesit/ birësuesve dhe të birësuarit sjell këto efekte:

- fëmija merr mbiemrin e prindit/prindërve
- fiton të drejtat dhe detyrimet si një fëmijë biologjik
- fiton të drejtat e trashëgimimore
- njihet nga ligji si fëmijë biologjik

*2.birësimi i thjeshtë*- me anë të këtij lloji birësimi, marrëdhënia që vendoset midis birësuesit dhe të birësuarit ka efekte të ndryshme me birësimin legjitim.

Kjo marrëdhënie sjell këto efekte:

- fëmija mban të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me familjen e tij të origjinës
- fëmija mban mbiemrin e tij (të familjes së origjinës)
- ky lloj birësimi nuk kalon të drejtat e trashëgimisë tek i birësuari
- birësuesi ka për detyrë ta rrisë dhe edukojë të birësuarin

- fëmija ruan të drejtat trashëgimore nga familja e origjinës
- ruan ekzistencen e lidhjeve ligjore me familjen e origjinës

*Procedurat e birësimit kalojnë në 3 faza kryesore:*

1. Deklarimi “i birësueshëm” për fëmijën
2. Zgjedhja e birësuesit dhe të birësuarit të përshtatshëm për njëri- tjetrin
3. Vendimi i birësimit

Në të trija këto faza, punohet duke marrë parasysh dhe pasur kujdes mos cënimin e interesit më të lartë të fëmijës. Kështu psh. në fazën e parë, është me rëndësi që të mund të evitohet largimi i fëmijës nga ambienti i vet familjar dhe deklarimi i tij si i gatështëm për birësim vetem nëse ky deklarim është në interesin më të lartë të fëmijës; në fazën e dytë, punonjësit social janë personat përgjegjës për hartimin e raporteve me kujdes në lidhje me prindërit birësues të ardhshëm, të cilët duhet të jenë sa më të përshtatshëm për fëmijën, duke marrë parasysh kritere të ndryshme për përshtatjen e tyre. Kjo njihet dhe si faza para-birësuese. Faza e tretë është dhe më e rëndësishmja gjatë së cilës gjykata e të miturve jep verdiktin për konkludimin e birësimit duke marrë parasysh dhe fazat e mëparshme.

Çdo javë gjykata e të miturve ngre Dhomën e Jurisë e përbërë nga dy gjyqtarë dhe dy gjyqtarë nderi, e cila pas dëgjimit të prindërve prospektive(aq sa kanë aplikuar), fëmijës nëse ka mbushur moshën 12 vjeçare ose më pak[72] dhe punonjësve social, vendos në favor të prindit/prindërve birësues të cilët janë më të përshtatshëm për rritjen, edukimin dhe ofrimin e një ambjenti familjar dhe prindër në interesin më të lartë të fëmijës. Në fund të këtij hapi,

[72] Nëse vertetohet se edhe pse nën moshën e kërkuar nga ligji, fëmija ka arritur pjekurinë e duhur për të gjykuar me cilët prindër dëshiron të jetojë.

gjykata e të miturve zgjedh midis partnerëve që kanë aplikuar, atë/ato që përmbushin më mirë nevojat e të miturit.

Kriteret për birësimin ndërkombëtar janë të njejta me ato për birësimin kombëtar, të rregulluara me ligjin 184/83 neni 6, ndryshuar me ligjin 149/2001.

Në lidhje me birësimin nga persona single, Gjykata e Apelit e Romes[73], ka ngritur pyetjen rreth kushtetueshmërisë së nenit 6 të Konvetes Europiane[74] mbi birësimin, për pjesën "*ku lejohet pa limite birësimi i një të mituri nga një person i vetem*" . Në arsyetimin që bën kjo gjykatë, neni 6 i Konventes bie në kundërshtim me nenet 3, 29, 30[75] të Kushtetutes Italiane. Çështja ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila është përballur me problemin në fjalë, kur birësimi i një fëmijë nga një person mund të paraqesë shkelje të Kushtetutes. Në vendimin nr.183/94 të 6 Majit 1994, Gjykata Kushtetuese, e ka quajtur të pabazuar pyetjen mbi kushtetueshmërinë e nenit 2 të ligjit të 22 marsit 1974 nr.357 në pjesën që zbaton nenin 6 të Konventes Europiane mbi birësimin e të miturve.

Ashtu si në legjislacionin tonë, birësimi në Itali është i parevokueshëm që nga momenti kur është vendosur marrëdhënia legjitime e bijësisë. Parevokueshmëria është rikonfirmuar nga Gjykata e Kasacionit me vendimin nr. 4395 të dt. 10 prill 1992 dhe me vendimin e Gjykates Kushtetuese nr.344 të dt.20 korrik 1992. Nëse jetesa e të miturit në familjen birësuese përbën rrezik për të, Gjykata e të miturve do të ndërhyjë sipas Kodit Civil në fuqi, nenet 330 dhe 333. Sipas Kodit Civil Italian, ndaj prindërve mund të merren masa duke i hequr

[73] Vendimi nr. 732, 3 korrik 1993

[74] Ratifikuar nga Italia me ligjin 357 të vitit 1974.

[75] Neni 29 "…nocioni i familjes si shoqëri natyrore e themeluar mbi martesën"; neni 30, paraqet interesin rëndësinë e të rriturit të fëmijës nga të dy prindërit, neni 3 " të gjithë qytetarët kanë të njejtin dinjitet shoqëror dhe janë të barabartë para ligjit pa dallim gjinie, race, gjuhe, feje, mendimi politik, personal dhe nga kushtet sociale…"

përgjegjësinë prindërore. Në këto raste, kur gjykata e të miturve ka deklaruar rishtas statusin 'i braktisur' për fëmijën (pasi prindërve u është hequr përgjegjësia prindërore), një birësim i dytë është i mundur për fëmijën. Vdekja e prindërve birësues nuk e ndryshon statusin e të birësuarit (ligji 184/83, neni 27).

Revokimin mund të ndodhë në varësi të disa kushteve, por vetem në birësimin e thjeshtë. Nëse vertetohet se ka pasur krime të bëra nga birësuesit kundra të birësuarit, apo nëse i birësuari mbi 14 vjeç ka kryer një krim kundrejt të birësuarve. Gjithashtu, revokimin e birësimin mund ta kërkojë dhe prokurori publik në rastin e cënimit të të drejtave të të birësuarit. Kërkesa e revokimit mund të plotësohet nga i birësuari, neni 51 ligji nr.184/83, nga i birësuari, neni 52, ose nga prokurori publik, neni 53. Është Gjykata e të miturve ajo që merr vendimin për revokimin e birësimit të thjeshtë.

Ashtu si shumica e shteteve të tjera edhe Italia akuzohet për vonesa burokratike në finalizimin e procedurave të birësimit ku në vitin 2014 sipas një raporti të Grupit CRC[76], 1900 fëmijë prisnin të birësoheshin e ndërsa 31000 çifte ishin në listat e pritjes për të birësuar[77].

---

[76] Grupi që punon për Konventen e të Drejtave të Fëmijëve (CRC) me objektiv kryesor në përpilimin e një Raport Suplementar perveç raportit të dorëzuar çdo 5 vjet për Kombet e Bashkuara nga Qeveria Italiane, siç kërkohet nga Konventa

[77] http://www.thelocal.it/20140624/1900-children-languish-in-italys-adoption-system parë me dt.24.04.2016

# KAPITULLI VI- ANALIZË E KUADRIT NORMATIV MBI TË DREJTEN E BIRËSIMIT NË SHQIPËRI

## 6.1 Hyrje

Ky institut njihet që në lashtësi dhe ka qënë gjithnjë pjesë e të drejtës pozitive shqiptare (Mandro, 2010: 463). Pothuajse në shumicën e vendeve tjera europiane, termi që përcakton këtë marrëdhënie prindërore të re, rrjedh nga fjala latine *"ad optão"* që do të thotë zgjedhje.[78] I/e birësuar mund të jetë si vajza ashtu dhe djali dhe duke qënë se në Shqipëri kjo marrëdhënie njihet nga legjislacioni me termin "birësim", mund të lëjë vend për diskutim. Në kuptimin literal, fjala *"birësim"* pra të bësh bir dikënd, i "përjashton" vajzat dhe se termi adoptim ashtu siç përdoret dhe në Kosovë, do i përfshinte të dyja gjinitë, edhe pse legjislacioni shqiptar nuk e bën këtë dallim. Në Kodin e Familjes së RSH-së nuk përmendet gjinia e të birësuarit në asnjë rast duke nënkuptuar me termin "fëmijë" të dyja gjinitë. Jam e mendimit se zëvëndësimi i fjalës *birësim* me *adoptim, i birësuar* e *birësues* me *i adoptuar* e *adoptues* do ishte një term më korrekt dhe do kishim të bënim apo do ishim pjesë e një terminologjie të "unifikuar" në nivel ndërkombëtar. Termat adoptim; adoptues; i adoptuar janë përdorur fillimisht në Kodin Civil të 1929, pasi ky Kod ishte një përmbledhje e Kodit Civil francez, italian, dhe pak gjerman e atij zvicerian. Ligji 4020, datë 23.6.1965 "Mbi Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë", vazhdonte të përdorte termin adoptim, adoptues dhe i/e adoptuar. Ndryshimin në terminologji e vëmë re duke filluar nga Kodi Civil i 1982 dhe në vazhdimësi, ku përdoret birësim, i birësuar, birësues. Ky ndryshim u bë me qëllim të heqjes së termave të huaj në legjislacionin shqiptar dhe zëvëndësimin me terminologji shqipe. Megjithatë, akoma sot

---

[78] Në vendet anglofone: adoption, në vendet frankofone: adoption, në Itali: adoptare, në Kosovë: adoptim, në Spanjë, Meksikë etj.: adopción, Portugali, Brazil: adoção

vëmë re një përdorim të dy termave edhe adoptim edhe birësim, si në tekstet akademike apo shkollore ashtu dhe në vendimet e gjykatave shqiptare[79].

Një pjesë e birësimeve para viteve ‘90 rezultonin me probleme si për fëmijët ashtu dhe për prindërit birësues, meqë mungonte një vlerësim i vertetë i familjes birësuese nga punonjësit socialë dhe psikologët[80].

Në Shqipëri birësimi dhe procedurat që lidhen me të rregullohen nga ligji nr. 9695, datë 19.03.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10358 datë 16.12.2010 dhe me ligjin nr. 132, datë 05.12.2015 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit” dhe nga dispozitat e KF, ligj nr. 9062, datë 08.05.2003 ndryshuar me ligjin nr. 134, datë 05.12.2015. Këto dy ligje janë në mbështjetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 53, 54, 81, pika 2 shkronja “d”, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës.

Kodi i Familjes në RSH në ndryshim nga legjislacionet e vendeve të BE-së, njeh vetem birësimin e plotë, që nënkupton vendosjen e marrëdhënieve midis të birësuarit dhe birësuesit të njëjtë me atë të prindit dhe fëmijës. Në këtë mënyrë, fëmija i shkëput të gjitha lidhjet me familjen biologjike pas birësimit sikur të mos kishin ekzistuar ndonjëherë. E gjithë tërësia e të drejtave tashmë i transferohen marrëdhënies së re prind-fëmijë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin 224, datë 20.05.2014 argumenton: “Me birësim, kuptohet transferimi ligjor i të drejtave dhe përgjegjësive prindërore nga prindërit biologjikë tek prindërit birësues”.

---

[79] Shih Vendimin 342 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, datë 27.10.2009

[80] Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror, National Albanian Center for Social Studies, Raport studimor i financuar nga UNICEF, Shqipëri, tetor 2005

Sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, përballë situatës së fëmijëve jetim ose të braktisur synohet:

1. Gjetja e një familje birësuese[81]
2. Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës

Pika e 1, gjetja e një familje birësuese, nuk mund të vazhdojë në realizimin përfundimtar të procedurës së birësimit nëse nuk garantohet pika e 2, ajo e interesit më të lartë të fëmijës. Birësimi mund të arrihet vetem në bazë të kushteve dhe procedurave të parashikuara me ligj (Aliu& Gashi, 2007: 250).

Duke u nisur nga trajtimi që i bën doktrina dhe legjislacioni në fuqi, vëmë re se duke u vënë gjithmonë fokusi në të drejtat e fëmijëve për t'u rritur dhe edukuar në një mjedis familjar, lihet paksa në hije ose pa u trajtuar rëndësia e bashkëshortëve pa fëmijë për të pasur një të tillë dhe për të krijuar një "familje të plotë". Kodi i Familjes dhe ligji "Mbi Procedurat e Birësimit dhe Komiteti Shqiptar i birësimeve", nuk e trajton në mënyrë specifike në asnjë dispozitë të drejtën dhe rëndësinë e krijimit të familjes parë në këndvështrimin apo në interesin e çifteve pa fëmijë. Në çdo dispozitë synohet mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës duke lënë në plan në dytë atë të prindërve birësues. Edhe pse gjithmonë prevalon mirëqënia dhe interesi më i lartë i fëmijës, ky interes nuk cënohet nëse dhe çifteve pa fëmijë u kushtohet më shumë hapësirë dhe mekanizma mbrojtës në lidhje me të drejtat e tyre për t'u bërë prindër. Ndaj, jam e mendimit se në KF duhet të parashikohet një dispozitë që t'i jepet prioritet çifteve të martuara pa fëmijë kundrejt atyre që kanë fëmijë tjerë (biologjik apo të birësuar).

[81] Kur është e pamundur ose në dëm të fëmijës, gjetja apo rikthimi në familjen biologjike.

Në *Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë*[82], Gjykata shprehet: ....Gjykata do t'i kushtojë rëndësi të veçantë interesave më të mira të fëmijës, të cilat, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të tyre, mund të kenë përparësi mbi ato të prindit.

Bazuar në studime të ndryshme sociologjike[83], birësimi i një fëmije sjell efekte pozitive tek prindërit birësues.

- prindërit që birësojnë marrin një eksperiencë e cila vazhdon të rritet pozitivisht jo vetem për ta, por edhe për fëmijën;
- ai i bën prindërit të ndihen më të plotësuar[84]

## 6.2 Prindërit birësues dhe biologjik; roli dhe legjitimimi i tyre në procedurat e birësimit

Duke qënë se është shumë e rëndësishme që fëmijët pa përkujdesje prindërore të birësohen dhe të mos rriten në institucionet rezidenciale të përkujdesjes sociale, po aq e rëndësishme është dhe gjetja e birësuesit/birësuesve sa më të përshtatshëm për fëmijën. Në ato raste kur nuk është e mundur që fëmija të rritet me prindërit biologjik, një ndër alternativat më të mira është birësimi i tij.

*Sipas KF, legjitimohen për të birësuar një fëmijë:*

1. Personat single
2. Bashkëshortët së bashku
3. Bashkëshorti/ja i njërit prind biologjik

[82] Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë, GJEDNJ Ankimi nr. 4604/09, Janar 2013
[83]http://www.minellalawgroup.com/10-positive-effects-of-child-adoption/; http://www.buzzle.com/articles/the-effects-of-adoption.html;
data e aksesit: 12.09.2016

*Personat të cilët ndalohen që të birësojnë:*

1. Të paralindurit e fëmijës
2. Vëllai nga motra dhe anasjelltas
3. Kujdestari i fëmijës[85]
4. Personat që me vendim gjykate i është hequr përgjegjësia prindërore
5. Personat me zhvillim mendor të metë dhe ato që vuajnë nga një sëmundje psikike
6. Personat e sëmurë me një sëmundje që vë në rrezik shëndetin dhe jetën e fëmijës së birësuar
7. Nuk arrin të garantojë përpara KSHB-së se do të kryejë në rregull detyrën e birësuesit në lidhje me mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës së birësuar
8. Dy ose më shumë persona së bashku të njejtin fëmijë (përveç dy bashkëshortëve)
9. Personi që ka diferencë moshe më të vogël se 18 vite më fëmijën

I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë (ligji 9695 datë 19.03.2007, neni 242 paragr.1). Lidhur me bashkëshortët birësues, KF-ja, nuk shprehet nëse birësimi duhet bërë njëkohësisht prej tyre ose në mënyrë suksesive (Mandro A., 2009: 471).

Përsa i përket të rriturve në proçesin e birësimit, i ndajmë në dy kategori:

-Ato që duan të birësojnë një fëmijë

[85] Kur nuk është parë akoma nga gjykata administrimi i pasurisë së të miturit prej tij, dorëzimi i pasurisë së të miturit, si dhe vlerësimi i detyrimeve në ngarkim të kujdestarit ose dhënia e garancisë nga kujdestari për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

-Ato që duhet të japin pëlqimin për dhënien në birësim të fëmijës së tyre

*"Prind"* është personi/personat që kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy sëbashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese (Ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", 2010: neni 3 pika h). Personat që legjitimohen për të birësuar një fëmijë shqiptar duhet të kenë minimalisht një diferencë prej 18 vjetësh me të birësuarin. Ashtu si në legjislacionet e huaja edhe në Shqipëri legjislatori ka pasur si qëllim që kjo diferencë në moshë ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit të imitojë diferencën natyrale që mund të ketë prindi me fëmijën e tij/saj biologjik. KSHB-ja në veprimtarinë e vet ka synuar të garantojë interesin më të lartë të fëmijëve të cilët janë deklaruar të braktisur, për të siguruar familje të përshtatshme dhe të denja, në mënyrë që të krijohen kushte për mirërritjen dhe edukimin e tyre[86]. Në studimin e familjes prospektive birësuese dhe përshtatshmërisë së prindërve për të birësuar, vlerësohet kapaciteti i tyre për të birësuar dhe ngritja apo rritja e familjes nëpërmjet birësimit të një fëmije.

### *6.2.1 Birësimi me pëlqim nga ana e prindërve*

Edhe fëmijët të cilët janë në përgjegjësinë prindërore të prindërve biologjik mund të përfshihen në listat e KSHB për t'u birësuar, nëse prindërit e tyre kanë dhënë pëlqimin para gjykatës për birësimin. Kërkesa para gjykatës për dhënien e pëlqimit për birësim bëhet bazuar në nenet 246, 247, 248 e vijues të KF-së, nga prindërit biologjik (të dy nëse janë gjallë); persona të tretë mund të jenë prindi/prindërit prospektiv birësues. Në pranimin e kërkesës për dhënien e pëlqimit për birësim nga prindërit biologjik të fëmijes gjykata ka parasysh interesin

[86] https://www.e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4691 data aksesit 21.05.2016

më të lartë të fëmijes i sanksionuar ne nenin 2 dhe 240 te Kodit te Familjes (Vendim nr.6209 i Gj. T). Neni 248 i KF-së u lë prindërve biologjik një afat kohor prej 3 muajsh, pas pranimit të kërkesës nga gjykata për dhënien e pëlqimit për birësim, pa mbarimin e të cilit birësimi nuk mund të kryhet dhe gjithashtu shërben si periudhë nëse prindërit vendosin të terheqin pëlqimin për birësimin e fëmijës së tyre. Po ashtu kjo periudhë, sherbën edhe si periudhë prove për vendosjen e marrëdhënieve midis birësuesve prospektiv dhe fëmijës. Meqënëse legjislacioni shqiptar në fuqi dhe ai ndërkombëtar, synojnë marrjen e masave konkrete që çdo fëmijë të rritet në familjen e tij biologjike, për përmbushjen e interesit më të lartë të fëmijës, kërkesa për tërheqjen e pëlqimit për birësim mund të bëhet edhe pas kalimit të afatit 3 mujor, deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. KSHB nuk mund të iniciojë procedurat e birësimit të fëmijës pa kaluar afati 3 mujor.

Kur i mituri është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes sociale, publike ose private, përfshirë spitalet publike ose private, nëpërmjet një deklarate noteriale të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim, afati prej një viti kufizohet në 6 muaj dhe fillon që nga momenti i lënies së të miturit (KF, neni 250, paragr. 4).

Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit, në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale (KF 2007, i ndryshuar, neni 6 paragr.4).

### *6.2.2 Forma ligjore e shprehjes së vullnetit të prindërve biologjik për birësim*

Forma ligjore për shprehjen e vullnetit nga prindëri biologjik, për dhënien për e fëmijës për birësim, deri me ndryshimet e fundit të KF nuk përcaktohej. Në Komisionin për Çështjet

Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Për projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003, "Kodi i Familjes", u sugjerua që duhet të ketë një formë të shprehur ligjore që të dalë qartë vullneti i lirë i prindërve biologjikë për të lënë fëmijën për birësim si dhe mundësinë e tyre për ta tërhequr deklaratën e bërë për lënien e fëmijës dhe jo një deklaratë e thjeshtë e bërë para çdo institucioni social ose spital, publik ose privat, pavarësisht se vullneti i tyre deklarohet edhe para gjykatës. Prindërit biologjikë duhet të informohen dhe të këshillohen për pasojat që sjell dhënia e pëlqimit për birësim dhe rolin e autoritetit publik, para të cilit paraqitet kërkesa, që të shpjegojë pasojat që sjell dhënia e pëlqimit për birësim të fëmijës në mardhëniet e ardhshme mes prindërve biologjikë dhe fëmijës që jepet për birësim.

KF me ndryshimet e 2015, sjell risi edhe përcaktimin e formës ligjore për shprehjen e këtij vullneti nëpërmjet një deklarate noteriale[87].

### *6.2.3 Diferenca e moshës ndërmjet prindit birësues dhe të birësuarit*

*A duhet të vendoset një kufi maksimal i moshës së prindit birësues me qëllim për të shmangur diferencen e madhe moshore ndërmjet të birësuarit dhe birësuesit?*

Kodi i Familjes nuk ka vendosur një kufi maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve. Që një person të legjitimohet për të birësuar një fëmijë në RSH, përveç kritereve tjera, si kriter moshe është vendosur diferenca prej 18 vitesh me të birësuarin dhe 15 vitesh nëse birësohet fëmija i bashkëshortit/bashkësortes. Duke qënë se vendosja e diferencës së moshës me ligj ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit synon që marrëdhënia e birësimit të ngjasojë me atë të

[87] Shih: nenin 250 të KF

prindit me fëmijën biologjik, atëherë edhe vendosja e një kufiri tavan, siç e kanë legjislacionet e disa vendeve europiane, psh. Italia, do pengonte krijimin e një marrëdhënie prind-fëmijë nëpërmjet birësimit, e cila do i ngjasonte asaj të gjyshit/gjyshes me nipin/mbesën. Psh. është e mundur të kemi birësimin e një të mituri nga një person 70 vjeç. Krijimi i një marrëdhënie të tillë me një diferencë të madhe në moshë, nuk e arrin qëllimin që ka instituti i birësimit…krijimin e marrëdhënies prind-fëmijë pa lidhje gjaku, bazuar në interesin më të lartë tijin.

Përsa i përket standarteve ndërkombëtare rreth cilësive dhe kushteve që duhet të plotësojnë prindërit birësues prospektiv, ato janë të përcaktuara në disa akte ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është pale, si: Konventa e Hages, Konventa Europiane e Birësimit, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Sipas nenit 10 të KEB-së, hetimet, deri në masën e konsideruar adekuate në secilin rast, do të kenë të bëjnë, sa të jetë e mundur dhe inter alia, me çështjet ne vijim:

a) personalitetin, shendetin dhe mjedisin shoqëror të personit adoptues, veçantitë e shtëpisë së tij apo të saj si edhe mundesitë e rritjes së fëmijës;
b) përse adoptuesi dëshiron të adoptojë fëmijën;
c) aty ku vetem njëri nga dy bashkëshortët apo partneret e regjistruar aplikon për të adoptuar fëmijën, përse nuk është bashkëngjitur edhe tjetri;
d) personaliteti, shëndeti dhe mjedisi shoqëror i femijës dhe në varësi të ndonjë kufizimi të vendosur nga ligji, prejardhja e tij apo e saj dhe statusi civil;
e) prejardhja etnike, fetare dhe kulturore e adoptuesit dhe femijës.

Në ndryshimet e fundit në 2015, të KF-së, u propozua që në nenin 2 të projektligjit, ndër kushtet që duhet të plotësonte aplikanti birësues, të ishte përfundimi i arsimit të detyrueshëm.

Nga analiza e nenit 10 i Konventës Europiane për Adoptimin e fëmijëve, vihet re se në nuk ekziston një përcaktim i tillë si kriter kualifikues, por rëndësi i kushtohet personalitetit, shëndetit, ambientit social dhe për më tepër të aftësisë për të rritur një fëmijë[88]. Nga analiza e dispozitës 18 pika 2 dhe 54 të Kushtetutes, vendosja e këtij kriteri, përbën diskrimin në lidhje me gjendjen arsimore. UNICEF në opinionin e tij thekson se "Ky lloj kushti mund të përbëjë diskriminim ndaj një segmenti të caktuar të popullates shqiptare, të cilët në këtë mënyrë do të përjashtoheshin nga mundësia për të birësuar një fëmijë dhe ne kështu do t'i prisnim mundësinë një fëmije shqiptar për të jetuar në një familje shqiptare që pavarësisht arsimit, mund ta dojë dhe të kujdeset shumë mirë për të". Save the Children dhe Avokati i Popullit për këtë projektligj, sugjeronin që ky të jetë një kriter konkurues. Komisioni duke marrë parasysh propozimet e mësipërme, vendosi mosmiratimin e këtij ndryshimi.

Prindi birësues ka të njejtin status me prindin që lind fëmijë në mënyrë natyrale. Ligji për sigurimet shoqërore i njeh të drejtën nënës birësuese e cila ka qënë e siguruar jo më pak se 12 muaj, që të përfitojë lejen e lindjes me afate kohore pothuajse të njejta me ato që përfiton nëna që lind fëmijë. Nëna, që birëson fëmijën e moshës deri në 1 vjeç dhe që ka qenë e siguruar jo më pak se 12 muaj, ka të drejtë për leje pas lindjes, e cila fillon ditën e birësimit, por jo më parë se mbas ditës së 63-të të lindjes së fëmijës, dhe vazhdon jo më shumë se 330 ditë nga dita lindjes së fëmijës. Minimumi i lejes për birësuesen është 28 ditë (Ligji për Sig.Shoqërore, neni 27, pika 5).

Është vënë një kufi moshe deri në 1 vjeç për fëmijën e birësuar, në radhë të parë sepse edhe nëna që lind fëmijë e përfiton lejen e lindjes gjatë 1 viti kalendarik nga lindja e fëmijës dhe

[88] Raport për Projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 "Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", të ndryshuar", 27.11.2015

së dyti kjo është mosha që fëmija e ka domosdoshmërisht të nevojshme prezencën e nënës, ndaj birësimi i fëmijës në një moshë më të madhe (mbi 1 vjeç) nuk është parë e nevojshme nga legjislatori që t'i lejohet nënës birësuese një "leje lindje". Megjithatë, jam e mendimit se, prindi birësues apo prindërit birësues (njëri prej tyre), të përfitojë një lloj "leje pushimi" në shtëpi rreth 30 ditë kalendarike, në mënyrë që të ndihmojë në vendosjen e marrëdhënieve dhe përshtatjen e fëmijës me jetën e re dhe prindin/prindërit birësues.

Sipas ligjit të sigurimeve shoqërore, lejen për kujdes ndaj fëmijës mund ta përfitojë edhe babai birësues pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes (periudhë kjo që e përfiton nëna që lind fëmijën), nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna birësuese.

Ndërkohë, prindërit/përfaqësuesit ligjorë kanë përgjegjësi parësore të krijimit të kushteve të jetesës për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin fëmijëve të lindur nga martesa dhe jashtë martese (neni 6 pika 2). Fëmija në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve aq sa është e mundur (neni 7 pika ç). Në lidhje me të ardhurat e prindërve prospektiv birësues, fillimisht është KSHB që merr në shqyrtim gjendjen financiare të tyre dhe më pas është gjykata ajo që merr e në konsideratë si një element të rëndësishëm klasifikues ose jo, të miratimit për të birësuar.

## 6.3 Të miturit që legjitimohen për t'u birësuar

Kodi i familjes lejon vetem birësimin e të miturve. Fëmijëve të cilët përballen me situatën e mungesës së përgjegjësisë prindërore, u sigurohet mbrojtja e posaçme përmes formave të

mbrojtjes siç janë: kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe birësimi. Mund të birësohen vetem fëmijët të cilët janë të përfshirë në listen e KSHB-së. Në këtë listë përfshihen fëmijët të cilët:

- Janë shpallur të braktisur nga gjykata, me vendim të formës së prerë (shih neni 250 i KF-së)
- Është dhënë pëlqimi nga prindi/prindërit e tij biologjik që fëmija të birësohet (shih neni 246 i KF-së)

*Parapërgatitja për birësim*

Përpara se procedura e birësimit të një fëmije të kalojë në fazën e gjykimit gjyqësor, fëmija i cili është përzgjedhur për t'u birësuar, duhet të parapërgatitet me informacionin e duhur (në bazë të moshës që ka) në lidhje me konceptin dhe efektet e birësimit. Parapërgatitja duhet të fillojë përpara periudhës 3 mujore të provës.

Mendimi dhe pëlqimi i fëmijës në lidhje me birësimin e tij merren progresivisht në lidhje me intelektin e tij, sipas KF-së merret në konsideratë mendimi i fëmijës nëse ka mbushur moshën 10 vjeç dhe pëlqimi i tij nëse ka mbushur 12 vjeç. Marrja e mendimit të fëmijës bëhet që në procedurat administrative për të vazhduar më pas gjithashtu edhe në procedurat gjyqësore. Ky parashikim ligjor shkon në të njejtën linjë me GJEDNJ-në, e cila në vendimet e saj ka dalë në përfundimin se ndaj fëmijës që ka mbushur moshën 12 vjeç, asnjë veprim nuk duhet të merret pa miratimin e tij.

## 6.4 Procedurat e birësimit

Ashtu siç sanksionohet edhe nga Konventa Europiane mbi Birësimin, si një parim i detyrueshem për shtetet nënshkruese të saj, por edhe nga KF së RSH-së, birësimi duhet të lejohet nga autoriteti gjyqësor dhe administrativ. Në çdo fazë proçeduriale që ndiqet për të realizuar një birësim, gjithmonë veprohet nën linjen e interesit më të lartë të fëmijës. KSHB-ja është autoriteti i vetëm në Shqipëri, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit vendas dhe ndërvendas[89].

### *6.4.1 Procedura administrative*

Kjo procedurë bëhet nëpërmjet KSHB-së. Komiteti Shqiptar i Birësimit është autoriteti qendror i vetem në Shqipëri, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit vendas dhe ndërvendas[90], veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë. Procedura e birësimit të një fëmije nis me depozitimin e kërkesës pranë KSHB-se nga personi/personat e interesuar. Kërkesa me motivimin e birësimit sëbashku me dokumentacionin e kërkuar (shih ligjin 9695, neni 18) dorëzohen pranë Komitetit. Vetem dosjet me të gjitha dokumentacionet e kërkuara, pranohen për aplikim. Personat që dëshirojnë të birësojnë të mitur shqiptarë mund të birësojnë vetem të miturit që figurojnë në listat[91] e KSHB-së (KF, neni 252 pargr. 1).

---

[89] https://www.e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4691 data aksesit 06.06.2016

[90] https://www.e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=4691 data aksesit 07.06.2016

[91] (Ligji 9695, Neni 20) Në listat e Komitetit regjistrohen ata fëmijë shqiptarë për të cilët:

a) Është deklaruar braktisja me një vendim gjyqësor të formës së prerë
b) Është dhënë pëlqimi nga prindërit biologjikë
c) Është dhënë pëlqimii nga gjykata për fëmijët që ndodhen në përkujdesje, sipas paragrafit të tretë të nenit 246 të Kodit të Familjes (Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të vepruar ose janë të panjohur, gjykata vendos nëse fëmija duhet të birësohet)

Shtetasit shqiptarë, në ndryshim nga shtetasit e huaj, kur duan të birësojnë fëmijë shqiptarë, i drejtohen drejtpërdrejtë Komitetit. KSHB-ja bashkëpunon me organet dhe institucionet në qëndren e banimit të aplikantëve birësues, me qëllim marrjen e informacioneve të detajuara për to.

Studimi i aplikantit birësues kalon në dy faza:

1. Shqyrtimi i të drejtës së aplikantit për të birësuar
2. Studimi i aftësisë së tij birësuese

Sekretariati ekzekutiv, shqyrton kërkesën me motivimin për birësim dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti. Studimi i aftësisë birësuese të prindit/prindërve prospektiv, bëhet vetem nësë është kaluar me sukses faza e parë e studimit të së drejtës së aplikantit për të birësuar. Harku kohor nga paraqitja e dokumentacionit deri në momentin që dilet në seancë këshillimore, është 3 muaj. Pas kalimit të këtij afati, aplikantët vendosen në listat e pritjes, derisa t'u propozohet një fëmijë. Qëndrimi në listat e pritjes nuk ka një afat të caktuar, pasi nuk është në varësi të institucionit apo të afateve proçeduriale të përcaktuara me ligj, por në varësi të gjetjes së një fëmijë që përshtatet me prindërit birësues.

Sekretariati ekzekutiv gjithashtu verifikon dhe vlerëson dokumentacionin e dërguar nga institucionet e përkujdesjes sociale, për çdo fëmijë që do të birësohet, gjë e cila shërben për gjetjen e familjeve të përshtatshme për secilin fëmijë. Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e sekretariatit ekzekutiv, bëhet vetem nëse raporti për gjendjen psikologjike dhe gjendjen shëndetësore ekzistuese dhe historikun mjekësor të fëmijës, janë të lëshuara brenda dy javëve të fundit.  Studimi i përgatitur i paraqitet këshillit drejtues për shqyrtim në mbledhjen e tij të radhës (ligji 9695, 2007: neni 19).

Këshilli drejtues:

a) Vendos nëse aplikanti birësues është i përshtatshëm ose jo për të birësuar

b) Jep pëlqimin me shkrim për birësimin e fëmijës nga aplikanti birësues

Sipas nenit 24, shkronja “c” të ligjit nr.9695 dt.19.03.2007:

> *“afati i konsiderimit i përshtatshëm, i aplikantit birësues, është 2 vjet nga data e dhënies së vendimit nga Këshilli Drejtues. Në rastet kur ky afat përfundon, sekretariati ekzekutiv i Komitetit Shqiptar të Birësimit i kërkon aplikantit rifreskimin e dokumentacionit dhe bën rivlerësim të situatës aktuale të tij, duke paraqitur edhe propozimet konkrete për rinovim të afatit të përshtatshmërisë ose heqje të tij. Rishqyrtimi i dosjes dhe kushteve të aplikantit bëhet brenda 2 muajve nga dita e përfundimit të afatit të përshtatshmërisë”.*

Pas superimit me sukses të këtyre fazave, Këshilli Drejtues vendos që aplikanti birësues është i përshtatshëm për të birësuar, jep pëlqimin me shkrim për birësimin e fëmijës dhe me propozim të sekretariatit ekzekutiv, përcakton periudhën e provës. Periudha e provës synon në fillimin e vendosjes së marrëdhënieve ndërmjet aplikantit birësues me fëmijën, për të evidentuar përshtatshmërinë e tyre. Afati maksimal i periudhës së provës është 3 muaj. Me mbarimin e periudhes së provës, sekretariati ekzekutiv, i cili e ka mbikëqyrur atë gjatë gjithë kohës, përgatit raportin për përshtatshmërinë e aplikantit/aplikantëve birësues me fëmijën, dhe dokumentacionin e përgatitur ia dërgon gjykatës. Kjo periudhë prove nuk është e nevojshme, nëse apliknati/aplikantët birësues e kanë pasur fëmijën në kujdestari për një periudhë kohore më të gjatë se 3 muaj dhe se ndërmjet tyre ka pasur një marrëdhënie afektive. Aplikanti/aplikantët nëse kanë krijuar afeksion në mënyrë specifike me njërin prej fëmijëve që është në listat e Komitetit, në kërkesën për motivim për të birësuar, mund të kërkojnë birësimin pikërisht të atij fëmije. Në qoftë se për të njejtin fëmijë, konkurojnë dy palë aplikantë birësues, vendimi merret në bazë të interesit më të lartë të fëmijës dhe që shpesh herë synohet zgjedhja e aplikantit/aplikantëve birësues më të ri në moshë.

### *6.4.2 Procedura gjyqësore*

Pas përfundimit me sukses të fazës administrative, pra, pas shqyrtimit të kërkesës dhe të dokumenteve përkatëse, Komiteti Shqiptar i Birësimit i dërgon gjykatës studimin për personin që kërkon të birësojë dhe atë të të miturit që mund të birësohet (ligji nr.9695, dt.19.03.2007 i ndryshuar, neni 253 paragr.1).

Sipas KPrC neni 349 pika c, miratimi i birësimit hyn në kompetencën lëndore të gjykatave të shkallës së parë, seksioni për mosmarrëveshjet familjare. Roli i gjykates është të marrë në shqyrtim çështjen dhe të përcaktojë nëse birësimi duhet të lejohet, bazuar në mirëqënien dhe interesin më të lartë të fëmijës[92]. Gjykata kompetente është ajo e vendbanimit të aplikantit birësues.

Gjykata i referohet dhe relacionit nga KSHB-ja mbi përshtatshmërinë e fëmijës me prindërit kërkues. Në një vendim[93] të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me miratimin e një birësimi ndërvendas KSHB-ja në relacionin e tij citonte: *"...përshtatja e tyre ka rezultuar pozitive nga të dyja palët, duke u bazuar në elementët e mëposhtëm: përkushtimi, dashuria, vëmendja maksimale, dhe devotshmëria e prindërve birësues për të plotësuar nevojat emocionale dhe materiale të fëmijës…".*

Përveç kritereve të tjerë të përcaktuar me ligj, për të realizuar birësimin e një fëmije, aplikantët duhet të paguajnë një tarifë prej 20 mijë lekësh, ndërsa për birësimin me pëlqim

[92] https://travel.state.gov/content/adoptionsabroad/en/country-information/learn-about-a-country/albania.html data aksesit 24.01.2015

[93] Vendim 667 datë 03.02.2016

është përcaktuar tarifa prej 10 mijë lekësh. Tarifa paguhet vetem nëse miratohet kërkesa për birësim.

### 6.5 Të drejtat e fëmijës të lindura pas birësimit

KF-ja i RSH, njeh vetem formën e birësimit të plotë, ndaj, fëmija i birësuar, pas miratimit të birësimit, fiton të njejtat të drejta dhe detyrime me fëmijën biologjik. Po kështu, edhe birësuesi ka përgjegjësi prindërore të njejtë (Mandro, 2009: 468) me prindërit biologjikë. Raporti i krijuar midis birësuesit dhe të birësuarit është i njejtë me atë të fëmijës me prindin biologjik. Birësimi është një marrëdhënie që krijohet me qëllimin e vendosjes së marrëdhënieve prind-fëmijë.

Sipas LFK, neni 163 paragr. 1, adoptimi është i lejuar vetem nëse i shërben mirërritjes dhe nëse pritet që mes prindit adoptues dhe fëmijës do të krijohen marrëdhënie prind-fëmijë.

Fëmija duhet të inkorporohet plotësisht në familjen e re duke marrë përsiper të drejtat dhe detyrimet që përcakton ligji, duke shkëputur marrëdhëniet me familjen biologjike dhe personat në gjini dhe duke i vendosur ato me familjen dhe prindërve të ri. Përsa i përket lidhjeve gjinore, ndërmjet birësuesit dhe gjinisë së tij, nga njera anë, dhe të birësuarit lindin të drejta dhe detyra të njejta me ato që kanë ndërmjet tyre personat që janë gjini (KF, neni 259, paragr.1). Çdo lloj e drejte e parashikuar nga KF-ja dhe legjislacioni në fuqi për fëmijët, në aspektin e marrëdhënies prind-fëmijë, garantohet njësoj edhe për fëmijët e birësuar. Këtu përmendim: detyrimin për ushqim, përgjegjësinë prindërore, të drejtat pasurore dhe trashëgimore, amësinë, atësinë etj.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin e saj 224, datë 20.05.2014, arsyeton:

*"Gjykata vlerëson të theksojë ashtu sikurse parashikohet edhe në legjislacionin tonë civil, se fëmija i birësuar, gëzon të njëjtin status ligjor dhe ka të njëjtat të drejta me fëmijët natyral të trashëgimlënësit. Legjislatori ka barazuar lidhjen që ekziston midis të birësuarit dhe birësuesit me lidhjen prind-fëmijë. Nga momenti i birësimit, i birësuari shkëput lidhjen me familjen e origjinës, e konsiderohet si fëmijë i birësuesit"*

Kjo marrëdhënie e re e krijuar ka efekte juridike dhe në emrin dhe mbiemrin e fëmijës që birësohet; për emrin nëse fëmija ndërron emrin, ndërsa përsa i përket mbiemrit, fëmija merr mbiemrin e përbashkët të prindërve. Pas birësimit, birësuesi apo birësuesit shënohen si prindërit e të birësuarit në regjistrin e gjendjes civile, ndërsa regjistrimi i mëparshëm në këtë amzë anullohet. Fëmija i birësuar merr për atësi dhe amësi atë të pridërve birësues. Në ato raste kur fëmija birësohet nga një person single, atësia/amësia e prindit tjetër biologjik fshihet. Psh. nëse prindërit biologjik kanë njohur atësinë dhe amësinë e fëmijës dhe fëmija birësohet nga një nënë single, amësia shënohet ajo e nënës birësuese dhe atësia shënohet me "I panjohur" në momentin e miratimit të birësimit[94].

Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa. I birësuari nuk trashëgon në familjen e origjinës së tij dhe as kjo nuk e trashëgon atë[95] (KC, neni 362).

Nëse ndodh që prindërit birësues të shkurorëzohen, në bazë të nenit 154 të KF-së, zgjidhja e martesës nuk prek të drejtat dhe detyrimet që kanë prindërit ndaj fëmijëve të tyre. Zgjidhja e martesës së prindërve birësues, sjell të njejtat pasoja juridike kundrejt fëmijës së birësuar siç sjell shkurorëzimi i prindërve biologjik ndaj fëmijës së tyre. Pra, nuk kemi një rregullim juridik të veçantë për fëmijët e birësuar, por çdo e drejtë dhe detyrim i tyre rregullohet nga të

[94] Shih vendimin nr. 838, datë 09.02.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

[95] Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.8781, datë 3.5.2001, neni 24

njejtat dispozita si për të gjithë fëmijët e tjerë, jetojnë apo jo me prindërit biologjik. Këtu përfshihen çështjet në lidhje me prindin të cilit me vendim gjykate i është lënë fëmija për rritje dhe edukim, heqjen e përgjegjësisë prindërore njërit apo të dy prindërve, kontributi për detyrimin ushqimor për fëmijën.

Në rastet e birësimit me pëlqim, të drejtat dhe detyrimet e prindërve, pra përgjegjësia prindërore[96], kundrejt fëmijës së tyre pushon. Titullarë të këtyre të drejtave dhe detyrimeve bëhen automatikisht prindërit birësues.

Birësimi i krijon efektet e tij që nga data që vendimi i gjykatës merr formë të prerë.

## 6.6 Kuadri normativ mbi të drejtat e fëmijëve

Të drejtat e fëmijëve shkelën çdo ditë në çdo vend të botës. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimet më të rëndësishme të politikave shoqërore edhe në Republikën e Shqipërisë (Strategjia Kombëtare për Fëmijët). Shqipëria ka ratifikuar UNCRC në vitin 1992 si një ndër instrumentet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare. Sipas nenit 1 të Konventes së OKB-së mbi të drejtat e fëmijës, *"...fëmijë është çdo qënie njerëzore nën moshën 18 vjeç..."*. Po ashtu dhe legjislacioni shqiptar në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, cilëson me termin fëmijë çdo person nën 18 vjeç.

Në nenin 3 pika d të ligjit "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" thuhet:

[96] Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij (KF, neni 215)

*“Fëmijë” është çdo person i lindur i gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht.*

Instrumente të ndryshëm ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijëve, të ratifikuar dhe nga Shteti Shqiptar, theksojnë se fëmijët të kushtëzuar nga elemente të tillë si: mosha, mungesa e pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vemendje të veçantë, nga familja si dhe institucionet shtetërore (Shegani, 2012: 41). Këto instrumente ftojnë për ruajtjen e të drejtave të atyre fëmijëve për të cilët jeta familjare mund të garantohet vetem nëpërmjet kujdestarisë dhe birësimit[97].

Si rezultat i reformave ligjore, kuadri ligjor mbi të drejtat e fëmijëve në Shqipëri ka pësuar ndryshime të here pas hershme, me qëllim përafrimin me standartet europiane. Për të pasur një proçes të rregullt ligjor për finalizimin dhe vendosjen e një marrëdhënie birësimi, duhet të respektohen të gjitha të drejtat e fëmijës të mbrojtura nga kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar. Ndoshta është e vështirë të gjehet *“familja perfekte”* për një fëmijë, por nëpërmjet birësimit, synohet që një fëmije t’i sigurohet një familje e pershtatshme dhe që në ambjentin familjar nuk i cënohen të drejtat e garantuara me ligj. Zakonisht, prindi është mbrojtësi më i mirë i të drejtave dhe ofruesi më i mirë i kujdesit ndaj fëmijës së tij (Kaldal & Leviner, 2010: 384). Në shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me të drejtat dhe mirëqënien e fëmijëve, pranohet se për ruajtjen e këtyre të drejtave, në rastet e fëmijëve jetim,

[97] Sherbimi social ndërkombëtar, seksioni Italian, E drejta e fëmijës për t’u rritur në një familje, Udhëzues për ndërhyrjen në birësimin kombëtar e ndërkombëtar dhe në kujdestarinë familjare, fq. 6

të braktisur apo pa një mjedis të rregullt familjar, zgjidhja më e mirë e mundshme është birësimi.

Kushtetuta e Shqipërisë në një serë nenesh[98] të saj garanton mbrojtjen e të drejtave të fëmijës për të mos u diskriminuar, për arsim, indentitet, për mbrojtje nga dhuna (Hazizaj, 2012: 32) dhe pikërisht në nenin 54 Kushtetuta mbron këto të drejta të fëmijës dhe bën dhe barazimin ligjor ndërmjet fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martese.

- Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzana dhe nënat e reja kanë mbrojtje të veçantë nga shteti
- Fëmijët e lindur jashtë martese do të kenë të njejtat të drejta me fëmijët e lindur nga martesa
- Çdo fëmijë do të ketë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht në moshë të mitur, të cilat dëmtojnë shëndetin dhe moralin, apo rrezikojnë jetën dhe zhvillimin normal të fëmijës

Neni 5 i Kodit të Familjes në RSH, parashikon si një ndër parimet kryesore atë çfarë parashikohet dhe në preambulën e Konvetës së OKB-së, rëndësinë e rritjes së fëmijës në një ambjent familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

*Kodi i Familjes së RSH-së ndër parimet kryesore të tij garanton:*

7 Interesin më të lartë të fëmijës

8 Kujdesin e prindërve ndaj fëmijëve për mirërritjen, zhvillimin, mirëqënien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese.

[98] Ne nenin 15; 16; 18; 54

9 Barazi ligjore ndërmjet fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martese

10 Të drejtën e fëmijës për t'u rritur në një mjedis familjar, atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi

11 Të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar në çështjet që kanë të bëjnë me të

Një sërë dispozitash[99] të K.F mbrojnë gjithashtu të drejtat e fëmijëve.

Ligji për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve[100], është një ligj i ri që i shtohet gamës së legjislacionit vendas për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe që ka për qëllim të rrisë zbatueshmërinë e Konvetes për të drejtat e fëmijës (Hazizaj, 2012: 33). Objekti i këtij ligji është të përcaktojë të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën (neni 1) Miratimi i këtij ligji shënon një arritje të rëndësishme në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes një kuadri të plotë ligjor dhe institucional në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (UNICEF, 2012: 4). Ligji përcakton mjetet, masat dhe mekanizmat institucionalë që garantojnë mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Parimet e përgjithshmë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë: (neni 2)

1. Interesi më i lartë i fëmijës
2. Barazia në lidhje me racën, ngjyrën, gjininë, gjuhën, fenë, opinionin politik apo çdo lloj opinion tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.

[99] Neni 53; 67; 170; 171 e vijues; 197
[100] Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010

3. Eleminimi i të gjitha formave të diskriminimit apo ndëshkimit të fëmijës

4. Respektimin e përgjegjësive të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/ përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.

5. Krijimi i kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim

6. Respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.

Legjislacioni shqiptar parashikon dy lloj mekanizmash për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

1. Mekanizmat në nivel qendror
    - Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
    - Ministri që bashkërëndon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës
    - Agjencia Shtetërore për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
2. Mekanizmat në nivel vendor
    - Njesia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut
    - Njesia për mbrojtjen e fëmijës në bashki

Shqipëria ka ratifikuar një sërë aktesh dhe konventash ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që kanë sjellë përmirësime të ndjeshme në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve duke iu përshtatur standarteve Europiane. Mbrojtja e fëmijës në aspektin juridiko-penal bëhet nga Kodi Penal i RSH-së. Në dispozitat e këtij kodi, synohet mbrojtja e fëmijës nga çdo lloj forme dhune dhe kryesisht mbron të drejtën e fëmijës për të jetuar. Ligji " Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"[101] synon të parandalojë

[101] Nr. 9669, datë 18.12.2006

dhunën në familje dhe kryesisht mbrojtje të veçantë u kushton fëmijëve si viktima të saj. Neni 19 i Konventes së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, parashikon se: *"Shtetet palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja ose mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual".* Në të gjitha mekanizmat kombëtar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, synohet pikësëpari të ruhet sa më "i pastër" interesi më i lartë i fëmijës.

Strategjia Kombëtare për fëmijët[102], është dokumenti bazë më i rëndësishëm bazuar në Kushtetutën e R.Sh-së dhe Konventen mbi të Drejtat e Fëmijëve, përsa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri[103] Ky dokument paraqet rolin e ministrive dhe autoriteteve përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Në Shqipëri ka një numër të madh Organizatash jo-fitimprurëse (rreth 100) të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Një pjesë e këtyre OJF-ve janë mjaft aktive dhe kanë ndikuar në modelimin e standarteve të reja të mbrojtjes së fëmijës si dhe modelimit të shërbimeve të reja për mbijetesën, zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre (Likaj, 2012: 82). Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës bashkëpunojnë me OJF-të, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 32 pika 5, ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 2010). Çështja e të drejtave të fëmijëve kërkon

[102] Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.368, datë 31.05.2005
[103] Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës, studim krahasues, Qëndra e Sherbimeve dhe Praktikave të Integruara

angazhim serioz institucional (Strategjia kombëtare 2012-2016: 19) në hartimin e politikave sociale dhe ekonomike.

"Drejtësia e të miturve" është në fokus të Reformës aktuale të Sistemit të Drejtësisë[104] në RSH. Me anë të kësaj reforme synohet garantimi në nivele më të larta i mbrojtjes së fëmijëve nëpermjet mekanizmave ligjorë dhe institucional. Në tryezën e konsultimit publik në lidhje me këtë çështje, ndërmjet Komisionit të Posaçëm Parlamentar dhe Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Antonella Scolamiero nën cilësinë e përfaqësueses së UNICEF, u shpreh:

> *"Kjo Reformë është një gur i rëndësishëm thellimi për vendin dhe për qytetarët e tij….. UNICEF, do të vazhdojë të nxisë dhe të ndihmojë qeverinë shqiptare, Kuvendin e sistemin e drejtësisë për të qenë më të përgatitur, për t'u ofruar të miturve zgjidhje lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre, për të dëgjuar zërin e tyre, në mënyrë që edhe ata të thonë fjalën e vet për çështje të rëndësishme që prekin të ardhmen e vendit të tyre, siç është edhe kjo Reformë e Sistemit të Drejtësisë, si edhe për të ndërtuar së bashku një kulturë të paqes dhe të shtetit të së drejtës, sidomos në mendjet e më të rinjve, ku drejtësia dhe të drejtat e njeriut të gjithsecilit të përbëjnë një vlerë të çmuar dhe të gjithëpranuar për çdo bashkësi në Shqipëri"*

Ndërsa Renate Winter, anëtare e Komitetit të OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve, vuri theksin në nevojën për një ligj specifik mbi drejtësinë për të mitur, që ofron mbrojtjen dhe trajtimin që u nevojitet fëmijëve në rastet kur kryejnë vepra penale[105].

---

[104] Reforma në Drejtësi u miratua me 22.07.2016

[105] http://reformanedrejtesi.al/aktivitet/drejtesia-e-te-miturve-ne-fokus-te-konsultimit-publik-per-reformen-ne-sistemin-e-0 data aksesit 24.06.2016

## 6.7 Statistikat e birësimeve të realizuara nga 2010-2015

Sipas KSHB-ve, gjatë vitit 2015 janë regjistruar:

- 5 kërkesa vendase me pëlqim
- 41 kërkesa vendase për birësim nga institucioni

Ndërsa realizuar janë:

- 6 birësime me pëlqim
- 22 fëmijë të braktisur janë birësuar

Në lidhje me klasifikimin e gjendjes shëndetësore të fëmijëve në total janë birësuar:

- 21 fëmijë të shëndetshëm (11 femra & 10 meshkuj)
- 1 fëmijë (seksi mashkull) me probleme shëndetësore

Struktura e familjes birësuese:

- 5 prindër të vetem birësues
- 23 çifte bashkëshortësh birësues

Mosha mesatare e prindërve birësues:

- Për nënat është 42.4 vjeç
- Për baballarët 43.4 vjeç

Për më tepër në lidhje me shifrat e birësimeve të realizuara në vitin 2015 i referohemi tabeles.

**<u>Viti 2015</u>**

| **Institucioni** | **MOSHA E TË BIRËSUARVE** | | | | | | | | **Totali** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **<1** | | **1-4** | | **5-9** | | **>10** | | **M** | **F** |
| | M | F | M | F | M | F | M | **F** | | |
| Sh. F. "Hannah& Montana" Tiranë | 4 | 5 | - | - | - | - | - | - | 4 | 5 |
| Sh. F. "Zyber Hallulli" Tiranë | - | - | - | - | - | - | - | 1 | - | 1 |
| Sh. F. 0-6 vjeç, Vlorë | - | - | 1 | 1 | - | - | - | - | 1 | 1 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sh. F. Durrës | 1 | - | - | - | - | 1 | - | - | 1 1 |
| Sh.F 0-3 vjeç, Shkodër | 1 | - | - | - | 1 | - | - | - | 1 1 |
| Sh. F. “Lulet e vogla” Korçë | 1 | 1 | - | - | - | - | - | - | 1 1 |
| Sh.F “Nënë Tereza” Elbasan | - | 1 | - | - | - | - | - | - | - 1 |
| Sh.F “Vatër e Ngrohtë” Gjirokastër | - | - | - | - | - | 1 | | - | - 1 |
| **Numri total i birësimeve vendase** | 9 | 7 | 1 | 1 | 1 | 2 | - | 1 | 11 11 |

Tab.5

| **Treguesi** | **Vlera** |
|---|---|
| 1. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur fillojnë procedurat e birësimit | 3.2 muaj |
| 2. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fillojnë procedurat e birësimit deri në birësimin e fëmijës | 5.1 muaj |
| 3. Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur birësohet | 7.4 muaj |

Tab. 6

**<u>Në vitin 2014 në Shqipëri janë realizuar:</u>**

- 5 birësime me pëlqim
- 37 birësime nga Institucioni

| **Institucioni** | **MOSHA E TË BIRËSUARVE** | | | | | | | | **Totali** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **<1** | | **1-4** | | **5-9** | | **>10** | | **M** | **F** |
| | M | F | M | F | M | F | M | **F** | | |
| Sh. F. "Hannah& Montana" Tiranë | 7 | 6 | 2 | 3 | - | - | - | - | 9 | 9 |
| Sh. F. 0-6 vjeç, Vlorë | 3 | - | 1 | 1 | - | - | - | - | 4 | 1 |
| Sh. F. Durrës | 3 | 5 | - | - | - | - | - | - | 3 | 5 |
| Sh.F 0-3 vjeç, Shkodër | - | - | 2 | - | - | - | - | - | 2 | - |
| Sh. F. "Lulet e vogla" Korçë | - | - | - | - | - | 1 | - | - | - | 1 |
| Sh.F "Nënë Tereza" Elbasan | - | 2 | - | - | - | 1 | - | - | 1 | 2 |
| Sh.F "Vatër e Ngrohtë" Gjirokastër | - | - | - | - | - | - | | - | - | - |
| **Numri total i birësimeve vendase** | 13 | 13 | 5 | 4 | 1 | 1 | - | - | 19 | 18 |

Tab.7

Në vitin 2013 janë realizuar 20 birësime nga Institucionet dhe 10 birësime me pëlqim.

Në vitin 2011 janë realizuar 27 birësime nga Institucionet dhe 3 birësime me pëlqim.

Në vitin 2010 janë realizuar 18 birësime nga Institucionet dhe 8 birësime me pëlqim.

Viti 2012 nuk figuron në statistikat e publikuara nga KSHB.

Në një intervistë për gazeten Shekulli në vitin 2009, kryetari i KSHB-së, Genci Terpo shprehet në lidhje me shifrat e birësimeve:

*“Tendenca e birësimit të fëmijëve shqiptare nga çiftet e huaja nuk mund të themi me plot gojë se është rritur në parametra shumë të dukshëm krahasimisht me vitet e meparshme, megjithatë pas vitit 2007 me miratimin e Ligjit Nr. 9695 datë 19.03.2007 "Për procedurat e birësimit dhe KSHB", duke realizuar implementimin e këtij të fundit është bërë me e qartë për të gjithë shtetasit shqiptarë apo të huaj (rastet kur shtetasit e huaj i përkasin një shteti që ka ratifikuar Konventen e Hagës për birësimin ndërvendas), procedura që duhet të ndjekin për të aplikuar dhe për të përmbushur kushtet e nevojshme në referencë të ligjit për birësimin e një fëmije shqiptar”.*

### 6.8 Birësimi ndërvendas në Shqipëri

Birësimi ndërvendas në Shqipëri rregullimin e parë me ligj e pati në Kodin Civil të 1929. Në nenin 259 të këtij kodi parashikohej: “Shtetasi mund të adoptojë një të huaj ose të adoptohet prej një të huaji. Adoptimi nuk i ndryshon të adoptuemit shtetësinë”.

Me ardhjen e regjimit komunist në Shqipëri pati ndryshime themelore në të gjithë sistemin e të drejtës, të cilat u shoqëruan me ndryshimin e të gjithë kuadrit ligjor. Në ligjin nr.602, datë 19.5.1948 “Mbi adoptimin”, në ligjin 4020, datë 23.06.1965 “Mbi Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë”, birësimi ndërvendas permendej, gjithashtu dhe në ligjin 6599, datë 29.06.1982 “Kodi i Familjes i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Në nenin 10 të ligjit 3920 dt.21.11.1964 “Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt në Shqipëri dhe zbatimin e ligjit të huaj”, është parashikuar se, birësimi dhe pushimi i tij rregullohen nga ana e legjislacionit të shtetit, shtetas i të cilit është birësuesi në momentin e birësimit apo të pushimit të tij (Kalia A., 2010: 220-221). Me dekretin nr. 146 datë 13.03.1992, në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, u bë nderprerja e birësimit të të miturve shqiptare nga shtetasit e huaj, me qëllim që të

disiplinohen juridikisht birësimet e të miturve shqiptarë nga shtetasit e huaj në përputhje edhe me konventat ndërkombëtare, deri në rregullimin ligjor të këtij problemi. Gjithashtu, u shfuqizua neni 10 i ligjit 3920 dt.21.11.1964. Më pas, në ligjin 7650, datë 17.12.1992, në nenin 8, paarashikohet mundësia e birësimit të një të mituri jashtë vendit, nëse nuk ka qënë e mundur gjetja e një vatre familjare brenda vendit.

Sot, në Shqipëri, birësimi ndërvendas rregullohet me ligjin nr.9695, datë 19.03.2007, nga KF, ligji nr.9062, datë 8.05.2003 i ndryshuar në 2012 dhe nga ligji nr.10428, datë 2.6.2011 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Hagës së 1993, me 12.09.2000 e cila hyri në fuqi me 01.01.2001.

Mundësia që një fëmijë të birësohet jashtë vendit lind atëherë kur nuk ka qënë e mundur të gjendet një familje birësuese e përshtatshme brenda vendit gjatë gjashtë muajve të parë të qëndrimit të tij në listat e fëmiljëve të gatshmë për tu birësuar. Bashkëpunimi i autoriteteve shqiptare me autoritetet e vendit pritës është një kusht i rëndësishëm që birësimi të mos dështojë dhe fëmija të autorizohet të hyjë për të banuar përgjithmonë në vendin pritës. Shtetasit e huaj mund t'i drejtohen KSHB-së vetem nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjencive ndërmjetësuese të vendit të tyre, të njohura si të tilla nga KSHB (ligji nr.9695: neni 14), i cili ka nënshkruar marrëveshje me këto agjensi[106]për të realizuar birësimin ndërvendas të fëmijëve shqiptar të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.

[106] 1. Amici Dei Bambini
2. SPAI
3. Bethany Christians Service
4.Adoption Worx Canada
5. Medicine du Monde
6. Comunità Sant'Egidio
7.Illien Adoption International INC
8.Nightlight

Në bazë të përcaktimeve të kësaj konvete, KSHB merr cilësinë e Autoritetit Qëndror, i cili, është autoriteti i vetëm në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit vendas dhe ndërvendas.

Legjitimohen për të aplikuar për birësimin e një fëmijë nëpërmjet birësimit ndërvendas:

1. Shtetasit shqiptarë kur duan të birësojnë:

   *a) fëmijë shqiptarë rezident jashtë RSH-së*

   *b) fëmijë të huaj*

2. Shtetasit e huaj që kërkojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë

3. Shtetasit e huaj rezident në RSH, që kërkojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë ose të huaj jo rezident në RSH

Për kategorinë e parë, shtetasit shqiptar mund të procedojnë për aplikim vetem nëpërmjet KSHB-së dhe jo drejtëpërdrejtë tek agjensitë apo autoritetet e huaja ndërmjetësuese në vendin ku dëshirojnë të birësojnë fëmijën. Edhe shtetasit e huaj rezident prej të pakten dy vitesh në RSH, nëse legjislacioni i tyre kombëtar e lejon birësimin, i drejtohen KSHB-së pa pasur nevojën e kontaktimit nëpërmjet agjensive ndërmjetësuese. Për shtetasit shqiptarë rezidentë në RSH, birësimi i një fëmije të huaj, mund të themi që është një fenomen pothuajse aspak prezent në shoqëri. Shtetasit e huaj mund të birësojnë vetem nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjensive ndërmjetësuese në vendin e tyre, të akredituara nga KSHB-ja. Kushtet për birësim, përfundimin e tij dhe efektet që sjell ai, rregullohen nga ligji i shtetit shtetësinë e të cilit kanë birësuesit në kohën e birësimit (Ligj 10 428, neni 30 & 31).

*Procedurat që ndiqen*

Ashtu si birësimi vendas edhe birësimi ndërvendas kalon nëpër dy faza:

1. Faza administrative
2. Faza gjyqësore

Procedura administrative kryhet nga KSHB në bashkëpunim me Agjensitë Ndërmjetësuese të akredituara ose me Autoritetet Qëndrore Kompetente të njohura nga Komiteti. Agjensia ndërmjetësuese pasi merr kërkesën për birësim nga një person single apo çift bashkëshortësh, të cilët janë shtetas në shtetin ku dhe agjensia ushtron veprimtarinë e saj, bën plotësimin e dosjes dhe studimin e familjes. Aplikantët vetem nëpërmjet agjensisë mund të aplikojnë te KSHB, për të birësuar një fëmijë në Shqipëri. Është Këshilli Drejtues i Komitetit që bën një sërë verefikimesh në lidhje me: vlefshmërinë e dokumentacionit të aplikantëve birësues; miratimin, nga organi kompetent i huaj, i përshtatshmërisë së aplikantëve birësues; dokumentacionin e plotë dhe të saktë të aplikantëve; përputhjen e parimeve të legjislacionit shqiptar më atë të shtetit të birësuesit; bashkëpunimin me autoritetet e vendit pritës, që birësimi të mos dështojë dhe fëmija të autorizohet të hyjë për të banuar gjithmonë në shtetin pritës (ligji 9695: neni 27)

Dosjes për aplikim të sjellë nga agjensia ndërmjetësuese, Komiteti i bashkëngjit edhe një sërë dokumentësh të tjerë, të cilët vertetojnë pamundësinë e birësimit të fëmijës në Shqipëri sipas afateve të përcaktuara me ligj, vertetimin se në vendin e prindërve birësues fëmija do të gëzojë të njejtat të drejta si në Shqipëri dhe se birësimi është i parevokueshëm.

Legjitimohen për t’u birësuar jashtë vendit ato fëmijë të cilët kanë qëndruar për 6 muaj në listat e KSHB-së dhe që gjatë kësaj periudhe janë ezauruar të gjitha mundësitë për kthimin e tij në familjen biologjike apo birësimin brenda vendit. Përjashtim nga afati 6 mujor, sipas nenit 23 pika 2, bëjnë ato raste të veçanta, kur në pritje të plotësimit të afatit të sipërpërmendur mund të dëmtohet shëndeti i fëmijës dhe duke u bazuar në interesin më të

lartë të fëmijës, Komiteti mund të japë pëlqimin për birësim edhe pa u përmbusheur ky afat, duke e motivuar këtë pëlqim. Dosja i dërgohet gjykatës për t'u ndjekur procedura gjyqësore. Disa fëmijë për shkak të disa karakteristikave të veçanta që paraqesin janë më të përshtatshem për t'u birësuar jashtë vendit kur:

1) Janë të diagostifikuar me një sëmundje e cila kërkon një trajtim mjekësor më të specializuar që nuk mund të ofrohet brenda territorit shqiptar

2) Janë fëmijë që vijnë nga familje me probleme sociale të rënda si psh. gjakmarrja dhe se birësimi i tyre jashtë vendit do ishte në interes të fëmijës dhe familjes biologjike

3) Arsye të tjera të ndryshme për t'u gjykuar rast pas rasti, që në cilësinë e tyre fëmija nuk ka një të ardhme të sigurtë nëse qëndron dhe birësohet në Shqipëri

Gjykata është organi kompentet për të deklaruar një fëmijë si "të birësueshëm". Gjykata nuk është organi kompetent që përcakton nëse fëmija duhet të jetë pjesë e një birësimi vendas apo ndërvendas, por është KSHB-ja që përcakton në bazë të rrethanave cilësuese të fëmijës birësimin e tij, brenda apo jashtë vendit. Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit sipas nenit 13 të ligjit mbi birësimin, mban një regjister me fëmijët e braktisur që mund të birësohen në vend apo jashtë tij.

Birësimi ndërvendas në bazë të ligjit KF neni 257 ndalohet kur

a) Birësimi nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit

b) Arrihet në përfundimin se birësimi është me pasoja të rënda për të miturin

c) I mituri, në shtetin ku banojnë birësuesit, nuk gëzon të njejta të drejta që njihen në Shqipëri

“Agjenci ndërmjetësuese” janë organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, të liçencuara ose të miratuara nga organet kompetente të birësimit (K.F, ligji 9695: neni 3).

Agjensitë e huaja të akredituara kanë për detyrë:[107]

a) Përgatitjen e dokumentave të aplikantit në përputhje me legjislacionin e vendit të tij/saj, legjislacionit shqiptar dhe paraqitjen e tyre para KSHB-së

b) Oraganizmin e sesioneve këshilluese me aplikantët për të birësuar rreth birësimit dhe pasojave të tij, po ashtu informimin rreth të drejtave dhe detyrimeve

c) Ndjekjen e procedurave pas dhënies së pëlqimit për birësim nga Komiteti deri në finalizimin e birësimit në Shqipëri.

d) Dërgimin e raporteve në lidhje me procedurat e birësimit

e) Dërgimin dhe vendosjen e fëmijës së birësuar në shtetin dhe familjën birësuese

Të huajt e interesuar për të birësuar një fëmijë shqiptar në përmbushje të procedurave të birësimit duhet të paguajnë një tarifë, të përcaktuar në një udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe asaj të Drejtësisë, e cila varion sipas kombësisë, deri në një mijë dollarë. Pas realizimit të birësimit, KSHB-ja ka për detyrë në bashkëpunim me agjensinë ndërmjetësuese të ndjekë përshtashmërinë e fëmijës me familjen birësuese.

[107] Coutry profile for intercountry adoption, state of origin, Permanent Bureau, mars 2010, fq 8

### *6.9 Statistikat të birësimeve ndërvendase*

Tabela tregon birësimet ndërvendase të realizuara ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të mëposhtme 2005-2009: [108]

| SHTETI PRITËS | NUMRI TOTAL I BIRËSIMEVE | | | | | MOSHA E TË BIRËSUARVE | | | | | | | | FËMIJËT E BIRËSUAR ME NEVOJA TË VEÇANTA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | <1 | | 1-4 | | 5-9 | | >10 | | |
| | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| SHBA-ja | 12 | 6 | 13 | 8 | 6 | - | - | 8 | 13 | 2 | 4 | 2 | 15 | 9 |
| ITALIA | 9 | 6 | 6 | 6 | 5 | - | - | 13 | 12 | 5 | - | 1 | - | 4 |
| FRANCA | 4 | 4 | 4 | 2 | 3 | - | - | 7 | 8 | 1 | - | - | 1 | 1 |
| KANADAJ-A | 5 | 4 | 2 | 1 | 1 | - | - | 5 | 8 | - | - | - | - | 1 |
| SPANJA | 3 | 4 | 2 | 3 | - | - | - | 4 | 5 | 1 | - | 1 | - | 3 |
| SUEDIA | 4 | 1 | 1 | 1 | - | - | - | 1 | 4 | - | - | - | 1 | 4 |
| **Numri total i birësimeve ndërvenda-se** | **37** | **21** | **28** | **21** | **15** | - | - | 38 | 50 | 9 | 4 | 4 | 17 | 22 |

Tab.1

Në statistikën e mësipërme vëmë re se fëmijët e preferuar për t'u birësuar janë kryësisht vajzat e moshës nga 1-4 vjeç, ndërsa vendin e parë të numrit të birësimeve me Shqipërinë e zë SHBA-ja e ndjekur nga Italia. Në vitin 2010 Shqipëria ka realizuar 12 birësime

[108] Annual Adoption Statistics Forms, hartuar nga Zyra Permanente, dokumenti mbi operimin praktik të Konventes së Hagës se 1993, Prill, 2010

ndërvendase, ndërsa në vitin 2011 ky numer ra në 7. Në vitin 2013 janë realizuar 17 birësime nga çiftet e huaja.

Franca ka birësuar 10 fëmijë shqiptarë në total për periudhën nga viti 2010-2013. Në këtë hark kohor 3 vjeçar vihet re rritja e numrit të birësimeve nga viti në vit dhe se kryesisht fëmija birësues i përkiste gjinisë femërore.

Në bazë të raportit të Schuster Institute for Investigative Journalism, Brandeis University, Shqipëria rënditet ndër vendet me parregullsitë më të mëdha në birësmin ndërvendas. Duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim, vihet re një rritje e numrit të birësimeve ndërvendase në Shqipëri (fëmijë shqiptarë të birësuar jashtë vendit). Për më tepër i referohemi statistikave të publikuara nga KSHB ndër vite.

**Birësime ndërvendase nga çdo institucion**

**2013**[109]

[109] Këto birësime në vitin 2013-të janë realizuar nëpërmjet agjensive të huaja të mëposhtme dhe përkatësisht:
• Shërbimi Polifunksional për Birësimet Ndërkombëtare SPAI, Itali
- Ka kërkuar 5 fëmijë për birësim dhe është realizuar vetem1 birësim (femer)
• Shërbimet e Krishtera Bethany, USA
- Ka kërkuar 7 fëmijë për birësim dhe janë realizuar 6 birësime (2 meshkuj & 4 femra)
• Miqtë e fëmijëve AIBI, Itali
- Ka kërkuar 9 fëmijë për të birësuar dhe janë realizuar vetem 2 (1mashkull & 1 femer)
• M.D.M Francë
- Ka kërkuar 6 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 2 birësime (femra)
• A.F.A Francë
- Ka kërkuar 2 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 1 birësim (mashkull)
• Sant'Edigio- 1 fëmijë (femer)
• Ka kërkuar 2 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 1 birësim (femer)
• Adoptionworx, Kanada- 2 fëmijë (1 mashkull & 1 femer)
• Ka kërkuar 4 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 2 birësime (1 mashkull& 1 femer)
• Autoriteti Qendror Grek- 1 fëmijë (mashkull)
• Ka kërkuar 3 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 1 birësim (mashkull)
• A.Q. Spanjë- 1 fëmijë (mashkull)
• Ka kërkuar 1 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 1 birësim (mashkull)
• A.Q Maltë
• Ka kërkuar 4 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 0 birësime
• A.Q Qipro
• Ka kërkuar 1 fëmijë për të birësuar dhe ka realizuar 0 birësime

| Institucioni | MOSHA E TË BIRËSUARVE | | | | | | | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **<1** | | **1-4** | | **5-9** | | **>10** | | **M** | **F** |
| | M | F | M | F | M | F | M | **F** | | |
| Sh. F. Tiranë | - | - | 1 | 3s 4 | - | - | - | - | 1 | 7 |
| Sh. F. Gjirokaster | - | - | - | - | - | - | 1rr | - | - | 1 |
| Sh. F. Korçë | - | - | 1s | - | - | - | - | - | 1 | - |
| Sh. F. Durrës | - | - | 1s 1 | - | - | - | - | - | 2 | - |
| Nënë Tereza | - | - | 2s | 1s | - | - | - | - | 2 | 1 |
| Sh. F. Shkodër | - | - | 1 | 1 | - | - | - | - | 1 | 1 |
| **Numri total i birësimeve ndërvendase** | - | - | 3-4s | 5-4s | - | - | 1rr | - | 7 | 10 |

Tab.2 [110]

**Birësime ndërvendase të realizuara në vitin 2014[111]**

| Institucioni | MOSHA E TË BIRËSUARVE | | | | | | | | Totali | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | **M** | **F** |
| | **<1** | | **1-4** | | **5-9** | | **>10** | | | |
| | M | F | M | F | M | F | M | **F** | | |
| Sh. F. "Hannah& Montana" Tiranë | - | 3 | 2 | 3 | - | - | - | - | 2 | 6 |
| Sh. F. Tiranë | - | 1 | - | - | - | - | - | - | - | 1 |
| Sh. F. 0-6 vjeç, Vlorë | - | - | - | 2 | - | 1 | - | | - | 3 |
| Sh. F. Durrës | 1 | - | 2 | 1 | - | - | - | - | 3 | 1 |
| Sh.F 0-3 vjeç, Shkodër | - | 2 | - | - | - | 1 | - | - | - | 3 |
| Sh. F. "Lulet e vogla" Korçë | 1 | - | - | - | - | 1 | - | | 1 | 1 |

[110] Shënim: sh- fëmijë të shëndetshëm; s- fëmijë me probleme shendetësore; rr- fëmijë në moshë të rritur
[111] Agjensitë ndërmjetësuese:
- SPAI, Itali - 8 fëmijë të birësuar (8 femra)
- Sant'Egidio, Itali - 2 fëmijë të birësuar (1 mashkull&1 femer)
- Medecins du Monde, Francë – 3 fëmijë të birësuar (2 meshkuj & 1 femer)
- Sherbimet Kristiane Bethany, USA – 6 fëmijë të birësuar (2 meshkuj & 4 femra)
- Adoptionworx, Kanada – 6 fëmijë të birësuar (3 meshkuj & 3 femra)

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sh.F "Nënë Tereza" Elbasan | 1 | | | 2 | | | | | 1 | 2 |
| Sh.F "Vatër e Ngrohtë" Gjirokastër | | | | | | 1 | | 1 | - | 2 |
| **Numri total i birësimeve ndërvendase** | - | - | 3-4s | 5-4s | - | - | 1rr | - | 8 | 17 |

Tab.3

24 prej këtyre fëmijëve janë birësuar nga çifte bashkëshortësh, ndërsa 1 fëmijë i gjinisë femer është birësuar nga një prind i vetem. Ndër këto, 6 fëmijë janë me probleme shendetësore dhe 19 janë të shendetshëm.

**Birësimet ndërvendase të realizuara në vitin 2015**[112]

| **Institucioni** | **MOSHA E TË BIRËSUARVE** | | | | | | | | **Totali** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **<1** | | **1-4** | | **5-9** | | **>10** | | **M** | **F** |
| | M | F | M | F | M | F | M | **F** | | |
| Sh. F. "Hannah& Montana" Tiranë | 1 | 2 | 2 | 1 | - | 1 | - | - | 3 | 4 |
| Sh. F. "Zyber Hallulli" Tiranë | - | 1 | - | - | - | - | - | 3 | - | 3 |
| Sh. F. 0-6 vjeç, Vlorë | - | - | 1 | - | 2 | - | - | | 3 | - |
| Sh. F. Durrës | - | 3 | 1 | - | - | - | - | - | 1 | 3 |
| Sh.F 0-3 vjeç, Shkodër | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Sh. F. "Lulet e vogla" Korçë | - | 1 | 1 | - | - | - | - | | 1 | 1 |
| Sh.F "Nënë Tereza" Elbasan | - | 1 | 3 | 1 | | | | | 3 | 2 |

[112] Agjensitë ndërmjetësuese:
- SPAI, Itali – 3 fëmijë të birësuar (2 meshkuj & 1 femer)
- Sant'Egidio, Itali - 1 fëmijë i birësuar (1 mashkull)
- AiBi, Itali – 5 fëmijë të birësuar (4 meshkuj & 1 femer)
- Medecins du Monde, Francë – 2 fëmijë të birësuar (2 meshkuj)
- Agjensia Franceze e Birësimeve, Francë – 3 fëmijë të birësuar (3 femra)
- Sherbimet Kristiane Bethany, USA – 7 fëmijë të birësuar (1 meshkuj & 6 femra)
- Adoptionworx, Kanada – 4 fëmijë të birësuar (1 meshkuj & 3 femra)
- Autoriteti Qendror i Maltes – 1 fëmijë i birësuar (1 mashkull)

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sh.F "Vatër e Ngrohtë" Gjirokastër | | | | | 1 | | | - | 1 | - |
| **Numri total i birësimeve ndërvendase** | 1 | 7 | 8 | 2 | 3 | 1 | - | 3 | 12 | 14 |

Tab.4

Bazuar në statistikat e KSHB-së vihet re një destabilitet i shifrave të birësimeve ndërvendase me luhatje herë rritëse dhe herë zbritëse të tyre.




Graf.1

Siç vihet re në një periudhë kohore 10 vjeçare numri i birësimeve ndërvendase ka lëvizur shpesh herë me diferenca të mëdha[113] nga viti në vit, psh. nga viti 2005 në 2006 numri pati rënie me 16 fëmijë më pak të birësuar jashtë vendit; me tendenca rritëse në 2007 me 7

[113] Krahasuar me numrin total dhe trendin e birësimeve ndërvendase në Shqipëri

birësime me tepër nga 2006; 5 vjeçarshi 2008-2013 pati një rënie drastike në kërkesa dhe birësime të realizuara ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Vlejnë për t'u përmendur masat shtrënguese që BE-ja ka vendosur kryesisht për vendet në zhvillim, në kuadër të birësimeve ndërvendase, pasi këto shtete, përfshirë dhe Shqipërinë, janë akuzuar ndër vite për "shitje të bebeve" apo "trafikim të ligjshëm" të tyre nëpërmjet birësimit ndërvendas. Ndërkohë, trendi rritës pas vitit 2011, mund të përkthehet si ndikim i përforcimit të shtetit ligjor dhe krijimit e besueshmërisë kundrejt aplikantëve të huaj për të birësuar fëmijë në Shqipëri.

Vitet e fundit, Shqipëria është bërë një vend më i sigurtë dhe i besueshëm në sytë e të huajve. Situata politike dhe sundimi i ligjit, të përcjellë në situata të ndryshme në mediat ndërkombëtare, janë faktorë indirekt që ndikojnë në kerkesat për birësim nga të huajt. Së fundmi vërehet një tendencë në rritje e shtetasve kanadezë e francez (Gazeta Shqip, 26 maj 2013) të cilët aplikojnë për të birësuar një fëmijë shqiptar.

Një ndër rastet më tipike të birësimit ndërvendas në Shqipëri është ai i Ambasadorit Austriak në Shqipëri z. Thomas Schnoell dhe bashkëshortes së tij, të cilët në vitin 2014 birësuan një vajzë shqiptare Anastasian. Zonja Schnoell, në një intervistë për një media informative online[114] tha:

> *"Në sajë të shumë ligjeve ekzistuese, është teper e vështirë dhe e pazakontë për fëmijët që të adoptohen para se të mbushin 1 vjeç. Por ne duhet ta dimë se viti i parë në jetën e një fëmije është kaq vendimtar për zhvillimin e trurit dhe zhvillimin emocional të tij…të mos kesh stimulimin e duhur emocional dhe konjitiv që nga lindja ka nje efekt shume negativ në zhvillimin e një fëmije që do ti shkaktojë një dëm shumë të madh në mireqënien e tij/e saj dhe në të gjitha aspektet e jetes."*

[114] http://infoalbania.al/sia-bebja-shqiptare-e-biresuar-nga-ambasadori-austriak-ne-tirane/ dt. 03.10.2014

Sipas ligjit Nr.10 428, datë 2.6.2011, “për të drejtën ndërkombëtare private”, kushtet, efektet e birësimit dhe përfundimi i tij rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e e të cilit kanë birësuesit në kohën e birësimit.

# KAPITULLI VII- QASJET BASHKOHORE DHE PROBLEMATIKAT E INSTITUTIT TË BIRËSIMIT

## 7.1 Doktrina "Interesi më i lartë i fëmijës"

*"Njërëzimi duhet t'u japë fëmijëve atë ç'ka ai ka me të mirë"*

*Deklarata e të Drejtave të Njeriut*[115]

Fëmijët janë qënia më e brishtë e planetit…jemi ne, të rriturit, që vendosim për çdo çështje ne lidhje to. Fëmija ëshë e ardhmja e vendit, si një qytetar, punëtor dhe prind dhe për të siguruar një të ardhme më të mirë për vendin, duhet që vemendja kryesore të fokusohet tek fëmijët, si themeli i së ardhmes.

Sipas Konvetes mbi të drejtat e fëmijëve "me fëmijë kuptohet çdo qënie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet". Neni 24 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike pranon të drejtën e çdo fëmije, pa diskriminim, për të marrë nga familja e tij, shoqëria dhe shteti mbrojtjen e nevojshme për shkak të statusit të tij si "i mitur". Pakti nuk jep ndonjë përkufizim të "të miturit", as nuk tregon moshën në të cilën fëmija bëhet madhor[116].

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës, është një koncept i vjetër, që së pari u shfaq si një standart i artikuluar në Ligjin e Birësimit në Amerikë në mes të viteve 1800 (Kohm L. M, 2009: 9), sot, ky parim, është ndër prioritet kyq të së Drejtës Ndërkombëtare dhe të legjislacioneve të brendshme të shteteve. Ndërsa e Drejta Ndërkombëtare i bën trajtim ligjor

[115] Shpallur nga Asambleja e Organizates së Kombeve të Bashkuara në vitin 1959

[116] Legjislacioni shqiptar dhe konveta e të drejtave të fëmijës, Qëndra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara; studim krahasues

të përgjithsëm, legjislacioni i brendshëm përcakton rregulla strikte proçeduriale për marrjen e vendimeve në lidhje me fëmijët vetem mbi bazën e interesit më të lartë të tij. Pavarësisht se në çdo konventë apo instrument ndërkombëtar në mbrojtjen e fëmijës, interesi më i lartë i tij është primar, në legjislacionet e vendeve të ndryshme europiane konteksti i këtij interesi shikohet në mënyra të ndryshme, kjo në varësi të zhvillimit ekonomiko-social të vendit. Në kuadër të evoluimit dhe të ndryshimeve ligjore për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri, është synuar krijimi i kuadrit ligjor dhe praktikave gjyqësore në përputhje me standartet ndërkombëtarë. Ky interes ka filluar të njihet gjërësisht nga punonjësit social, prakticienët dhe profesionistët që punojnë me fëmijët[117].

Sipas *Janusz Korczak*[118], interesi më i lartë duhet të konsiderohet jo si bamirësi apo favor ndaj fëmijëve, por si një e drejtë e tyre.

Deklarata e të Drejtave të Njeriut e viti 1959, e vendos interesin më të lartë të fëmijës në konsideratën më të lartë dhe e përmend në nenet 3, 9, 18, 20, 21, 37, 40; Konventa Europiane "Mbi birësimin" dhe Konventa "Për të drejtat e fëmijëve", vendosin gjithashtu në konsideratën parësore ILF-në. Këto Konventa parashikojnë detyrimin e Shteteve Palë që të marrin masat e duhura që në lidhje me çdo veprim që ndërmerret për fëmijët, interesi më i lartë i fëmijës të jetë çështja kryesore.

Në instrumentat ligjorë ndërkombëtarë dhe legjislacionet kombëtare të vendeve të BE-së, në mënyrë eksplicite proklamohet interesi më i lartë i fëmijës si kushti më kryesor dhe i domosdoshëm për të ardhmen e fëmijës. Ndërsa Konventa e 2008 në nenin 4 të saj e sheh

[117] The Rights of Children in Italy, Perspectives in the third sector, Suplementary Report to the United Nations, Romë, nëntor 2001, fq. 14

[118] Janusz Korczak (1878-1942), poet i famshëm polak, i cili gjithë jetën e tij ia dedikoi punës ndaj fëmijëve, si me veprat e tij të shkruara ashtu dhe me punën e tij si drejtor i një jetimoreje në Varshavë.

interesin më të lartë të fëmijës si kusht të domosdoshëm; sipas Aktit Anglez të 2002 interesi më i lartë i fëmijës është një kusht i mjaftueshëm për të realizuar proçesin e birësimit (Sloan B.,2009; 18). Çdo interpretim i interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë në përputhje me frymën e gjithë Konventes (Doracak trajnimi, 2012: 16).

Siç thuhet në nenin 25 të Kartes Themelore të të Drejtave në BE: “në të gjitha veprimet ndaj fëmijëve të ndërmarra nga institutet publike apo private, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore”. Në radhë të parë me birësim duhet të mbrohen interesat e fëmijës (Weisberg, Appleton, 2006; 1129). Mirëqënia e fëmijës përcaktohet nga rrethana individuale karakterizuese për fëmijën, të tilla si mosha e fëmijës (e cila lidhet dhe me aftësinë e fëmijës për të përceptuar), ambjenti ku rritet fëmija dhe marrëdhënia me prindërit biologjik.

Legjislacioni jonë, po ashtu dhe legjislacionet e brendshme të vendeve të BE-së, i japin prioritet rritjes së fëmijës nga prindërit biologjik, duke përcaktuar verefikimin e të gjitha mundësive për të mbajtur fëmijën në familjen e tij/saj, gjë e cila duhet të shoqërohet me politikat mbështetëse të qeverisë kundrejt familjeve me gjendje të rëndë ekonomike, duke u krijuar lehtësira në mënyrë që të shmanget heqja dorë nga përgjegjësia prindërore dhe dhënia e pëlqimit për birësim të fëmijës.

Një ndër parimet kryesore të KF është interesi më i lartë i fëmijës. Ashtu si Kushtetuta, edhe ligje të tjera e kanë parë të mturin të përfshirë në konceptin e shtetasit pa e diferencuar atë (UNICEF, 2009: 25). Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e përkrahjes shoqërore publike apo private, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese (KDF, neni 3).

Në rastet kur vërehet se të drejtat e një fëmije nuk respektohen, Avokati i Popullit mund të fillojë trajtimin e këtij rasti edhe me iniciativën e tij, në rastet kur vlerëson se interesi më i lartë i fëmijës nuk merret në konsideratë[119].

ILF është një standart i dizenjuar për të drejtuar gjykatësit kur marrin vendime që kanë të bëjnë me fëmijët[120], gjithashtu është një faktor përcaktues për veprime specifike, kryesisht për birësimin (KDF, neni 21).

Gjykata, në shqyrtimin e çështjes së birësimit të një fëmije, për të vendosur se çfarë është më e mirë për fëmijën, duhet të bazohet së pari në lumturinë e fëmijës (në atë çfarë do fëmija), apo në aspekte të tjera si feja apo raca, kombësia, apo në gjendjen ekonomike të prindërve birësues? Cili ndër këto kritere është më i rëndësishëm për mirëqënien, mirërritjen dhe edukimin e një fëmije?

Në radhë të parë nuk kemi të bëjmë me një listë hierarkike nga A-Z, e cila përcakton kriteret, kushtet dhe vlerat që duhet të plotësojnë prindërit birësues, por diversiteti i vlerave dhe rrethanave që karakterizojnë fillimin e një marrëdhënie të re prind-fëmijë, e drejton gjykatën në përcaktimin dhe përzgjedhjen e kritereve primare rast pas rasti dhe se çështja e interesit më të lartë të fëmijës nuk ka rregulla strikte. Në interpretim të këtij interesi, vihet theksi te fëmija si një individ me mendime dhe ndjenja të tij si dhe te fëmija si subjekt i të drejtave civile dhe politike, ashtu sikurse dhe mbrojtjes së veçantë (Doracak trajnimi, 2012: 16). Në shumë raste, vetem legjislacioni nuk mund të përcaktojë interesin më të lartë për çdo fëmijë

[119]http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/të-drejtat-e-fëmijëve data e aksesit: 31.7.2016
[120]http://www.parentalrights.org/index.asp?Type=B_BASIC&SEC=%7B485B7DA5-CCC2-4A61-94D7-E73763D3945E%7D data aksesit 19.06.2016

individualisht, në çdo situatë të veçantë[121]. Gjithmonë birësimi duhet lejuar nëse i shërben interesit të fëmijës, pra interesit të fëmijës për mirërritje (Weisberg, Appleton, 2006: 1129). Gjithsesi doktrina, përcakton një listë përmbledhëse të përgjithshme të kritereve që duhet të merren në konsideratë në përcaktimin e interesit më të lartë të fëmijës në lidhje me vendosjen e marrëdhënies së birësimit, të tilla si:

- Përshtatshmëria e fëmijës me prindërit birësues
- Dëshira e shprehur e fëmijës në lidhje me birësimin
- Aftësia e prindërve prospektiv për të rritur fëmijë
- Gjendja ekonomike e prindërve birësues
- Ndryshimi i racës ndërmjet prindërve dhe fëmijës (sidomos në ato raste kur birësuesi dhe i birësuari kanë ngjyrë të ndryshme lekure)
- Orientimi seksual i prindërve birësues
- Feja, gjuha, kultura (në ato raste kur fëmija është në një moshë që kupton dhe mund të vuajë ndryshime të tilla)
- Mosha e prindërve birësues dhe diferenca moshore ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit
- Ndonjë aspekt tjetër që gjykata e konsideron të rëndësishëm

Parimi i ILF-së, duhet të përcaktojë të gjitha politikat dhe vendimet në lidhje me fëmijët, duke mos lejuar prevalimin e interesit të të rriturve (UN Suplementary Report, Italy, 2001: 15). Detyrimi ligjor për respektimin e interesit të fëmijës nuk sjell cënim të të drejtave të të

[121] Challenges in adoption procedures in Europe: Ensuring the best interests of the child, Joint Council of Europe and European Commission Conference,brochure conference proceedings, 2009, Strasbourg, fq. 10

rriturve, në rastin tonë të prindërve biologjik dhe atyre birësues, por ky interes sipas KDF të OKB-së prevalon mbi të drejtat e tjera.

Sipas deputetes M. Bregu, në një relacionin në mars të 2015, për Projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr.81116, datë 29.03.1996 'Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar"

> *"Mënyra e hartimit të neneve përkatëse[122] të KPrC lë mjaft hapësirë për interpretim rast pas rasti dhe bie ndesh me detyrimin e përcaktuar në Konventen e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, ku interesi më i lartë i fëmijëve duhet të prevalojë si dhe njeh detyrimin e të dy prindërve për rritjen dhe edukimin e fëmijëve".*

A mund të merret një vendim në lidhje me fëmijën kundra dëshirës së tij edhe nëse është në interesin më të lartë të tij?

Sipas nenit 9 të KDF-së, në rastet që kanë të bëjë me ndarjen e fëmijës nga njëri apo të dy prindërit, nëse fëmija nuk është dakort, ky veprim nuk ndërmerret edhe pse mund të jetë në interesin e tij.

Në ato raste kur vertetohet se dëshira e fëmijës është shprehur nën kanosjen apo ndikime të formave të ndryshme nga persona të tjerë, mund të merret vendim i kundërt me dëshirën e tij që në gjykim të gjykatës përbën interesin më të lartë tijin.

Në çështjen *Sommerfeld kundër Gjermanisë* gjykuar nga GJEDNJ-ja, kërkuesi pretendon se gjykata gjermane nuk e ka marrë parasysh kërkesën e tij për të pasur kontakte me të bijën, e cila ishte e lindur jashtë martese, ndaj ka pasur shkelje të së drejtës së tij në respekt të jetës familjare dhe se ai ishte viktimë e trajtimit diskriminues. Ai e mbështetet në nenet 6, 8 dhe 14 të Konventes. gjykatat gjermane bazuar në seksionin 1634 § dhe 1711 § të Kodit Civil

[122] Nenet 317 dhe 365

gjerman, vendosin në mënyrë të pajustifikueshme në një pozitë me pak favorizuese babain e fëmijëve të lindur jashtë martese sesa babain e fëmijëve i cili është i divorcuar nga nëna biologjike dhe në rastet e dhënies së kujdestarisë nuk merret parasysh interesi më i lartë i fëmijës por çështja gjykohet mbi bazën e statusit të babait.

Më e rëndësishmja është se gjykata rajonale gjermane nuk e konsideronte lejimin e kontaktit ndërmjet fëmijës dhe babait natyral *prima facie*[123] në interesin më të lartë të saj, pasi fëmija refuzonte vazhdimisht takimin me të atin. Gjykata kishte të drejtën e refuzimit të kërkesës së babait, përsa kohë kjo nuk ishte në interesin më të lartë të fëmijës. Sipas nenit 9 paragr.2 i KDF, fëmija i cili është i ndarë nga njëri apo dy prindërit, duhet të mbajë marrëdhëniet personale dhe kontaktin direkt me të dy prindërit në mënyrë të rregullt, vetem nëse kjo është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

Po në rastet e procedurave të birësimit të një fëmijë nga një çift që ka dhe fëmijë të tjerë biologjik, interesi i cilit fëmijë duhet të prevalojë? A duhet të merret parasysh dhe dëshira e fëmijës biologjik nga gjykata në lidhje me birësimin e një vëllai apo motre?

As legjislacionet e brendshme as instrumentet ndërkombëtarë në lidhje me birësimin dhe të drejtat e fëmijëve nuk shprehen në lidhje me situata të tilla. Gjykatat bazohen kryesisht në parimin se duhet të merret në konsideratë dëshira e fëmijës në lidhje me veprimet e kryera në lidhje me të, me synimin për të vendosur në respekt të interesit më të lartë të tij, por si vendoset nëse preket interesi i njërit fëmijë për të përmbushur interesin e fëmijës tjetër? Procedurat e birësimit sipas ligjit 9695 “Mbi Procedurat e birësimit”, nuk e parashikon si

[123] Një fakt që prezumohet të jetë i vertetë derisa të provohet e kundërta

pjesë të procedurave administrative as atyre gjyqësore marrjen e mendimt të fëmijës biologjik që prindërit e tij të birësojnë një fëmijë.

Një lloj tjetër birësimi, ai transracial[124], shpesh i kundërshtuar nga organizata të ndryshme në shtete të ndryshme dhe e shoqëruar me debate kontraversiale të vazhdueshme, konsiderohet si cënim i interesit të fëmijës. Gjykatat në përgjithësi, në arsyetimin në lidhje me qëndrimin e tyre kundra në vendimet në lidhje me këtë lloj birësimi, shprehen se një marrëdhënie e tillë birësimi do të ishte lehtësisht e evidentueshme nga të tjerët, fëmija do e kishte të lehtë të kuptonte që në moshë të vogël lidhjen jo-biologjike me prindërit dhe se kjo marrëdhënie e re nuk imiton familjen natyrale, siç është dhe qëllimi i birësimit. Duke qënë se interesi më i lartë i fëmijës është në interpretim të gjykatës, në ato raste kur miratohet birësimi transracial, kryesisht fëmija është me ngjyrë ndërsa prindërit janë të bardhë. Kjo vendos në pozita diskriminuese aplikantët birësues me ngjyrë, që për aplikimin për birësim transracial, gjykatat vendosin cënim të interesit më të lartë të fëmijës. Studiues të ndryshëm[125] e përkufizojnë birësimin trans-racial si birësim të fëmijëve të zi nga familje të bardha (Turner& Taylor, 1996: 262). Për sociologët, të jesh i bardhë, në shoqëri nënkupton privilegj dhe superioritet, ndërsa të qënurit me ngjyrë nënkupton disavantazh dhe diskriminim (Patel, 2004: 25).

Një fëmijë dhe prindërit e tij ose të saj kanë të drejtë të marrin dhe të mbajnë marrëdhënie të rregullta me njëri-tjetrin. Këto marrëdhënie mund të kufizohen ose përjashtohen kur kjo

[124] Bëhet fjalë për birësimit ndërmjet njerëzve të bardhe dhe atyre me ngjyrë

[125] Bagley, Courtney, Gill, Jackson, Small

kërkohet nga interesat e larta të fëmijës (Konventa Europiane për marrëdhëniet me fëmijët; 1980, neni 4).

### 7.2 Birësimi i personave madhorë

Birësimi i personave madhorë është një praktikë e vjetër që daton që me lindjen e këtij instituti[126]. Në ato shtete ku lejohet dhe praktikohet birësimi i personave mbi 18 vjeç, birësuesi dhe i birësuari fitojnë të drejtat dhe detyrimet e marrëdhënies prind-fëmijë, duke përfshirë edhe të drejtat trashëgimore dhe kalimin e mbiemrit.

Austria, Danimarka, Gjermania, Greqia, Finlanda, Italia, Qipro, Spanja, Suedia nuk kanë vendosur një limit të moshës së personave që birësohen, duke lejuar dhe birësimin e personave në moshë madhore. Sot ai lejohet pothuajse në të gjithë SHBA-në dhe dekadën e fundit ka pasur një trend rritës në numrin e birësimeve të miratuara.

Duke qënë se i birësuari është në moshë madhore, në bazë të legjislacioneve të brendshme të vendeve që e lejojnë këtë lloj birësimi, prindi nuk është i detyruar të kujdeset financiarisht për të birësuarin, sepse edhe për fëmijët biologjik kalimi i një moshe të caktuar i çliron prindërit nga detyrimet financiare kundrejt tij. Përjashtim bëjnë rastet e të birësuarve me aftësi të kufizuara. I birësuari ashtu si në rastet e birësimit të të miturve, vendoset në çertefikatën familjare të familjes birësuese dhe merr atësinë dhe amësinë e birësuesve.

Motivi i birësimit të një të rrituri ndryshon substancialisht nga ai i birësimit të një të mituri (Wadlington, 1969: 568). Në ndryshim me birësimin e të miturve, birësimi i personave

[126] Shih kapitullin II "Vështrim historik mbi birësimin"4

madhorë nuk synon të shkëpusë marrëdhëniet e të birësuarit me familjen biologjike (vetem nëse diçka e tillë dëshirohet nga ai), por vendosjen e një marrëdhënie të re prind-fëmijë kryesisht për qëllime trashëgimie, kalimi pasurie, dhënies së një mbiemri me reputacion apo për kujdesjen e prindit/prindërve birësues për shkak të moshës së thyer. Për më tepër, kur i birësuari është në moshë madhore i "zgjedh" vetë prindërit birësues dhe në këto raste nuk është e nevojshme prania e psikologut për hartimin e raportit të përshtatshmërisë. Megjithatë edhe pse me dakortësinë e dy palëve, birësuesit dhe të birësuarit, gjykata mund të vendosë edhe për mos miratimin e birësimit.

Kur birësimi miratohet, i birësuari fiton të njejtat të drejta më fëmijët biologjik, duke përfshirë dhe të drejtat trashëgimore, të cilat përbëjnë kryesisht qëllimin e themelimit të një marrëdhënie të tillë.

Ndër ato shtete që lejojnë birësimi e të rriturve është gjithnjë e më e zakonshme gjetja e procedurave të thjeshtuara për realizmin e tij (Wadlington, 1969: 571). Procedurat e thjeshtuara në birësimin e personave madhorë janë si rezultat i mospranisë së disa elementëve të cilët janë prezent në birësimin e të miturve, të tillë si: kalimi i afateve 1 ose 3 muaj për vendosjen e fëmijës në qendrat rezidenciale[127] ; vendosja e fëmijës në listat e pritjes për birësim; marrja e vendimit për birësim nga autoritetet kompetente duke synuar interesin më të lartë të fëmijës; gjetja e familjes së përshtatshme; periudha e provës; etj.

Gjykatat në marrjen e vendimit për miratimin e birësimit të një personi madhor, e vendos theksin kryesisht në qëllimin e vendosjes së kësaj marrëdhënie midis birësuesit dhe të birësuarit, në mënyrë që të shmangen çdo lloj mashtrimi apo manipulimi për qëllime pasurore

[127] Shih: 6.6 Vendosja e fëmijës në Institucionet të Përkujdesjes Shoqërore për Fëmijë

në emer të birësimit. Nësë i birësuari prospektik është i martuar në kërkesën që i bën gjykatës duhet të përfshijë dhe pëlqimin e bashkëshortit/es tjetër[128]. Meqënëse ky birësim ka si "palë" birësuesin dhe të birësuarin, të dy në moshë madhore, interesi më i lartë i fëmijës nuk gjen më zbatim.

Në Shqipëri sipas legjislacionit në fuqi dhe përkatësisht në bazë të nenit 241 paragrafi 1 i KF-së, lejohet të birësohet vetem i mituri, duke përjashtuar mundësinë e birësimit të personave që kanë mbushur moshën madhore (mbi 18 vjeç). Por me KF e vitit 1965, neni 85 bëntë një përjashtim në lejimin e adoptimit të personit në moshë madhore, nëse në mituri është rritur nga ai që do e adoptonte

*A njihet në Shqipëri birësimi në moshë madhore i kryer në një shtet tjeter (ku lejohet) i një shtetasi/sje shqiptar/e?* Sipas nenit 394 pika (dh) i KPrC, vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në RSH kur nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar. Me parime bazë të legjislacionit shqiptar kemi parasysh të gjitha ato parime të përcaktuara në normat materiale. Shqyrtimi i kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj bëhet nga gjykata e apelit, e cila nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394 të këtij kodi (KPrC, neni 395& 396). Duke qënë se sipas KF të RSH-së, nuk lejohet birësimi i personave që kanë mbushur moshën 18 vjeç e sipër, vendimit të një gjykate të huaj i cili miraton birësimin e një shtetasi/sje shqiptar/e nuk i jepet fuqi pasi bie ndesh me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Gjykata e Lartë, në vendimin 342, datë 27.10.2009 arsyeton:

---

[128] http://www.scscourt.org/self_help/probate/adoption/adoption_adult.shtml data aksesit 21.08.2016

*"kur themi vendimi i nje shteti te huaj "nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar", kemi parasysh që e drejta materiale e zbatuar në çështjen konkrete në gjykatën e shtetit te huaj (konkretisht ne Gjykatën Italiane), e cila ka lëshuar vendimin, të mos bjerë ndesh me të drejtën materiale që zbatohet për të njejtën çështje në Republikën e Shqipërisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë "për rrëzimin e kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës italiane" me nr.7, datë 12.07.2007 është marrë në respektim të ligjit dhe si i tillë ai duhet te lihet në fuqi"*

GjL të njëjtin arsyetim përdor edhe në vendimin 179 datë 02.04.2015, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër për "Rrezimin e kërkesës së kërkuesit L. Gj. si të pabazuar në ligj dhe në prova".

Në vendimin nr. 115 datë 12.09.2012, Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson se*:*

*„nga pikëpamja e themelit të kësaj çështje, Vendimi Nr.7/2012 i dt.09.03.2012 i Gjykatës Shumëanëtareshe të Gjykates së Shkalles së Parë të Tripolis në Greqi, me të cilin është vendosur birësimi i shtetases madhore shqiptare A. Ç., nga shtetasi grek N. Ch., bashkëshort i nënës së saj I. B., nuk mund të njihet, pasi birësimi i personit madhor në Republikën e Shqipërisë nuk njihet dhe nuk lejohet „*

Për ta përmbledhur, në bazë të legjislacionit tonë në fuqi, nuk mund të njihen dhe t'i jepet fuqi ekzekutive vendimeve të gjykatave të huaja që miratojnë birësimin e personave madhor. Në rastin *Negrepontis Giannisis kundër Greqisë*, GJEDNJ-ja kritikoi margjinën e gjërë të vlerësimit[129] që është përdorur nga Greqia (Roagna, 2012: 54) pasi nuk njohu birësimin e realizuar në SHBA, të një përsoni madhor nga xhaxhai i tij prift. Fillimisht gjykata e Athinës e njohu vendimin e birësimit të kryer në Michigan, por pas apelimit të motrave dhe vëllezërve të birësuesit, gjykatat greke vendosen se vendimi i birësimit binte ndesh me politikat publike dhe nuk mund të njihej, duke argumentuar se në bazë të Drejtës Kanonike Ortodokse, një

[129] Margjina e vlerësimit varet nga Gjykata Europiane dhe juridiksioni i vendeve

prift nuk mund të birësonte një fëmijë. GJEDNJ-ja vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8; duke gjetur se refuzimi për të zbatuar urdhrin e birësimit nuk kishte të bënte me asnjë nevojë të ngutshme sociale dhe nuk kishte qënë në proporcion me qëllimin e synuar; nenit 8 dhe 14 duke gjetur se aplikanti është trajtuar në mënyrë diskriminuese si i birësuar në krahasim më një fëmijë biologjik; nenit 6§1 (e drejta për një proçes të rregullt ligjor**)**; dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventes, pasi vendimi i gjykatave e ka privuar aplikantin nga statusi i trashëgimtarit.

### 7.3 Birësimi i të miturve nga persona homoseksual

Birësimi LGBT[130], është një temë aktive e hapur për debat, duke u shoqëruar me qëndrime pro dhe kundër, qoftë nga doktrina, studiues të ndryshëm, ligjbërësit dhe nga qytetarët e thjeshtë të çdo shteti.

Marrëdhëniet homoseksuale datojnë që në lashtësi, ku emra të njohur në shkencë, letersi dhe politikë kishin këtë orientim seksual. Edhe pse shpesh herë homoseksualiteti konsiderohet nga shoqëria si sëmundje, mjekët dhe psikologët e përkufizojnë atë si një devjim apo ç'rregullim. Koncepti i orientimit seksual ka të bëjë shumë më tepër se sjellje seksuale, duke përfshirë ndjenja dhe identitet[131].

[130] Lezbike, gay, biseksual, trans-seksual
[131] http://www.aleancalgbt.org/edukim data e aksesit: 30.07.2016

Orientimi seksual mund të kuptohet se i referohet “kapacitetit të personave për tërheqje seksuale, dashurore, emocionale të thellë ndaj, dhe marrëdhënie intime me individë të një gjinie të ndryshme ose të njëjtë ose më shumë se një gjini”[132].

Sot, homoseksualët po konsiderohen më seriozisht si prindër birësues, por megjithatë homoprindërimi nuk është një nocion juridik.

Statistikat tregojnë një trend rritës të numrit të fëmijëve të birësuar nga personat me orientim seksual të njejtë. Vitet e fundit birësimi i fëmijëve po përdoret nga ato si një mjet për të krijuar familje. Përkrahësit e birësimit të fëmijëve nga personat LGBT, sugjerojnë se shumë fëmijë janë në nevojë të shtëpive dhe se përderisa aftësia prindërore nuk lidhet me orientimin seksual, e drejta duhet t’i lejojë ato të birësojnë fëmijë (Patterson, 2007: 2). Sipas tyre, shoqëritë e civilizuara nuk diskriminojnë në lidhje me racën, gjininë, apo orientimin seksual. Shoqata Katolike e Birësimit në Britani, deklaroi se do ndalonte së gjeturi shtëpi për fëmijët nëse do detyrohej nga legjislacioni që të vendoste fëmijët me çifte të të njejtit seks[133].

Përhapja e homoseksualitetit ka sjellë ndryshime ligjore, doktrinale dhe debate politike. Shtetet Europiane në përgjithësi lejojnë birësimin nga personat single homoseksual, por jo nga çiftet homoseksuale. Edhe pse Karta Europiane e të Drejtave Themelore e vitit 2007, garantonte mos diskriminimin në bazë të orientimit seksual, çështja e martesave dhe birësimeve homoseksuale, është akoma kontraversiale dhe qëndrimi i BE-së mbetet i dyshimtë (Altuna A., & Suárez, M., 2013: 70)

---

[132] Ky përkufizim i pranuar gjerësisht është marrë nga “Parimet e Yogyakarta për Zbatimin e ligjit ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut në Lidhje me Orientimin Seksual dhe Identitetin Gjinor”, mars 2007, i disponueshëm në adresën: http://www.yogyakartaprinciples.org/principles_en.htm data aksesit 23.08.2016

[133] Times online, “Catholic adoption agency seeks exemption on gay adoption regulations”, 3 mars 2010, data aksesit 10.07.2014

Suedia miratoi birësimin e fëmijëve nga çiftet homoseksuale në 2002 duke u bazuar dhe në një studim 18 mujor që tregonte se çiftet gay janë po aq të aftë sa ato heteroseksual në kujdesjen dhe në rritjen e fëmijës[134]. Prej 18 Majit 2013, në Francë hyri në fuqi ligji që lejon martesat e të njejtit seks dhe birësimin sëbashku të dy partnerëve. Në Itali për herë të parë në prill të 2016, një çifti homoseksual i përbërë nga dy gra, iu miratua birësimi i fëmijëve të njëra-tjetres. Partnerja Grassadonia mund të birësonte djemtë binjakë të partneres së saj, gjithashtu, partnerja e saj mund të birësonte djalin e Grassadonias, të tre të ardhur në jetë nëpërmjet insemimit artificial[135]. Sipas Grassadonias: "Në nivelin personal është një kënaqësi shumë e madhe, por unë nuk mund të jem plotësisht e lumtur kur mendoj se familjet tona varen në vendime individuale".

Shtetet Europiane që lejojnë birësimin e plotë nga çiftet e të njejtit seks janë: Andora (2014), Austria (2010), Anglia (2005), Belgjika (2006), Danimarka (2010), Estonia (2016), *Finlanda (ligji hyn në fuqi në 2017),* Gjermania (2013) Franca (2013), Irlanda (2016), Islanda (2016), Luksemburgu (2015), Malta (2014), Holanda (2001), Zelanda e Re (2013), Norvegjia (2009), Portugalia (2016), Spanja (2005), Suedia (2003), Uellsi (2005), Skocia (2009).

Në SHBA, lejimi i birësimit nga prindër homoseksual varion nga shteti në shtet, pasi rregullimi i birësimit bëhet në nivel shteti. Në nëntor të vitit 2015, Gjykata e Lartë e Kolumbisë aprovoi birësimin nga çiftet/ personat single homoseksual. Në SHBA pothuajse në të gjitha shtetet është i mundur ky lloj birësimi.

---

[134] BBC News, Sweden legalizes adoption, http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/2028938.stm, data e aksesit: 29.03.2015

[135] https://www.theguardian.com/ëorld/2016/apr/29/italian-couple-win-same-sex-adoption-case data e aksesit: 20.06.2016

Homoseksualiteti po pranohet dhe integrohet gjithmonë e më tepër nga shoqëritë e sotme, gjithsesi kur vijmë të formimi i familjes me prindër homoseksual, shtrohen disa pyetje dhe problematika:

- Birësimi i fëmijëve nga prindër homoseksual duhet të bazohet mbi interesin më të lartë të fëmijës apo në mosdiskriminimin e këtyre personave për shkak të orientimit tyre seksual?
- A është e drejtë për fëmijën të privohet nga figura e nënës apo babait?
- A mund të kemi të drejtën e dy baballarëve ose dy nënave ligjërisht të njejtë, apo ato do konkurojnë kush do ketë përgjegjësinë prindërore?

Birësimi është një e drejtë për fëmijën, i cili ka nevojë për figurën permanente të prindërve. Përsa i përket rëndësisë së interesit më të lartë të fëmijës dhe mosdiskriminimit në bazë të orientimit seksual të personit/personave prespektiv birësues, janë dy të drejta që nuk konkurojnë në terësi me njëra-tjetren. Kryesisht në të gjitha debatet në lidhje me këtë temë, vihet në diskutim interesi më i lartë i fëmijës. Sipas nenit 25 të Kartes Themelore të të Drejtave në BE: “në të gjitha veprimet ndaj fëmijëve të ndërmarra nga institutet publike apo private, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata kryesore”. Sipas nenit 2 të KF “Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.”

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut thotë: …të gjithë janë të barabartë përpara ligjit…të gjithë kanë të njejtën mbrojtje kundër diskriminimit”. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe në lidhje me përgjegjësitë prindërore, ndalohet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Vendimi për miratimin e birësimit të një fëmije bëhet gjithmonë në interesin

më të lartë të fëmijës, ku ndër të tjera, ky interes përbën dhe aftësinë e aplikantit prospektiv birësues për të qënë prind i mirë, pavarësisht orientimit të tij seksual. Sipas GJEDNJ-së në *Görgülü kundër Gjermanisë*[136] dhe *Krisztian Barnabas Toth kundër Hungarisë*[137], interesi më i lartë i fëmijës mund të prevalojë mbi atë të prindërve.

### *7.3.1 Çiftet homoseksuale në Shqipëri dhe lidhja e tyre me birësimin*

Pas viteve ’90, Shqipëria ndryshoi pothuajse të gjithë legjislacionin duke iu përshtatur ndryshimeve të fundit politike, ekonomike dhe shoqërore. Duke filluar nga viti 1995 marrëdhëniet seksuale midis personave të të njejtit seks nuk ishin më të ndaluara me ligj, por megjithatë, marrëdhënia e tyre nuk rregullohet akoma me ligj. Në RSH, nuk ka asnjë dispozitë ligjore që garanton të drejtën e personave apo çifteve të të njejtit seks të kenë fëmijë si nëpërmjet farëzimit artificial in vitro apo birësimit (Loloci, 2012: 3).

Pavarësisht kohës në të cilën jetojmë, vëmë re se shoqëria jonë është akoma konservatore në këtë drejtim. Duke qënë se ligji 9695 dhe KF nuk e specifikojnë orientimin seksual që prindërit birësues duhet të kenë, është e mundur që personat single homoseksual të mund të birësojnë, nëse ato provojnë se mund të jenë prindër të mirë, kështuqë, aftësia për të qënë prind mund të përmbushet nga dy gjinitë. Sipas KF, martesa mund të lidhet midis një burri dhe një gruaje…, duke përjashtuar kështu martesen ndërmjet dy personave të të njejtit seks

[136] Görgülü kundër Germanisë, nr. 74969/01, § 43, 26 shkurt 2004
[137] Krisztian Barnabas Toth kundër Hungarisë, nr. 48494/06, 12 shkurt 2013, § 32

dhe rrjedhimisht dhe birësimin e fëmijëve, pasi sipas nenit 242 të KF-së i mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç kur ata janë bashkëshortë.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, në paketën e propozimeve të ndryshimeve kushtetuese, në nenin 18 të Kushtetutës u propozua të futej termi i orientimit seksual, "Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si raca, gjinia, feja, etnia….orientimi seksual…", duke i dhënë mbrojtje kushtetuese komunitetit LGBT. Ky draft pretendohej se i hapte rrugën martesave gay në Shqipëri. Por sipas deputetes së pozites V. Hysi, në Komisionin e Posaçëm të Reformes, parashikimi në Kushtetutë i motiveve mbi bazën e të cilave ndalohet diskriminimi, nuk do të thotë detyrimisht lejim martese dhe birësim fëmijësh nga çifte të LGBT-së.

Pas reagimeve të forta publike në radhët e shoqërisë civile, opozitës dhe kryesisht të komuniteteve fetare, Komisioni i Posaçëm i Reformes në Drejtësi hoqi nga drafti për ndyshimet kushtetuese, nenin që i hapte rrugën martesave të personave të të njejtit seks. Sipas deputetes së opozites M. Doda: "arritëm të ndalonim një ndryshim që mund të sillte një strukturë tjetër sociale, larg modelit të familjes natyrale e tradicionale".

Duke qënë se Shqipëria nuk i lejon martesat midis personave të të njejtit seks, çfarë ndodh kur një fëmijë shqiptar, birësohet nga një person single i huaj, i cili më pas (birësuesi) emancipohet në një lidhje martese me një person të të njejtit seks? A duhet të anullohet birësimi? A cënohet në këtë rast interesi më i lartë i fëmijës?

Një rast i tillë ka ndodhur me birësimin e dy fëmijëve shqiptar nga një shtetase amerikane në vitin 2003, konform procedurave të rregulla përmes birësimit ndërvendas bazuar në legjislacionet e dy vendeve dhe në Konventen e Hagës së 1993 dhe më pas të dy fëmijët, në vitin 2011, janë birësuar nga një çift homoseksualësh, i cili njeri prej tyre ishte i biri i

birësueses së parë. Verdikti i birësimit të dytë u dha nga Gjykata e State Island, në New York. Lidhur me problematikën e shtruar bazuar dhe në rastin në fjalë, pasi miratohet një birësim ndërvendas, fëmija i birësuar bëhet shtetas i shtetit pritës dhe rrjedhimisht i nënshtrohet legjislacionit të atij vendi duke humbur kështu lidhjen me shtetin e origjinës. Në shtetet që e lejojnë birësimin nga personat homoseksual, nuk konsiderohet më në aspektin e përgjithshëm si cënim i interesit më të lartë të fëmijës, por vlerësohet rast pas rasti në lidhje me aftësitë e personit për të ushtruar përgjegjësinë prindërore.

### *7.3.2 Birësimi nga çiftet e të njejtit seks sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së*

GJEDNJ-së i adresohen dy lloje/tipe çështjesh në lidhje me birësimin nga prindër homoseksual:

a) Birësimi nga një prind i vetem homoseksual

b) Birësimi i fëmijës së partnerit/partneres

Në rastin *E.B kundër Francës*, aplikanti pretendonte se i ishte refuzuar autorizimi për birësim, për arsye të orientimit seksual, pasi mungonte figura e babait në shtëpi. Gjykata mbështeti faktin se ankesa kishte të bëntë me të drejtën e personave beqarë mbi parashtrimin e kërkesës për birësim, e cila shprehimisht është paraparë në legjislacionin e Francës (Roagna, 2012: 14).

Çështja *Gas dhe Dubois kunder Francës (mars 2012)*, i referohet dy grave që bashkëjetonin, ku njërës i ishte refuzuar birësimi i thjeshtë i fëmijës së partneres. Fëmija ishte konceptuar me anë të riprodhimit të asistuar mjekësor me dhurues të panjohur, gjatë kohës kur dy

aplikantet bashkëjetonin. Kërkesës për birësim të thjeshtë iu përgjigj me refuzim nga shkallët e gjyqësorit të brendshëm me arsyetimin se në bazë të nenit 365 të K.C francez, në birësimin e thjeshtë, përgjegjësia prindërore transferohet nga prindi biologjik tek ai birësues; përveç rasteve kur fëmija birësohet nga bashkëshorti/bashkëshortja e prindit biologjik. Përgjegjësia e përbashkët prindërore nuk zbatohet për çiftet që bashkëjetojnë. Aplikantët pretenduan se ky vendim ka ndikuar në jetën e tyre private dhe familjare në një mënyrë diskriminuese. Gjykata përsëriti se KEDNJ-ja nuk u kërkon qeverive të shteteve anëtare të lejojnë martesat e të njejtit seks. Përsa i përket çifteve heteroseksuale të cilët bashkëjetojnë janë në të njejtën pozitë me ato homoskesuale, pasi legjislacioni francez, po ashtu nuk u lejon birësimin sëbashku të një fëmije, apo birësimin e fëmijës së partnerit/partneres. Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8.

Çështja *X dhe të tjerë kundër Austrisë* (shkurt 2013), si ajo *Gas dhe Dubois kundër Francës* ka të bëjë sërish me dy gra që bashkëjetojnë në bazë të një marrëdhënie homoseksuale dhe përpjekjet e tyre për të marrë miratimin për birësimin e fëmijës së njërës partnere nga partnerja tjeter. Ndryshimi qëndron se legjislacioni austriak lejon çiftet heteroseksuale që bashkëjetojnë të birësojnë fëmijën e partnerit/partneres, por ndalon këtë lloj birësimi për çiftet homoseksuale. Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8.

Në *X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Prill 1997), aplikantët X një femer trans-seksuale dhe Y një grua, jetonin sëbashku në një marrëdhënie të qëndrueshme. Aplikanti i tretë Z, u lind nga Y, si rezultat i një insemimi artificial me dhurues. Ankimi i aplikanteve kishte të bëntë me mos njohjen e rolit të aplikantes X si babai i Z, duke pretenduar se rasti i tyre përbënte diskriminim. Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 8 të Konventes,

pasi neni 8 nuk mund t'i imponojë shtetit në fjalë detyrimin për të njohur si babain e fëmijës një person që nuk është babai biologjik.

Në *Fretté kundër Francës*[138], aplikanti pretendon se aplikimi për birësim si prind i vetem, i është refuzuar në bazë të orientimit tij seksual. Ai pohoi se ka qënë viktimë e diskriminimit për këtë shkak, duke sjellë shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8. Gjykata konkludoi se refuzimi për autorizimin ndiqte një qëllim legjitim për të mbrojtur shëndetin dhe të drejtat e fëmijëve të cilët mund të përfshiheshin në një procedurë birësimi. Gjykata vendosi se diferenca në trajtimin e të ankimuarit nuk ishte diskriminues brenda kuptimit të nenit 14 të Konventes.

Në *Salgueiro Da Silva Mouta kundër Portugalisë*[139], aplikanti u ankua se përgjegjësia prindërore për vajzën e tij i ishte dhënë ish-gruas së tij, vendim ky i marrë nga gjykata e apelit portugeze mbi baza të orientimit seksual të tij. GJEDNJ-ja konstatoi se vendimi i gjykatës së apelit është bazuar mbi orientimin seksual të aplikantit duke bërë një diferencim në trajtimin ndërmjet tij dhe ish-bashkëshortës së tij dhe nuk kishte marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura, ndaj ka pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me nenin 14 të Konventes.

### 7.4 Braktisja e fëmijës nga prindërit birësues

KF rregullon rastet e braktisjes së fëmijës me vendim gjykate kur prindërit e tij në mënyrë të dukshme nuk janë interesuar për të gjatë një viti, apo rastet e heqjes së përgjegjësisë

[138] Nr.3651/97, 26 Shkurt 2002
[139] Nr.33290/96, 21 Dhjetor 1990

prindërore të prindërve ndaj fëmijës në ato raste kur kemi të bëjmë me keqtrajtim të fëmijës nga prindërit biologjik, ose kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, duke dhënë zgjidhje alternative siç është birësimi. Por megjithatë, KF nuk trajton rastet kur fëmija i birësuar keqtrajtohet apo braktiset nga prindërit birësues.

*Si duhet të veprohet nëse fëmija i birësuar braktiset nga prindërit birësues?*

Në KF-në dhe në ligjin nr. 9695, nuk ka asnjë dispozitë specifike që parashikon braktisjen e fëmijës nga prindërit birësues. Supozohet se, kur dikush vendos të birësojë një fëmijë, vështirë të mendohet se mund ta braktisë atë, duke qënë se është një veprim i kryer totalisht nga bindja dhe dëshira personale e birësuesit/birësuesve. Por megjithatë, kur edhe prindërit biologjik arrijnë që të braktisin fëmijën e tyre që mban të njejtin gjak me to, atëhere pse nuk mund të pretendohet për një braktisje edhe nga ana e prindërve birësues? Ndonëse një familje birësuese përcaktohet si e përshtatshme në momentin e birësimit të të miturit, më vonë mund të ndodhë që prindërit birësues të gjenden përballë rreziqeve të mëdha social-ekonomike dhe mund të vendosin braktisjen e fëmijës.

Duke qënë se KF i barazon fëmijët e birësuar me ato biologjik, edhe në rastin e braktisjes veprohet në bazë të të njejtave dispozita të legjislacionit shqiptar për ndjekjen e procedurave përkatëse për gjetjen e një familje kujdestare apo për institucionalizmin e tyre. Neni 224 i KF-së i referohet pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke dhënë si alternativa vendosjen e fëmijës pranë një personi të caktuar si kujdestar, një familje kujdestare, apo një institucioni të përkujdesjes. Ky nen nuk bën dallim ndërmjet pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve biologjik apo atyre të birësuar.

Por KF-ja në nenin 242 paragrafi 2, sanksionon birësimin e ri vetem për fëmijët që u ka vdekur prindi apo prindërit birësues, ose njëri prej birësuesve, në qoftë se kërkesa është paraqitur nga bashkëshorti i ri i birësuesit. Pra një fëmijë i braktisur nga prindërit birësues nuk mund të birësohet për herë të dytë nga një familje tjeter dhe se më e mundshmja është ri-institucionalizimi i tij/saj në IPSHRF sesa gjetja e një familje kujdestare.

*Po në ato raste kur prindërit biologjik kërkojnë rimarrjen e fëmijës tyre, pas braktisjes apo dhënies së pëlqimit për birësim nga ana e tyre?*

Kur prindërit biologjik të fëmijës, gjatë një viti, nuk janë interesuar në mënyrë të dukshme për fëmijën dhe kur fëmija gjendet në një ndër qendrat rezidenciale publike ose private, apo tek një person që e ka në përkujdesje, mund të kërkohet deklarimi i braktisjes së fëmijës. Deklarimi i braktisjes së fëmijës bëhet nga gjykata e rrethit, me kërkesë të të interesuarve. Ndërsa përsa i përket rasteve të pendimit dhe dëshirës së prindërve për rimarrjen e fëmijës, është në varësi të fazës në të cilën ndodhen procedurat e birësimit. Nëse birësimi është miratuar me vendim të formës së prerë, në bazë të KF-së, jemi në kushte parevokueshmërie

## 7.5 Revokimi dhe pavlefshmëria e birësimit

Kodi ynë i familjes, e përcakton birësimin si një institut të parevokueshëm, duke mos bërë përjashtime as për raste përjashtimore. Si çdo marrëdhënie tjetër në jetë, ashtu dhe ajo midis birësuesit dhe të birësuarit, mund të mos funksionojë për arsye të ndryshme, duke u bërë shpeshherë dhe rrezik për mirëqënien dhe jetën e fëmijës. Në këto kushte, a është e domosdoshme revokimi i birësimit dhe zhvendosja e fëmijës nga familja birësuese? Llogjika e parevokueshmërisë, qëndron në faktin se me realizimin e birësimit lind një marrëdhënie

dhe një fakt i ri juridik që është marrëdhënia prind-fëmijë ,me të njejtat të drejta dhe detyrime si ajo midis fëmijës dhe prindit biologjik. Prindi ushtron përgjegjësinë prindërore, e cila sipas nenit 215 të KF "…përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës…". KF nuk bën dallim ndërmjet përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës biologjik dhe atij të birësuar, ndaj dhe heqja e përgjegjësisë prindërore sipas nenit 228, bëhet në rastet kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore, ndërsa humbja sipas nenit 223 bëhet kur nëpërmjet një vendimi penal që i ka dënuar ata si autorë ose si bashkëpuntorë për një vepër penale ndaj fëmijës së tyre, si bashkëpunëtorë në një vepër penale të kryer nga fëmija i tyre ose nëse janë dënuar për ndonjë nga shkaqet e braktisjes së familjes, për sa kohë që ata nuk kanë marrë përsipër detyrimet që kanë ndaj saj. Fëmija pa përgjegjësi prindërore, mund të deklarohet nga gjykata si i braktisur dhe për rrjedhojë të bëhet pjese e listës pritëse për t'u birësuar. Prindit birësues mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore e fëmijës, por siç është trajtuar dhe në çështjen 7.4 të këtij kapitulli, i birësuari nuk mund të ribirësohet më nga një familje tjetër. KF duhet të parashikojë një dispozitë e cila lejon revokimin e birësimit për rrethana madhore, të cilat vënë në rrezik zhvillimin fizik, emocional, shoqëror të fëmijës.

Gjithashtu, ashtu si dhe për institute të tjera të kësaj disipline, si psh.tek martesa, për shkak të mosplotësimit të kushteve substanciale që parashikojnë dispozitat e KF, kur vërehen parregullsi apo vese që godasin martesën si akt, ajo quhet juridikisht e pavlefshme (Mandro A., 2010: 154-155).

Por a mund të pretendohet pavlefshmëria e birësimit? A gjejnë zbatim parimet e përgjithshme të pavlefshmërisë së veprimit juridik edhe për këtë institut? Në lidhje më këtë situatë, juristët dhe doktrina mbajnë qëndrime të ndryshme në aplikimin apo jo të këtij sanksioni civil për marrëdhënien e birësimit. Bazuar në rregullimin ligjor që i bëhet këtij instituti, pavlefshmëria është një koncept që nuk përmendet në asnjë rast, ndaj është e paqartë nëse duhet t'i referohemi pavlefshmërisë së veprimit juridik apo jo. Për një tjetër institut të rëndësishëm të KF-së, siç është martesa, pavlefshmëria e tij zë një hapësirë të rëndësishme në këtë kod, nga neni 33-49, duke përjashtuar interpretimet e ndryshme mbi mundësinë e pretendimit të pavlefshmërisë apo jo të martesës. Sipas Vendimit Unifikues nr. 5 datë 30.10.2012 të Gjykatës së Lartë, në lidhje me pavlefshmërinë e veprimit juridik, Gjykata përjashton nga ky objekt trajtimi disa veprime juridike që i përkasin fushës së të drejtës familjare, për rastet e pavlefshmërisë së martesës, duke mos iu referuar apo duke "përjashtuar" mundësinë e pavlefshmërisë së birësimit.  Revokimi në vetvete mbart anullimin e një veprimi juridik, ndërsa pavlefshmëria e kthen atë në gjendjen fillestare, sikur të mos kishte asnjëherë. Nëse veprimi juridik nuk është kryer sipas kushteve substanciale dhe formale të ligjit, jemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute (Mandro A., 2010:206).

Sipas juristëve që mbështesin tezën e pavlefshmërisë së birësimit, kur birësimi realizohet në kundështim me kushtet substanciale dhe formale të parashikuara në KF dhe ligjin 9695, jemi në kushtet e pavlefshmërisë së birësimit. Në rast se shkaku i pavlefshmërisë zbulohet pasi vendimi i miratimit të birësimit nga gjykata ka marrë formë të prerë, personi i interesuar do t'i drejtohet gjykatës me "kërkesë për rishikim", në kushtet e parashikuara nga neni 494 i KPrC (Omari S., 2010: 465).

### 7.6 Sekreti i origjinës, e drejta për konfidencialitet dhe privatësi përballë të drejtës për të njohur origjinën

Birësimi dhe sekreti i origjinës përbëjnë në vetvete një marrëdhënie të ngushtë ndërveprimi, marrëdhënie kjo që shpesh herë shoqëron lidhjet e birësimi. Në shtetet që birësimi njihet në dy forma, ai i pjesshëm/ i thjeshtë dhe ai i plotë, vetem në birësimin e plotë, në bazë të cilit marrëdhëniet e fëmijes me familjen biologjike shkëputen, gjen zbatim ruajtja e sekretit të origjinës.

Ruajtja e sekretit të origjinës dhe lidhjeve familjare, bëhet duke fshehur ose fshirë informacionin, gjë e cila bie ndesh me neni 8 të Konventes së të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara. Sipas nenit 7 paragrafi 1 i kësaj konvente, fëmija…brenda mundësive, ka të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre; gjithashtu për të vazhduar në nenin 8, i cili orienton Shtetet Palë që në qoftë se një fëmije i mohohen mënyrë të paligjshme disa ose të gjithë elementet e identitetit të tij, t'i japin atij ndihmën dhe mbrojtjen e duhur, me qëllim që identiteti i tij të rivendoset shpejt.

Çështja e njohës së origjinës lidhet jo vetem me birësimin, por edhe me insemimin artificial apo me fëmijët e lindur jashtë martese. Këtu sërish kemi të bëjmë me të drejta që konkurojnë sëbashku, ajo e nënës për privatësi, e drejta e fëmijës për të njohur identitetin e tij dhe e drejta e prindërve birësues për të njohur origjinën e fëmijës së birësuar. Ndërkombëtarisht, kjo e drejtë njihet gjërësisht si "E Drejta për të Ditur" dhe konsiderohet si një pjesë integrale e Të Drejtës së Jetës dhe Të Drejtës për Privatësi[140].

---

[140] Jayna Kothari, "The Child's Right to Identity: Do Adopted Children have the Right to know their Parentage"?, www.cry.org data e aksesit: 09.08.2016

E drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij biologjike dhe gjenetike ngre disa nga çështjet më të vështira ligjore dhe etike që janë ngritur këto 20 vitet e fundit (Besson, 2007: 137). Në vendet e vogla dhe më pak të zhvilluara është më i lartë numri i nënave apo të dy prindërve, që kërkojnë fshehjen e identitetit tyre, kur lënë një fëmijë në institucionet e përkujdesit social. Këto familje nuk dëshirojnë as të kontaktohen as të njihen si prindërit e fëmijës nga të tjerët, kjo për shkak të tabuve dhe të opinionit të shoqërisë që i rrethon. I birësuari nuk ka të drejtë për marrëdhënie aktuale sociale me prindërit biologjik, por i birësuari i rritur nuk duhet të privohet nga informacioni që atyre u duhet për të ndërtuar historinë koherente të origjinës…(Shnaley, 2002: 22).

Sipas nenit 262 të KF-së, *I mituri, prindërit biologjikë dhe birësuesit kanë të drejtën e mirëbesimit për proçesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private. Kur mosha dhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri katë drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me të dhënat për prindërit biologjikë.* Gjithashtu dhe KF nuk është i qartë cila e drejtë prevalon mbi tjetrën, ajo e respektimit të jetës private dhe privatësisë apo e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e tij/saj.

Neni 8 i KEDNJ-së, ndërsa siguron mbrojtjen e privatësisë dhe të drejtave të familjes, garanton në të njejtën kohë dy të drejta të kundërta, të tilla si: të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën për të njohur origjinën (Lamçe, Çuni, 2013: 605).

Në rastin *Odièvre kundër Francës,* aplikantja ishte braktisur nga e ëma në lindje dhe ishte lënë nën Kujdesin Shtetëror për t'u birësuar më vonë nëpërmjet "birësimit të plotë". Nëna e saj kishte kërkuar që identiteti i saj të qëndronte sekret ndaj vajzës së saj (aplikantes) dhe për këtë arsye, më vonë aplikantes iu refuzua kërkesa për të njohur identitetin e prindërve

biologjik dhe vëllezërve të saj. Aplikantja kishte lindur sipas një proçedure të veçantë, që lejonte ruajtjen e anonimatit të nënës. Ajo ankohej se mungesa e informacionit për familjen e saj biologjike e privonte atë të rikonstituonte historinë e jetës së saj. Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës, pasi aplikantës i është dhënë akses për informacion jo-identifikues në lidhje me të familjen e saj biologjike duke i lejuar asaj të asaj të gjente paksa rrënjët e saj, ndërsa sigurohej mbrojtja e interesit të palëve të treta. Gjykata shtoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8**,** duke gjetur se aplikantja nuk ka vuajtur nga diskriminimi në lidhje me origjinën e saj pasi ajo kishte lidhje prindërore me prindërit e saj birësues.

Çështja *Godelli kundër Italisë,* gjithashtu i referohet konfidencialitetit të informacionit të origjinës së aplikantes, e braktisur nga e ëma që në lindje. Aplikantja parashtroi se kishte përjetuar disa dëmë për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me origjinën e saj dhe familjen biologjike. Në këtë rast gjykata ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventes. Ajo argumenton se aplikantja në kohën e aplikimit ishte 69 vjeç, moshë kjo madhore që tregon se ajo nuk ka hequr dorë nga dëshira dhe kërkesa për të njohur prindërit biologjik nuk është zhdukur me kalimin e viteve, përkundrazi është forcuar më tepër duke i shkaktuar dhimbje mendore dhe psikologjike.

Në krahasim me çështjen *Odièvre kundër Francës,* legjislacioni Italian nuk parashikon asnjë mekanizën për balancimin e interesave konkuruese në rrezik dhe në mënyrë të pashmangshme iu dha përparësi interesave të nënës. Autoritetet italiane kanë dështuar të arrijnë një balancë të drejtë ndërmjet interesave në rrezik dhe kanë tejkaluar margjinën e vlerësimit.

Në çdo çështje që ka të bëjë me fëmijët interesi më i lartë i tij prevalon mbi çdo të drejtë, ndaj dhe gjykatat në vendimin e tyre, nëse zbulimi i sekretit të origjinës është në interesin më të lartë të fëmijës, (psh. kur është vertetuar se ai ka qënë pjesë e diskriminimit apo ka vuajtur psikologjikisht mungesën e këtij informacioni), vendosin se kjo e drejtë prevalon mbi atë të ruajtjes së jetes private të prindit/prindërve.

## 7.7 Birësimi ndërvendas

*"Pavarësisht se nga vinë ato, të gjithë fëmijët janë të çmuar dhe duhet të trajtohen me dashuri"*

Birësimi ndërvendas përfshin transferimin e fëmijëve për qëllime prindërimi nga një vend në një tjetër (Bartholet, 2005: 107). Ky lloj birësimi është një fenomen gjithnjë në rritje dekadat e fundit duke u mundësuar fëmijëve pa familje mundësinë për të pasur një prind apo dy prindër birësues dhe për t'u rritur e edukuar në një mjedis familjar të shendetshëm. Nevoja e fëmijëve për prindër e mjedis familjar dhe nevoja e prindërve prospektiv për fëmijë bashkohen në atë që quhet birësim. Ashtu si birësimi vendas dhe ai ndërvendas, mbeshtetet në rëndësinë që ka rritja e fëmijës në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi si kushte esenciale që ndikojnë në zhvillimin e plotë dhe të harmonishëm të personalitetit të fëmijës (Mandro, 2009: 486).

Lufta e parë dhe e dytë botërore la shumë familje pa fëmijë dhe shumë fëmijë pa familje. Në këto rrethana lidhur me nevojat emergjente për t'u siguruar fëmijëve jetim një familje birësuese, vihet re fillimi i praktikimit më gjërë i birësimit ndërvendas. Tendenca në rritje

për birësime ndërvendase e pati pikënisjen nga luftërat botërore; edhe pse me kalimin e viteve arsyet për realizimin e këtij lloji birësimi ndryshuan, numri i birësimeve të finalizuara vazhdon të jetë në rritje edhe sot. Korea e Jugut për shkak të luftës Koreane, lehtësoi procedurat e birësimit ndërvendas me qëllim që t'u siguronte fëmijëve jetim apo të braktisur një birësim në interesin më të lartë të tyre, duke gjykuar se lufta dhe kriza politike në vend nuk u lejonte këtyre fëmijëve një të ardhme të sigurtë.

Birësimi ndërvendas filloi si një përpjekje njërëzore ndaj fëmijëve të luftës (Carro, 1995: 121); amerikanët e filluan birësimin ndërvendas të fëmijëve pikërisht pas Luftës së Dytë Botërore kur shumë fëmijë mbetën jetimë, të braktisur ose të ndarë nga prindërit e tyre si rezultat i luftës në Europë dhe në Japoni (Weil, 1984: 276-293). Kufizimi ligjor në Kinë, që çiftet të kenë vetem një fëmijë, sjell rritjen e numrit të fëmijëve të braktisur dhe për pasojë birësimi vendas bëhet vetem nga prindër prospektiv steril, duke lënë në shtëpitë e fëmijëve një numër të madh fëmijësh, me shpresën për t'u birësuar në një vend tjetër. Që prej Luftës së Dytë Botërore, birësimi ndërvendas ka qënë një aspekt i vogël por i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare (Pereboom, 2004: 2). Si vende të origjinës së fëmijëve të birësuar janë kryesisht ato të Europës lindore dhe Ballkanit; si vende pritëse në top list janë vendet e zhvilluara, në përgjithësi ato të Europës Perendimore dhe SHBA-ja. Rusia, Kina dhe Guatemala janë shtetet me numrin më të madh të fëmijëve të "transferuar" në një shtet tjetër. Statistikat tregojnë se shifrat e birësimeve ndërvendase ndryshojnë trendin e tyre shpesh herë dhe studiues të ndryshëm japin interpretime të ndryshme në lidhje me arsyet. Ndër këto arsye, ajo që përmendet më tepër është rritja e fertilitetit të çifteve.

Në Itali numri total i birësimeve në 2010 ishte 20 përqind më i lartë sesa në 2q004 dhe në Francë numri është rritur pas një rënie të vazhdueshme deri në 2009 (Selma, 2010: 3).[141] Megjithatë, numri global i birësimeve për periudhën 2004-2009 ra me 35 përqind (Selman, 2012: 3). Italia, Franca dhe Kanadaja ishin shtetet që u perjashtuan nga rënia e numrit të birësimeve gjatë kësaj periudhe. Kina është shteti i origjines me numrin më të lartë të fëmijëve të birësuar nëpër botë por edhe ajo i është bashkuar trendit rënës gjatë periudhës 2005-2009[142]. Rusia si shteti dërgues i fëmijëve me numrin më të lartë në Europë, gjithashtu në vitin 2009 kishte 3073 birësime ndervendase më pak, të realizuara, në krahasim me vitin 2005.

Shqetësime të shumta janë ngritur ndër vite nga ekspertët e fushës në lidhje me tarifat e larta që shoqërojnë procedurat e birësimit. Procedurat e tej zgjatura, burokracitë dhe kostot shumë të larta të shpenzimeve, bëjnë që shumë familje me ekonomi mesatare, të cilat mund t'i ofrojnë fëmijës një ambjent familjar shumë të ngrohtë dhe me dashuri, të terhiqen nga birësimi i një fëmije të huaj. Shpesh herë ndodh në praktikë që familja birësuese të jetë shumë e pasur dhe se perveç të mirave materiale dhe kujdesit nga persona të punësuar (siç mund të jetë dado) nuk i ofron asgjë tjetër fëmijëve, as përkujdesje, kohë dhe dashuri prindërore, madje shpesh herë birësuesi/birësuesit dhe i/e birësuara nuk jetojnë as nën të njejtën çati. Lehtësimi i procedurave burokratike dhe ulja e kostove të një proçesi birësimi do ndihmonte që shumë familje të cilat dëshirojnë t'u dhurojnë dashuri dhe një ambjent familjar këtyre

[141] Peter Selman "Global Trends in Intercounrty Adoptions 2001-2010",Këshilli Kombëtar për Birësim(USA) Shkurt 2012

[142] Nga 14,496 birësime ndërvendase në 2005 ky numer ra në 5,085 në 2009.

fëmijëve, të mund të birësonin dhe të formonin një familje të shëndetshme të ngjashme me atë biologjike.

Rumania ishte vendi me numrin më të madh të birësimeve ndërvendase me SHBA-në dhe për një kohë të gjatë u kritikua për politikat e gabuara dhe për korrupsionin e lartë në procedurat e birësimit, derisa BE-ja e akuzoi për shitje fëmijësh dhe e detyroi të ndalonte birësimin ndërvendas nëpërmjet një moratoriumi për disa vite[143]. Në lidhje me situatën në Rumani, Qeveria e SHBA-së mbajti qëndrimin se "ligji i ri imponon pengesa serioze te të gjithë birësimet dhe krijon një sistem në të cilin fëmijët mbesin për vite të tëra nën kujdesin e shtetit pa prindër" (Pereboom, 2004: 5).

Në Britani, birësimi ndërvendas është shumë më pak i zakonshëm sesa në SHBA dhe në Europën kontinentale [144]. Birësimi konsiderohet si një çështje tepër private në Francë dhe Belgjikë, ndërsa në SHBA ka një kulturë më të gjërë në pranimin e tij në krahasim me këto dy shtete (Lammers, 2008: 2-3).

Afrika njihet vetem për birësimet ndërvendase të realizuara me prindër birësues të famshëm, ndërsa përsa i përket prindërve birësues jo të famshëm numri është krejt i vogel ndër vite.

Në të drejtën ndërkombëtare dy janë instrumentet më të rëndësishëm që rregullojnë birësimin ndërvendas:

1. Konventa e Hages për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në Respekt të Birësimit Ndërvendas
2. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

[143] Për informacion më të detajuar shiko "3.1 Hyrje" fq 44
[144] http://www.guardian.co.uk/child/story/0 parë me dt. 10.05.2014

Të zgjedhesh vendin në të cilin dëshiron të birësosh një fëmijë ka të bëjë me elemente të ndryshëm që konsistojnë në kulturën, historinë, racën, largësinë gjeografike dhe në legjislacionin e vendit. Me gjithë këto elementë ndikues në përzgjedhjen e vendit, një element tjetër tepër influencues është zhvillimi ekonomik i vendit. Zakonisht, shihet si një model eksportimi i fëmijëve nga vendet e varfëra tek ato të pasurat (Frost & Stein, 1989: 106).

Prindërit prospektiv nga shtetet e zhvilluara janë më të prirur që të birësojnë fëmijë nga vendet e treta për këto arsye:

1. Plotësohet interesi më i lartë i fëmijës duke u birësuar në një shtet me mirëqënie më të lartë se ai i origjinës
2. Shpesh hasin procedura më të thjeshta për birësim
3. Familjet biologjike për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike janë më pak të predispozuara të kërkojnë rivendosjen e marrëdhënieve me fëmijët pas birësimit
4. Arrijnë rezultatet e dëshiruara edhe nëpërmjet korrupsionit

Avantazhet e birësimit ndërvendas qëndrojnë në faktin se duke u bazuar në interesin më të lartë të fëmijës, gjithmonë synohet të arrihet një birësim në një vend dhe në një familje më të kamur ekonomikisht se ajo e origjinës. Parë në këtë aspekt e ardhmja e fëmijës së birësuar në një vend më të zhvilluar është më e siguruar dhe se mundësitë për t'iu realizuar të drejtat e garantuara nga konventat e ndryshme ndërkombëtare, janë më të mëdha. Përmendim këtu të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, zhvillimin e talenteve etj. Sipas Bartholet, "Tipikisht prindërit birësuese janë njerëz të bardhë nga vendet më të pasura në botë, të cilët birësojnë një fëmijë nga një nënë e dëshpëruar e cila i përket një ndër grupeve raciale apo etnike më pak të privilegjuar në një nga vendet më të varfëra në vend" (Bartholet, 2005: 107).

Megjithatë, anët negative që mund të ndikojnë në zvogëlimin e numrit të aplikimeve për birësim ndërvendas janë:

1. Burokracitë me të cilat përballen nëpër institucione të vendit të fëmijës
2. Tarifat shumë të larta për realizimin e birësimit
3. Afatet proçeduriale të gjata relativisht, duke avantazhuar birësimin vendas
4. Vështirësia me përshtatshmërinë ndaj vendit, kulturës, gjuhës etj., kryesisht kur fëmija është 14-18 vjeç.

### *7.7.1 Problematikat e birësimit ndërvendas; trafikimi i fëmijëve*

Birësimi ndërvendas për vetë natyrën e tij ndërkombëtare është një proçes më i vështirë dhe me më shumë problematika se ai i kryer brenda vendit, pasi përfshin brenda tij legjislacionet e dy vendeve dhe atë ndërkombëtar. Prindërit e ardhshëm birësues mund të mos kualifikohen për të birësuar në një shtet por mund të fitojnë "dritën jeshile" në një shtet tjetër. Kjo lidhet me kriteret që kërkon çdo shtet për prindërit birësues. Psh. Kina sipas Departamentit të Shtetit të SHBA-së në vitin 2008, u jepte akses për të birësuar vetem çifteve heteroseksuale. Variablat kryesore që ndikojnë në birësimin ndërvendas janë kohazgjatja e pritjes dhe kostoja financiare. Në përgjithësi në shumicën e shteteve Europiane birësimi vendas ka një procedurë më të shkurtër se ai ndërvendas. Shtetet nënshkruese të Konventes bashkëpunojnë midis tyre që të ndalojnë çdo formë abuzimi apo përfitimi me fëmijët nëpërmjet birësimit. Para se të propozohet një birësim ndërvendas, autoritetet kompetente ose entet e akredituara të vendit të fëmijës duhet të verifikojnë që të mos ketë konflikte të ligjeve në lidhje me birësimin ndërmjet dy vendeve të përfshira në këtë proçes. Përveç kësaj, nuk duhet të ketë pengesa për

daljen e fëmijës nga vendi i tij i origjinës ose në hyrjen e vendit të prindërve të ardhshëm birësues, prandaj dokumentat e udhëtimit duhet të lëshohen në kohën e duhur (Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijës, neni 29). Birësimi ndërvendas nëpërmjet procedurave të rregullta ligjore, përveç kostove të pakalkuluara që aplikantët për të birësuar mund të kenë gjatë procedurave, çdo shtet vendos dhe një tarifë e cila paguhet gjatë ose në fund të procedurave të birësimit. Në Shqipëri kjo tarifë paguhet në fund të procedurave dhe kushton rreth 700 euro për shtetasit e BE-së dhe 1000 dollarë për ato jashtë kufijve të BE-së. Ky lloj birësimi në të gjithë botën shpesh herë është shoqëruar me akuza të forta në lidhje me trafikimin e fëmijëve dhe korrupsionin pasiv.

Kjo problematikë është ekzistente në dy aspekte:

- Kur fëmija birësohet për qëllime trafikimi pas hyrjes në shtetin e huaj
- Kur fëmija trafikohet në vende të tjera për t'iu shitur familjeve që nuk kanë mundur të birësojnë një fëmijë legalisht.

CNN, në një artikull online[145], paraqet dëshmi të verteta të fëmijëve që janë "vjedhur" nga familjet e tyre. Rasti i Lemmas, një vajzë nga Etiopia, e cila në moshën 13 vjeçare ishte dhënë nga prindërit me idene për ta shkolluar atë dhe motren e saj në SHBA, por që pas mbërritjes në shtetin birësues kanë kuptuar se ishin të birësuara nga një çift në Arizona. Gjithashtu, CNN, përmend dhe rastin e D. Smolin, prind birësues së bashku me bashkëshorten e tij të dy vajzave nga India. Arsyeja e birësimit ishte që të zbulonte se vajzat ishin rrëmbyer nga e ëma dhe deklaroheshin nga autoritetet indiane si të braktisura dhe të "gatshme" për birësim.

---

[145] http://edition.cnn.com/2013/09/16/world/international-adoption-saving-orphans-child-trafficking/ data aksesit 03.03.2015

Sipas Smolin[146], " E njejta histori ndodh sërish vend pas vendi". Përballë këtyre fenomeneve negative, gjithmonë e më shumë janë përforcuar kriteret për të birësuar një fëmijë nga një shtet në një tjetër. Kriteret strikte në birësimin ndërvendas nënkuptojnë më shumë fëmijë të lënë në institucione më gjatë, gjë që mund të jetë e dëmshme për shëndentin mendor dhe fizik të fëmijëve[147].

Pas termetit të 2010 në Haiti, një grup misionaresh katolike u akuzuan se kishin "rrëmbyer" fëmijë me pretendimin se kishin mbetur pa asnjërin prind dhe për t'i dhënë më tëj për birësim. Akuzat më tej u vertetuan pasi fëmijët kishin gjallë të pakten njërin prind. Shumë prindër nisen nga ideja për të bërë një bamirësi duke birësuar një fëmijë nga një vend shumë i varfër dhe duke i dhënë atij/asaj mundësinë të rritet dhe edukohet në një familje në një shtet të zhvilluar ekonomikisht.

Natalie Clark, në një artikull të shkruar për Daily Mail "E verteta shokuese rreth fabrikës së bebeve", i datës 22 dhjetor 2006, hedh dritë rreth trafikimit të bebeve për qëllime birësimi. Në këtë artikull raportohet një skemë mashtrimi dhe kërcënimi nga trafikantë shqiptarë, të cilët "rekrutonin" gra dhe vajza të reja të shëndetshme, për të lindur fëmijë, që më pas t'i shisnin ato në mënyrë të paligjshme tek çiftet kryesisht pa fëmijë. Trafikantët i rekrutonin gratë dhe vajzat në mënyra të ndryshme. Një ndër këto mënyra ishte mashtrimi për t'u siguruar pasaportë apo viza false[148] për të kaluar kufirin grek dhe pas mbërritjes në Greqi, atyre u kërkohej të paguanin një shumë të madhe parash (e cila ishte e pamundur të paguhej),

---

[146] Drejtor në "Qendren për fëmijët", fakulteti i Drejtësisë dhe i Etikes, Universiteti Samford

[147] http://healthland.time.com/2013/11/04/the-dark-side-of-cleaning-up-international-adoptions-kids-are-left-in-orphanges-longer/ parë me dt. 20.03.2015

[148] Në atë kohë Shqipëria nuk bëntë pjesë në zonën Schengen

ose u ofrohej opsioni i shtatzanisë dhe pas lindjes dhënien e fëmijës këtyre trafikantëve. Sipas burimeve të policisë ato mbeteshin shtatzëna nga anëtarët e grupit të trafikantëve.

Në një artikull të New York Times[149] të datës 13 nëntor 2013, reporteri Nicholas Wood, rrëfen historinë e shqiptares F.B, burri i së cilës kishte shitur djalin e tyre 3 vjeçar në këmbim të një televizori dhe gjithashtu planifikonte të shiste dhe fëmijën tjetër të sapolindur për një shumë rreth 5 mijë eurosh.

Sipas The Guardian[150], F.B thotë se ajo nuk e kishte shitur djalin e saj 3 vjeçar por e kishte dhënë atë që të kishte një jetë më të mirë në Itali. Pasi merren nga prindërit biologjik, fëmijët shiten nga trafikantët për një çmim shumë të lartë.

Në vitin 1992, The Independent, i kushton një artikull problemit të tregtimit të bebeve në Shqipëri, si pasojë e “kaosit” që po përjetontë vendi dhe se ishte urgjente të ndërhyhej për parandalimin e asaj çfarë kishte ndodhur në Brazil, Peru, Ekuador, Kili, Guatemalë, një epidemi ilegale e birësimit të fëmijëve, që bëhej e mundur nga juristët dhe zyrtarët e korruptuar. Në bazë të një studimi të UNICEF të vitit 2005, është arritur në përfundimin se rritja e kërkesës për birësim ka ndihmuar në rritjen e trafikimit të paligjshmëm të bebeve dhe fëmijëve të vegjël. Në vendet në zhvillim nganjëherë vetë nënat e shesin fëmijën e tyre, ose ka raste kur fëmija vidhet dhe nënës i thuhet se ka vdekur.

Çdo problem i lidhur me birësimin ndërvendas si: grabitja nga familja biologjike, trafikimi për qëllime prostitucioni apo për marrje organesh, në shumicën e rasteve kanë një të përbashkët…përfitimin ekonomik. Megjithatë, me gjithë kritikat dhe problematikat e shumta…birësimi ndërvendas vazhdon të mbetet shumë i kërkuar.

---

[149] Nicholas Wood, “For Albanians, it’s come to this: A son for a TV”, New York Times, 13 nëntor 2003
[150] Sophie Arie, artikulli “I gave away my son so he could escape squalor”, The Guardian, 14 tetor 2003

## 7.8 Vendosja e fëmijës në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror Rezidencial për Fëmijë

IPSHRF-të janë qendra rezidenciale publike që ofrojnë strehim, rritje, edukim për të miturit nga 0-18 vjeç[151], të cilët ndodhen në rrethana të caktuara që nuk lejojnë rritjen e tyre pranë prindërve.

Sherbimet sociale për fëmijë kanë për qëllim mbrojtjen dhe sistemimin në institucione të përkujdesit shoqëror të fëmijëve në nevojë si fëmijët jetim, socialë dhe biologjik[152]. Këto institucione janë në varësinë e Sherbimit Social Shtetëror dhe mund të jenë publike ose

---

[151] Sipas informacionit të publikuar në websitin e sherbimit social http://www.sherbimisocial.gov.al/pyetje-pergjigje-2/

Në institucionet e përkujdesjes shoqërore pranohen fëmijët sipas VKM Nr. 425, datë 27.6.2012:

1. Të cilëve u kanë vdekur prindërit dhe nuk kanë persona të tjerë të afërm, të cilët marrin përsipër kujdestarinë ose birësimin e tyre, si dhe të cilët me vendim gjykate nuk janë vendosur në kujdestari apo nuk janë birësuar.
2. Të lindur jashtë martese dhe që, për rrethana të gjendjes ekonomiko-shoqërore, nuk mund t'i rrisë njëri nga prindërit.
3. Prindërit e të cilëve, të dyve ose njërit, u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.
4. Prindërit e të cilëve janë ndaluar/arrestuar ose dënuar me vendim të formës së prerë me heqje lirie, për të gjithë periudhën kohore të ndalimit/arrestimit apo vuajtjes së dënimit të prindërve dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në shërbimet e përkujdesjes shoqërore, kur gjykata është shprehur me vendim për vendosjen e tyre në institucionet e përkujdesjes shoqërore,
   të deklaruar të braktisur nga gjykata e rrethit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
5. Për të cilët gjykata, me vendim të formës së prerë, vendos që të sistemohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore, pavarësisht nga gjendja familjare.
6. Prindërit e të cilëve nuk janë në gjendje ekonomike, të vërtetuar me dokumentet përkatëse, ta mbajnë fëmijën.
7. Familjet e të cilëve deklarojnë se janë në krizë të rëndë sociale, për shkak se prindërit janë të divorcuar ose janë rimartuar.
8. Prindërit e të cilëve shtrohen në spital ose dërgohen për kurim jashtë shtetit dhe deklarojnë me vullnet të lirë sistemimin e fëmijëve në institucionet e përkujdesjes shoqërore deri sa njëri ose të dy prindërit janë fizikisht të aftë për t'u kujdesur për fëmijët.
9. Që nuk mbikëqyren më ose janë larguar nga prindi apo kujdestari deri në momentin e identifikimit dhe gjetjes së prindit apo kujdestarit të tyre. Në këto kushte këta fëmijë duhet të vendosen në institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në identifikimin e prindërve apo kujdestarit të tyre.
10. Fëmijët "të kequshqyer" ose me prapambetje të zhvillimit fizik dhe çrregullime të shëndetit mendor nuk mund të pranohen në shtëpitë e foshnjës dhe të fëmijës edhe kur ata i plotësojnë kriteret e përmendura më sipër.

[152] https://www.e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=2086 data e aksesit: 30.07.2016

jopublike. Institucionet jopublike menaxhohen nga OJF-të dhe liçensohen nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë. Fokusi i reformave të Qeverisë Shqiptare në fushën e mbrojtjes sociale ka të bëjë kryesisht me familjen dhe individin, gërshëtimi i këtyre dy politikave ka të bëjë me forcimin e mbeshtjetjen e familjes dhe si rrjedhojë me parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve (Dibra, 2012: 104). Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes (KF, neni 3 paragr.2).

Këshilli i Europes, nëpërmjet Rekomandimit (2005) 5 "Për të drejtat e fëmijëve në institucionet rezidenciale", përcakton parimet e përgjithshme që duhet të aplikohen kur fëmija është i vendosur në këto institucione.

Sipas këtyre parimeve bazë, vendosja e fëmijës në institucionet në fjalë, duhet të bëhët:

- duke garantuar të drejtat themelore të fëmijës
- duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës
- qëndrimi i fëmijës nuk duhet të jetë më i gjatë seç është e nevojshme aty dhe të kontrollohet periodikisht
- të gjitha procedurat duhet të bëhën në respekt të drejtave të fëmijëve dhe të respektohet e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar
- të gjithë mjetet e kontrollit apo disiplinës për të parandaluar dëme kundrejt vetes apo tjerëve, duhet të bazohen në rregulla publike apo standarte të aprovuara

GJEDNJ-ja, vazhdimisht ka theksuar se vendosja e fëmijës në institucionet rezidenciale, duhet të jetë e përkohshme, me qëllimin final se gjatë kohës të qëndrimit të fëmijës në këto institucione, të bëhët sa më shpejt të jetë e mundur ribashkimi i familjes (Gomien D., 2005: 86).

Karta Sociale Europiane, mbron të drejtat e individëve për të gëzuar shërbime sociale. Kryesisht numrin më të madh të fëmijëve të vendosur në këto institucione e zënë ato që me vendim gjykate janë deklaruar të braktisur dhe jetimët. Statusin e jetimit në bazë të ligjit nr.8153, datë 31.20.1996 "Për statusin e jetimit", neni 1, e përfitojnë të gjithë ato persona me moshë nga 0-25 vjeç[153], që kanë kaluar ose jo nëpër institucione shtetërore a private të përkujdesit shoqëror, të cilët:

a) Janë të lindur jashtë martese

b) Nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit

c) Me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton;

d) Braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre

Kushtetuta e RSH-së në nenin 59/e të saj, sanksionon detyrimin e shtetit për të siguruar përkujdesjen dhe ndihmën për fëmijët jetimë. Në mbështetje të saj janë nxjerrë ligje dhe VKM-të që rregullojnë mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdes prindëror dhe përcaktojnë mjetet e mekanizmat që duhen ndjekur. Kodi i Familjes, parashikon vendosjen e fëmijës në një institucion të përkujdesjes, si një ndër alternativat në ato raste kur fëmija është jetim, apo

[153] Personat mbi 25 vjeç, mund të vazhdojnë të përfitojnë nga ky status, nëse nuk janë trajtuar nga shteti me strehim dhe janë në kushte të vështira jetese.

mbetet pa përgjegjësi prindërore. Fëmijët pa kujdes prindëror janë ajo pjesë e shoqërisë që kërkojnë vëmendje të veçantë nga qeveria, pushteti lokal dhe shoqëria civile.

Sipas nenit 224 të KF-së, në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtari të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes.

Gjykata vendos për kujdestarinë e fëmijës pa përgjegjësi prindërore, nëse do vendoset nën kujdestarinë e një personi, një familje kujdestare apo të një institucioni të përkujdesjes. Kur i mituri nuk ka të afërm të njohur ose të aftë për të ushtruar detyrën e kujdestarit, kujdestaria mund t'i jepet nga gjykata një institucioni publik ose privat të liçensuar për përkujdesjen e fëmijëve. Vendosja e fëmijëve jetimë në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror bëhet sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave (ligji 8153, datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit": neni 3). Drejtuesi i institucionit i delegon njërit nga punonjësit e tij të drejtën e ushtrimit të funksioneve të kujdestarit (KF, neni 271 paragr. 2). Fëmija i vendosur në këto institucione, nuk mund ta braktisë atë pa lejen e kujdestarit. Me braktisje dhe largim nënkuptohet vendosja faktike e të miturit në kujdestarinë e një personi tjetër. Në këtë rast, kujdestari i caktuar nga institucioni, i drejtohet gjykates për kthimin e tij. Institucionet e përkujdesjes sociale ose të shërbimit social, kanë për detyrë që t'i dërgojnë KSHB-së dokumentacionin në lidhje me fëmijët që janë për birësim. Duke qënë se, organika e punonjësve të këtyre qendrave rezidenciale të përkujdesjes ndaj fëmijëve, caktohet në bazë të numrit të fëmijëve, shpesh herë, këta punonjës janë akuzuar se fshehin ose manipulojnë dokumentacionin e saktë dhe raportet psikologjike dhe shëndetësore të fëmijës, duke bërë që birësimi i fëmijës të jetë i pamundur. Një formë tjetër, është edhe ndikimi apo presioni

psikologjik që ato mund të ushtrojnë kundrejt fëmijëve mbi 12 vjeç në lidhje me birësimin, në mënyrë që fëmija të mos japë pëlqimin për birësim, e drejtë kjo që i njihet nga KF. Sa më shumë fëmijë të ketë në këto qendra, aq më shumë punonjës nevojiten për t'u përkujdesur për to.

Nga statistikat e qendrave rezidenciale rezulton se pjesa më e madhe e fëmijëve janë të braktisur dhe vijnë nga familje me probleme social-ekonomike kryesisht nga Shqipëria e Mesme dhe Veriore [154]. Vendosja dhe qëndrimi në institucion është alternativa e fundit e shërbimit ndaj fëmijëve dhe për këtë duhet të punohet më shumë për fuqizimin dhe funksionimin e mekanizmave të cilët operojnë në fushën e mbrotjes së të drejtave për fëmijë[155]. Sipas SHSSH, vizioni i tyre është transformimi i shërbimeve rezidenciale në sherbime me fokus fëmijën dhe familjen, duke ofruar sherbime për rritjen e kapaciteteve social-ekonomike të familjeve të origjinës në nivelin e marrjes së pergjegjësisë për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijës.

Çdo muaj 8 fëmijë braktisen në Shqipëri. Fëmijët e braktisur në spital qëndrojnë për disa muaj në 'Djepin e Engjëjve' në spitalin Nëna Geraldinë në Tiranë. Në këtë qendër fëmijët janë nën kujdesin e mjekëve dhe punonjësve sociale; qendra nuk merret me procedurat e birësimit të fëmijëve, por veç me kujdesjen ndaj tyre. (Top channel, edicioni informativ kryesor, 02.04.2016). Në vitin 2013 numërohen 41 fëmijë të braktisur në maternitet, ndërsa jetimë social të sistemuar në institucionet rezidenciale janë rreth 80[156].

---

[154] http://www.sherbimisocial.gov.al/qendra-zhvillimi/ data aksesit 07.06.2016
[155] Po aty
[156] http://www.sherbimisocial.gov.al/nje-familje-per-cdo-femije-te-reja-dhe-sfida-per-sherbimin-social/ data e aksesit 10.01.2017

Analiza e të dhënave mbi numrin e fëmijëve të vendosur në institucione, si dhe dinamika e hyrjes dhe daljes tregon se afërsisht 60 % e fëmijëve vijnë nga familje të varfëra ose me probleme sociale, 35 % janë të braktisur që në lindje dhe 5 % janë të vendosur për arsye të tjera (Strategjia kombëtare, 2012-2-15; 9). Në maj të 2016, në shtëpitë e fëmijëve në të gjithë vendin jetonin 140 fëmijë.

Në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin e tyre 9 institucione publike dhe 13 qendra rezidenciale jopublike.

1. Shtëpi fëmije nga 0-3 vjeç Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë
2. Shtëpi fëmije nga 3-6 vjeç Shkodër
3. Shtëpi fëmije nga 6-16 vjeç Tiranë, Shkodër, Sarandë

KSHB-ja, ushtron kontrolle në institucionet e përkujdesjes publike dhe private për fëmijët që plotësojnë kushtet për t'u birësuar dhe verifikon raportet periodike, të paraqitura prej tyre në Komitet për gjendjen e fëmijëve. Deinstitucionalizimi dhe ofrimi i shërbimeve alternative, si ai i kujdestarisë, janë objektivat madhorë të politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes sociale për fëmijët e braktisur, jetimë ose në nevojë. [157]

Sipas nenit 250 të KF, i mituri i strehuar në një nga institucionet e përkujdesjes sociale publik ose privat, deklarohet i braktisur nga gjykata e rrethit, nëse gjatë 1 viti (përpara paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes) prindërit e tij nuk janë interesuar në mënyrë të dukshme për të.

Kur i mituri ka qënë strehuar që nga lindja e tij në këtë institucion, afati prej 1 viti kufizohet në 3 muaj. Për fëmijët e strehuar në këto institucione, kërkesa për deklarimin e braktisjes

[157] http://www.sherbimisocial.gov.al/qendra-zhvillimi/ data aksesit 10.06.2016

bëhet nga drejtuesi i institucionit. Gjykata që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njejtin vendim edhe kujdestarin për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijës, një institucion të përkujdesjes sociale ose një person të caktuar, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës (neni 251, KF: paragr.2 & 3)

Për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti duhet të sigurohen standarte[158] në këto institucione, të cilët shërbejnë për ofrimin e një jetese sa më normale të fëmijëve të vendosur në këto institucione.

Këto standarte mbështeten dhe synojnë respektimin e parimeve si: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; decentralizimi; pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit (VKM Nr. 659, datë 17.10.2005). Standartet aktuale janë të formuluara në bazë të modelit të shtëpive të fëmijëve në formë konvikti; ato rregullohen me VKM të vitit 2005 dhe se një dekadë më pas është e nevojshme rishikimi i këtyre standarteve për t'iu përshtatur rikonceptimit të shtëpive të fëmijëve të cilat tashmë po synohet gjithnjë e më tepër në konvertimin e tyre në shtëpi-familje.

Gjithashtu, ka një numër shumë të vogël studimesh apo monitorimesh të  kryera për qendrat rezidenciale të fëmijëve (kryesisht të kryera nga organizatat ndërkombëtare); shpesh herë dhe mungesë transparence të statistikave.

[158] Shih: VKM 659, 17.10.2005, "Për Standartet e Sherbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Fëmijë në Institucionet Rezidenciale"

Sipas nenit 20 pika 1, 2 dhe 3 të KDF-së, një fëmije që i është mohuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi familjar…shtetet palë sigurojnë një përkujdesje alternative…. e cila mund të ketë, *inter alia,* formën e vendosjes në një familje, të “kafalasë” sipas të drejtës islamike, të birësimit, ose, në rast nevoje në një qënder të përshtatshme të kujdesit për fëmijët. Vendosjen e fëmijës në qendrat rezidenciale për fëmijë, Konventa e sheh si mundësinë e fundit, nëse nuk arrihet asnjëra nga opsionet e më sipër cituara. Kjo sepse, institucionet e përkujdesjes sociale për fëmijë, sado të arrijnë standartet e përcaktuara nuk mund të arrijnë t’u ofrojnë fëmijëve një ambjent familjar që përafrohet me jetën familjare.

Që në 1926, Henry Dwight Chapin, një studiues pediater në SHBA, doli në përfundimin se: “mbledhja e shumë fëmijëve nën një çati, pavarësisht si e menaxhojnë institucionin, nuk është në të mirën e tyre”. Studimi bazohej në të dhëna empirike mbi jetesën e fëmijëve në shtëpitë e fëmijëve dhe në shtëpitë-familje, ku jetesa në shtëpitë e fëmijëve rrezikonte seriozisht shendetin mendor dhe emocional të fëmijëve.

Në 2013, në bazë të një studimi amerikan [159] 14 vjeçar në Rumani, në 136 jetimore, u dol në përfundimin se fëmijët kishin një formim më të mirë nëse rriteshin në shtëpi familje sesa në jetimore. Në atë kohë, zyrtarët rumun, besonin vendosmërisht se problemet në sjellje dhe përparim të fëmijëve të institucionalizuar, vinin si pasojë e idesë së braktisjes nga prindërit biologjik dhe jo nga problematikat në institucionet rezidenciale dhe për këtë arsye është më e drejtë të rriten aty sesa nga prindër kujdestarë. [160]

[159] Bucharest Early Intervention Project
[160] http://phenomena.nationalgeographic.com/2013/07/31/the-orphanage-problem/ data e aksesit 10.01.2017

Sot, shtëpitë rezidenciale për fëmijë, edhe në Shqipëri, kanë filluar të konceptohen në formën e shtëpive familje, si një imitim sa më i afërt i ambjentit familjar. Sipas drejtores së Shtëpisë së Fëmijës "Zyber Hallulli", në një intervistë të saj për Deutsche Welle[161] u shpreh:

> *"institucioni krijon për fëmijët kushtet dhe karakteristikat e një ambienti të përafërt me atë familjar, integrimin e tyre në ambientin e jashtëm. Institucioni ofron për fëmijët, strehim rezidencial 24 orë, edukim, arsimim të detyrueshëm 9 vjeçar dhe përkujdesje sociale".*

Shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli" në Tiranë, vitet e fundit është konceptuar në shtëpi-familje, e ndarë në apartamente me kapacitet rreth 12 fëmijë secili, në mënyrë që t'u ofrojë fëmijëve një ambjent sa më të ngjashëm me atë familjar.

Sipas Bashkisë Shkodër, në këtë qytet ndodhen 12 shtëpi-familje që financohen nga bashkia dhe në programin e saj, është marrja e 27 apartamenteve të cilat do shërbejnë për fëmijët jetim.

### 7.8.1 Problematikat në IPSHRF-ve, dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve në këto institucione

*Shtetet Palë marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojten e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja apo keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja….*

*(Neni 19 i Konventes të të Drejtave të Fëmijëve)*

Problematikat në Institucionet e Përkujdesit Rezidencial për Fëmijë, (më poshtë shtëpitë e fëmijëve), konsistojnë në një sërë aspektesh, duke përfshirë infrastrukturën, ushqimin,

[161] http://www.dw.com/sq/misioni-i-shtëpisë-së-fëmijës-zyber-hallulli/a-4914138 data aksesit 06.10.2014

kujdesin social dhe shëndetësor, por mbi të gjitha dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve. Ato shpesh herë janë bërë mediatike nga emisione investigative, duke u denoncuar nëpërmjet kamerave të fshehta të vendosura në ambjentet e brendshme të tyre.

Kategoritë e fëmijëve që institucionalizohen në IPRSHF, janë jetimët biologjik, jetimët social dhe fëmijët që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike. Duke qënë se numri i stafit në shtëpitë e fëmijëve përcaktohet në bazë të numrit të fëmijëve të vendosur në këto institucione, disa prej tyre e pengojnë qëllimisht birësimin e fëmijëve për të "ruajtur" numrin e punonjësve, duke ndikuar tek fëmijët me anë të formave të ndryshme të bindjes, në mënyrë që ato të mos pranojnë të birësohen dhe të binden se zgjidhja më e mirë është të rriten në këto institucione. Përballë këtij fenomeni ekzistues, duhet të parashikohen me ligj mekanizma më të fortë kontrollues që përfshijnë disa faza verefikimi të përshtatshmërisë së fëmijës me familjen prespektive birësuese gjithashtu dhe informimin dhe parapërgatitjen e fëmijëve për efektet e birësimit nëpërmjet sesioneve informuese për të gjithë fëmijët që banojnë në shtëpitë e fëmijëve.

Problematikë tjetër shqetësuese janë rastet e fëmijëve të cilët nuk arrijnë të birësohen dhe në bazë të ligjit "për statusin e jetimit", mbahen në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror deri në moshën 14 vjeç, pas kësaj moshe nëse pushteti lokal nuk gjen hapësira strehimi në konviktet e shkollave të mesme apo të larta, ato mbeten rrugëve, me vetem një trajtim minimal financiar. Në rastet kur fëmija nuk ka arritur të mbarojë arsimin e detyrueshëm, mbahet në këto institucione deri në moshën 16 vjeç. Kjo klauzolë e ligjit, ka bërë që mos përfundimi qëllimisht i arsimit të detyrueshëm deri në moshën 16 vjeçare, të praktikohet në masë nga fëmijët e vendosur në këto institucione rezidenciale. Ky rregullim ligjor, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në të ardhmen e këtyre fëmijëve, të cilët edhe nëse

janë me rezultate të larta në në mësime dhe dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta, janë të "detyruar" të zgjedhin një strehëz për të banuar edhe 3 vite më shumë në të, në vend të arsimimit dhe të ardhmes së tyre. Pas mbushjes së moshës 16 vjeçare, ata që fitojnë statusin e jetimit, përfitojnë vetem bursë dhe trajtim për veshmbathje për vitet e shkollës së mesme dhe të lartë, që përcaktohet nga KM.

Dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve të vendosur në shtëpitë e fëmijëve është shqetësuese dhe në mënyrë të vazhdueshme. Kjo dhunë konsiston në dhunë psikologjike, fizike dhe seksuale. Por fëmijët që banojnë në shtëpitë e fëmijëve, ashtu si shumica e fëmijëve tjerë, janë viktima të dhunës edhe në shkollat ku mësojnë. Mësuesit janë ushtrues të vazhdueshëmn të dhunës, kryesisht në shkollat në zona rurale, gjë për të cilëm shpesh herë kanë dhe "lejen" apo miratimin e prindërve.

Në bazë të një studimi për dhunën në Shqipëri, ndër gjetjet kryesore u evidentua se të rriturit e intervistuar e dinin se dhuna fizike dhe psikologjike ka pasoja negative për fëmijën, por pranojnë se dhuna ka edhe efekte pozitive në edukimin e fëmijës, prandaj ajo duhet përdorur në rastet kur është e nevojshme, por në forma të lehta dhe jo te të vegjlit (UNICEF, 2006: 7). Sipas Thomas Hammarberg, Komisioner i të Drejtave të Njeriut në KiE,

*"….qeveritë ose të rriturit e keqperdorin interesin më të lartë të fëmijës për të justifikuar veprimet që në fakt kanë shkelur të drejtat e fëmijëve. Dhunimet trupore janë mbrojtur me argumentin se u mësojnë fëmijëve limitet e nevojshme…."*

Ky pohim gjen zbatim edhe në realitetin shqiptar, ku dhuna e ushtruar ndaj fëmijëve nuk haset vetem në shtëpitë rezidenciale për fëmijët jetim dhe të braktisur, por edhe në familjet shqiptare. Madje, dhuna ndaj fëmijëve "justifikohet" dhe në shprehjet e urta të popullit shqiptar, duke e cilësuar atë si të nevojshme dhe dobiprurëse për të ardhmen e fëmijës. Edhe

pse Rekomandimi (2005)5, ndër parimet bazë të tij[162] përcakton që mjetet e kontrollit dhe disiplinës të jenë konform standarteve të aprovuara apo në bazë të rregullave publike, vëmë re që në institucionet rezidenciale për fëmijë në Shqipëri nuk gjen zbatim ky parim. Kjo vihet re në vazhdimin e edukimit të fëmijëve jo vetem në institucione por dhe në familje, në bazë të "metodave të vjetra" që konsistojnë në ushtrimin e dhunës për të marrë rezultatin e dëshiruar.

Sipas Avokatit të Popullit Igli Totozani, "Dhuna ndaj fëmijëve është akt i patolerueshëm, i dënueshëm me ligj si veper penale dhe çdo akt njerëzor. Kjo formë dhune bëhet edhe më e rëndë kur ushtrues të saj janë edukatorët dhe kujdestarët e tyre".

Në korrik të 2015, nëpërmjet një videoje të publikuar në media, shikoheshin qartë skena dhune dhe keqtrajtimi të fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkodër nga kujdestaret e këtij institucioni, në ambjentet e jashtme të tij. Menjëherë pas publikimit të videos ka nisur proçedimi penal për tre kujdestaret. Prej korrikut të 2015, MMRS ka marrë masa për parandalimin e rasteve të tilla, përmes testimit të punonjësve për njohuritë, si dhe standartet, ku njëri prej elementeve ka të bëjë me parandalimin e dhunës[163]. Megjithatë, këto masa nuk mjaftuan për të parandaluar rastet e dhunës në shtëpitë e fëmijëve në periudhën në vazhdim. Në maj të 2016 sërish në shtëpinë e fëmijës Shkodër, është evidentuar dhunë seksuale ndaj 3 vajzave të mitura. Masat e marra për parandalimin e dhunës dhe ndërrimi i personelit një vit më parë nuk shërbyen për eleminimin e rasteve të tilla.

[162] Shih: Kapitulli VI, 6.5 fq. 174-175
[163] http://www.balkanweb.com/site/skandal-ne-shtepine-e-foshnjes-ne-durres-kujdestarja-dhunon-femijen-3-vjecar-reagon-ministri-klosi/ data e aksesit: 02.04.2016

Në prill të 2016, u publikuan një raste dhune në Shtëpinë e Foshnjes në Durrës, ushtruar nga punonjësit e institucionit. Raste të tilla, ndikojnë në shëndetin psikologjik, fizik dhe emocional të fëmijëve në këto institucione rezidenciale.

Dhuna ndaj fëmijëve, përbën shkelje të rëndë të të drejtave themelore të fëmijës të sanksionuara nga legjislacioni shqiptar dhe instrumentët ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është i vetmi nen kushtetues që trajton dhunën ndaj fëmijëve në mënyrë të veçantë e të drejtpërdrejtë (Tamo A., Karaj Th., 2006: 75). Përveç dhunës psikologjike dhe fizike, në këto qendra ndër vite ka pasur evidenca për dhunë seksuale ndaj fëmijëve, kryesisht ndaj vajzave.

Direktiva 2011/92/EU, e cilëson abuzimin dhe shfrytëzimin seksual, duke përfshirë dhe pornografinë, si shkelje serioze të të Drejtave Themelore, në veçanti të Drejtat e Fëmijëve, të sanksionuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara e 1989 “Për të Drejtat e Fëmijëve” dhe nga Karta Themelore e të Drejtave, nga BE.

Kodi Penal i RSH-së, trajton disa forma të dhunës seksuale ndaj fëmijëve si: neni 100- marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur; neni 101- marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur; neni 106- marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari; neni 108- kryerja e veprave të turpshme me të mitur; neni 114/a.1- shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese me të mitur; neni 117- shpërndarja, reklamimi dhe botimi i materialeve pornografike në mjediset e të miturve.

Avokati i Popullit konstaton si problematikë dobësimin e mekanizmave mbrojtës të të drejtave të fëmijëve, pjesë e strukturave të pushtetit vendor, përmes ndryshimit të

vazhdueshëm të stafeve të trajnuara me fondet e taksapaguesve shqiptarë dhe organizmave ndërkombëtarë[164].

Aktualisht, në Shqipëri nuk ka ndonjë strukturë të mirëfilltë, as në nivel qendror as në nivel lokal që të trajtojë në mënyrë specifike problemin e dhunës kundër fëmijëve (Tamo A., Karaj Th., 2006: 80), por disa struktura qeveritare të cilat merren me çështjet e fëmijëve në përgjithësi, në disa raste trajtojnë dhe problematikat e ushtrimit të dhunës ndaj tyre. Ndër këto struktura përmendim: Komitetin Ndërministror për të Drejtat e Fëmijëve dhe Sekretariatin Teknik të Fëmijëve, të cilët ndjekin zbatimin në praktikë të gjithë masave të parashikuara nga të gjitha Strategjitë të cilat përfshijnë edhe fëmijët si subjekt apo të drejtat e tyre [165]. Sipas nenit 4 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat legjislative, administrative dhe masat e tjera të nevojshme për të siguruar zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Me masa të tjera të nevojshme Konventa synon t’a lëjë në diskrecion të shteteve, të cilët sipas nevojave, të caktojnë dhe masat e duhura për të vënë në jetë të drejtat e fëmijëve.

Në bazë të Raportit të Monitorimit të AP u evidentuan këto problematika në institucionet publike të përkujdesjes rezidenciale për fëmijët në shtëpi fëmijë dhe shtëpi foshnje:

- Organika e miratuar nuk është në përputhje me paketën e standarteve dhe procedurave për institucionet rezidenciale, ku përcaktohen specialitetet dhe standarti punonjës për numër fëmijësh

[164] http://botasot.info/shqiperia/532216/totozani-denon-dhunen-e-perseritur-fizike-dhe-psikologjike-ndaj-te-miturve-ne-shtepite-e-femijeve/ data e aksesit: 05.04.2016
[165] Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës, Studim krahasues, Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara

- Nuk ka trasnparencë në lidhje me rekrutimin e stafit dhe procedurat e ndjekura nga bashkitë përkatëse
- Për shkak të mungesës në numër të kujdestareve, edukatoreve apo pranisë me kohë të pjesshme e mjekëve, psikologëve, punonjësve social gjithashtu dhe për shkak të mungesës së stafit mbështetës si kuzhinier, sanitar, punonjës lavanderie…, punonjësit e shërbimit social, kryejnë të gjitha këto funksione duke lënë pas dore në mënyrë të theksuar përmbushjen e detyrës së tyre funksionale që ka të bëjë me përkujdesjen ndaj fëmijëve.
- Rojet e sigurisë për shkak të mungesës në buxhet ishin kontraktuar me kohë të pjesshme.
- Procedurat e transferimit të fëmijëve që kanë mbushur moshën, në institucione të përshtatshme për ta, është shumë e gjatë duke sjellur problematika të ndryshme sidomos me mungesa të kuotes ushqimore
- Infrastruktura e pjësës dërrmuese të shtëpive është problematike
- Nga intervistat konfidenciale me fëmijët dhe bisedat në grup, rezultoi se në disa nga këto qendra ishte ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj fëmijëve nga ana e stafit që punon në këto qendra
- Në disa shtëpi fëmijësh mungojnë mjeket apo infermierët[166]

Vendosja e kamerave monitoruese në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të këtyre institucioneve do reduktonte deri në eleminim format e dhunës së ushtruar ndaj të miturve, sidomos ato fizike dhe seksuale. Megjithatë, kjo është kundërshtuar shpesh si shkelje e nenit

[166] Shiko organikën në http://www.sherbimisocial.gov.al/cfare-jane-ipsh-2/

8 të KEDNJ-së. Në vendet e BE-së qendrat rezidenciale për fëmijë janë mbyllur që në fillim të viteve 2000, dhe fëmijët jetimë e të braktisur vendosen dhe rriten në shtëpi familje.

Për vite me rrallë, në bazë të vëzhgimeve të mia personale, vajzat e institucionalizuara në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër, kanë një karakter të ashper dhe një zhvillim fizik të ngjashëm me djemte, apo shpesh herë të dallueshëm me vështirësi. Shumica pranojnë se janë dhunuar fizikisht dhe seksualisht nga punonjës të institucionit dhe shprehen se kjo ka ndikuar në formimin e personalitetit tyre. Pas mbushjes së moshës për të lënë rezidencën, ato gjenden përballë vështirësive të jetës, në pamundësi për t'u punësuar ose për të krijuar familje, strehohen në konviktet e shkollave të mesme.

# KAPITULLI VIII- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Duke pranuar punën dhe përpjekjet që janë bërë ndër vite për rregullimin dhe përmirësimin e kuadrit normativ në lidhje me birësimin e të miturve, ky punim nxjerr në pah disa mangësi dhe problematika të dispozitave që rregullojnë këtë institut. Kuadri normativ kërkon përmirësime edhe përsa i përket fëmijëve jetimë apo atyre pa përgjegjësi prindërore. Në përfundim të këtij punimi, arrijmë në disa konkluzione dhe në parashtrimin e disa rekomandimeve si më poshtë:

## KONKLUZIONE

- Kultura e birësimit ndryshon nga shteti në shtet; disa janë më të hapur ndaj birësimeve duke pranuar edhe birësimin nga personat homoseksual, e disa shtete të tjerë janë më hermetik ndaj këtij instituti, duke e pranuar më me vështirësi atë në kulturën e tyre ose duke mos e njohur as versionin klasik, birësimin e një të mituri nga dy prindër heteroseksual.
- Duke qënë se në bazë të rregullimit ligjor të institutit të birësimit nuk parashikohet pavlefshmëria e tij, është e paqartë nëse edhe për këtë institut gjejnë zbatim parimet e përgjithshme të pavlefshmërisë së veprimit juridik.
- Burokracitë dhe korrupsioni që hasin aplikantët për të birësuar një fëmijë në institucione për marrjen e dokumenteve të nevojshme për aplikim, përbëjnë mungesë të besimit për institucionet e administratës publike dhe organet gjyqësore, duke ndikuar në uljen e numrit të aplikantëve për të birësuar.

- Në KF-në dhe në ligjin nr. 9695, datë 19.03.2007 nuk ka asnjë dispozitë specifike që parashikon braktisjen e fëmijës nga prindërit birësues. Duke qënë se KF i barazon fëmijët e birësuar me ato biologjik, edhe rasti i braktisjes nga prindërit birësues rregullohet nga të njejtat dispozita të legjislacionit shqiptar për ndjekjen e procedurave përkatëse për gjetjen e një familje kujdestare apo për institucionalizmin e tyre. Neni 224 i KF-së i referohet pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, duke dhënë si alternativa vendosjen e fëmijës pranë një personi të caktuar si kujdestar, një familje kujdestare, apo një institucioni të përkujdesjes. Ky nen nuk bën dallim ndërmjet pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve biologjik apo atyre të birësuar. Por KF-ja në nenin 242 paragrafi 2, sanksionon birësimin e ri vetem për fëmijët që u ka vdekur prindi apo prindërit birësues, ose njëri prej birësuesve, në qoftë se kërkesa është paraqitur nga bashkëshorti i ri i birësuesit. Pra, një fëmijë i braktisur nga prindërit birësues nuk mund të birësohet për herë të dytë nga një familje tjeter dhe më e mundshmja është ri-institucionalizimi i tij/saj në IPSHRF sesa gjetja e një familje kujdestare.
- Për shkak të problematikave të theksuara dhe të vazhdueshme në institucionet rezidenciale për fëmijët jetim dhe pa përgjegjësi prindërore, është e nevojshme ngritja e strukturave të posaçme në nivel qëndror dhe lokal të cilat monitorojnë dhe raportojnë zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në këto institucione, si dhe eleminimin e çdo forme dhune të ushtruar ndaj këtyre fëmijëve. Nevojiten ndryshime ligjore për të hartuar strategji për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve në këto institucione.

- Birësimi ndërvendas si problematikë kryesore ka trafikimin e fëmijëve jashtë vendit të origjinës. Duke qënë një situatë tejet problematike dhe në vendin tonë, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje forcimit të dispozitave të Kodit Penal apo krijimit të masave mbrojtëse nëpërmjet ligjeve të tjera në lidhje me fëmijët, të cilët kanë ndikim të drejtëpërdrejtë me trafikimin e tyre.
- Standartet aktuale janë të formuluara në bazë të modelit të shtëpive të fëmijëve në formë konvikti; ato rregullohen me VKM të vitit 2005 dhe pas më shumë se një dekade, është e nevojshme rishikimi i këtyre standarteve për t'iu përshtatur rikonceptimit të shtëpive të fëmijëve, të cilat tashmë po synohet gjithnjë e më tepër të konvertohen në shtëpi-familje.
- Problematikë tjetër shqetësuese janë rastet e fëmijëve të cilët nuk arrijnë të birësohen dhe në bazë të ligjit 8153 datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit", mbahen në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror deri në moshën 14 vjeç; pas kësaj moshe nëse pushteti lokal nuk gjen hapësira strehimi në konviktet e shkollave të mesme apo të larta, ato mbeten rrugëve, me vetem një trajtim minimal financiar. Bazuar në VKM nr. 425, datë 27.6.2012, mosha e pranueshme për t'u vendosur në institucionet rezidenciale është deri 16 vjeç. Por sipas ligjit 8153, në rastet kur fëmija nuk ka arritur të mbarojë arsimin e detyrueshëm, mbahet në këto institucione deri në moshën 17 vjeç. Kjo klauzolë e ligjit, ka bërë që të praktikohet në masë mos përfundimi qëllimisht i arsimit të detyrueshëm deri në moshën 17 vjeçare, nga fëmijët e vendosur në këto institucione rezidenciale. Ky rregullim ligjor, ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në të ardhmen e këtyre fëmijëve, të cilët edhe nëse janë me rezultate të larta në mësime dhe dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta, janë të

"detyruar" të zgjedhin një strehëz për të banuar edhe 3 vite më shumë në të, në vend të arsimimit dhe të ardhmes së tyre. Pas mbushjes së moshës 17 vjeçare, ata që fitojnë statusin e jetimit, përfitojnë vetem bursë dhe trajtim për veshmbathje për vitet e shkollës së mesme dhe të lartë, që përcaktohet nga KM.

- Ashtu siç sanksionohet dhe në legjislacionin ndërkombëtar dhe atë kombëtar, prioritet duhet t'i jepet rritjes së fëmijës në familjen biologjike, duke ndërhyrë me mbështetje financiare apo sociale. Është me rëndësi hartimi i programeve dhe politikave sociale për sensibilizimin apo nxjerrjen e familjes nga vështirësitë të cilat kanë sjëllë si pasojë braktisjen e fëmijës.
- Vendosja e fëmijës në nevojë pranë një familjeje kujdestare është e përcaktuar në VKM Nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë". Parashikimi në ligj i familjeve kujdestare kundrejt një pagese, të cilat rrisin dhe edukojnë fëmijët jetim apo të braktisur, ka sjellë rritje të numrit të fëmijëve të vendosur në familje kujdestare duke sjellë efekte pozitive në të ardhmen e këtyre fëmijëve, si një alternativë për t'u ofruar një ambjent familjar (në pamundësi të birësimit) duke i larguar nga institucionalizimi në këto qendra. Megjithatë pagesa mujore që marrin familjet kujdestare nuk është e mjaftueshme për të mbuluar të gjitha nevojat e fëmijës.
- Vendosja e kamerave monitoruese në ambjentet e brendshme dhe të jashtme të institucioneve rezidenciale për fëmijë do reduktonte deri në eleminim format e dhunës së ushtruar ndaj të miturve, sidomos ato fizike dhe seksuale.
- Pas kalimit të jetimëve në konviktet e shkollave të mesme, realiteti në praktikë ka treguar se shumica prej tyre, gjatë gjithë jetës së nuk kanë mundur të largohen nga

aty për të krijuar një jetë familjare, ndaj në konviktet e shkollave të mesme në të cilët strehohen fëmijë nga 15-18 vjeç që vijnë nga rrethet për të ndjekur studimet, të jetojnë sëbashku në të njejtin ambjent me jetimët që në disa raste janë dhe mbi 60 vjeç. Përballë kësaj situate, Shteti shqiptar ka dështuar në sigurimin e standarteve dhe mbrojtjen e të drejtave për fëmijët e vendosur në konvikte.

- Institucionet e përkujdesjes shoqërore, kanë për detyrë që t'i dërgojnë KSHB-së dokumentacionin në lidhje me fëmijët që janë për birësim. Duke qënë se, organika e punonjësve të këtyre qendrave rezidenciale të përkujdesjes ndaj fëmijëve, caktohet në bazë të numrit të fëmijëve, shpesh herë, këta punonjës janë akuzuar se fshehin apo manipulojnë dokumentacionin e saktë dhe raportet psikologjike dhe shëndetësore të fëmijës, duke bërë që birësimi i fëmijës të jetë i pamundur.

## REKOMANDIME

- Kodi i Familjes nuk ka vendosur një kufi maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve. Që një person të legjitimohet për të birësuar një fëmijë në RSH, përveç kritereve tjera, si kriter moshe është vendosur diferenca prej 18 vitesh me të birësuarin dhe 15 vitesh nëse birësohet fëmija i bashkëshortit/bashkëshortes. Duke qënë se vendosja e diferencës së moshës me ligj ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit synon që marrëdhënia e birësimit të ngjasojë me atë të prindit me fëmijën biologjik, atëherë edhe vendosja e një kufiri tavan, siç e kanë legjislacionet e disa vendeve europiane, psh. Italia, do pengonte krijimin e një marrëdhënie prind-fëmijë nëpërmjet birësimit, e cila do i ngjasonte asaj të gjyshit/gjyshes me nipin/mbesën.

Rekomandoj që neni 241 të KF-së "mbi kushtet e birësimit", paragrafi i dytë të bëhet: Birësuesi nuk duhet të jetë mbi 50 vjeç dhe duhet të ketë një diferencë moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin.

- Është e nevojshme ndërhyrja në KF dhe ligjin 9695, për t'i dhënë një zgjidhje ligjore braktisjes së fëmijëve nga prindërit birësues dhe lejimit të revokimit të birësimit për situata të caktuara, ndaj rekomandoj që tek neni 242 i KF-së, paragrafi dytë, birësimi i ri përveç rasteve të cituara në këtë nen, të lejohet gjithashtu për fëmijët të cilët janë braktisur nga prindërit birësues dhe për ato të cilëve birësimi i parë u është revokuar.
- Duke qënë se termi adoptim është një term ndërkombëtar që i referohet institutit të birësimit, edhe në Shqipëri shpesh herë përdoret nga media, nga juristët apo nga gjykatat në vend të termit "birësim". Ndryshimi i terminologjisë në legjislacion nga birësim në adoptim do ishte në përputhje të plotë me kuptimin dhe qëllimin që ka instituti i birësimit në bazë të legjislacionit në fuqi i cili është gjithpërfshirës, dhe jo selektiv vetem për djemtë (të bësh bir dikënd). Rekomandoj ndryshim të termit nga birësim në adoptim.
- Në mënyrë që të sigurohet interesi më i lartë i fëmijës dhe për mbrojtjen e të ardhmes së fëmijës, sygjeroj që për çiftet e martuara të kërkohet një periudhë kohore të pakten prej dy vitesh martesë, si një tregues stabiliteti i jetës së përbashkët të çiftit.
- Në ndryshim nga shumë vende të tjera Europiane, në Shqipëri numri i fëmijëve në listat e pritjes për t'u birësuar është më i madh se ai i personave që kërkojnë të birësojnë një fëmijë. Numri i vogël i aplikantëve birësues përkundrejt numrit të fëmijëve në listat e KSHB-së, nuk duhet të synohet të rritet nëpërmjet lehtësimit të kritereve për birësim, pasi kjo mund të sjellë dhe cënim të interesit më të lartë të

fëmijës, por në hartimin politikave dhe programeve mbështetëse, informuese, sensibilizuese kryesisht për çiftet pa fëmijë, apo dhe për qytetarët që të krijohet një mentalitet më i hapur për të "pranuar" fëmijët e birësuar në shoqëri.

- Ligji 8153 datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit" është i vjetër dhe ka nevojë për ndryshime në përputhje me ndryshimet që janë bërë ndër vite në legjislacion duke përmendur ndryshimet që janë bërë në arsimin e detyrueshëm nga 8 klasë në 9. Sipas neni 5 pika 1 të këtij ligji, jetimët në institucionet shtetërore ose private të përkujdesit shoqëror mbahen deri në moshën 14 vjeç. Në rastet kur fëmija brenda kësaj moshe nuk ka mundur të kryejë shkollën 8-vjeçare mbahet deri në moshën 17 vjeç. Pas kësaj moshe zbatohet neni 6 për ata që fitojnë stratusin e jetimit.

  Bazuar në problematikat në praktikë që sjell ky nen, të cilat janë parashtruar në kapitullin e VII-të, për të shmangur fenomenin e "mos kalimit të klasës", rekomandoj të ndryshohet pika 1 e nenit 5 të këtij ligji duke e shtrirë moshën e qëndrimit në institucionet rezidenciale deri në mbushjen e moshës madhore dhe të shfuqizohet fjalia e dytë e pikës 1 të nenit 5 sepse ndikon negativisht në të ardhmen e fëmijës duke cënuar indirekt interesin më të lartë të fëmijës.

- Trajtimi financiar i familjeve që birësojnë fëmijë, apo përjashtimi nga pagimi i disa taksave apo tarifave të ndryshme (psh. tarifa e studimeve), për një periudhë të caktuar kohore, që mund të shtrihet deri në mbushjen e moshës madhore të të birësuarit ose deri në moshën 25 vjeçare nëse vazhdon studimet, do ndikonte në uljen e numrit të fëmijëve të institucionalizuar, uljen e kostove për krijimin dhe menaxhimin e shtëpive-familje dhe ç'është më e rëndësishmja fëmija do rritej në një familje të vertetë.

- Forcimi i mekanizmave kontrollues në institucioneve shtetërore dhe gjyqësore do ndikonte në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në mënyrë indirekte dhe në rritjen e numrit të aplikantëve për të birësuar.

***

Në fund dëshiroj ta mbyll me një shprehje të Prof.Dr. Arta Mandros:

*" Ligjit i japim jetë ne, në qoftë se nuk do t'i jepnim ne jetë, atëherë ligji do të ishte i vdekur; thjesht një gjë e shkruar dhe e harruar"*[167]

[167] Referat i mbajtur nga A.Mandro, në seminarin "Në radhë të parë njeriu", Qendra Horizonte te Reja, Dhjetor 2013

# BIBLIOGRAFIA

## LITERATURË PARËSORE:

### Legjislacioni ndërkombëtar


1. Deklarata e të Drejtave të Fëmijëve
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
3. European Social Charter (revised), Conclusions (2007), volume 2, Council of Europe Publishing, Strasbourg
4. Karta Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqënien e Fëmijës
5. Karta Arabe mbi të Drejtat e Njeriut, 2004
6. Karta Europiane Sociale, 1996
7. Karta Themelore të të Drejtave në BE
8. Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut, 1987
9. Konventa e Hages 1993 "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit"
10. Konventa e Hages 1996 "Mbi marrëdhëniet me fëmijën"
11. Konventa Europiane "Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve"
12. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
13. Konventa Europiane për Birësimin e Fëmijëve 1967 ndryshuar në 2008
14. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
15. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe LiriveThemelore, 1950
16. Konveta e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës

17. Ligji 149/2001 “Disciplina dell’adozione e dell’ affidamento dei minori”

18. Ligji 184/83 “Diritto del minore ad una famiglia”

19. Parliamentary Assembly Resolution 1995 (2014) “Ending child poverty in Europe”

20. Rekomandimi (2005)5 i Këshillit të Europes për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionet Rezidenciale

21. Rekomandimi i Asamblesë Parlamentare 1443, mbi birësimin ndërvendas: për respektimin e të drejtave të fëmijëve, 26 janar 2000

22. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 45/113 (Rregullat e Havanës) datë 14 dhjetor 1990

23. Rregullat për Standartet Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë së të Miturve (Rregullat e Pekinit) 1985

24. Rregullat Standart Minimum lidhur me Masat për mos-arrestimin (Rregullat e Tokios), 1990 (aplikohen për të rritur dhe fëmijë)

25. Standartet Minimale për Trajtimin e Burgosurve, OKB, (1955)

26. The Massacusetts Adoption of Children Act, 1851

27. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimeve të të Miturve, (Rregullat e Riyadh), 1990

28. Udhëzimet për Veprimet ndaj Fëmijëve në Sistemin e Drejtësisë Penale (Aneks i Rezolutës 1997/30 të Kombeve të Bashkuara), (Udhëzimet e Vjenës), 1997

29. Udhëzuesi drejt një Drejtësie Miqësore për Fëmijët, KiE, 2011

UNICEF, (2009), Raport Alternativ i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (2005 – 2009), Pegi, Tiranë

**Legjislacioni shqiptar (ligje/akte nënligjore)**

1. Kodi Civil i 1929
2. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013
3. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 dhe ndryshuar me ligjet nr.8431, datë 14.12.1998; nr.8491, datë 27.5.1999; nr.8535, datë 18.10.1999; nr.8812, datë 17.5.2001; nr.9953, datë 14.7.2008, nr.10 052, datë 29.12.2008, nr.49/2012; 122/2013; 160/2013
4. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995
5. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (Ndryshuar me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007; ligjin nr.9904, datë 21.4.2008; me ligjin nr.88/2012, datë 18.9.2012, me ligjin nr.137/2015, datë 17.12.2015
6. Ligji 4020, datë 23.06.1965 "Mbi Kodin e Familjes të Republikës Popullore të Shqipërisë",
7. Ligji 6599, datë 29.06.1982 "Kodi i Familjes i Republikës Popullore të Shqipërisë"
8. Ligji 8153 datë 31.10.1996 "Për Statusin e Jetimit
9. Ligji 8389 dt 5.8.1998 "Për Shtetësinë Shqiptare"
10. Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjet Nr. 7932, datë 17.05.1995; Nr. 8286, datë 16.02.1998; Nr. 8392, datë 02.09.1998; Nr. 8575, datë 03.02.2000; Nr. 8776, datë 26.04.2001; Nr. 8852, datë 27.12.2001; Nr. 8889, datë 25.04.2002; Nr. 9058, datë 20.03.2003; Nr. 9114, datë 24.07.2003; Nr. 9377, datë 21.04.2005; Nr. 9498, datë

03.04.2006; Nr. 9600, datë 27.07.2006; Nr. 9708, datë 05.04.2007; Nr. 9768, datë 09.07.2007; Nr. 10070, datë 05.02.2009; Nr. 10447, datë 14.07.2011; Nr. 13/2014, datë; Nr. 104/2014, datë 31.07.2014

11. Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"
12. Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"
13. Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 "Për Procedurat E Birësimit Dhe Komitetin Shqiptar Të Birësimit", ndryshuar me ligjin nr. 10358, datë 16.12.2010 dhe nr. 132/2015, datë 5.12.2015)
14. Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011 Për të Drejtën Ndërkombëtare Private
15. Ligji nr.1037, dt.04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"
16. Ligji nr.602, datë 19.5.1948 "Mbi adoptimin"
17. Ligji nr.6340, datë 26.6.1981 Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë
18. Ligji nr.9062, datë 8.05.2003 i ndryshuar në 2012, ndryshuar me ligjin 134/2015, datë 5.12.2015 "Kodi i Familjes"
19. VKM Nr. 425, datë 27.6.2012 "Për Përcaktimin e Kritereve dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Pranimin e Personave eë Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, Të Përkujdesjes Shoqërore".
20. VKM nr. 659, 17.10.2005, "Për Standartet e Sherbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për Fëmijë në Institucionet Rezidenciale"
21. VKM nr. 89, datë 26.1.2012 "Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe të procedurës së shërbimit të kujdestarisë".

**Legjislacion i huaj**


1. Adoption Act 1926, Mbretëria e Bashkuar
2. Akti Anglez i birësimit 2002
3. Dokumentet Nuzi
4. Kodi Civil Austriak- Allgemeines bürgerliches Gesetzbuch (ABGB), 1812, i azhornuar
5. Kodi Civil Francez- 1804, i azhornuar
6. Kodi Civil Italian- 1942, i azhornuar
7. Kodi i Hamurabit
8. Kodi i Justinianit
9. Ligji 149/2001 "Disciplina dell'adozione e dell' affidamento dei minori"
10. Ligji 184/83 "Diritto del minore ad una famiglia"
11. The Massacusetts Adoption of Children Act, 1851


**LITERATURË DYTËSORE:**

**Literaturë e huaj**


1. Altuna, A., & Suárez, M. (Eds.) (2013). Rethinking Citizenship: New Voices in Euroculture. Groningen: Euroculture consortium, Hollandë
2. Avi G. Haimowitz, (2015), "Heredity Versus Environment: Twin, Adoption, and Family Studies", Instituti teknologjik Rochester, New York

3. Babb, L. (1999), “Ethics in American Adoption", Westport, Connecticut: Bergin & Garvey
4. Barcons Natalia, Albert Fornieles and Carme Costas, (2011), “Psychological adaptation of adopted children examined in Spanish study”, Spanish Journal of Psychology, Spanjë
5. Bashkimi Ndërparlamentar dhe UNICEF, (2005), “Lufta kundër trafikut të fëmijëve”, Manual për parlamentarët, SADAG S.A., Francë
6. Bauböck Rainer, Perchinig Bernhard & Sievers Wiebke, (2009) “Citizenship Policies in the New Europe”, Amsterdam University Press, Hollandë
7. Beard John Relly, (1847), “The people’s dictionary of the Bible”, Londër
8. Borzova Olga, (2015) “Legislation and practice of the removal of children from their families in Council of Europe member States”, Social Services in Europe, Asambleja Parlamentare
9. Bos, Henny M. W.; Knox, Justin R. MPH; van Rijn-van Gelderen, Loes PhD; Gartrell, Nanette K. MD, (2016) “Same-Sex and Different-Sex Parent Households and Child Health Outcomes: Findings from the National Survey of Children's Health”, Journal of Developmental & Behavioral Pediatrics, volumi 37
10. Breasted, James Henry (2003) “Ancient Time or a History of the Early World”, Part 1., Kessinger Publishing, Boston
11. Brulard Yves, Dumont Létitia, (2007) “Comparative study relating to procedures for adoption among the member states of the European Union, practical difficulties encounteres in this field by European citizens within the context of the European

Pillar of the justice and civil matters and means of solving these problems and of protecting children's rights", Komisioni Europian

12. Cantwell N. & Holzscheiter A. (2008) "Children deprived of their family environment', A commentary on the United Nations Convention on the Rights of the Child, Martinus Nijhoff Press, Boston

13. Carro, J. L. (1994-1995), "Regulation of intercountry adoption: Can the abuses come to an end"? Hastings International and Comparative Law Review, San Francisco, California

14. Child on Europe, Form for the compilation of good practises in the post adoption phase for the Seminar on post adoption Art.9 c), Hague Convention Firence, 26 Janar 2006

15. Claude Hermann Walter Johns (1910) Babylonian Law-The Code of Hammurabi. Edicioni i 11-të i Encyclopedia Britannica

16. Clothier Florence, (1943) "The Psychology of the Adopted Child," Mental Hygiene, Boston

17. Cournil C & Reico M., (2009), "Le regroupement familial: cadre général et beneficiares, in Actualité juridique de la Famille", Paris

18. Daniels, Denise., & Plomin, Robert. (1985) "Origins of individual differences in infant shyness", Developmental Psychology, http://psycnet.apa.org/?&fa=main.doiLanding&doi=10.1037/0012-1649.21.1.118

19. Davies, W. W. (2003) "Codes of Hammurabi and Moses", Kessinger Publishing, SHBA

20. Fortin Jane, (2009), “Children's Rights and the Developing Law”, botimi 3-të, Cambridge University Press, Mbretëria e Bashkuar

21. Freema Michael, (2007), “A commentary on UN Convention on the Rights of Children, article 3, The Best Interest of the Child”, Universiteti College London, Londër

22. Frost N. and Stein, M. (1989) “The Politics of Child Welfare: Inequality, Power and Change”, Harvester Wheatsheal, Londër

23. Galgano Francesco, (1992), “Diritto Privato”, CEDAM, Padova

24. Galgano Francesco, (2006), “E drejta private” botim i tretë, perktheu nga origjinali italisht Alban Brati, Luarasi University Press, Tiranë

25. Gaudement Jean, (2000), “Droit Prive romain”, botimi i dytë, Montchrestien

26. Glynn Claire Fenton, (2015) “Adoption without consent”, Directorate General for Internal Policies, Policy Department C: Citizens’ rights and Constitutional Affairs, Bruksel

27. Gomien Donna, (2005), “Udhëzues i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut”, Gent Grafik, KiE, Strasbourg

28. Goody Jack (1969), “Adoption in Cross-Cultural Perspective, Comparative Studies in Society and History”, Londër

29. Hillis Lisa (2008), “Intercountry Adoption Under the Hague Convention: Still an Attractive Option for Homosexuals Seeking to Adopt”, Global Leg. Stud, Universiteti Indiana, SHBA

30. Horne Charles, (1915) The Code of Hamurabi, ribotim i Forgotten books (2007)

31. HouhouYamina, (2014) “La Kafala en droit Algerien e ses effets en droit français”, Universite de Pau et des Pays de l’Adour, tezë doktorature, Francë
32. Houlihan Lindsey Grey, (2010), “Child attachment at adoption and three months”, tezë doktorature, Universiteti Case Western Reserve
33. Huebner Sabiner, (2013) “The family in Roman Egypt, A comparative approach to intergenerational solidarity and conflict”, Cambridge University Press, Londër
34. Idem, (1950), “L’adoption d’Octave, Mél.de Visscher IV”, Bruksel
35. Kaldal Anna & Leviner Pernilla, (2010) “Silencing the Conflict of Interests between Parental Rights and the Rights of the Child”, Instituti Stockholm për të drejtën skandinave, Stockholm
36. Kelly D., Weisberg & Susan Frelich Appleton, (2006) “Droit general de l’union europeenne, Paris
37. Killerby M., (1995), “The draft European Convention on the Exercise of Children’s Rights”, International Journal of Children’s Rights, SHBA
38. Kohm Lynne Marie, (2009) “Tracing the Foundations of the Best Interests of the Child Standart in American Jurisprudence”, Universiteti Regent, Fakulteti drejtësisë, SHBA
39. Kothari, Jayna, “The Child’s Right to Identity: Do Adopted Children have the Right to know their Parentage”?, www.cry.org data aksesit 09.08.2016
40. Lammers Meredith, (2008) “The Culture of Adoption in the United States as Compared to France and Belgium”, Universiteti Shtetëror i Ohios, SHBA
41. Loreti Beghé Adriana, (1996) “Internal and intercountry adoption laws”, edituar nga International Social Service, Gjenevë

42. Maarten Pereboom, "The European Union and International Adoption, Center for Adoption Policy", Universiteti Salisburny, Maryland
43. Marc Van De Mieroop, (2005) "King Hammurabi of Babylon: A Biography", Blackwell Publishing, Londër
44. Mary Lyndon Shanley, (2002), Making Babies, Making Families: What Matters Most in an Age of Reproductive Technologies, Surrogacy, Adoption, and Same-sex and Unwed Parents, Beacon Press, SHBA
45. Morin Michel, (1986), "L'adoption, régime juridique avec formules d'application", edicioni i 3, Paris
46. Nejat Karen Rhea Nemet, (1998) "Daily Life in Ancient Mesopotamia", Greenwood Press Westport, Connecticut
47. Oxford Dictionary of Law, edituar nga Elizabeth A. Martin, New York, 2003
48. Parsi B., (1963),"Désignation et investiture de l'empereur romain 1e et 2e siècle ap.J.C", Paris
49. Patel Tina, (2004) "Trans-racial Adoption, A study of race, identity and policy", Tezë doktorature, Universiteti i Sheffield, Angli
50. Pati Jagannath, (2007), "Adoption: Global Perspektive and Ethical Issues", New Delhi, Indi
51. Patterson Charlotte & Jennifer L. Wainright, (2007) "Adolescents with Same-Sex Parents: Findings from the National Longitudinal Study of Adolescent Health, Universiteti i Virxhinias, SHBA

52. Paul Sullins, (2015), Emotional Problems among Children with Same-Sex Parents: Difference by Definition", British Journal of Education, Society and Behavioural Science 7(2), Britani e Madhe
53. Paulissian Robert, Adoption in Ancient Assyria and Babilonia http://jaas.org/edocs/v13n2/Paulissia1.pdf data aksesit 13 nëntor 2014
54. Pearl D. & Menski W., (1998) "Muslim family law", botimi i 3-të, Sweetand Maxwell, Londër
55. Pesle O., (1919) L'adoption en droit musulman, tezë doktorature, Université d'Alger, Algjeri
56. Plomin, R., DeFries, J. C., McClearn, G. E., & Rutter, M. (1997). "Behavioral genetics" (botimi 3-të), Freeman, New York
57. Prévost, (1949) "Les adoptions politique à Rome sous la Republique et le Principat", Paris
58. Regnerus Mark, (2012), "How different are the adult children of parents who have same-sex relationships? Findings from the New Family Structures Study," Social Science Research Vol 41, online http://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0049089X12000610
59. Rejou J., (2003)"Le Bible de l'Adoption", Botimi I-rë, Paris
60. Roagna Ivana, (2012) "Mbrojtja e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut", Doracakët për të Drejtat e Njeriut Këshilli i Europës, Strasburg (përkthim në shqip)
61. Ruzik Anna, (2008) "Adoptions in the European Union", Centre for Social and Economic Research, Poloni

62. Selman Peter (shkurt 2012) “Global Trends in Intercounrty Adoptions 2001-2010”, Këshilli Kombëtar për Birësim, SHBA
63. Stephen M. Cretney (1984), Princliples of Family Law, botimi i 4-t, 1984
64. Studim i Universitetit Stanford, (2010) “Nontraditional Families and Childhood Progress Through School”, Kaliforni
65. Studim i Universitetit të Kalifornisë-San Francisko, Universitetit të Kalifornisë-Los Angjeles dhe, Universitetit të Amsterdamit, publikuar në Pediatrics (2010)“U.S. National Longitudinal Lesbian Family Study: Psychological Adjustment of 17-Year-Old Adolescents”
66. Studimi i Universitetit Tufts, (2010) Qendra Mjekësore Boston dhe Komitetit për Aspektet Psikologjike të Fëmijës dhe Shëndetit të Familjes, publikuar në Pediatrics, “Promoting the Well-Being of Children Whose Parents Are Gay or Lesbian”
67. The children Act 1989 guidance and regulations, (2015) volumi 2: care planning, placement and case review, Department of Education, Mbretëria e Bashkuar
68. Thelma Chedgzsey Smith-McKeever (2002), “African American Adoptions: An Exploratory Study of Post-Adoption Outcomes Among African American Adoptive Families”, tezë doktorature, Universiteti i Teksasit, Austin
69. Turner, S. and Taylor, J. (1996) Under-Explored Issues in Transracial Adoption, Joumal of Black Psychology, SHBA
70. Usang M Assim, (2014) “Islamic kafala as an alternative care option for children deprived of a family environment”, African Human Rights Law Journal, Afrika e Jugut

71. Vries Yloid, (2003) “Adoption becoming easier for gays, CBS, Concerned Women for America”, SHBA
72. Wadlington Walter, (1969), “Adoption of adults a Family Law Anomaly”, Cornell Law review, volumi i 54, botimi 4-t
73. Weaver Ann, (1999), “Addressing Psycho-Social Implications in Social Policy: The Case of Adoption and Early Intervention Strategies”, Universiteti i Viktorias Uellington
74. Weil, R. H. (1984). International adoptions: The quiet migration. International Migration Review, 18(2), SHBA
75. Zbatimi i të drejtave të Njeriut në Praktikë, Manual Trajnimi për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut, (2015) Fondacioni SLYNN, Londër, Mbretëria e Bashkuar

**Literaturë shqiptare**

1. Aliu Abdullah, Gashi Haxhi, (2007) “E drejta familjare”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
2. Anastasi A, (2006), “Histori Institucionesh”, ribotim, Pegi, Tiranë
3. Canaj Erjona, Bana Sokol, (2014), “E drejta e Bashkimit Europian”, Onufri, Tiranë
4. Doracak Trajnimi për Avokatët në Fushën e Drejtësisë për Fëmijë, Tetor, 2012
5. Gashi Haxhi, Aliu Abdullah, Vokshi Adem, (2012), “Komentar, Ligji për familjen i Kosoves”, botim i parë, Deutsche GEsellschft für Internationake Zusammenarbeit GIZ GmbH
6. Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës, studim krahasues, Qëndra e Sherbimeve dhe Praktikave të Integruara, online:

https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Albanian%20Legislation%20%26%20Child%20Rights%20Convention.pdf

7. Legjislacioni Shqiptar dhe Konventa e të Drejtave të Fëmijës, Studim krahasues, Qendra e Sherbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
8. Mandro Arta, (2009), "E drejta Familjare", Emal, Tiranë
9. Mandro-Balili Arta, (2014), "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore", Shkolla e Magjistratures & UNDP, Tiranë
10. Omari Sonila, (2010), "E drejta Familjare", Botimet Morava, Tiranë
11. Peto Zhaklina, (2011), "E drejta e sigurimeve shoqërore", Adelprint, Tiranë
12. Sufaj Femi, (2011), "Sistemi i Drejtësisë për të mitur në Shqipëri, Revista Shqiptare për Studime Ligjore, Volumi 1
13. Zyberi Gentian, (2011), "E drejta Ndërkombëtare e të drejtave të Njeriut", BOTART, Tiranë

**Raporte dhe Dokumente Strategjikë**

1. Achermann Alberto, Achermann Christin, D'Amato Gianni, Kamm Martina, Von Rütte Barbara, (korrik 2013) "EUDO Citizenship Observatory, Country Report: Switzerland", Robert Schuman, Centre for Advanced Studies
2. European Social Charter (revised), Conclusions (2007), volume 2, Council of Europe Publishing, Strasbourg
3. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Raport për Projektligjin "Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 9062, Datë 8.5.2003, "Kodi i Familjes", Tiranë 27.11.2015

4. Loloçi Krenar, (2012) Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity Legal Report: Albania, COWI, Instituti danez për të drejtat e njeriut
5. Sherbimi Social Ndërkombëtar, seksioni italian, "E drejta e fëmijës për t'u rritur në një familje", Udhëzues për ndërhyrjen në birësimin kombëtar e ndërkombëtar dhe në kujdestarinë familjare
6. Strategjia Kombëtare për Fëmijët, miratuar me VKM nr.368, datë 31.05.2005
7. Tamo Adem, Karaj Theori, (2006) "Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri", Qendra e Zhvillimeve Humane, Raport studimor i financuar nga UNICEF, Tiranë
8. Qendra Ndërkombëtare e Referimit për Mbrojtjen e Minoreve në Birësim, Sherbimi Social Ndërkombëtar, Seksioni Italian, (1999), "Të drejtat e fëmijëve në birësimin kombëtar dhe ndërkombëtar"
9. The Rights of Children in Italy, Perspectives in the third sector", (2001) Suplementary Report to the United Nations, Romë
10. The rights of children in Italy", (2001) Supplementary report to the United Nations, working group on the Convention on the rights of the child, Romë
11. United Nations Children's Fund (UNICEF), (2015) The Regional Office for CEE/CIS, "Children's Equitable Access to Justice, Central and Eastern Europe and Central Asia", Gjenevë
12. Vlerësim i shërbimeve të kujdesit ndaj fëmijës dhe i institucioneve për fëmijët pa kujdes prindëror", (2005), National Albanian Center for Social Studies, Raport studimor i financuar nga UNICEF

13. “20 years of the 1993 hague convention assessing the impact of the convention on laws and practices relating to intercountry adoption and the protection of children,” Zyra Permanente, 2015
14. Council of Europe Achievement in the field of law, (2008) “Family Law and the Protection of Children”, Secretariat of the Directorate of Human Rights and Legal Affairs (DG-HL), Strasburg
15. Council of Europe Strategy for the rights of the child (2016-2021), 2 mars 2016
16. OSCE, Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, (2010), “Procedura për birësimin e fëmijëve në Kosovë”, Prishtinë

**Artikuj dhe Konferenca Shkencore**

1. Berro-Lefevre Isabelle, (2009) “The case law of the European Court of Human Rights concerning adoption”, Challenges in adoption procedures in Europe, 2009
2. Bisha Eugena (2015), “Adoption in ancient times”, European Science Review, Vienë, Austri
3. Bisha Eugena, (2016), “The 2008 European Convention on children adoption, changes it brought different from 1967 Convention”, artikull shkencor, European Journal of Law and Political Sciences, Vienë, Austri
4. Bisha Eugena, (2016)“The International Legal Framework on the rights of children”, Konferenca IACS , Madrid, Spanjë

5. Canaj Erjona, (2011), “Bashkimi familjar nën dritën e zhvillimeve të reja europiane”, Jus&Justicia 7, UET Press, Tiranë
6. Dambach Mia, (2009) “The child’s consultation and consent in adoption” Challenges in adoption procedures in Europe”: Ensuring the best interests of the child, Joint Council of Europe and European Commission Conference, conference proceedings, Strasbourg
7. De Boer Maud, (2009) “Challenges in adoption procedures in Europe: Ensuring the best interests of the child, Joint Council of Europe and European Commission Conference”, conference proceedings, Strasbourg
8. Dibra Denada, (2012) “Mbështetja ndaj familjes e fëmijëve-prioritet i reformave të programeve të mbrojtjes sociale”, Konferenca Shkencore “Dhuna kundër fëmijëve në Shqipëri”, PEGI, Tiranë
9. Hazizaj Altin, (2012), “Mekanizmi i Ankesave për mbrojtjen e adoleshenteve LGBT nga dhuna dhe diskriminimi në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri” Konferenca Shkencore “Dhuna Kundër Fëmijëve”, Tiranë
10. Hubing Bridget M., (2014), “International Child Adoptions: Who Should Decide What Is in the Best Interests of the Family”, 15 Notre Dame J.L. Ethics & Pub. Pol'y
11. Lamçe Juelda, (2013) The rights and obligations of spouses in Islamic Classic Law, Iliria International Review, Prishtinë, Kosovë
12. Lamçe Juelda, Çuni Enarda, (2013) “The Right of the Children to know their origin in Adopting and Medically Assisted Reproduction”, Mediterranean Journal of Social Sciences, MCSER-CEMAS-Sapienza University of Rome

13. Lamçe Juelda, Vasjari Arjan, (2014), "Mbrojtja e të miturve nëpërmjet institutit islamik të 'kafala', pasojat e tij në vendet e BE-së", Jus&Justicia, Revistë shkencore e fakultetit juridik, UET Press, Tiranë
14. Likaj Brikena, (2012), "Mbrojtja shoqërore dhe parandalimi i abuzimit të fëmijës", Konferenca Shkencore "Dhuna kundër Fëmijëve në Shqipëri", PEGI, Tiranë
15. Lowe N. V, (2009) "The child's legal status in adoption", Challenges in Adoption Procedures in Europe, Ensuring the best interests of the child, Strasburg
16. Russet Cynthia, (2012), American Adoption, A brief History", Adoption by Lesbians and Gay Men, a New Dimension in Family Diversity, Oxford University Press, New York
17. Shegani Altin, (2012) "Dhuna ndaj fëmijëve në kontekstin familjar", (konferencë shkencore), Tiranë
18. Sloan Brian, (2009) "The consent of the birth parents to the adoption", Challenges in adoption procedures in Europe: Ensuring the best interests of the child, Joint Council of Europe and European Commission Conference, brochure conference proceedings, Strasburg
19. Spiezia Christina, (2013), "In the Courts: State Views on the Psychological-Parent and De Facto-Parent Doctrines", Children's Legal Rights Journal, Volumi 33, Chicago
20. Selmani Arta, (2008) "Adoptimi- Mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër dhe pa përkujdesje prindërore sipas legjislacionit të RM-së", Konferenca: Çështje të adoptimit në Maqedoni-RSHSL, Maqedoni

**Vendime të Gjykates Europiane të Drejtave të Njeriut (ECtHR)**


1. Chbihi Loudoudi dhe të tjerë kundër Belgjikës, nr. 52265/10, datë 16.12.2014
2. E.B kundër Francës, nr. 43546/02, datë 22.1.2008
3. Frétte kundër Francës, nr. 36515/97, datë 26.2.2002
4. Gas dhe Dubois kundër Francës, nr. 25951/07, 15.03.2012
5. Godelli kundër Italisë, nr. 33783/09 datë 18.03.2013
6. Görgülü kundër Gjermanisë, nr. 74969/01 datë 26.05.2004
7. Harroudj kundër Frances, nr. 43631/09, datë 04.10.2012
8. Keegan kundër Irlandës, 18 EHRR 34, 26 maj 1994
9. Krisztian Barnabas Toth kundër Hungarisë, 48494/06, datë 12.02.2013
10. Kroon kundër Hollandës, nr. 00018535/91 datë 27 tetor 1994
11. Qama kundër Shqipërisë dhe Italisë, nr. 4604/09, datë 08.01.2013
12. Negrepontis Giannisis kundër Greqisë, nr. 56759/08, 09.04.2014
13. Odièvre kundër Francës, nr. 42326/98, datë 13.02.2003
14. Pini kundër Rumanisë, nr. 27110/95, datë 22.09.2004
15. Pla dhe Puncernau kundër Andorës, nr. 69498/01 datë 13.07.2004
16. Salgueiro Da Silva Mouta kundër Portugalisë, nr. 33290/96, datë 21.12.1999
17. Schalk dhe Kopf kundër Austrisë, nr. 30141/04, 24.06.2010
18. Sommerfeld kundër Gjermanisë, nr. 31871/96, datë 08.07.2003
19. Söderbäck kundër Suedisë, nr. 113/1997/897/1109, 28.10.1998
20. X, Y dhe Z kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 75/1995/581/667, 22.04.1997
21. X. dhe të tjerë kundër Austrisë, nr. 19010/07, 19.02.2013

**Vendime të Gjykatave të huaja**

1. Vendimi nr. 732, Gjykata e Apelit Romë, 3 korrik 1993
2. Vendim i Gjykatës së Apelit të Lionit, nr.10LY01740, datë 22 shkurt 2011
3. Çështja Gouardo, Gjykata e Apelit Paris, 18 prill 2008

**Praktika gjyqësore shqiptare**

1. Vendimi nr. 115, Gjykata e Apelit Tiranë, datë 12.09.2012
2. Vendimi nr. 224, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, datë 20.05.2014
3. Vendimi nr. 2754, Gjykata e Shkallës së Parë te Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 04.04.2016
4. Vendimi nr. 342, Gjykata e Lartë, datë 27.10.2009
5. Vendimi nr. 6209, Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, 13.07.2016
6. Vendimi nr. 667, Gjykata e Apelit Tiranë, datë 03.02.2016
7. Vendimi nr. 838, Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 09.02.2016
8. Vendimi nr.179, Gjykata e Lartë, datë 02.04.2015

**Burime Interneti & media**

1. http://www.debatingeurope.eu/focus/arguments-gay-adoption/#.V5qSMVKKTIU data aksesit 29.07.2016
2. http://austria.usembassy.gov/adoption.html data aksesit 10.12.2015
3. http://echr-online.info/right-to-family-life/ data aksesit 13.06.2015

4. http://edition.cnn.com/2013/09/16/world/international-adoption-saving-orphans-child-trafficking/
5. http://healthland.time.com/2013/11/04/the-dark-side-of-cleaning-up-international-adoptions-kids-are-left-in-orphanges-longer/ data aksesit 20.03.2015
6. http://irishbarrister.com/citizenship.html
7. http://pages.uoregon.edu/adoption/topics/adoptionhistbrief.htm data aksesit 23.08.2014
8. http://pages.uoregon.edu/adoption/topics/adoptionhistbrief.htm data aksesit 03.02.2014
9. http://reformanedrejtesi.al/aktivitet/drejtesia-e-te-miturve-ne-fokus-te-konsultimit-publik-per-reformen-ne-sistemin-e-0 data aksesit 24.07.2016
10. http://www.adoptionbirthmothers.com/a-comparison-in-adoption-the-united-states-vs-europe/ parë me dt.02.04.2016
11. http://www.aleancalgbt.org/edukim data aksesit 30.07.2016
12. http://www.anidoadoption.org/en/programs/austria data aksesit 16.11.2015
13. http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/të-drejtat-e-fëmijëve data aksesit 19.06.2016
14. http://www.balkanweb.com/site/skandal-ne-shtepine-e-foshnjes-ne-durres-kujdestarja-dhunon-femijen-3-vjecar-reagon-ministri-klos data aksesit 02.04.2016
15. http://www.bbinternationaladoption.com/single-parent-adoption data aksesit 27.06.2016
16. http://www.biblearchaeology.org/post/2006/02/27/Great-Discoveries-in-Biblical-Archaeology-The-Nuzi-Tablets.aspx

17. http://www.cbsnews.com/news/adoption-becoming-easier-for-gays/ data aksesit 12.07.2014

18. http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/treaty/202

19. http://www.debatingeurope.eu/focus/arguments-gay-adoption/#.V5qSMVKKTIU data aksesit 29.07.2016

20. http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Parental data aksesit 25.07.2016

21. http://www.jewishvirtuallibrary.org/jsource/judaica/ejud_0002_0001_0_00486.html dt07/12/2014

22. http://www.jus.unitn.it/cardozo/review/Persons/Marella1.html data aksesit 24.04.2016

23. http://www.jus.unitn.it/cardozo/review/Persons/Marella1.html data aksesit.24.04.2016

24. http://www.migrationsverket.se/English/Private-individuals/Becoming-a-Swedish-citizen/Citizenship-for-children/Automatic-citizenship.html data aksesit 27.03.2016

25. http://www.parentalrights.org/index.asp?Type=B_BASIC&SEC=%7B485B7DA5-CCC2-4A61-94D7-E73763D3945E%7D data aksesit 31.07.2016

26. http://www.researchetcinc.com/historyofadoption.html data aksesit 06.03.2014

27. http://www.sherbimisocial.gov.al/cfare-jane-ipsh-2/ data aksesit 13.07.2016

28. http://www.thelocal.it/20140624/1900-children-languish-in-italys-adoption-system data aksesit 24.04.2016

29. http://www.thelocal.it/20140624/1900-children-languish-in-italys-adoption-system data aksesit 24.04.2016

30. https://travel.state.gov/content/adoptionsabroad/en/about-us/statistics.html data aksesit 15.08.2016
31. https://travel.state.gov/content/adoptionsabroad/en/country-information/learn-about-a-country/austria.html data aksesit 20.09.2015
32. https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 data aksesit 10.04.2016
33. http://www.aleancalgbt.org/edukim/5-orientimi-seksual-dhe-homoseksualiteti data aksesit 28.07.2016
34. http://www.yogyakartaprinciples.org/principles_en.htm data aksesit 23.08.2016
35. https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 dt.12.04.2016
36. https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P227_15126 https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1780157&direct=true#P232_15857 data aksesit 05.03.2016
37. https://www.e-albania.al/sherbimi.aspx data aksesit 01.06.2016
38. https://www.gov.uk/government/publications/guidance-on-hoë-adopted-children-can-become-british/intercountry-adoption-and-british-citizenship#adoption-in-the-uk data aksesit 25.03.2016
39. www.coe.int data aksesit 25.04.2016
40. http://www.aleancalgbt.org/edukim data aksesit 30.07.2016
41. The Superior Court of California http://www.scscourt.org/self_help/probate/adoption/adoption_adult.shtml data aksesit 21.08.2016

42. http://europa.eu/youreurope/citizens/family/children/adoption/index_en.htm data aksesit 10.09.2016

43. European Parliament, Adoption: Cross-border Legal Issues and Gaps in the European Union, 2015, www.europarl.europa.eu/studies

**Media online**

1. BBC News, Sweden legalizes adoptions, (2015) http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/2028938.stm , data aksesit 29 mars
2. Gazeta Shqip, (2016) "Birësimet, tarifat sipas kombësive, 20 mijë lekë – 1 mijë dollar", http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2013/05/26/biresimet-tarifat-sipas-kombesive-20-mije-leke-1-mije-dollare/ ,23 maj
3. Top channel, edicioni informativ kryesor, 02.04.2016
4. The Guardian, (2016) https://www.theguardian.com/world/2016/apr/29/italian-couple-win-same-sex-adoption-case, data aksesit 20 qershor http://www.guardian.co.uk/child/story/0 data aksesit 10.05.2014
5. CNN (2015) http://edition.cnn.com/2013/09/16/ëorld/international-adoption-saving-orphans-child-trafficking/ data aksesit 3 mars
6. Times online, (3 mars 2010), "Catholic adoption agency seeks exemption on gay adoption regulations", data e aksesit 10 korrik 2014

*Shënim: Të gjitha vendimet e GJEDNJ-së të përdorura në këtë punim janë të botuara në bazën e të dhënave në HUDOC* http://hudoc.echr.coe.int/